

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXVI nr. 82 / 2007

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXVI nr. 82 - 2007

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr. Pajazit Nushi,
Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahim, Hamiti,
Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë: **Hajrullah Hoxha***

Lektor: Bislim Berisha

Korrektor: Skender Rashiti

*Realizimi: **Shtëpia Botuese***



Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

Shtyp: Koha - Prishtinë

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXVI nr. 82 / 2007

Prishtinë
2007

EDITORIALI

Mr. Qemajl Morina

**Me rastin e 814 vjetorit të vdekjes
PËRKUJTIMI I SALAHUDIN EL-EJUBIT
(1138-1193)**

Përkujtimi i biografive të figurave historike, të çdo kombi, feje a kulture, është një bazë e fortë në të cilën mbështetet historia e çdo populli. Këto figura trimërojnë dhe u japin kurajë gjeneratave të reja, që edhe ata të ndjekin gjurmët e tyre, nëse dëshirojnë të kenë një jetë me dinjitet sikurse popujt tjerë të botës. Kështu ishte në të kaluarën, kështu është edhe sot.

Historia islame, që shtrihet në një periudhë të gjatë kohore prej më shumë se katërmëdhjetë shekujsh, është e begatshme me figura të këtilla, që lanë gjurmë të pashlyeshme, jo vetëm në historinë islame, por edhe në atë botërore. Në grupin e këtyre figurave më markante, pa mëdyshje, është edhe Salahudin el-Ejubi. Edhe pse nga vdekja e tij kanë kaluar tetëqind e katërmëdhjetë vjet, ai është i pranishëm edhe sot në mendjen e kujtesën e shumë njerëzve, jo vetëm të myslimanëve, por edhe të të krishterëve.

Salahudini u shqua për trimërinë, guximin dhe modestinë e tij në kohët më të vështira që kaluan myslimanët. Kjo ka qenë periudha e shekujve njëmbëdhjetë e dymbëdhjetë, atëherë kur kryqtarët kishin

okupuar zemrën e Botës Islame, përfshirë edhe Jerusalemin, ku gjendet xhamia e tretë e shenjtë e myslimanëve - mesxhidu-l-Aksa, prej nga Pejgamberi a.s. që nisur në rrugëtimin e tij për në qiell, i njohur në historinë islame me emrin “el-Mi’raxh”.

Kalorësit e krishterë kishin mësuar shumë gjëra nga Salahudini. Historianët, si shembull theksojnë se kur kryqtarët morën Jerusalemin në vitin 1099, ata patën vlarë pothuaj të gjithë banorët e tij, saqë gjaku nëpër rrugët e qytetit të shenjtë kishte arritur deri në gjunjë. Ndërsa, kur do ta rimerre qytetin më 4 korrik 1187, Salahudini do të kursente viktimat, duke u dhënë kohë të mjaftueshme që të largoheshin dhe duke u siguruar atyre vendkalime të sigurta.

Pas fitores në Hittin, Salahudini kishte hedhur krejtësisht idenë e hakmarrjes ndaj kryqtarëve, qoftë në masat luftarake për rikthimin e Jerusalemit dhe qoftë me sjelljet e tij ndaj numrit të madh të kryqtarëve të zënë rob, të cilët ishin dorëzuar në qytet. Salahudini u ofroi atyre ndihma gjithfarëshe dhe ndaj tyre pati sjellje njerëzore. Tregoi respekt ndaj të gjithë atyre figurave të larta të kryqtarëve, që ishin dorëzuar para tij, të cilët kishin pasuri të mëdha në bregdetin e Palestinës. Një prej tyre ishte edhe Kontesha e Tripolit, së cilës Salahudini i lejoi të shkonte e shoqëruar nga përcjellësit e saj, për Tripoli, pasi e kishte dorëzuar qytetin e Taberisë. Të gjithë banorëve të qyteteve u lejoi të tërhiqeshin në siguri të plotë derisa të arrinin në Evropë. Mbretëreshës Sibila i lejoi të qëndronte me bashkëshortin e saj – mbretin De Lorian, kurse Poljan, mbreti i qytetit të Nablisit, kishte kërkuar leje të hynte në Jerusalem, sepse gruaja e tij - mbretëresha Maria, dhe fëmijët e saj kishin kërkuar strehim tek ajo në Jerusalem. Salahudini i lejoi atij të hynte në Jerusalem, me kusht që të mos bartte armë me vete dhe të qëndronte vetëm një natë. Por, Poljani nuk e pati mbajtur premtimin, sepse, posa hyri në qytetin e shenjtë, iu bashkua vëllezërve të tij kryqtarë, që ishin kundër Salahudinit. Më vonë Salahudini i nënshtroi ata dhe Poljanin e zuri rob, por në vend që të hakmerrej ndaj tij për shkeljen e premtimit, ai e fali atë dhe siguroi familjen e tij.

Po ashtu Salahudini i fali të gjithë kryqtarët, që nuk kishin mundësi të paguanin taksën e caktuar nga ai, për lirin e tyre. Liroi me

mijëra kryqtarë të zënë rob dhe i detyroi anijet evropiane t'i bartnin ata pa pagesë deri në Evropë. Salahudini pati sjellje tejet njerëzore ndaj pleqve, grave dhe fëmijëve.

Kronisti arab i kohës së Salahudinit, ibnu Shedadi, rrëfen për një shembull mirësie dhe sjelljeje të njerëzishme të Salahudinit, me se ai (Salahudini) kishte treguar kulmin e qytetërimit islam: Një grua e krishterë, pas disfatës së kryqtarëve në Hittin dhe hyrjes së ushtrisë së Salahudinit në Jerusalem, nga paniku dhe rrëmuja e krijuar, kishte humbur foshnjën e saj. Pas shumë përpjekjesh, ajo nuk mundi ta gjente foshnjën, për se kishte alarmuar njerëzit e saj në mesin e kryqtarëve. Ata e patën këshilluar që të shkonte tek Salahudini, duke i thënë se ai ishte shumë i mëshirshëm dhe do të bënte të pamundurën për t'ia gjetur foshnjën. Gruaja, pa humbur kohë, u drejtua te kampi i Salahudinit dhe kërkoi ndihmën e ushtarëve të tij, të cilët e çuan te komandanti Salahudin, i cili, posa mori vesh problemin e saj, u brengos shumë dhe i rrodhën lot. Menjëherë urdhëroi ushtarët të kërkonin foshnjën dhe t'ia kthenin s'ëmës. Pas pak kohe, ushtarët ia kthyen foshnjën nënës, të cilën dikush e kishte shitur. Nëna e mori foshnjën e saj, e përqafoi dhe e shtrëngoi gjatë duke mos u besuar syve të saj. Të gjithë njerëzit që ishin për rreth saj, filluan të qanin. Salahudini urdhëroi që asaj gruajë t'i sigurohej një kalë dhe të përcillej derisa t'i bashkohej grupit të kryqtarëve, të cilët kishin lëshuar Jerusalemin. Edhe ky qe një shembull i sjelljes së heroit të Hittinit.

Është e njohur se, kur myslimanët morën Jerusalemin për herë të parë, Omeri, halifi i dytë i myslimanëve, bëri marrëveshje me patriarkun Sofranios për rregullimin e statusit të jomyslimanëve në qytetin e shenjtë. Këtë marrëveshje Salahudini e zbatoi me përpikëri, pas më shumë se pesëqind vjetësh. Ai u garantoi të krishterëve jetën, pasurinë, kishat dhe kryqet e tyre.

Pavarësisht, se ishte një kundërshtar i fortë ndaj ushtrive të kryqtarëve, Salahudini kishte fituar një respekt të madh në Evropë, si një kalorës bujar dhe i sjellshëm. Marrëdhëniet e tij me mbretin Riçardi i parë, i njohur me llagapin Zemërluani, i cili deshi ta mposhte Salahudin në betejën e Arsufit më 7 shtator 1191, përkshkruhen nga kronis-

tët e kohës me një respekt të ndërsjellë dhe me një rivalitet ushtarak. Me rastin e plagosjes së Riçardit, Salahudini i ofroi atij shërbimet e mjekut të tij personal. Në Arsuf, kur Riçardi humbi kalin e vet, Salahudini i pati dërguar atij dy kuaj. Salahudini, po ashtu i dërgoi edhe pemë të freskëta me akull për t'i mbajtur të ftohta lëngjet.

Në anën tjetër, Riçardi i kishte propozuar Salahudinit, që motra e tij të martohej me të vëllanë e Salahudinit, të cilin e kishte njohur gjatë bisedave për arritjen e marrëveshjes paqësore, dhe Jerusalemi të ishte dhuratë e martesës së tyre.

Salahudini dhe Riçardi, në vitin 1192 nënshkruan marrëveshjen e Remlas, sipas së cilës Jerusalemi do të mbetej nën sundimin e myslimanëve, me kusht, që të ngelte i hapur edhe për pelegrinët e krishterë. Marrëveshja e kufizonte Mbretërinë Latine në një rrip të ngushtë prej Tirit deri në Jaffa.

Salahudini vdiq më 4 mars 1193 në Damask, në moshën 56 vjeç. Kur bashkëpunëtorët e Salahudinit hapën arkën e tij, panë se vlera e të hollave që gjendeshin aty, nuk mjaftonte për kryerjen e ceremonisë së varrimit. Shumicën e të hollave të tij ai e shpërndante për akte bamirësie dhe për armatimin e ushtrisë. Ai u varros në xhaminë e Emevinjve në Damask

Varri i tij vizitohet nga vizitorë të shumtë. Ai është simbol i qëndresës, krenarisë dhe bujarisë islame. Jeta e tij është bërë një mit i vërtetë dhe ajo do të mbetet në kujtimin e shumë brezave e do të përcillet prej një brezi në tjetrin, sepse ai ishte ndërtues i historisë islame në mesjetë, në kohën kur myslimanët ishin në pritje të çlirimit dhe shpëtimit të Jerusalemit, qytet i shenjtë i tyre.

Kjo është arsyeja pse, shtatë shekuj më vonë, kur gjenerali francez Goro hyri në Damask, në vitin 1913, në fillim të Luftës së Parë Botërore, veprimi i parë që do të bënte ai, qe pikërisht vizita e varrit të Salahudin el-Ejubit, ku pati deklaruar: "Ja, ne u kthym përsëri o Salahudin"!

Andaj përkujtimi i Salahudin el-Ejubit në përvjetorin e tetëqind e katërmëdhjetë të vdekjes së tij është një respekt për një figurë historike, e cila rrallë herë mund të përsëritet në histori, për të cilën bota

islame ka nevojë më shumë se asnjë herë më parë. Aq më tepër kur dihet që qyteti i shenjtë i të tri feve më të mëdha të botës, Jerusalemi (Kudsi), është nën okupimin e Izraelit, që nga qershori i vitit 1967. Brezi i ynë pret që në qytetin e shenjtë të tri feve të mbretërojë paqja dhe liria për besimtarët e tri feve monoteiste.

Qemajl Morina

ON THE 814th ANNIVERSARY OF THE DEATH OF SALAHUDDIN AYYUBI (1138-1193)

(Summary)

The commemoration of historical figures is the foundation on which the history of each nation is based. These figures inspire the younger generations to follow their footsteps if they want to live in dignity as the other nations of the world do.

The history of Islam, which covers a period of over 14 centuries, is full of such figures, which left deep traces in the history of Islam as well as that of the world. One of them is Salahuddin Ayyubi. Despite the fact that 814 years have passed since his death, he is still present in the minds and hearts of many people, not only Muslims but Christians as well.

كمال مرينا

بمناسبة مرور 814 عاما على وفاته في ذكرى صلاح الدين الايوبي (1138-1193)

(خلاصة البحث)

إن ذكرى سير الشخصيات التاريخية لكل قوم و دين وثقافة تعتبر ركيزة أساسية يعتمد عليه تاريخ كل شعب من شعوب العالم و الشخصيات المذكورة تعتبر مثالا أعلالا للاحياء الجديدة التي تحرضهم و تحثهم على اتباع خطواتهم اذا أرادوا ان يعيشوا حياة كريمة مثل بقية شعوب العالم. هكذا كان في الماضي و هكذا هو اليوم. ان التاريخ الاسلامي الذي يمتد في فترة تاريخية تزيد عن اربعة عشر قرنا من الزمن أعطى شخصيات تركت آثارا كثيرة ليس فقط على نطاق التاريخ الاسلامي وحده بل على نطاق تاريخ العالم. و من بين هذه الشخصيات العظيمة هو صلاح الدين الايوبي مع انه توفي قبل 814 سنة هو يعيش في خيال الكثير من الناس ليس المسلمين وحدهم بل المسيحيين أيضا.

FRAKSIONE

Nexhat Ibrahimi

HARIXHITËT DHE MURXHITËT – SEKTE TË HERSHME ISLAME

I. Harixhitët

Formimi i harixhitëve

Harixhitët janë sekti më i hershëm filozofik dhe fetaro-politik¹, i cili lidhet drejtpërdrejt me halifin e katërt mysliman, Ali ibn Ebi Talibin dhe çështjen e pranimet të arbitrazhit nga ana e Aliut r.a., të ofruar nga guvernatori i Sirisë, Muavij ibn ebi Sufjan.²

Periodha e parë e harixhitëve karakterizohej me jotolerancë, fanatizëm dhe ekskluzivitet, të manifestuara në politikë përkatëse të ngritur thuajse deri në dogmë, të përcjella me metoda dhune. Disa shkencëtarë sektin harixhit e kanë quajtur sekt të rrezikshëm politiko-religjioz.³

Rëndësia e studimit të sektit harixhit në aspektin ideologjik dhe juridik qëndron, ndër të tjera, edhe për shkak se ata formuluan pyetjet që kishin të bëjnë me teorinë e hilafetit, kurse në aspektin e historisë politike, qëndron në atë se vazhdimisht shqetësonin masën dhe pushtetin me rebelime të shpeshta e fanatike. Po ashtu, me rolin e tyre destruktiv, ndikuan që edhe pa dashur t'i ndihmojnë fitores së Muaviut kundrejt Aliut r.a. dhe fitores së abasitëve kundrejt emevitëve.⁴

Emërtimi

Emri i tyre vetvetiu nuk implikon konotacione doktrinare. Emri *havarixh* është shumësi i fjalës *harixhij* me kuptimin *rebelim, largim, dalje* apo *aktiviteti revolucionar*.⁵ Krahas emrit *harixhit*, të cilin e morën për shkak se në kohën e pritjes së epilogut të arbitrazhit ushtria e Aliut r.a. ishte duke pritur në Kufe, e ky grup, i pakënaqur doli nga Kufa. Për këtë edhe u quajtën harixhij, që ka kuptimin: ata që dolën, ata që shkuan, që u shpëputën nga gjiri i Bashkësisë.⁶

Por, ata quheshin edhe me emra tjerë, si: *Harurijeh*, sipas fshatit Harura, ku u strehuan pas largimit nga ushtria e Aliut r.a., *Muhakkime*, ata që shqiptonin maksimën *La hukme il-la li l-Lah*, dhe *Shurat*, që kishte kuptimin e shitësve, d.t.th. ata që kishin shitur shpirtin për çështjen e Zotit, e të cilin emër ia kishin dhënë vetes.⁷

¹ Filip Hiti, op. cit., fq. 234.

Edhe H. Fahuri - H. Xherr pohon se “harixhitët janë sekti i parë politik dhe fetar që u paraqit në islam”. Sipas: Hana Fahuri - Halil Xherr, *Tarih’ul-felsefeti’l-arabijeti*, I, botimi III, Bejrut, 1993, fq. 137.

² Kharijism—The earliest religious sect of Islam: www.princeton.edu/~batke/itl/denise/kharijis.htm.

³ H. Laoust, op. cit., fq. 43. Abdulbakiy Golpinarli, *Tarih Boyunca islam mezhepleri ve siilik*, botimi II, Kum, Iran, 1411 h./1991, fq. 184.

⁴ N. Smailagic, *Leksikon*, op. cit., fq. 240. Abdulhalim Mahmud, op. cit., fq., 133-138.

⁵ F. Rahman, op. cit., fq. 236.

⁶ Sabir Tuajmeh, *Dirasatun fi’l-firek: Esh-Shi’atu, En-Nusajrijetu, El-Batinijetu, Es-Sufijetu, El-Hawarixhu*, botimi II, Rijad, 1404 h./1983, fq. 127-133.

⁷ N. Smailagic, *Leksikon*, op. cit., fq. 240. Naser Bin Abdul Kerim El-Akli, op. cit., fq. 22-24.

Doktrina e harixhitëve dhe çështje tjera

Disa historianë mendojnë se, nëse nuk llogariten disa veprime ekstremiste e fanatike të pjesëtarëve të këtij sekti, harixhitët konsiderohen mjaft të devotshëm dhe njerëz religjiozë puritanë.⁸

Si shkas për daljen në skenë të harixhitëve ishte *arbitrazhi* (tahkim), të cilën e propozoi Muaviu në Betejën e Siffinit më 37 h./ 26 korrik 657, kurse e pranoi Aliu r.a., ndonëse ishte në pozitë fituese.⁹

Sipas F. Rahmanit, harixhitët deri në këtë kohë ishin në përbërje të shi'itëve, respektivisht në anën e Aliut r.a. Këta njerëz të Osmani r.a. dallojnë periudhën e mirë prej 6 vjetësh dhe atë të keqen prej 6 vjetësh¹⁰, dhe nuk u pajtuan me pranimin e arbitrazhit nga ana e Aliut r.a., sepse ai kishte të drejtë hyjnore, kundrejt mashtimit diplomatik të Muaviut, dhe iu nënshtrua arbitrazhit njerëzor. Ata luftuan kundër Muaviut, të bindur se e drejta është në anën e Aliut dhe të tyre, kurse Muaviun e mendonin për uzurpues të pushtetit dhe rebelues, kundër të cilit duhet luftuar me të gjitha forcat.¹¹ Parulla e tyre ishte se “*La hukme il-la li'l-lah*” (Arbitrimi dhe gjykimi i takon vetëm Zotit) kurse pranimi i arbitrazhit ishte thyerja e legjitimitetit të luftës së tyre dhe se të gjitha sakrificat e deriatëhershme paskan qenë të kota. Duke u nisur nga parimi se besimi dhe dyshimi nuk ecin tok, këta përfundimisht i lëshojnë radhët e Aliut r.a., e shpallin atë për pabesimtar dhe kërkojnë që publikisht të pendohet dhe sërish të përqafojë islamit.¹²

Meqë kjo nuk ndodhi, prej atëherë këta idealistë dhe kryengritës fanatikë u tërhoqën në fshatin Harura afër Kufës dhe zgjodhën udhëheqësit e tyre. Me kalimin e kohës, dhe për shkak të gjendjes kaotike

⁸ F. Rahman, op. cit., fq. 236

⁹ Në Betejën e Siffinit vdiqën rreth 50.000 myslimanë, më shumë se në të gjitha luftërat e deriatëhershme me persianët, bizantinët e të tjerët. Sipas: I. Džananovic, op. cit., fq. 55. F. Hiti, op. cit., fq. 175-177. S. Tuajmeh, op. cit., fq. 134-138 dhe 138-140.

¹⁰ H. Laoust, op. cit., fq. 19.

¹¹ I. Džananovic, op. cit., fq. 56.

¹² Ali Mustafa El-Gurabi, *Tarih'ul-firek'il-islamijjeti ve nesh'et'ul-ilm'il-kelam inde'l-muslimin*, Kajro, 1958, fq. 276, sipas: I. Džananovic, op. cit., fq. 56. Ahmed Emin, *Fexhr'ul-islam*, botimi XIII, Kajro, 1982, fq. 256-258.

në Bashkësinë myslimane, grupi i tyre rritej.¹³ Ata luftuan edhe kundër Aliut r.a., e pas vrasjes së Aliut r.a., edhe kundër Muaviut, edhe kundër emevitëve më pastaj. Aktivitetin e tyre, edhe pse me intensitet më të vogël e kanë vazhduar edhe gjatë abasitëve.¹⁴ Harixhitët, si duket, i ndali Jusuf El-Haxhaxhi, pas luftërave të vazhdueshme.¹⁵

Disa dijetarë mendojnë se harixhitët kanë qenë të manipuluar nga një grup i tretë, që qëndronte i fshehur dhe në prapavijë, e kreu i të cilëve ishte Abdullah ibn Sebe', hebraik që pranoi islamin, por vazhdimisht vepronte kundër myslimanëve. Ai dhe grupimi rreth tij mendohet edhe si nismëtar dhe nxitës i vazhdueshëm i përçarjes ndërmjet myslimanëve në kohën e Osmanit r.a. dhe Aliut r.a.¹⁶

Faktorët e ndarjes nga sunizmi

I. Njëri nga parimet thelbësore të doktrinės së harixhitëve është se ata refuzuan pikëpamjen ortodokse se pozita e halifit duhet të kufizohet në anëtarët e fisit Kurejsh. Ata mendonin se çdo mysliman i mirë mund të zgjidhet në këtë pozitë, madje qoftë ai edhe *rob abesinas*.¹⁷ Me këtë qëndrim harixhitët erdhën në kundërshtim edhe me shi'itët, të cilët pozitën e halifit e shohin vetëm brenda pasardhësve të Aliut r.a.¹⁸ Mirëpo, Aliu r.a., tolerant nga natyra, e duke mos dëshiruar të derdhet gjaku i myslimanëve, shpalli se nuk do të luftojë kundër tyre derisa mësimi i tyre të mbetet brenda kufijve të trajtimit teoretik të rolit të halifit dhe hilafetit. Iu mundësoi vizitimin e xhamive, luftën e përba-

¹³ N. Smailagic, *Leksikon*, op. cit., fq. 240.

¹⁴ S. Tuajmeh, op. cit. 141 e tutje. F. Rahman, op. cit., fq. 237.

“Abasitët, sikur edhe emevitët, qenë të padobishëm për halifatin.” Sipas: Ahmed Emin, *Duha'l-islam*, pjesa III, botimi IX, Kajro, 1978, fq. 336-337.

¹⁵ N. Smailagic, *Leksikon*, op. cit., fq. 241. F. Hiti, op. cit., fq. 198.

¹⁶ N. b. A. El-Akli, *Hauarixhët – grupi i parë i devijuar në historinë e islamit*, Tiranë, 2003, fq. 11.

¹⁷ Sipas: A. Emin, *Fexhr*, op. cit., fq. 258.

Harixhitët liderin / halifin e shihnin në kualitetin shpirtëror dhe personal e jo në afërsinë e gjakut dhe fisit (Kurejshitët) apo të familjes së ngushtë të Pejgamberit a.s.: *Kharijite Islam*: www.globalsecurity.org/military/intro/islam-kharijite.htm.

¹⁸ F. Rahman, op. cit., fq. 238. N. b. A. El-Akli, op. cit., fq. 31 e tutje.

shkët, ndarjen e presë së luftës dhe premtori se i pari nuk do ta përdorë dhunën.¹⁹ Mirëpo, harixhitët nuk u ndalën. Filluan përgatitjet dhe së shpejti zhvilluan Betejën e Nehervanit, në të cilën pësuan humbje të rëndë. Në pamundësi që të luftojnë frontalisht, vendosën të bëjnë atentat kundër Aliut r.a., Muaviut dhe Amr ibn Asit. Pati sukses vetëm sulmi ndaj Aliut r.a..²⁰

II. Parimi tjetër thelbësor që ndikoi në largimin e harixhitëve nga Bashkësia myslimane ishte se a mund të jetë myslimani besimtar pas mëkatit të rëndë, për të konstatuar se besimtari pas bërjes së mëkatit të rëndë nuk është mysliman.²¹ Ata mendojnë se njeriu mund të jetë ose besimtar ose jobesimtar. Për shembull, ai që braktis namazin është jobesimtar, ai që vjedh, pi pije dehëse e të ngjashme, ai nuk është besimtar. Ai që beson, besimin e tij duhet ta provojë me praktikë.²² Sekti i tyre ekstrem i ezrekitëve mendon se ata që janë larguar nga islami njëherë, me fjalë apo veprim, nuk mund të kthehen prapa, kështu që ata duhet të mbyten, bashkë me gratë dhe fëmijët e tyre.²³ Këta përdorin parimin e *isti'radit*, vrasjes fetare. Këtë parim këta kanë filluar ta përdorin edhe para formulimit teorik. Çdo mysliman joharixhit është murted, i rebeluar, heretik dhe si i tillë duhet të mbytet. Por, për çudi, harixhitët kanë qëndrim më të butë kundër jomyslimanëve të feve tjera, duke ua pranuar shehadetin e ndryshuar: “Muhammedi është i dërguar i Zotit për arabët, por jo për ne.”²⁴

¹⁹ Jusuf El-Karadavi, Sheri'at'ul-islam, Bejrut, 1977, fq. 62-63, sipas: I. Džananovic, op. cit., fq. 56.

²⁰ H. Laoust, op. cit., fq. 23 dhe 24. N. Smailagiq përpjekjen për atentat të trefishtë e quan si të dyshimtë. Leksikon islama, op. cit., fq. 240. S. Tuajmeh, op. cit., fq. 144 e tutje.

²¹ F. Rahman, op. cit., fq. 130.

Ndër dijetarët dhe komentuesit më të njohur të rrethit harixhit-ibadit është Muhammed ibn Jusuf Ifejjishi (i lindur në Algjeri, kurse vdiq në Kairo më 1332 h.), i cili nuk dallon nga doktrina e sektit të tij. J. Ramic, op. cit., fq. 201-202.

²² A. M. El-Gurabi, op. cit., 278. A. Emin, Fexhr, op. cit., fq. 259.

²³ F. Hiti, Istorija arapa, bot. II fot., Sarajevë, 1988, fq. 200, fusn. 8.

²⁴ N. Smailagic, Leksikon, op. cit., fq. 241.

Ja një rast mjaft ilustrativ ndërmjet Ebu Hanifes dhe harixhitëve, që do të ndihmonte të kuptohej më qartë doktrina harixhite:

Derisa Ebu Hanife ishte në xhami me nxënësit e tij, hyri vullshëm një grup harixhitësh. Të frikësuar, nxënësit e Ebu Hanifes, filluan të ikin, por Ebu Hanife u tha të mos ikin.

Degëzimi i harixhitëve

Harixhitët ndahen në shumë nëngrupe²⁵, por grupet kryesore të tyre janë:

1) Ezrekitët

Sipas të dhënave, ezrekitët qenë sekti më rigoroz dhe më ekstrem nga harixhitët. Themelues ishte Nafi' ibn El-Ezreka, i cili vdiq në luftëra me pushtetin qendror në Huzistan në vitin 60 h. Ky sekt është ndjekur rigorozisht nga emevitët. Sekti ezrekit ishte ekstrem dhe, sipas tyre, të gjithë mëkatarët janë jomyslimanë dhe janë të mallkuar amshueshëm.²⁶ Të gjithë ata që e kundërshtojnë këtë grup, duhet të ekzekutohen.²⁷

2) Sufritët

Paraqiten në fillim të hilafetit të Jezidit, me Ebu Bilal Mirsadin. Ky me një grup simpatizuesish e lëshoi Basrën dhe u vendos në Huzistan, duke u ndarë nga Bashkësia, të cilën filloi ta quajë të pafe, kurse pushtetin ta quajë eksploatues. Ishin më tolerantë se ezrekitët dhe dallonin shumë nga ata.²⁸

Lideri i harixhitëve e pyeti Ebu Hanifen: Kush janë njerëzit tu? “Njerëzit që kërkojnë strehim” u përgjigj Ebu Hanife, sepse Zoti ka thënë: “Nëse dikush nga politeistët të lutë për mbrojtje, ti mbroje që t'i dëgjojë fjalët e All-llahut, e pastaj përcille në një vend të sigurt. Kështu duhet për shkak se ai është një popull që nuk di.” (Et-Tewbeh, 6). Meqë harixhitët konsideronin se të gjithë joharixhitët janë kafirë dhe duhet mbytur, Ebu Hanife kërkoi që t'u mundësohet leximi i Kur'anit, sipas ajetit të sipërm. Lideri i tyre tha: “Lexoni Kur'an që edhe ata ta dëgjojnë e pastaj përcillni deri në shtëpi të tyre.” Sh. Nu'mani, Abu Hanifa – zivot i djelo, Zagreb, 1996, fq. 93.

²⁵ Gjerësisht për harixhitët dhe grupet e tyre lexo: El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijin, op. cit., fq. 86-130.

²⁶ H. Laoust, op. cit., fq. 44-45 dhe 50. Esh-Shehrestani, op. cit. 118. S. Tuajmeh, op. cit., fq. 148-149. H. Fahuri - H. Xherr, I, op. cit., fq. 138.

²⁷ Fahrudin Razi, Traktat o sektama (I'tikadatu fireki'l-muslimin ve'l-mushrikin), komentoj: Taha Abdurreuf Sa'd dhe Mustafa Huverij, Islamska Misao, nr. 72/1984, Sarajevë, fq. 24. El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijin, op. cit., fq. 87.

²⁸ H. Laoust, op. cit., fq. 43-44 dhe 51. Esh-Shehrestani, op. cit., fq. 137. Ebu Zehreh, Tarikh ..., op. cit., fq. 76 e tutje. A. Emin, Fexhr, op. cit., fq. 261. El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijin, op. cit., fq. 89 ...

3) Nexhdeitët

Nexhdeitët janë pasues të Nexhde ibn Uvejm El-Harurit, dhe rezultat i përçarjes së ezrekiteve dhe reaksion ndaj ekstremizmit të tyre. Mendonin se një i vetmi gabim nuk e bën njeriun jomysliman, por vetëm përsëritja e mëkatit. Ky sekt nuk pajtohej me legjitimitetin e vrasjeve politike²⁹

4) Ibaditët

Themelues të ibaditëve janë Abdullah ibn Jahja (sipas disave Abdullah ibn Abad Et-Temimi³⁰), organizator dhe lider ushtarak, dhe Ebu Hamza, teoricien dhe mendimtar. Ibaditët ishin më tolerantë dhe bashkëvepronin edhe me sekte tjera.³¹

Ibn Ibadi do të pohojë se myslihanët jashtë grupit të tyre janë jobesimtarë, por jo edhe politeistë. Me këta mund të martohet ibaditi dhe mund të trashëgojnë pasurinë.³² Vendi i myslihanëve joharixhitë konsiderohet si vend i tevhidit, kurse mëkatarët e mëkateve të mëdha i quajnë muvehhidunë, d.t.th. ata që besojnë në Njëjësinë e Zotit, por nuk i quajnë edhe besimtarë.³³

²⁹ H. Laoust, op. cit., fq. 46 dhe 51. Esh-Shehrestani, op. cit., fq. 122 ...; Ebu Zehreh, Tarih ..., op. cit., fq. 74 e tutje. A. Emin, Fexhr, op. cit., fq. 260.

³⁰ Ebu Zehreh, Tarih ..., op. cit., fq. 78.

³¹ Gjerësisht: A. M. El-Gurabi, op. cit., fq. 268-271. H. Laoust, op. cit., fq. 43-53. Esh-Shehrestani, I, op. cit., fq. 134 e tutje. Ebu Zehreh, Tarih ..., op. cit., fq. 78-79.

³² A. Emin, Fexhr, op. cit., fq. 261.

³³ Kenan Čemo, Haridžijske sekte i njihova misao prema Šehrestaniju - el-Mukrimiyye, el-Ma'lumiyye, el-Medžhuliyye, el-Ibadiyye, sipas: www.znaci.com.

Sipas tyre, Allahu është ai që i krijon veprat njerëzore. Ky sekt lejon dënimin e fëmijëve politeistë nga hakmarrja, por mendojnë se edhe këta fëmijë do të futen në xhennet. Sipas: www.znaci.com.

Nënsekti ibadije ka disa nënsekte tjera:

1. El-Hafsijje – Lider i këtij grupimi është Hafs ibn Ebi'l-Mikdam, i cili fillimisht ishte me ibaditët. El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijiin, op. cit., fq. 102.
2. El-Harithijje – janë pasues të El-Hart El-Ibadije. Për shkak të çështjes së predes-tinimit, El-Haris do t'u bashkangjitet mësimi mu'tezilit. El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijiin, op. cit., fq. 104.

Qëndrimi i sunizmit ndaj harixhitëve

Sunitët kanë mendime të ndryshme për harixhitët. Ebu Hanifë dhe Shafi'u i konsiderojnë myslihanë rebelues kundër pushtetit ekzistues, kundër të cilëve duhet luftuar. Maliku është diç më i ashpër, dhe pohon se nëse nuk pendohen duhet mbytur ata, jo për shkak të mosbesimit (kufr) të tyre, por për shkak të rrëmujës (fesadit) që shkaktojnë në këtë botë. Ibn Hanbeli është rigoroz dhe i konsideron si mohues të islamit.³⁴

F. Rahmani, pas një analize të thellë mendon se termi sekt, në kuptimin rigoroz, nuk bën t'i atribuohet harixhizmit, për shkak se në doktrinën e tyre nuk ka asgjë që do t'i ekskomunikonte nga islami, pos faktit që ata duke përdorur armët kundër Bashkësisë Islame vetveten e kanë përjashtuar nga bashkësia e gjerë.³⁵

Rënia e harixhitëve dhe gjendja e tyre sot

Në mospërhapjen e tyre para së gjithash ndikoi forca e ushtrisë së Haxhaxhit. Pastaj radhiten edhe faktorët tjerë, si: rigoroziteti i tyre ndërmjet vete dhe me të tjerët, fanatizmi ekstrem dhe rebelimet e brendshme, duke akuzuar njëri-tjetrin se nuk ka zbatuar deri në fund parimin e tyre etj. Por, shkatërrimit të tyre i ka ndihmuar edhe refuzimi i pranimit të hadithit nga të gjitha palët e përziera në luftëra.³⁶

Forcat harixhite u thyen herët. Sot harixhitët i hasim diç më tepër në Oman, dhe vetëm në bashkësi të vogla në në Afrikën veriore, Libi, Tunizi (në Xherba rreth 40 mijë berberë) Algjeri (në Mzab mendohet se ka mbi 100 mijë) prej nga kaluan në Afrikën Lindore, Zanzibar,

3. El-Jezidijje – janë pasuesit e Jezid ibn Unejsit. Kah fundi i jetës do të deklarojë se sheriatu do të derogohet. Sipas: www.znaci.com. El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijiin, op. cit., fq. 103.

³⁴ H. Laoust, op. cit., fq. 397. O. Nakicevic, Uvod u hadiske znanosti – Hadis I, Sarajevë, 1986, fq. 16. N. b. A. El-Akli, op. cit., fq. 38 e tutje.

³⁵ F. Rahman, op. cit., fq. 238.

³⁶ Për fikhun e harixhitëve shih: I. Dzananovic, op. cit., fq. 58-59.

Madagaskar, të njohur brenda sekti të matur të ibaditëve.³⁷ Ibaditët e sodit nuk janë ekstremistë, nuk përjashtojnë botën myslimane dhe nuk përdorin mjete të dhunës në sendërtimin e synimeve të tyre. Ata janë më afër shumicës sunnite në shumë aspekte. Sipas F. Rahmanit, një lloj fryme, një lloj ngjashmërie e harixhitëve-ibaditëve mund të haset në lëvizjet e reja të *Vehabistëve*, të *Vëllezërve myslimanë* dhe të *Xhe-maati islami* në Pakistan.³⁸ Studime të tilla janë shkruar dhe paraqesin motiv interesant për analiza bashkëkohore.³⁹

Pa dyshim, harixhizmi ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e teologjisë islame, qoftë drejtpërdrejt, qoftë me nxitjen për meditime për çështjet e ndryshme fetare.

II. Murxhitët

Murxhitët u paraqitën në periudhën emevite, por ndikimi i tyre ishte më pak i rëndësishëm, krahasuar me atë të harixhitëve dhe shi'itëve. Ndonëse në fillim fizionomia e tyre ishte më tepër politike, neutrale dhe pasive në raport me harixhitët dhe shi'itët, më vonë sekti i murxhitëve krijoi edhe pikëpamjet e veta fetare. Paraqitja e tyre mendohet se është rezultat i mosmarrëveshjeve të shumta në bashkësinë myslimane, keqësimit të gjendjes për shkak të luftërave qytetare myslimane etj. Ata u paraqitën pas Luftës së Sifinit dhe ndarjes së pasuesve të Aliut r.a. në dy grupe kryesore⁴⁰, në ata të cilët e refuzuan arbitrazhin dhe ata që e miratuan atë.⁴¹

³⁷ J. –R. Milot, op. cit., fq. 126. I. Džananović, op. cit., fq. 57. A. Golpinarli, op. cit., fq. 187. F. Hiti, op. cit., fq. 234.

Kharijite Islam: www.globalsecurity.org/military/intro/islam/kharijite.htm.

³⁸ F. Rahman, op. cit., fq. 238-239. El-Akli, op. cit., fq. 74 e tutje.

³⁹ Shih studimin rreth lëvizjeve moderne dhe ndikimit të mundshëm të sekti harixhit: Johannes J. G. Jansen, Rani islamski pokret haridzija i moderni muslimanski ekstremizam: Sličnosti i razlike në: Enes Karic, Kur'an u savremenom dobu, II, Sarajevë, 1997, fq. 293-305.

⁴⁰ Shih: F. Hiti, op. cit., 234. N. Tërnavë, Fraksionet në islam, Prishtinë, 1997, fq. 77.

⁴¹ A. Golpinarli, op. cit., fq. 187.

Emrin *murxhi* që d.t.th. “të vonohet, të shtyhet çështja e palëve kundërshtare, të cilët derdhen gjakun mes vete, afat”⁴² etj., e morën pikërisht për arsye të parimit të tyre thelbësor fetar, që zë fill në mosgjykimin (irxha) e atyre besimtarëve që bëjnë mëkat dhe në mosshpalljen e këtyre mëkatarëve për mosbesimtarë.⁴³ Respektivisht, mendimi i tyre është se mëkati nuk e anulon vlerën e besimit të besimtari, por vetëm e dëmton, e damkos, dhe se gjykimi absolut i lihet vlerësimit të Allahut në Ditën e gjykimit dhe për këtë arsye ranë në konflikt me shumicën myslimane.⁴⁴

Në pozicionimin e mendimit të tyre se ç’është *iman* / besim dhe *kufir* - mosbesim, i detyruan harixhitët dhe grupimet tjera që i dëlnin në sipërfaqe për çdo ditë. Derisa harixhitët mendonin se pabesimtarë janë të gjithë të tjerët pos harixhitëve, Hasan El-Basri dhe simpatizantët e tij pohojnë se besimtari që bëri mëkat të rëndë është hipokrit (*muna-fik*), sepse synimi është argument i zemrës e nuk është gjuha argumenti i imanit⁴⁵, murxhitët mendonin se “të besuarit e Zotit dhe të dërguarit të Tij, Muhammedit a.s.” është kusht që dikush të quhet besimtar. Këtë mendim ata e mbështesin në hadithin e njohur të Muhammedit a.s., në ç’rast Xhibrili e pyeti Muhammedin a.s. se ç’është imani, ai u përgjigj: “... Të besosh Zotin, Engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e fundit dhe të besosh në të caktuarit e Tij të së mirës dhe të keqes. ...”⁴⁶

Murxhitët largimin e emevitëve nga ligji fetar nuk dëshiruan ta shikojnë si shkak të arsyeshëm që atyre t’u mohohet e drejta e besimit

⁴² T. Muftic, Arapsko-srpsko-hrvatski jezik, I, Sarajevë, 1973, fq. 1180.

⁴³ El-Bagdadi, El-Ferku ..., nr. 62/1984, op. cit., fq. 16.

Ibn Hazm, vol. II, fq. 89, sipas: F. Hiti, op. cit., fq. 234.

Për njoftim, ju informojmë se Sh. Ahmeti shkroi për këtë sekt në: Edukata islame – revistë fetare tremujore, nr. 18/1976, Prishtinë, fq. 66-69.

⁴⁴ U. Ferruh, Tarih’ul-fikr’il-arabijji ila ejjami Ibni Haldun, botimi IV, Bejrut, 1983, fq. 212. Abdulhalim Mahmud, op. cit., fq. 140.

⁴⁵ M. Ebu Zehreh, Tarih ..., op. cit., fq. 119-120. Shumica e muslimanëve mendon se mëkatar i rëndë vazhdon të jetë besimtar dhe është në dorën e Zotit a do ta falë apo do ta dënojë njeriun e tillë. Ibid., op. cit., fq. 120.

⁴⁶ Imam En-Nevevi, Dyzet Hadithe dhe shtojca e Ibni Rexhebit, Shkup, 1413 h./1992, fq. 1-13.

dhe të abstenojnë nga dëgjueshmëria ndaj tyre si udhëheqës politikë të islamit. Atyre u mjaftonte që emevitët të jenë myslimanë.⁴⁷

Në fillim, pjesëtarë të këtij grupi kryesisht ishin shokët e Pejgamberit a.s. Mirëpo, për shkak të pjesëmarrjes së një numri të shokëve të Pejgamberit a.s. në njërën apo në palën tjetër, një numër i tyre, filloi të marrë qëndrim më të saktë. Thuhet se ata janë motivuar me hadithin e Muhammedit a.s. *“Do të ndodhin ndërmjet jush trazira, e më i mirë është ai që nuk përzihet se ai që përzihet, kurse më i mirë është ai i cili merr pjesë se ai i cili i nxit trazirat. ...”*. Ky hadith, sipas tyre, nuk u jep të drejtë as harixhitëve as shi’itëve.

Sipas tyre, edhe Osmani edhe Aliu, sikur edhe Muaviu, kanë qenë krijesa të Zotit dhe vetëm Zoti mund t’i gjykojë absolutisht.

Konsiderohet se murxhitët janë shumë tolerantë, kurse nga disa murxhitë edhe Ebu Hanifeh konsiderohet si një ndër pjesëtarët më të dalluar të murxhitëve.⁴⁸ F. Rahmani mendon se murxhitët tolerantë gradualisht u pasivizuan dhe ranë në nivel të determinizmit të pastër. Baza e tyre gjatë emevitëve ishte në Medinë. Udhëheqja e Medinës, ndonëse ishte e pakënaqur me aktivitetin fetar e politik të emevitëve, megjithatë nuk iu kundërvunë aktivisht këtij pushteti dhe u dhanë më tepër në studimin dhe hulumtimin e diturive fetare.⁴⁹

Fillimisht, pikëpamjet e murxhitëve ishin më tepër politike, që më vonë të shtrihen në fushat teorike dhe filozofike.⁵⁰ Me askënd nuk grindeshin, askënd nuk e atakonin dhe prisnin kohë më të mira, përkundër agresivitetit harixhit dhe dinakërisë shi’ite. Edhe te emevitët edhe te abasitët ishin të pranueshëm për shkak të qëndrimit të tyre jo të deklaruar. Mirëpo, ky qëndrim i përmbajtur i tyre politik, por edhe fetar,

bëri që si përreth tyre ashtu edhe brenda tyre të lindin rryma të ndryshme.⁵¹

Ibn Hanbeli i konsideron murxhitët si sektin më ndjellakeq, kurse i biri i tij, Abdullahu, në veprën e tij *Kitab’us-sunneh*, i përgënjeshtroi mjaft rreptë. Ebu Bekr El-Hal-lali përcjell njoftime të ndryshme në të cilat theksohet rreziku i madh për islamin, por ky autor nuk i ekskomunikon nga islami, por në ta sheh infiltrues të risive dhe ndalon pjesëmarrjen në lutje që ata i udhëheqin. Sipas tij, ata duhet eliminuar nga jeta në bashkësi. Edhe Ebu Bekr El-Axhuri, në veprën *Kitab’ush-sheri’a*, ka mendim të ngjashëm.⁵²

Mirëpo, kadiu Ebu Ja’la është më pak i rreptë. Sipas tij, murxhitët duhet kuptuar si “keramitë”, të cilët përfaqësojnë pikëpamjen vijuese: “çdo njeri plotësisht përgjegjës, i cili thotë se Zoti është Zoti i vetëm dhe se Muhammedi është pejgamber i Zotit, dhe i cili pastaj kryen akte të ndryshme të mosnënshtrimit, në parim nuk mund të arrijë në xhehennem.” As Ibn Tejmijeh, i cili në veprën *Vasitijeh* i kritikon rreptë murxhitët, në një vend tjetër, duke folur për Ebu Hanifen, pohon se “mospajtimet që murxhitët i ndan nga sunnizmi më së shpeshti janë verbale.”⁵³

Ibn Hazmi formalist (dhahirij) në fikh dhe selefi në akaid, vetëm selefistët i pranon për sunni, kurse kelamistët sunni i konsideron murxhitë. Ai pohon: “Më të afërtit ndaj ehl-i sunnetit do të thotë selefijes) nga fraksionet murxhite, janë ata që ndodhen në fraksionin e juristit Ebu Hanifeh (maturiditët), kurse më të largët janë esh’aritët.”⁵⁴

⁵¹ M. Omerdic, Murdzije, op. cit., fq. 32.

⁵² El-Axhuri, Kitab’ush-sheri’at, botimi I, Kuvait, 1421 h./20000. Citati ynë sipas: H. Laoust, op. cit., fq. 394.

⁵³ Hanabila, I, 24, Kitab as-sunna e shejh Abdullahut, fq. 72-105, sipas: H. Laoust, op. cit., fq. 395.

Edhe A. Golpinarli, në bazë të burimeve tjera, pohon se Ebu Hanifeh ishte i afërt me murxhitët. A. Golpinarli, op. cit., fq. 188.

⁵⁴ Shih veprën e tij El-Fasl, II, fq. 11-112, sipas: B. Topaloglu, Hyrje në kelam, op. cit., fq. 144.

⁴⁷ U. Ferruhi pohon se murxhitët pohuan “ne u nënshtrohemi emevitëve, sepse ata janë halifë dhe se ne nuk i luftojmë ata, sepse jemi të bindur se çdo mëkat, qoftë edhe i madh, nuk nxjerr nga imani. Njeriu vazhdon të mbetet mysliman dhe nuk lejohet mbytyja as atakimi i tyre.” Op. cit., fq. 212.

⁴⁸ F. Hiti, op. cit., fq. 234. M. Ebu Zehreh, Tarih ..., op. cit., fq. 123.

⁴⁹ F. Rahman, op. cit., fq. 130 dhe 131.

⁵⁰ A. Emin, Duha, III, op. cit., fq. 270.

Degëzimi i murxhitëve

Në përgjithësi, murxhitët mund t'i ndajmë në dy grupe kryesore:

1) *Murxhitët sunnitë*, të cilët mësonin se bërësi i mëkatit të madh do ta vuajë dënimin merituar sipas mëkatit të bërë, se nuk do të qëndrojnë amshueshëm në xhehennem, dhe se në fund do t'i falet dhe se një pjese, me mëshirën dhe vullnetin e Zotit, do t'i falet dhe nuk do ta shijojë dënimin. Në këtë grup janë shumica e juristëve dhe tradicionalistëve.

2) *Murxhitët ekstremë*, të cilët mësonin se në iman nuk ndikon mëkati sikur edhe puna e mirë në mosbesim. Mendimtarët myslimanë kryesisht kanë mendim të keq për këtë grup. Sipas tyre, njeriu nuk duhet të falë namaz që të bëhet besimtar. Sipas tyre, iman do të thotë të besosh dhe të konfirmosh, kurse veprat nuk janë karakteristikë e besimit apo e mosbesimit.⁵⁵

Kurse autori i njohur klasik, Esh-Shehrestani, pohon se mësimi murxhitë ndahet në katër fraksione: 1. *Murxhitët harixhitë*, janë të hamendur ndërmjet lirisë së plotë dhe detyrimit të plotë në kryerjen e veprave; 2. *Murxhitët kaderitë*, janë për liri absolute të veprimit të njeriut; 3. *Murxhitët xhebritë*, janë për detyrim në veprim dhe; 4. *Murxhitët e autentikë* (halis) mbajnë qëndrim neutral ndërmjet qëndrimeve të sipërme.⁵⁶

El-Esh'ariu mendon se murxhitët janë dymbëdhjetë nënsekte, kurse A. Mahmud e pranon si të qëndrueshëm ndarjen e murxhitëve sipas skemës së Shehrestanit dhe mendon se ata kanë doktrinë të pavarur, natyrore.⁵⁷

Marrë përgjithësisht, murxhitët mund të ndahen në gjashtë nëngrupe:

1) **El-Junusijeh**: janë ithtarët e Junus ibn Avn En-Numejrit. Mendojnë se imani është besimi i Zotit me zemër dhe deklarimit Atij,

⁵⁵ M. Omerdic, Murdzije, në: Islamska Misao, nr. 64/1984, Sarajevë, fq. 33.

⁵⁶ Esh-Shehrestani, I, op. cit., fq. 139.

⁵⁷ Abdulhalim Mahmud, Et-Tefkir'ul-felsefij fi'l-islam, botimi II, Kajro, 1989, fq. 138-139.

braktisja e mendjemadhësisë kundrejt Zotit, dashuria e pastër në zemër etj.

2) **El-Ubejdijeh**: Ithtarët e Ubejd El-Mukteibit, të cilët pohonin se të gjitha mëkatet falen, pos politeizmit. Po ashtu pohojnë se kur njeriu vdes duke besuar në një Zot nuk do të ketë pasoja nga kurrfarë mëkati që e ka bërë.

3) **El-Gassanijeh**: janë ithtarët e Gassanit nga Kufa. Mendohet se ky ka predikuar mendimet e Ebu Hanifes. Sipas Gassanit imani nuk shtohet as nuk mungohet, sepse çdo segment i imanit është iman.

4) **Eth-Thewbanijeh**: Ithtarët e Ebu Thewbanit, të cilët pohonin se imani është njohje dhe pohim i Zotit dhe i të dërguarit. Çdo gjë që mendja nuk e miraton nuk bën pjesë në domenin e imanit, qoftë është vepruar apo nuk është vepruar, derisa atë që e miraton, duhet vepruar dhe është pjesë përbërëse e tij. Sipas F. Raziut "mëkatet që e ndeshin myslimanin në rrugën e tyre të drejtë janë termi të zjarrit të tmerrshëm. Por, ata kurrë nuk do të shkojnë në skëterrë."

5) **Et-Tumenijeh**: Ithtarët e Ebu Muadh Et-Tumeniut. Mëkati, qoftë i madh apo i vogël nuk e bën besimtarin mosbesimtar.

6) **Es-Salihijeh**: Ithtarët e Salih ibn Umer Es-Salihiut. Sipas tyre, mosbesim është mosdija për Zotin e jo diç tjetër.⁵⁸

El-Bagdadi mendon se *murxhitët ekstremë* ndahen në tri grupe kryesore:

1) Këta mendojnë se vetëm imani është me rëndësi, kurse për caktimin e Zotit mendojnë sikurse kaderitët, për ç'arsye njihen edhe si kaderitë edhe si murxhitë, sikur Ebu Shimr El-Murxhi, Muhammed ibn Shebib El-Basri dhe El-Halidi;

2) Ky grup mendon se imani është parësor dhe përkrahin mendimin e Xhehmit mbi veprat dhe vetëfitimin. Këta kryesisht njihen edhe si xhehmitë edhe si murxhitë;

⁵⁸ El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijin, op. cit., fq. 132-154. Esh-Shehrestani, El-Milelu we'n-nihalu, pjesa I, Kajro, pa vit botimi, fq. 140-145.

Edhe për raportet hanefit - murxhit shih në faqet 141 të Shehrestanit.

Fahrudin Razi, Traktat o sektama, op. cit., fq. 31.

Mbi junusitët: Abdulhalim Mahmud, op. cit., fq. 143-144.

3) Grupi i tretë nuk pranon qëndrimin kaderit dhe është grupi më i madh (junusitët, gassanitët, thebanitët, tumenitët dhe murisitët).⁵⁹

Ahmed Emin, pohon se murxhitët ndahen në shtatë grupe, nënsekte kryesore: junusijeh, gasanijeh, thu'banijeh, tevmijeh, mersijeh, shemerijeh, kaderijeh.⁶⁰

Mendohet se murxhiti më i njohur që njëhej ishte Thabit Kutneh (110 h./728), kurse Shehrestani mendon se ndër murxhitët e parë ishte Seid ibn Xhubejri nga Ispahani, i cili banonte në Kufë, kurse të cilin e mbyti El-Haxhaxhi në vitin 95 h./714.⁶¹ Ebu Zehreh pohon se murxhitët numërojnë shumë personalitete në mesin e grupit të tyre, sikur: Hasan ibn Muhammed ibn Alij ibn Ebi Talibin, Amr ibn Murreh, Seid ibn Xhubejrin, Muharib ibn The'rin, Mukatil ibn Sulejmanin, Ham-mad ibn Ebi Sulejmanin, Kadid ibn Xha'ferin⁶² etj.

Mendohet se qëndrimi neutral i murxhitëve u shkante në favor të gjitha palëve, harixhitëve, shi'itëve, por edhe emevitëve. Sekti murxhi` u fikë të ekzistojë në kohën e abasitëve, sepse ata megjithatë mendonin se kanë qenë në favor të emevitëve.⁶³

Edhe El-Esh'ariu në *Mekalatin* e tij i trajton me kompetencë murxhitët dhe ofron njohuri të mjaftueshme për t'u njoftuar me synimet, tendencat dhe mendimet e këtij sekti të dëmshëm.⁶⁴

⁵⁹ El-Bagdadi, El-ferku bejne'l-firek, nr. 62/1984, op. cit., fq. 16.

⁶⁰ Ahmed Emin, op. cit.

⁶¹ U. Ferruh, op. cit., fq. 213.

⁶² Ebu Zehreh, Tarih ..., op. cit., fq. 123.

⁶³ F. Rahman, op. cit., fq. 131.

⁶⁴ Ebu'l-Hasan Alij ibn Ismail El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijjin ve ihtilafi'l-musal-lin, (e përgatiti Helmut Riter), botimi II, Wiesbaden, 1980, fq. 132 -154.

Nexhat Ibrahim

KHARIJISM AND MURJISM – EARLY ISLAMIC SECTS KHARIJITES

(Summary)

Kharijism is the earliest philosophical (religious-political) sect in Islam. Originally, they were supporters of the fourth caliph (Ali b. Abi Talib). The Kharijites left the followers of Ali because of Shia willingness to allow human arbitration of Ali's dispute with Mu'awiya, the governor of Syria. In the very beginning Kharijism was characterized by fanaticism and intolerance and was manifested through a certain policy which resembled a dogma. Some scholars consider Kharijism a dangerous religious sect.

نجد إبراهيم

الخوارج و المرجئية فرق إسلامية قديمة

(خلاصة البحث)

يعتبر الخوارج أقدم فرقة ذات فلسفة خاصة و كذلك ذات صيغة دينية و سياسية برتبط مباشرة مع الخلفية الرابع للمسلمين على بن أبي طالب و مسألة قبول الحكم من قبل عليّ ر.ع. و الذي تم تقديمه من جانب و إلى دمشق معاوية بن أبي سفيان.

تميزت الفترة الاولى لفرقة الخوارج بالتشدد و عدم التسامع و استخدام العنف. و قد سماه عدد من العلماء الخوارج بفرقة خطيرة من حيث مضمونها السياسي و الديني.

BURIMET ISLAME

BURIMET E TË DREJTËS SË SHERIATIT

Në të drejtën e Sheriatit ekzistojnë burimet kryesore dhe seko-ndare. Të gjitha burimet kryesore nuk kanë rang të njëjtë, ngase disa prej tyre gëzojnë përparësi ndaj të tjerave. Juristët e Sheriatit i kanë radhitur burimet kryesore sipas rangut të tyre, kuptimit juridik dhe rëndësisë së tyre, në mënyrën si vijon: 1) Kur'ani, 2) Suneti (tradita), 3) Ixhmaul-Ummeti (Pajtueshmëria e dijetarëve islam për ndonjë çështje), 4) Kijasi (Dispozitat e nxjerra në bazë të analogjisë).

Kur'an do të thotë përmbledhje dispozitash. Ai është burimi themelor dhe kryesor i mësimi islam, pra, paraqet një lloj Kushtetute në të cilën janë përfshirë parimet themelore të besimit, moralit dhe të jurisprudence. Sipas besimit Islam, Kur'ani përmban dispozita hyjnore të shpallura të Dërguarit të Zotit Muhamedit a.s. Ai nuk është shpallur përnjëherë, dispozitat e tij janë shpallur për një kohë prej 23 vjetësh. Dispozitat e para janë shpallur në Mekë në vitin 611 pas Isait a.s. ndërsa të fundit në Medine në vitin 633 (gjegjësisht 610-632. Vër. përkth.)

Ky sistem i shpalljes graduale ka pasur për qëllim që ta përgatitë dhe ta aftësojë popullin shpirtërisht për të pasur respekt ndaj fesë së re. Këtë mënyrë graduale e thekson edhe vetë Kur'ani, kurse teologët islam e quajnë veprim e mëshirë hyjnore dhe vërtetojnë se Kur'ani me

sistemin e tij moral dhe social, vështirë se do të kishte gjetur përgjigje në popullin jobesimtar arab sikur të ishte shpallur përnjëherë.¹

Në fillim janë shpallur dispozitat thjesht të natyrës së besimit dhe moralit, kurse më vonë ato të natyrës socialo-juridike. Për këtë mund të dëshmojë argumenti më i mirë, krahasimi ndërmjet dispozitave të zbritura në Mekë dhe atyre në Medine.

Në Meke gjatë 13 vjetëve të para të punës predikuese të Muhamedit a.s. është shpallur më tepër se gjysma e Kur'anit. Gati të gjitha dispozitat kuranore nga kjo periudhë flasin për besim dhe moral, e vetëm një numër i vogël i tyre kanë pika kontaktuese me jurisprudence. Ato janë dispozita të cilat ndalojnë disa ushqime, gjykojnë vrasjen dhe rekomandojnë ruajtjen e pasurisë së personave të mitur.

Vetëm atëherë kur qendra Islame u bart në Medine Kur'ani filloi me përmasa më të mëdha të sjellë dispozita të natyrës juridike. Në Kur'an ka afro pesëqind thënie (ajete) të cilat kanë të bëjnë me rregullimin e marrëdhënieve shoqërore. Kur merret parasysh se në të ka më tepër se gjashtëmijë thënie (ajete) atëherë shihet se ky numër relativisht është i vogël. Prandaj, më shumë i është kushtuar rëndësi besimit dhe moralit sesa jurisprudence, ngase Kur'ani përkrah pikëpamjen se për zhvillim të drejtë shoqëror më e nevojshme është të forcohet besimi dhe morali sesa të sillen dispozitat juridike të cilat pa besim nuk do të kishin rëndësi të madhe dhe vlerë për rregullimin shoqëror. Kuptohet se ai numër i vogël i dispozitave juridike nuk ka mundur të parashohë të gjitha dispozitat shoqërore. Kur'ani kryesisht tërheq vëmendjen në të drejtën familjare, trashëgimore, penale dhe të luftës. Për shembull ka institucione nga këto dy lëmi juridike, të cilat nuk janë rregulluar me Kur'an, siç janë dhurimi, kaparimi, përshtetsh-

¹ Mbi këtë flet Kur'ani: S. El-En'am 114, El-Isra 106. Në këtë kuptim është e përshtatshme të theksohen fjalët e një besimtar nga gjenerata e parë e myslimanëve të cilën e shënon Rahmetullahu në veprën e tij "Idharul-hakk, vol, 1 fq. 32: Zoti ka lëshuar mbi ne mirësinë e Tij. Kemi qenë pabesimtarë dhe sikur i dërguari i Zoti të na i kishte paraqitur të gjitha dispozitat e fesë së re për njëherë, ne atë nuk do ta kishim pasuar. Në fillim na është ngarkuar vetëm një dogmë (besimi) dhe kur shpirtërat tonë thithen kënaqësinë e besimit, vetëm atëherë janë shpallur tjerat. Këtë ide njëjtë e thekson Fahrudin Raziu në Tefsirin e tij vol.II, fq. 327, duke folur mbi pijet alkoolike.

mëria (vakufnimi) etj. Këto institucione janë rregulluar me burime tjera juridike për të cilat do të flitet. Ndër këto dispozita juridike ka një numër të konsiderueshëm, të cilat janë shfuqizuar dhe nuk kanë vlefshmërinë e tyre praktike. Këtë anulim e ka bërë edhe vet Kur'ani, i cili përveç kësaj në disa vende përmend se disa dispozita të tij të caktuara janë anuluar.²

Nuk janë abroguar vetëm dispozitat e natyrës juridike, por gjithashtu edhe ato të cilat kanë të bëjnë me rregullat fetare.³

Sa u përket dispozitave të besimit të pastër aty nuk ka pasur abrogim, ngase të gjitha dispozitat kuranore që flasin për të në mënyrë reciproke plotësohen dhe vërtetohen. Kur'ani, madje vërteton se të gjitha religjionet monoteiste përmbajnë dhe shtrojnë principe të njëjta për besimin. Ai konsideron se principet e besimit janë thelbi dhe përmbajtja kryesore të atij religjioni universal, të cilin Zoti ia shpalli njerëzimit në forma të ndryshme nga fillimi i botës.⁴

Prandaj, Kur'ani nuk ka ardhur për të krijuar besim të ri, por për të vërtetuar atë besim universal, sepse besimi si dritë hyjnore, mbetet gjithmonë i njëjtë, nuk ndryshon, vetëm format e tij, ndryshojnë sipas shkallës kulturore dhe nevojave të njerëzve në shkallë të caktuar të zhvillimit të tyre. Jurisprudenca të cilën Kur'ani e trajton si anë të jashtme formale të atij religjioni universal, ka pësuar ndryshime sipas kohës dhe popullit. Me qëllim të vendosjes së kësaj feje hyjnore universale Kur'ani pamëshirshëm ka gjykuar dhe rrënuar besimet e vjetra arabe. Mirëpo, ai më but ka gjykuar dhe ka vepruar ndaj zakoneve të tyre juridike. Në realitet ai nuk e ka hedhur rregullimin juridik, i cili është bazuar në traditat e atëhershme në tërësi, por nëse ka qenë e mundur e ka përshtatur atë traditë të vjetër juridike sistemit të tij moral. Kur'ani ka bërë një lloj seleksioni të traditave të vjetra juridike. Ai

² Kur'ani, S. El-Bekare 106, En-Nahl 101. Në mësimin islam ekziston një degë e veçantë e diturisë, e cila merret me abrogimet në Kur'an, e quhet: "Nasih ve Mensuh". Ka dijetarë Islam të cilët e mohojnë kuptimin e abrogimit dhe pohojnë se asnjë dispozitë kuranore nuk është anuluar. Abdurrahman Seoharvi, Eine kritische Prufung der Quellen des Islamistischen, Oxford, 1914, fq. 30.

³ Kur'ani, S. El-Bekare 145. Kjo dispozitë ka të bëjë me ndërrimin e Kiblës.

⁴ Kur'ani: S. El-Bekare 136, Esh-Shura 13.

një pjesë të atyre traditave i ka anuluar si p.sh., adoptimin dhe të drejtën e marrjes së gruas si trashëgim (pas vdekjes së burrit të saj. Plot. përkth.). Ndërsa janë përvetësuar me pak apo me shumë ndryshime një numër mjaft i madh i institucioneve tradicionale juridike: afërsia për nga qumështi, poligamia, dhurata e niqahut (kurorëzimit) lëshimi i grave me vetëdëshirë etj. Gjithsesi këto dispozita juridike nuk kanë mundur t'i plotësojnë të gjitha nevojat e bashkësisë Islame. Kur'ani pra, prej kohësh në kohë ka sjellë edhe dispozita të reja, të cilat kanë pasur për qëllim rregullimin e raporteve të krijuara. Si shembull të kësaj forme origjinale mund të shërbejë një institucion interesant kuranor, e ai është "Liani" mundësia që me anë të betimit për shkeljen e kurorës (adulteris) të bëhet shkurorëzimi dhe të mohon paterniteti i fëmijës së porsalindur.⁵

Kur'ani paraqet parimet e përgjithshme të jurisprudentës, ai nuk hyn në shqyrtimin detaj të disa institucioneve juridike. Me këtë i jep mundësi që institucionet e paparapara të rregullojnë pastaj faktorët kompetent sipas nevojave dhe zhvillimit social të botës Islame. Nga kjo shihet se Kur'ani lejon dhe pranon evolucionin e jurisprudentës si anë formale të jashtme të fesë. Kjo edhe më lehtë mund të konkludohet në bazë të fakteve që Kur'ani ka anuluar dhe ka miratuar institucionet e traditës së vjetër juridike arabe dhe se disa herë ka abroguar edhe dispozitat e tij juridike të mëhershme.

Dispozitat e Kur'anit kanë më tepër karakter moral sesa juridik. Kjo shihet në atë se në Kur'an ka mjaft dispozita juridike me të cilat diçka porositet si edhe në atë se dispozitat kuranore kanë karakter sakral. Për thyerjen e dispozitave të tij Kur'ani parasheh sanksion të dyfishtë. Çdo thyerje duhet të bartë dënimin qoftë nga ana e organeve shtetërore, qoftë nga ana e Zotit në këtë ose në botën e ardhshme. Pra-

⁵ Në të drejtën e Sheriatit shkelja e kurorës mund të argumentohet me deklaratën e katër dëshmitarëve meshkuj. (Kur'ani En-Nisa 14). Mirëpo, nëse burri e zë gruan e tij në flagrancë e nuk mund të vërtetojë me anë të dëshmitarëve, atëherë mbetet betimi, me këtë rast, si mjet dokumentues. Gruaja e paditur mund ta pranojë veprën ose të refuzojë padinë duke u betuar (Kur'ani, S. En-Nur 4-9). Në këtë rast kurora priset. Me anë të Lianit mund të mohohet gjithashtu paterniteti i fëmijës i cili lind 6 muaj pas lidhjes së kurorës: Ahkamush-Sheriah: 334-336, Ibrahim Halebi "Multeha" Stamboll 1916, fq. 149.

ndaj, sipas Kur'anit fajtori nuk mund t'i ikë dënimit për veprën e bërë.⁶

Me rastin e përcaktimit të fajit Kur'ani përfaqëson principin e përgjegjësisë individuale, ndërsa me rastin e caktimit të dënimit miraton sistemin e përzier, sistemin e kompozicionit dhe sistemin e frikësimit.⁷

Kur'ani është shpallur në gjuhën arabe në prozë të rimuar “sexh”. Ai nuk ka qenë tubuar në një libër të veçantë për të gjallë të Muhamedit a.s. Për këtë arsye gjatë tërë kohës ka ekzistuar në pjesë (fragmente). Vetëm pas ndërrimit jetë të tij ky material i parregulluar është mbledhur në një libër, gjatë sundimit të halifit të parë islam Ebu Bekrit r.a.⁸

Kur'ani është i ndarë në sure (kaptina) e suret në ajete (fjali). Në të ka 114 sure nga të cilat një pjesë janë shpallur në Meke e pjesa tjetër në Medine. Të gjitha suret e Kur'anit nuk kanë gjatësi të njëjtë as numër të njëjtë fjalish. Disa prej tyre përmbajnë mbi 200 ajete e tjerat vetëm nga disa ajete. Këto sure nuk janë të radhitura sipas rendit kronologjik të shpalljes së tyre, por në parim sipas gjatësisë së tyre, kështu që në fillim gjinden suret e gjata kurse në fund suret e shkurtra. Këtë renditje e ka miratuar komisioni i cili ka pasur për detyrë për ta tubuar Kur'nin në një libër (Mus-haf).

Fjalitë apo dispozitat kuranore nuk janë radhitur në disa sure sipas materies, por kryesisht sipas kohës që janë shpallur. Në këtë mënyrë dispozitat që kanë të bëjnë me jurisprudencë janë të shpërndara nëpër sure të ndryshme. Për këtë arsye është shumë vështirë të fitohet kuptimi i qartë mbi të drejtën e Sheriatit vetëm nga Kur'ani, aq më tepër ngase dispozitat e tij paraqesin principe të përgjithshme. Për arsye se

⁶ Kur'ani, S. Ez-Zulzile 7-8.

⁷ Kur'ani, S. El-Bekare 178.

⁸ Shejbani: Tejsirul-vusul, fq. 211. Egjipt 1346. Shukrija Alagiq: Mushafi, Glasnik IVZ, Beograd 1933, nr. 8, fq. 9-13, nr. 9, fq. 1-6.

disa prej dispozitave të tilla janë anuluar dhe për atë se ka institucione, të cilat fare nuk janë paraparë me Kur'an.⁹

Suneti – Burimi i dytë i i drejtës së sheriatit është suneti (tradita). Shkenca mbi Islamin me këtë nocion kupton: thëniet e Muhamedit a.s. mënyrën e jetës së tij dhe më në fund lejimin e veprave të të tjerëve me kusht që ato t'i ketë bërë pas fillimit të predikimit të fesë islame. Disa dijetarë këtë nocion e zgjerojnë dhe mendojnë se duhet të konsiderohen edhe thëniet, veprat dhe lejimet me heshtje të cilat rrjedhin nga katër halifët e parë si vazhdim të sunetit të Muhamedit a.s. dhe sipas kësaj edhe si burim të së drejtës së Sheriatit.¹⁰

Mirëpo dominon mendimi se sunet në kuptimin e vërtetë mund të konsiderohet vetëm ajo që Muhamedi a.s. ka thënë, e ka bërë ose e ka lejuar, ngase përfaqësuesit e këtij mendimi konsiderojnë se fjalët dhe veprat e katër halifëve të parë thjesht i përsëritin dhe i shpjegojnë veprimet dhe punët e Muhamedit a.s.

Në mësimin Islam bëhet dallimi rreptë mes Kur'anit dhe Sunetit. Kur'ani trajtohet si vepër hyjnore, kurse syneti si shpjegim i Kur'anit nga Muhamedi a.s.. Kur'ani i cili në një mënyrë koncize i shtron principet e përgjithshme të besimit, moralit dhe jurisprudencës, ka

⁹ Kur'ani megjithëkëtë mbetet si themel, bazë e tërë mësimi Islam. Për këtë arsye myslimanëve iu rekomandohet ta mësojnë, ta njohin dhe iu porositet ta mësojnë përmendësh. Ky rekomandim është dhënë si masë kujdesi për të mos mundur rastësisht, Kur'ani të humbë ose të falsifikohet. Kështu që ka pasur shumë persona të cilët qysh për të gjallë të Muhamedit a.s. që kanë ditur për ta recituar tërë Kur'anin. Edhe sot në botën Islame madje edhe te ne mund të gjinden një numër mjaft i madh i njerëzve (hafizëve) që plotësisht e dinë përmendësh. Kur'ani është përkthyer në shumë gjuhë. Përkthimi i parë në serbokroatisht është bërë nga Miko Lubobratiq, Kur'an, Beograd viti 1895. Tani Kur'ani me koment është përkthyer nga Shukrija Alagiq. Vëllimi i parë i përkthimit të tij u botua në Sarajevë në vitin 1926, me titull: Tefsirul-Kur'anit-kerim – Komentari Kurana. Pastaj ka dalë studimi i posaçëm mbi Kur'anin nga Osman Nuri Haxhiq me titull: “Muhamedi i Kur'an” Beograd 1931. (Mandej Kur'ani është përkthyer nga Ali Riza Karabeg, Xhemaludin Çausheviqi dhe Besim Korkuti, ndërsa në gjuhën shqipe nga: Feti Mehdiu, Hasan ef. Nahi dhe H. Sherif Ahmeti (plot. përkth.).

¹⁰ Me një rast vet Muhamedi a.s. ka thënë: “Përmbahuni sunetit – traditës time dhe traditës së halifëve të drejtë – pas meje – “Sha'ravi: Mizan El-Kubra, Kajro 1351, 1, 3. Megjithatë nga kjo nuk duhet të konkludohet se shpjegimet e katër halifëve të drejtë të parë kanë vlefte të njëjtë si suneti i Muhamedit a.s, sepse ata nuk kanë qenë të zgjedhur me insipirim hyjnor si Muhamedi a.s.

qenë vështirë të kuptohen dhe të praktikohen pa koment. Muhamedi a.s, për të cilin konsiderohet se ka qenë i pajisur me fuqi të posaçme shpirtërore, ka qenë më kompetenti dhe më i thirruri të sjellë komentim korrekt për çfarëdo dispozitë të Kur'anit. Kjo përveç tjerash mund të nxirret nga disa thënie kuranore, e sidomos nga kjo e cila thotë: **“Në të kemi shpallur këtë libër për të gjykuar atë që është kontestuese mes tyre.”**¹¹

Komentimi i Muhamedit a.s. ka pasur karakter të pakontestueshëm, ngase komentimet, të cilat i kanë dhënë shokët e tij, nuk kanë mundur të dominojnë as të shtyjnë atë që e ka dhënë Muhamedi a.s.. Një karakter të tillë të komentimit e pranon edhe vetë Kur'ani, i cili në disa vende thotë: **“Bindjuni Zotit dhe të Dërguarit të Tij”**.¹²

Ai ka mundur ta komentojë si duhet Kur'anin, me fjalë, me punë ose me pranimin e heshtur të mënyrës së jetës të tjetrit. Dijetarët Islam hadith e quajnë çdo transmetim (rivajet) i cili flet dhe ka të bjë me ndonjë komentim të Muhamedit a.s. përmes thënies, veprës ose lejimit në heshtje.

Hadithi ka të bëjë me të gjitha lëmenjtë e jetës dhe veprimit të njerëzve. Disa komentojnë dispozitat fetare-morale të Kur'anit, kurse tjerat ato social-juridike. Këto të fundit kanë rëndësi dhe kuptim të veçantë për të drejtën e Sheriatit, për arsye se në to bazohen nga pjesë e madhe e institucioneve juridike Islame.

Në realitet të gjitha urdhrat që i ka dhënë Muhamedi a.s. si shef i shtetit Islam, rekomandimet si gjykatës suprem dhe komentimet tjera të tij juridike, kanë shërbyer si material për hartimin e të drejtës së Sheriatit.

Këto komentime apo hadithe të ndryshme të Muhamedit a.s. nuk janë shkruar për të gjallë të tij, siç është duhur të veprohet me dispozitat e Kur'anit. Andaj, hadithet thjesht i kanë mbajtur në mend shokët e

tij dhe sipas tyre janë udhëhequr dhe kanë qeverisur. Kështu ka mundur të veprohet sa ishte gjallë vetë, kur shteti islam ishte ende i vogël dhe kur ai kishte mundësi për aplikimin e drejtë të dispozitave fetare dhe juridike islame. Në atë kohë nuk ka ekzistuar rreziku që në emër të tij në formë të hadithit të mbathen apo të futen mendimet ose komentimet e të tjerëve. Pas ndërrimit jetë të tij puna ndryshon, ngase, vërtetë në emër të tij filluan t'i mvishen mendimet e të tjerëve madje edhe të tilla që ishin shpeshherë në kundërshtim me frymën dhe dispozitat e vetë Kur'anit.¹³

Kjo ka mundur të ndodhë pavetëdijshëm mungesa dhe pasiguria e memories njerëzore ose vetëdijshëm si shprehje e interesave individuale ose kolektive. Këto hadithe të pavërteta dhe të rrejshme i kanë futur në popull pa vështirësi dhe aty kanë marrë besueshmëri dhe respekt sikur ato që kanë rrjedhur nga Muhamedi a.s.¹⁴

Kjo çështje ka ndodhur për shkak të rrethanave dhe kushteve në vijim: 1) Nuk ka ekzistuar koleksioni me të cilin kishte mundur të bëhet kontrollimi i suksesshëm mbi praktikimin e hadithit. 2. Shokët e Muhamedit a.s. si njohësit më të mirë të hadithit vdisnin, kështu që gradualisht humbej edhe kjo pengesë më e sigurt e keqpërdorimit të këtij lloji. 3. Islami u përhap shpejt dhe te besimtarët e rinj fituan rëndësi ato hadithe të cilat më së miri u përgjigjeshin zakoneve të tyre. 4. Në Islam, qysh në gjysmën e parë të shekullit të parë sipas Hixhre-

¹³ Muhamedi a.s. ka paraparë këtë fenomen dhe ka porositur ithtarët e tij për t'i marrë për të besueshme vetëm ato hadithe të cilat janë në përputhje me Kur'anin: “Tërë atë që është në përputhje me Kur'anin pranone, sepse ajo rrjedh prej meje, kurse atë që është në kundërshtim me librin e Zotit hudhë”. “Ai që më mbath atë që nuk e kam thënë ai le t'i përgatit vetes vendin në Xhehennem”. Mbi futjen e mendimeve të tjerëve në emër të Muhamedit a.s. dhe mbi pasojat e dëmshme të tyre, flet Sharaviu në: Mizanul-Kubra vëll. I, fq. 53. Es-Sejjid Sulejman En-Nedevi El-Hindi” “Sto znaci sunnet i zasto nam je potreban” - Çka do të thotë sunet dhe përse na është i nevojshëm”. Glasnik IVZ. Beograd 1934, nr. 11, fq. 593 etj.

¹⁴ Halif Ymer r.a. e ka parandier rrezikun që në mes të ithtarëve të rinj të Islamit, mos po përhapen komentime të rrejshme mbi hadithin. Me qëllim që ta parandalojë këtë fenomen i porosit sahabët (shokët e Muhamedit a.s.) që myslimanëve të tillë fare të mos u folet mbi hadithet derisa që në zemrat e tyre të mos forcohet imani-besimi në bazë të Kur'anit. Këtë ua ka porositur, tregon Ibni Maxhe, Sahabëve të cilët i ka dërguar në Kufë. Ibni Maxhe: Sunnen, Kairo 1313, vëll. I, fq. 8-9.

¹¹ Kur'ani, S. Nahl: 64.

¹² Kur'ani, S. Ali Imran 31, En-Nisa 57. Ka dijetarë Islam të cilët mbajnë qëndrim se dispozitat e sunetit, mund të anulojnë dispozitat e Kur'anit. Mirëpo shumica absolute e dijetarëve paraqesin mendim të kundërt – Hazin, Tefsir, Egjipt 1317, vol I, fq. 337, Rushd, Bidaje vol. II, fq. 338, Maverdi, El-Ahkamin-sulltanije.

tit shpërthyen çrregullimet dhe luftërat me karakter fetar. Secili fraksion ose sekt mundoheshin të gjenin arsytetim të pikëpamjeve të veta në Kur'an e në hadithe, dhe kur ajo nuk kishte mundësi të arrihet, atëherë për këtë qëllim filluan të sajojnë dhe përhapin hadithe të rrejshme.¹⁵

Në këtë pikëpamje u paraqit anarkia e vërtetë dhe iu kanos rreziku fesë dhe pastërtisë së saj.

Mënyra e vetme dhe më e sigurt për të përmirësuar atë qëndronte në mbledhjen dhe studimin kritik të hadithit. Për këtë çështje ua dha iniciativën dijetarëve të kohës së tij halifi Ymer II Abdul Azizi.¹⁶

Pas kësaj u zhvillua një lëvizje shkencore për studimin e kësaj lënde, e cila ka lulëzuar sidomos në shekullin II dhe III të hixhretit. Në shekullin e dytë në këtë lëmi është dalluar Imami Malik, ndërsa në shekullin e tretë Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibni Maxhe.¹⁷

Në mesin e mbledhësve të përmendur të haditheve vendin më të shquar e kanë nxënë Buhariu dhe Muslimi. Këta dy dijetarë gati tërë veprimtarinë shkencore të tyre ia kanë kushtuar mbledhjes dhe studimit të haditheve. Për këtë qëllim ata kanë udhëtuar në tërë botën Islame dhe drejtpërdrejt nga populli i mbledhën hadithet. Buhariu në këtë rrugë shkencore ka mbledhur afro 600.000 hadithe, kurse Muslimi afro 300.000. Nga ky material shumë i madh i parregulluar dhe jo i

¹⁵ Kjo sidomos vërehet për ato luftërat rreth hilafetit të cilat i ka udhëhequr halifi Aliu r.a. kundër Muavisë (vit 658 e.r.). Në atë kohë janë formuar dy sekte Islame: shiitë dhe harixhitë.

Është e nevojshme të theksohet se sekti që quhet "Ehlul-Kur'an" për shkak të keqpërdorimeve të përmendura, demanton çdo vlerë të sunetit dhe pranon Kur'anin si burim të vetëm të mësimi Islam. Abdurrahman Seoharvi, Eine kritische prufung der duellen des Islamatischen Rechts, fq. 123.

¹⁶ Ymeri II Abdulazizi ka sunduar nga viti 99-101 sipas Hixhretit. Siç po shihet iniciativa zyrtare për tubimin e haditheve ka ndodhur pasi që kishte kaluar gati një shekull pas vdekjes së Muhamedit a.s.

¹⁷ Imam Maliku ka vdekur në vitin 197 pas Hixhretit. Ai ka filluar i pari për të mbledhur dhe për të vërtetuar në mënyrë kritike hadithet. Në veprën e tij "Muvetta" ka afër 300 hadithe. Buhariu ka vdekur në vitin 256 pas hixhretit, Muslimi në vitin 261, Ebu Davudi në vitin 275, Tirmidhiu në vitin 279, Ibni Maxhe në vitin 293, Nesaiu në vitin 303. Mbi jetën dhe veprën e tij jep të dhëna interesante Shejbaniu Tejsirul-usul, vëll. I, fq. 1-10.

sigurt është dashur të nxirren ato hadithe, të cilat sipas anës së tyre formale dhe materiale japin garanci që janë të vërteta dhe që rrjedhin nga vetë Muhamedi a.s. Buhariu nga 600.000 i ka pranuar dhe i ka shënuar në veprën e tij kah 7.000, kurse Muslimi nga 300.000 ka pranuar vetëm 12.000 hadithe. Veprat e këtyre dyve konsiderohen të vërteta dhe të drejta dhe pas Kur'anit, gëzojnë respektin më të madh në botën Islame.¹⁸

Në të drejtën e Sheriatit ka mjaft institucione të cilat bazohen vetëm në hadithe. Si shembull vlen të theksohen ato institucione të cilat edhe sot kanë vlerëshmëri në jetën sociale të myslimanëve tonë, siç është institucioni bëmires i vakëfit etj.

Ixhmaul-Ummeti – Burimi i tretë i të drejtës së Sheriatit quhet Ixhmaul-Ummet. Ky kuptim shpreh vendimin njëzëri të ylemave islam për ndonjë çështje fetare ose juridike. E drejta për dhënien e mendimit për ndonjë çështje të caktuar në fillim u është pranuar vetëm shokëve të Muhamedit a.s.. Mirëpo, kjo më vonë u zgjerua edhe në nxënësit e tyre (tabiinët) e më në fund edhe në të gjithë ylematë islam, në bazë të atij hadithit, i cili thotë: "Ylemaja janë trashëgimtarët e të dërguarve të Zotit".¹⁹

Kjo aftësi që u pranohet njerëzve dijetarë të Islamit për të mundur t'i komentojnë në mënyrë kompetente dispozitat e Kur'anit dhe të hadithit dhe në raste të mungesës për të krijuar norma të reja, quhet "Ixhtihad". Vlen theksuar se të gjithëve nuk iu pranohet e drejta e njëjtë e Ixhtihadit. Në këtë pikëpamje ekzistojnë grupime të caktuara. Kështu që realisht Ixhtihadi ndahet në tri kategori: 1) Ixhtihad fish-Sheriah (ixhtihadi në Sheriat), 2. Ixhtihad fil-medh-heb (Ixhtihadi në drejtim) dhe 3. Ixhtihad fil-Mesail (Ixhtihadi në çështje të caktuara).

¹⁸ Shkenca e cila merret me studimin e vërtetësisë të ndonjë hadithi quhet Usuli hadith.

¹⁹ Institucioni i Ixhmai umetit gjen arsytimin e vet në Kur'an i cili në një ajet thotë "Prej jush le të bëhet një grup (njerëzish) i cili do të thërrasë në të mira, do të urdhërojë në (punë) të bukura dhe do të ndalojë nga të këqijat..." (S. Ali Imran 104).

Sekti i shiive ulemave nuk iu pranonë aftësitë për të sjellë komentime të pagabueshme. Ata këtë ua pranojnë vetëm imamëve të pagabueshëm të sektës së tyre (imami-ma'sum) do të thotë imami Alisë dhe pasardhësve të tij të drejtpërdrejtë.

Dijetarët, të cilëve u është pranuar lloji i parë i ixhtihadit, kanë mundur në mënyrë të pavarur të hartojnë rregulla, e metoda në bazë të të cilave nga Kur'ani dhe suneti kanë nxjerrë zgjidhje të reja dhe konkluzione. Ndërsa dijetarëve të cilëve u është pranuar lloji i dytë i Ixhtihadit, nuk kanë mundur në mënyrë të pavarur, sipas gjykimit të tyre, t'i komentojnë burimet themelore islame, por në këtë u janë përmbajtur metodave, të cilat i kanë vendosur dijetarët e llojit të parë të ixhtihadit. Për sa u takon dijetarëve të cilëve u pranohet lloji i tretë i ixhtihadit, ata nuk mundën për t'i nxjerrë konkluzionet e tyre nga Kur'ani dhe Suneti, por me rastin e shpjegimeve duhet t'u përmbahen atyre zgjidhjeve (vendimeve) të cilat i kanë sjellë paraardhësit e tyre. Deri te ky grupim i ixhtihadit (vendimet juridike) ka ardhur me detyrimin e vetë rrethanave dhe nevojave të bashkësisë islame. Gjatë tre shekujve të Islamit ka ekzistuar kryesisht ixhtihadi i llojit të parë dhe u është pranuar së pari shokëve të Muhamedit a.s. pastaj nxënësve të tyre dhe në fund dijetarëve Islam, të cilët kanë jetuar deri në shekullin e IV pas Hixhretit.

Ky komentim i parë i tyre, i cili sipas shkencës ka qenë i natyrës absolute (mutlak) ka prodhuar krahas pasojave të mira edhe pasoja të këqija. Dhe ana e keqe duket në krijimin e sekteve dhe shkollave (drejttimeve) të shumta të cilat kanë shkaktuar mosmarrëveshje dhe dobësim të disiplinës në bashkësinë Islame. Për këtë arsye dijetarët islam në interes të unitetit të bashkësisë së vetë filluan mjaft herët të lëshojnë këtë lloj të parë të Ixhtihadit dhe të përmbahen komentimeve, metodave dhe rregullave të tyre, të cilat i kishin hartuar paraardhësit e tyre. Kështu që në shekullin e IV, pas vdekjes së Taberisë në vitin 310, nuk gjenden më dijetarë të cilët me rastin e shpjegimeve të Kur'anit dhe Sunetit që udhëhiqen lirisht sipas mendimit të tyre personal. Në shkencë (të sheriatit) thuhet se nga kjo kohë ixhtihadi absolut është mbyllur, se deri te kjo ka ardhur në bazë të pëlqimit të heshtur, pra kjo është prodhuar automatikisht me vetë moszbatimin e jurispru-dencës.

Nga kjo kohë në Islam nuk ka më komentues të vërtetë (muxhtehid), por vetëm imitues (mukal-lid). Prandaj Ixhmaul-Ummeti si trup

ligjdhënës në kuptimin e vërtetë ka ekzistuar vetëm deri në shek. IV pas Hixhretit dhe i kufizuar në ato gjenerata të cilat kanë jetuar para asaj kohe. Do theksuar se komentuesit nuk kanë pasur liri absolute në marrjen e konkluzioneve edhe pse e drejta e tyre quhet absolute. Ata nuk kanë mundur me vendim të tyre të njëzëshëm për të hequr ose zëvendësuar dispozitat e Kur'anit dhe Sunetit. Vendimet e tyre në parim është dashur të bazohen në burimet e përmendura, ngase norma të reja kanë mundur të hartohen vetëm aty ku nuk ka mundur që të gjendet zgjidhje të ndonjë çështjeje konkrete. Pra, roli i tyre është kufizuar në konstatimin dhe vërtetimin e atyre rregullave juridike, të cilat tashmë kanë ekzistuar dhe në formimin e normave të reja. Me rastin e hartimit të dispozitave të reja, dijetarët i janë përmbajtur analogjisë, bindjes së lirë e nganjëherë edhe zakoneve juridike. Vendimet të cilat i kanë marrë njëzëshëm të gjithë juristët islam kanë karakter të përgjithshëm obligues, sepse konsiderohen si të pagabueshme në frymën e këtyre fjalëve të Muhamedit a.s.: Bashkësia (ymeti) ime nuk bashkohet në të gabuarën.

Kijasi – Analogjia – Burimi i katërt i të drejtës së Sheriatit quhet Kijas. Me këtë nënkuptohen ato vendime të cilat në bazë të analogjisë i kanë nxjerrë juristët Islam nga dispozitat ekzistuese juridike. Pra, e drejta e Sheriatit lejon që raportet e paparapara juridike të mund të vihen nën dispozitat të cilat ekzistojnë me kusht që për raportin e caktuar ekzistojnë shkaqet e njëjta ligjore si për ato dispozita nën të cilat vihet raporti i caktuar.

Juristët Islam kanë gjetur arsyetim për analogjinë në vetë Kur'anin.²⁰

Ky veprim në praktikë ka rëndësi të madhe, sepse në këtë mënyrë shpejt dhe me sukses mund të zgjidhet një çështje konkrete për të cilën nuk ekziston rregull i theksuar në burimet e përmendura. Kjo sidomos ka qenë me rëndësi për gjykatësit dhe funksionarët tjerë të cilët e kanë pasur (obligim) për t'i zbatuar dispozitat e Sheriatit në praktikë. Ato tri burimet e para nuk i kanë përfshirë të gjitha rastet të cilat janë

²⁰ Kur'an, S. Haxhr, 2.

paraqitur në Botën Islame, nën ndikimin e rrethanave të reja ekonomike dhe politike. Kështu që analogjia ka mundur të shërbejë si mjet i përshtatshëm për t'u plotësuar zbrazëtitë në Legjislacion.

Krahas këtyre rezultateve të mira, analogjia ka dhënë edhe rezultate të këqija. Ajo shpeshherë ka shërbyer si mjet dhe mënyrë me ndihmën e së cilës janë bishtëruar dhe keqpërdorur dispozitat e Kur'anit dhe Sunetit. Për këtë shkak mjaft herët është paraqitur reaksioni i caktuar kundër përdorimit të analogjisë. Në realitet një grup juristësh kanë dyshuar dhe gjykuar vlefshmërinë e saj për shkak të keqpërdorimeve të cilat kanë ndodhur me praktikimin e saj. Në këtë, sidomos përmendet shkolla Dhahiriye, e cila gjykon rreptë praktikimin e analogjisë juridike logjike (Kijasi aklij) kurse vetëm në rast të jashtëzakonshëm lejon përdorimin e analogjisë ligjore. Megjithatë, shumica e juristëve janë të mendimit se përdorimi i analogjisë sidomos në jurisprudencë është e arsyeshme, në realitet i domosdoshëm. Në këtë është shkuar aq larg dhe është bërë si rregull sa që ai që nuk e pranon analogjinë nuk mund të kryejë funksionin gjyqësor.

Në realitet analogjia nuk mund të merret si burim i veçantë. Ajo është një lloj i komentimit a metodë me ndihmën e së cilës rasti i papraparë të sillët në rregull, i cili tani më ekziston. Juristët islam analogjinë e kanë quajtur burim, ngase me atë rast më tepër e kanë marrë parasysh rezultatit e arritur sesa vetë procedurën. Prandaj, sipas kësaj Kijasi apo Analogjia, mund të konsiderohet si burim indirekt i së drejtës së Sheriatit.

Përktheu:

Hajrullah Hoxha

Marrë nga vepra: "Izbor Hutbi i vazova".

Artikulli është pa emër të autorit, është zgjedhur dhe recensuar nga Bilall Hasanoviqi, botuar nga KBI në BH Sarajevë 1979.

SOURCES OF THE SHARIAH

(Summary)

The Shariah has its primary and secondary sources. Some are more important than others. Shariah jurists have listed the sources of Shariah law according to their importance: 1. The Qur'an 2. Sunnah (the practice of the Prophet) 3. Ijma (consensus of legal scholars) 4. Qiyas (analogical reasoning).

The Qur'an is a collection of sacred writings. The core of Islamic teaching is the Qur'an. It is similar to a constitution as it contains the basic principles of this religion, its moral principles and jurisprudence. The Qur'an contains sacred writings revealed to Mohammed, the Messenger of God. The Qur'an was revealed throughout a period of 23 years. The first revelations were made in Mecca in 611. The last revelation was made in Medina in 633 (610-632).

مصادر التشريع الاسلامي

(خلاصة البحث)

في التشريع الاسلامي هناك مصادر اساسية و مصادر ثانوية، و هذا يعني ان هناك تفاوتاً بين مصادر التشريع الاسلامي. و قد قام علماء التشريع بترتيب المصادر على النحو التالي: القرآن الكريم و السنة النبوية و إجماع الامة و القياس.

القرآن الكريم هو المصدر الرئيس للدين الاسلامي و هو بمثابة دستور يحتوى على المبادئ الاساسية للعقيدة و الاخلاق و المعاملات. و طبقاً لتعاليم الاسلام يحتوى القرآن التشريعات الاهلية التي نزلت على الرسول محمد صلعم عن طريق الوحي خلال فترة زمنية استمرت 23 عاماً.

TOLERANCA ISLAME

Abdullah Nasih Ulvan

LIRIA E BESIMIT NË LIGJIN ISLAM – (2)

Qëndrimi i Islamit ndaj paganëve

Kush janë paganët?

Pagan, konsiderohet çdokush që adhuron zot tjetër veç All-llahut, apo zot tjetër në vend të All-llahut. Ky definicion përfshin politeistët arabë, adhuresit e zjarrit, yjeve, idhujve e të tjerë.

Për të studiuar këtë temë nga të gjitha anët, duhet të klasifikojmë politeistët dhe paganët në dy grupe:

Politeistët arabë

Paganët joarabë siç janë adhuresit e zjarrit dhe yjeve.

Politeistët arabë

Islami nuk e pranon xhizjen nga njerëz të tillë. Kështu, ata kanë vetëm dy zgjidhje, ose të pranojnë Islamin ose të vriten. Këtë mendim e kanë shumica e juristëve islamë, duke përfshirë Ebu Hanifen, Malik-un, Ebu Ubejden dhe Zejdin. Në një transmetim të tyre thuhet, “Xhi-

zja, duhet të merret nga çdo jomysliman përveç adhuresve arabë të idhujve”.

Megjithëkëtë, juristët tjerë islamë si Evzaiu, Thevriu dhe disa nga shkolla e medhhebit Maliki janë të mendimit, që xhizja duhet të merret nga çdo jomysliman, qofshin arabë apo joarabë, "Ithtarë të Librit" apo adhures të idhujve.

Mendimi i drejtë i takon shumicës, të cilët thonë që xhizja është e papranueshme nga politeistët arabë, ngase Muhamedi a.s. jetoi mes tyre, Kur’ani zbriti në gjuhën e tyre dhe ekzistojnë dëshmi se shpallja është e vërtetë. Prandaj, duhet të besojnë në mrekullinë e tyre dhe duhet të binden me mësimet e tij. Gjithashtu duhet të detyrohen të pranojnë Islamin apo të vriten. Arsyeja për këtë qëndron në faktin, që Gadishulli Arabik, në të cilin zbriti meleku Xhibril, të jetë bastion i Islamit, kryeqytet i myslimanëve, vendi i tyre i preferuar dhe vend i unitetit të tyre. Ajo gjithashtu është qendër e udhëzimit dhe dritë për tërë botën.

Konfirmimi i këtij mendimi është si vijon.

1. Junus ibn Jezid el-Aili transmeton, e pyeta djalin e Shihabit, “A ka marrë i Dërguari a.s. xhizjen nga idhujtarët arabë?” Ai u përgjigj: “Ai a.s. merrte xhizjen nga arabët, Ithtarë të Librit, çifutët dhe të krishterët, ngase ajo merrej prej tyre dhe shpenzohej për ta. Kjo i referohet faktit, që ai nuk ka marrë xhizjen nga politeistët arabë”.

Ebu Ubejd thotë: “Të gjitha hadithet, që janë transmetuar nga Muhamedi a.s. dhe halifët (pasuesit) e tij konfirmojnë që kushdo që është arab dhe nuk është nga "Ithtarët e Librit", vetëm Islami apo lufta pranohet nga ta. Për joarabët, xhizja është marrë nga ta madje edhe nëse nuk ishin nga "Ithtarët e Librit". Muhamedi a.s. thotë lidhur me adhuresit e zjarrit, “Trajtoni ata sikur Ithtarët e Librit”.

Ahmedi dhe Tirmidhiu transmetojnë që Muhamedi a.s. i tha axhës së tij: “Axhë, dëshiroj që ata (arabët e Mekës) të deklarojnë një frazë me të cilën të gjithë arabët do t’u detyrohen atyre dhe jo arabët do t’ua paguajnë xhizjen”. Axha i tij e pyeti: “Cila është ajo?” Ai iu përgjigj, “Të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut”.

Ajo që cekëm më lart konfirmon, që xhizja nuk është marrë nga politeistët arabë dhe është marrë nga joarabët. Arsyeja për këtë qëndron në reformimin e shoqërisë njerëzore dhe mbrojtjen e jetës njerëzore nga paganizmi, i cili nuk përputhet me nderin dhe dinjitetin e njeriut. Myslimanët besojnë, që paganizmi është adhurimi më i keq, që mund të lëndojë shpirtin, mendjen e fatin e njeriut. Prandaj, vrasja e një pagani është mëshirë për të për ta shpëtuar nga ky besim.

Arsye tjetër për këtë është themelimi i një qendre zyrtare të Islamit me qëllim të përhapjes së tij në gjithë botën. Myslimanët duhet të bartin përgjegjësinë e thirrjes Islame dhe ta mbrojnë atë. Kështu që, në fillim lindi një konflikt i dhunshëm mes mysliimanëve dhe politeistëve arabë në Gadishullin Arabik. Prandaj, i Dërguari a.s. urdhëroi para vdekjes së tij: “Nuk duhet të ekzistojnë dy fe në Gadishullin Arabik”.

Muhamedi a.s. nuk u largua nga kjo botë derisa kombi arab besoi e u përmirësua, ishin të kualifikuar të shpallnin mesazhin Islam financiarisht e moralisht dhe të aftë që të ndikonin në përmirësimin e kombeve tjera. Faktikisht ata edhe e bënë këtë. Kështu, Gadishulli Arabik ishte pikë startuese për udhëzimin dhe reformimin e njerëzve tjerë.

Ajeti më i qartë lidhur me këtë, që vetëm Islami apo lufta pranohet nga politeistët arab është ajeti vijues:

“Atyre nga beduinët që ngelën pas, thuaju: “Ju do të ftoheni te një popull luftarak e i fuqishëm, t’i luftoni ata ose të dorëzohen (të pranojnë fenë islame)...”. (el-Fet’h: 16)

Arsye tjetër, pse xhizja nuk pranohet nga politeistët arabë është, që arabët janë të parët që duhet të pranojnë Islamin. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe tërhiq vërejtjen fafesisit tënd më të afërt”. (esh-Shuara: 214)

All-llahu xh.sh. i nderoi dhe u dha dinjitet me Islam. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe se ajo (shpallja) është lëvdatë e madhe për ty dhe për popullin tënd dhe për këtë (lëvdatë) më vonë do të përgjigjeni”. (ez-Zuhruf: 44)

Ajeti do të thotë që Islami dhe Kur’ani janë nder për ty dhe fisin tënd. Prandaj, do të llogaritni për nderin e kësaj feje në Ditën e Gjykimit.

Gjithashtu All-llahu xh.sh. e ka caktuar hilafetin në fisin Kurejsh. Muhamedi a.s. thotë: “Udhëheqësit (imamët) janë nga fisi kurejsh”.

Ky është një nder tjetër për kurejshët. Prandaj, është detyrë që udhëheqësit islamë të jenë për njerëzimin dhe t’i udhëzojnë ata në Islam. Prandaj, kushdo që braktis këtë detyrë mohon këtë mirësi dhe anon nga besimi më inferior, paganizmi. Ai e meriton të vritet si një që e mohon mirësinë dhe harxhon besimin hyjnor dhe i tilli nuk duhet të jetojë në shoqërinë njerëzore.

Arabët jetojnë në vendin e tyre, qendrën e udhëheqjes përmes së cilës deklaruan Thirrjen Islame në gjithë botën. Prandaj, All-llahu xh.sh. e ka paracaktuar atë për ta. Nuk u lejohet jomysliimanëve të jetojnë në të. Muhamedi a.s. thotë: “Nuk duhet të ekzistojnë dy fe në Gadishullin Arabik”.

All-llahu xh.sh. thotë:

“E kur të kalojnë muajt e shenjtë, luftoni idhujtarët kudo që t’i gjeni...”. (et-Tevbe: 5)

Paganët joarabë, siç janë adhuresit e zjarrit

Lejohet të merret xhizja nga ta dhe të lihen në fenë e tyre. El-Xhasi transmeton se kur Muhamedi a.s. u pyet për trajtimin e adhuresve të zjarrit, ai tha: “Trajtoni ata sikur Ithtarët e Librit”.

Megjithëkëtë, marrëveshja (mbrojtja) e “dhim-mive” nuk duhet dhënë përveç se me disa kushte. Juristët hanbelij thonë: “Marrëveshja e mbrojtjes duhet dhënë vetëm Ithtarëve të Librit apo atyre që kanë libër të ngjashëm, siç janë adhuresit e zjarrit. Udhëheqësi mysliiman mund të bëjë marrëveshje me ta, nëse ndien siguri nga ta dhe beson se ata do veprojnë në përputhje me katër kushte:

1. Pajtohen të paguajnë xhizjen me bindje të vullnetshme dhe e ndiejnë veten të nënshtruar.
2. Lavdërojnë Islamin.

3. Nuk do të shkaktojnë dëme.

4. Rregullat Islame do të zbatohen për ta.

Dëshmi për këtë mendim është ajo që vijon: Ahmedi, Buhariu, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu transmetojnë që Omeri r.a. nuk e ka marrë xhizjen nga adhuresit e zjarrit derisa Abdurrahman ibn Avfi erdhi dhe dëshmoi që Muhamedi a.s. e ka marrë atë nga adhuresit e zjarrit të Haxharit. El-Xhasasi në një version tjetër nga Shaf'iu përmend që Abdurrahmani ka thënë: “Dëshmoj se e kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut duke thënë, “Trajtoni ata sikur Ithtarët e Librit”.

Ebu Ubejda transmeton nga ibn Shihabi ez-Zuhari: “Jam informuar se i Dërguari i All-llahut ka marrë xhizjen nga adhuresit e zjarrit të Bahrejnit”.

Gjithashtu Ebu Ubejda transmeton nga ibn Shihabi ez-Zuhari: “Jam informuar se i Dërguari a.s. e ka marrë atë nga adhuresit e zjarrit të Bahrejnit dhe se Omeri e ka marrë nga adhuresit e zjarrit persian, dhe Othmani e ka marrë nga berberët”.

Ahmedi dhe Tirmidhiu transmetojnë se Muhamedi a.s. i ka thënë axhës së tij Ebu Talibit: “Axxhë, dëshiroj që ata (arabët e Mekës) të deklarojnë një frazë me të cilën të gjithë arabët do t’u detyrohen atyre dhe jo arabët do t’ua paguajnë xhizjen”. Axha i tij e pyeti: “Cila është ajo?” Ai iu përgjigj: “Të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut”.

Të përmbledhim, nëse paganët janë arabë, atëherë i kanë dy zgjidhje: të pranojnë Islamin apo të vriten. Nëse ata janë joarabë, myslimanët duhet të marrin xhizjen dhe t’i lënë në fenë e tyre, pasi që Muhamedi a.s. ka thënë: “Trajtoni ata sikur Ithtarët e Librit”.

Qëndrimi i Islamit ndaj ateistëve dhe renegatëve

Para se të flasim për qëndrimin e Islamit, duhet të definojmë ateizmin dhe braktisjen e fesë.

Kuptimi i braktisjes së fesë

Myслиmani që pranon një fe tjetër veç Islamit apo beson në besim tjetër quhet renegat.

Kuptimi i ateizmit

Ateizmi është mohim i ekzistimit të All-llahut dhe mospranim i mesazhit hyjnor që All-llahu xh.sh. e ka zbritur te të dërguarit. Shkurtimisht, ateizëm do të thotë përgënjeshttrim i të Padukshmes që është konfirmuar në librat hyjnorë dhe fjalët e profetëve.

Ateizmi dhe braktisja e fesë janë prej faktorëve që ulin dinjitetin e njeriut, dobësojnë personalitetin e tij dhe e molisin shpirtin e tij. Prandaj, Islami e ndalon atë. Myслиmani nuk ka kurrfarë lirie të jetë ateist apo renegat apo të pretendojë të jetë ateist apo renegat. Këto dy fenomene e shkatërrojnë besimin Islam, humbin besimin dhe largojnë shenjat e udhëzimit në qenien njerëzore.

Manifestimet e braktisjes së fesë

Përkrahja e atyre gjërave që e largojnë njeriun nga adhurimi i All-llahut xh.sh.

Nën këtë lloj përfshihen shumë nën lloje tjera:

a. Përkrahja e nacionalizmit dhe bërja e tij qëllim për të cilin dikush lutet, punon dhe lufton. Ebu Davudi transmeton se i Dërguari a.s. ka thënë: “Kushdo që thërret për fanatizëm (apo nacionalizëm) apo lufton për hir të fanatizmit (apo nacionalizmi) apo vdes për hir të tij nuk është nga umeti mysliman”.

b. Përkrahja e patriotizmit dhe bërja e tij qëllim për të cilin dikush lutet, punon dhe lufton. All-llahu xh.sh. i kritikon njerëzit, të cilët e duan vendin e tyre aq shumë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Sikur t’i kishim obliguar ata: mbytni vetveten tuaj apo dilni prej atdheut tuaj, atë (obligim) nuk do ta zbatonin, me përjashtim të një pakice prej tyre. Po sikur të zbatonin atë që këshilloheshin do të ishte më mirë për ta dhe do t’i përforconte më shumë”. (en-Nisa: 66)

Kështu, të qenit renegat është kufizimi i mundësisë të përkrahjes së patriotizmit, shenjtërimi i tij deri në shkallë të adhurimit dhe duke mos pasur për qëllim tërë këtë për hir të All-llahut xh.sh..

Por, nëse njëri ka për qëllim të gjitha këto përpjekje për hir të All-llahut, duke zbatuar mësimet e Tij, arritjen e interesave të tokës myslimane, ruajtjen e tokës myslimane, mbrojtjen e nderit, pastërtisë, vetës, pasurisë dhe fesë, atëherë padyshim, kjo pajtohet me mësimet e All-llahut xh.sh. dhe e meriton kënaqësinë e All-llahut xh.sh. dhe shpie në fitore apo rënie dëshmor. Ebu Davudi transmeton se I Dërguari a.s. ka thënë: “Kushdo që vritet duke mbrojtur pasurinë e tij është dëshmor. Kushdo që vritet në mbrojtje të vetes së tij është dëshmor. Kushdo që vritet në mbrojtje të fesë së tij është dëshmor dhe kushdo që vritet në mbrojtje të familjes së tij është dëshmor”.

c. Përkrahja e njerëzimit dhe injorimi që njeriu është krijuar për t’i udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë të All-llahut xh.sh. dhe për t’i informuar kombet tjera për Islamin, në mënyrë që të jenë të devotshëm. All-llahu xh.sh. thotë:

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”. (el-Huxhuratë: 13)

d. Përkrahja e socializmit dhe besimi që kjo është rruga e vetme për nderin e shpëtimitin e punëtorëve, fermerëve dhe nëpunësve, si dhe zhdukjes e tiranisë së tmerrshme të varfërisë, dobësisë dhe injorancës. Duke vepruar në këtë mënyrë, myslimani e injoron faktin që Islami

urdhëron për solidaritet shoqëror për t’i përmbushur nevojat e të varfërve dhe të paaftëve. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë, por nuk lyp)”. (edh-Dharijatë: 19)

Gjithashtu ai injoron faktin që zbatimi i këtij sistemi gjatë jetës së Muhamedit a.s. luajti një rol vital në luftën kundër varfërisë dhe largimin e skamjes. Historia është dëshmitare për këtë.

Në përgjithësi, çështja e ndihmuar nga një mysliman, që bie ndesh me mësimet islame apo nuk përputhet me kënaqësinë e All-llahut xh.sh. apo nuk përkrahet nga feja e All-llahut xh.sh. është çështje e njerëzve injorantë. Kushdo që pranon një çështje të tillë dhe thirr për të dhe lufton për hir të saj konsiderohet renegat, që lufton kundër All-llahut xh.sh. dhe të Dërguarit të Tij. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ata (që i adhuron ju) nuk janë tjetër, vetëm se emra që ju dhe prindërit tuaj i emërtuat. All-llahu nuk zbriti për ta ndonjë fakt. Po ata (idhujtarët), nuk ndjekin tjetër vetëm se paragjykime dhe çka duan vetë, megjithëse prej Zotit të tyre u pati ardhur udhëzimi”. (en-Nexhm: 23)

Mysliman i vërtetë është ai që beson në moton kuranore:

“Thua: “Namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve! Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe i bindem)”. (el-En’amë: 162-163)

Qëllimi i kësaj është të qenit besnik All-llahut dhe fesë së Tij gjithmonë.

Gjykimi me ligjet e njerëzve dhe braktisja e ligjeve të All-llahut xh.sh.

All-llahu xh.sh. thotë:

“...E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues”. (el-Maide: 44)

“Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër fare...”. (el-Ahzabë: 36)

“Ata i konsideruan “ahbarët” (rabinë çifutë) të tyre, “ruhbanët” (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes për zota pos All-llahut...”. (et-Tevbe: 31)

“Thuaj: “Unë i përmbahem të vërtetës (që më erdhi) nga Zoti im. Ju e gënijet atë, e për atë që nguteni ju (dënimin), nuk e bëj unë, vendimi i takon vetëm All-llahut, Ai e rrëfen të vërtetën, Ai është më i miri i gjykatësve”. (el-En’amë: 57)

“Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht”. (en-Nisa: 65)

Mospëlqimi i disa mësimëve islame, apo preferimi i disa mësimëve ndaj tjerave, apo barazimi i tyre me mësimet tjera

Për shembull, dikush mund të thotë, nuk më pëlqen agjërimi, pasi që ndikon në zvogëlimin e ekonomisë. Tjetri mund të thotë, nuk më pëlqen shamia (hixhabi) i femrës, ngase është shenjë e prapambetjes. I treti mund të thotë, nuk më pëlqen Islami, ngase ndalon kamatën apo përzjerjen e gjinive dhe kështu me radhë. All-llahu xh.sh. thotë:

“E atyre që nuk besuan, ata qofshin të përmbysur. Ai atyre ua ka asgjësuar veprat. Këtë për shkak se ata e urrejtën atë që e zbriti All-llahu, prandaj atyre ua zhduk veprat”. (Muhamed: 8-9)

Tallja me diçka nga Kur’ani i Shenjtë, apo hadithi, apo mësimet islame

Kjo mund të përfshijë, për shembull, talljen me ligjet e trashëgimisë, ngase ato dallojnë mashkullin nga femra, apo talljen me hadithet e Muhamedit a.s. që i ndalojnë mashkullit të mbajë ari, apo tallja me ezanin (thirrjen për namaz), apo tallja me njerëzit fetarë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Hipokritët kanë dro se do të zbritet ndonjë kaptinë që do të nxjerrë në shesh atë që kanë në zemrat e tyre. Thuaj: “Ani, talluni!” All-llahu do ta zbulojë atë që i frikësoheni. E nëse i pyet ti ata (përse tallen), do të thonë: “Ne vetëm jemi mahitur e dëfruar”. Thuaju: “A me All-llahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni?” Mos kërkoni fare ndjesë, ju pasi që (shpallët se) besuat, keni mohuar. Nëse një grupi nga ju i falim, grupin tjetër e dënojmë, ngase ishin kriminelë”. (et-Tevbe: 64-66)

Buhariu transmeton se i Dërguari a.s. ka thënë, “Njeriu mund të shprehë një fjalë (pavëmendshëm) që nuk i pëlqen All-llahut duke mos menduar për rëndësinë e saj, dhe për shkak të saj do të hidhet në xhehenem”.

Ndalimi i asaj që All-llahu e ka lejuar dhe lejimi i asaj që Ai e ka ndaluar

Vetëm All-llahu xh.sh. dhe i Dërguari i Tij a.s., i cili nuk ka folur me dëshirën e tij, kanë të drejtë të lejojnë dhe të ndalojnë. Kushdo lejon atë, që All-llahu e ka ndaluar apo ndalon atë që All-llahu e ka lejuar e bën veten shok të All-llahut dhe i jep vetës të drejtë të jetë ligjvënës. Ky është mosbesim i vërtetë dhe drejtim i keq. All-llahu xh.sh. thotë:

“Mos i thoni asaj rrenës së gjuhëve tuaja: “Kjo është hallall e kjo është haram” e të shpifni ndaj All-llahut rrenën. Vërtet, ata që shpifin rrenën ndaj All-llahut nuk kanë shpëtim. Kanë një përjetim të vogël (në këtë jetë), e do të kenë dënim të padurueshëm”. (en-Nahl: 116-117)

“Thuaj: “Më thoni, atë që All-llahu ju dha si ushqim (të lejuar), e ju nga ai diçka bëtë të ndaluar e diçka të lejuar?” thuaj: “A ju lejoi All-llahu ju, ose ju i shpifni All-llahut?” Po çfarë është mendimi i atyre që i shpifin All-llahut, për ditën e kiametit?...”. (Junus: 59-60)

Besimi në disa mësimet islame dhe mosbesimi në të tjera

Për shembull, myslimani mund të besojë në Islam si fe e adhurimit dhe të mos besojë në Islam si fe e jetës, udhëheqjes e udhëzimit. Apo mund të besojë se ai është fe e moralit e sistem shpirtëror dhe të mos besojë që ajo është fe e ekonomisë. All-llahu xh.sh. thotë:

“...A e besoni një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni. Ç’mund të jetë ndëshkimi ndaj atij që punon ashtu prej jush, pos poshtërim në jetën e kësaj bote, e në ditën e gjykimit ata hidhen në dënimin më të ashpër...”. (el-Bekare: 85)

Besimi në Kur’an dhe mosbesimi i haditheve të Muhamedit a.s.

Kur’ani u drejtohet myslimanëve që t’i binden të Dërguarit të All-llahut a.s. në çdo gjë. Sa i përket bindjes së të Dërguarit se është si bindja ndaj All-llahut, All-llahu xh.sh. thotë:

“Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur All-llahut, e kush e refuzon. Ne nuk të dërguam ty roje kundër tyre”. (en-Nisa: 80)

“Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi ty dhe (derisa) të mos binden sinqerisht”. (en-Nisa: 65)

“Kur thirrën besimtarët për gjykim ndërmjet tyre te All-llahu dhe te i Dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: “Dëgjuam dhe respektojm!...”. (en-Nurë: 51)

Dëshmi tjetër në synet për këtë është transmetimi i Ebu Davudit dhe ibn Maxhes nga Mikdad ibn Ma’d Jakribi r.a., se i Dërguari i All-llahut a.s. ka thënë: “Njeriu do të mësojë mësimet e mia dhe derisa është i ulur në divan do të thotë: ‘Gjykimi mes teje dhe neve është Libri i All-llahut. Çfarëdo të gjejmë në të lejuar, do ta lejojmë dhe çka do të gjejmë në të ndaluar, do ta ndalojmë. Gjithashtu, atë që e ndalon i Dërguari a.s. është e ndaluar”. Në një transmetim tjetër të Ebu Davudit, Muhamedi a.s. thotë, “Më janë dhënë mësimet e Librit dhe të tjera shtesë të ngjashme me të”.

Aktualisht dëgjojmë që shumë personalitete udhëheqëse arabe e mohojnë hadithin profetik, por të cilët njëkohësisht pretendojnë se janë myslimanë. Ata janë vazhdim i sektit indus të quajtur Kadijani, të cilin e formuan anglezët për të shtrembëruar Ligjin Islam dhe të ngritë dyshime për profecinë e Muhamedit a.s.

Konsiderimi i jobesimtarëve, hipokritëve dhe ateistëve si mbrojtës e miq

Është pjesë e braktisjes së fesë konsiderimi i këtyre njerëzve si mbrojtës e miq dhe kërkimi i nderit të tyre, sikur të jenë ata mbrojtës e miq të njëri-tjetrit. Gjithashtu, urrejtja e besimtarëve dhe e thirrjes në islam është një aspekt tjetër i braktisjes së fesë. All-llahu xh.sh. thotë:

“O ju që besuat! Mos i merrni për miq ata, të cilëve u është dhënë libri para jush edhe as jobesimtarët që me fenë tuaj tallen e luajnë. Kini dro All-llahun po qe se jeni besimtarë”. (el-Maide: 57)

“O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqarë”. (el-Maide: 51)

“Hipokritët dhe hipokritet janë si njëri-tjetri; urdhërojnë për të keqen e ndalojnë nga e mira dhe shtrëngojnë duart e tyre. Harruan All-llahun (nuk u bindën), prandaj Ai i harroi (nga mëshira). Nuk ka dyshim, hipokritët janë ata të prishurit”. (et-Tevbe: 67)

“Dhe asnjërit prej tyre kur të vdesin, mos ua fal namazin (e xhenazes) kurrë, e as mos qëndro pranë varrit të tij (për lutje e vizitë), pse ata mohuan All-llahun dhe të dërguarin e Tij dhe vdiqën kryeneçë”. (et-Tevbe: 84)

“O ju që besuat, mos u ofroni miqësi (dashuri) prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesimin kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë”. (et-Tevbe: 23)

Mosrespektimi i Muhamedit a.s. tallja apo kritika ndaj cilësive apo punëve të tij

Shembuj të kësaj është kritikimi i Muhamedit a.s. për praktikimin e poligamisë apo pretendimi se ai ishte vetëm një reformator dhe udhëheqës i zgjuar si filozofët e reformuesit tjerë, apo akuzimi i ndonjë prej grave të tij si jo të ndershme. All-llahu xh.sh. thotë:

“O ju që keni besuar, mos ngritni zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos iu ngërmoni atij si i ngërmoheni njëri-tjetrit, e të zhduken veprat tuaja duke mos ditur ju”. (el-Huxhuratë: 2)

Nëse ngritja e zërit të ndokujt mbi zërin e Muhamedit a.s. është vepër e pafrytshme dhe vepër e renegatit, atëherë si çka për ata që veprojnë më shumë?

Pretendimi që kuptimi i brendshëm i fshehtë i Kur'anit është i ndryshëm nga kuptimi i jashtëm

Ekziston një grup të quajtur Batinij, të cilët i drejtojnë gabimisht disa njerëz dhe pretendojnë që u është dhënë inspirimi (për kuptimin e domethëniesve të fshehta në Kur'an). Ky pohim e shkatërron Islamin dhe rregullat e interpretimit të tekstit kur'anor. Nëse kjo përhapet në mesin e myslimanëve, Kur'ani do të bëhet i padobishëm, dhe nuk do të ketë nevojë që t'i referohemi gjuhës arabe. Kur'ani është zbritur në gjuhën arabe, ashtu siç thotë All-llahu xh.sh. :

“Ne e zbritëm atë, Kur'an arabisht, ashtu që ta kuptoni”. (Jusuf: 2)

“Dhe ashtu, Ne e shpallëm atë (Kur'anin) kushtetutë në arabisht...”. (err-Rra'd: 37)

“...e edhe ky është libër që vërteton (librin e Musait) është në gjuhën arabe...”. (el-Ahkaf: 12)

Interpretimi i çfarëdo teksti kur'anor, që nuk mbështetet në retorikën arabe apo poezinë arabe është e pavlefshme. Në atë rast, interpre-

tuesi është renegat. Fatkeqësisht, ata të cilët thirrën për këto pohime të kota janë Batinijët dhe ateistët e devijuar.

Atributi i pavend i All-llahut xh.sh.

Për shembull, kushdo që thotë se All-llahu xh.sh. është personifikuar në njeriun ka devijuar. Apo kushdo që thotë që All-llahu xh.sh. ka trupin si trupin tonë, apo që Ai është i treti i Trinisë, apo që Ai është i varfër e ne jemi të pasur, apo çfarëdo thënie tjetër që nuk përputhet me madhërinë e Tij ka devijuar nga rruga e drejtë.

Askush nuk është i barabartë me All-llahun në thënie, vepra apo cilësi. Ai është larg nga koha, vendi e personifikimi. Ai i Vetmi është i Lavdëruar, i Gjithëfuqishëm, i Gjithëdijshëm dhe është i Vetmi. All-llahu xh.sh. thotë:

“Të parët (e njerëzve) nuk mund ta përfshinë Atë, e Ai i përfshin të parët. Ai është shumë i kujdesshëm, hollësisht i njohur”. (el-En’amë: 103)

“Asgjë nuk është i ngjashëm me të...”. (esh-Shura: 11)

“As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë”. (el-Ihlas: 3-4)

Prandaj, për të larguar këto besime të gabuara që shpijnë drejt braktisjes së fesë, besimtari i vërtetë duhet të jetë i matur nga besimet, veprat dhe thëniet e rreme me të cilat bëhet renegat. Ai duhet të shtojë veprat e tij të mira dhe të përkrahë me vendosmëri mësimet islame. Ai duhet të pyesë njerëzit e sinqertë, të cilët kanë dije fetare për çdo çështje të dykuptimtë dhe për çdo thashetheme misterioze që lidhet me besimet islame. Këtë duhet ta bëjë për të mbrojtur veten nga devijimi dhe të takojë All-llahun me zemrën plot besim, me fytyrë të gëzuar dhe shpirt të kënaqur. Muslimi dhe Ahmed i transmetojnë se i Dërguari i All-llahut a.s. ka thënë: “Jeni të saktë në bërjen e veprave të mira para se t’ju kapë shqetësimi që mund të jetë pjesë e natës së errët. Gjatë kësaj periudhe të stuhishme njeriu mund të jetë mysliman në mëngjes dhe jobesimtar në mbrëmje, apo mund të jetë besimtar në

mbrëmje dhe jobesimtar në mëngjes dhe mund të shesë besimin e tij për të mirat e kësaj bote”.

Lusim All-llahun xh.sh. të mbrojë myslimanët nga bërja e gabimeve dhe t’i ruajë nga lajthitja në besim, thënie apo vepra. Gjithashtu e lusim Atë që të na bëjë të vendosur me fjalën që qëndron me vendosmëri në këtë botë dhe na udhëzon në rrugën e Tij të drejtë, dhe të na mbrojë nga joshjet e brendshme e të jashtme. Vërtet, Ai është më i miri që mund të plotësojë nevojat tona.

Ateizmi

Më lart cekëm që mohimi i ekzistimit të All-llahut xh.sh. dhe refuzimi i besimit në Shpalljen e Muhamedit a.s. konsiderohet ateizëm, sepse ateisti refuzon fenë e All-llahut dhe mohon shtyllat e fesë dhe parimet e Ligjit Islam.

Në kohën bashkëkohore, shumica e vendeve kanë përvetësuar ateizmin dhe ua imponojnë atë njerëzve. Fatkeqësisht, këto vende kanë agentë dhe udhëheqës në gjithë botën, të cilët thërrasin në ateizëm, mohimin e fesë dhe marrin guxim të kundërshtojnë All-llahun publikisht.

Këto vende ateiste e intensifikojnë thirrjen veçanërisht në vendet myslimane, sepse ateistët e marksistët e dinë që Islami përhapet shpejt, ka sistem dinamik e njerëz të guximshëm, dhe ka elementet e kulturës, gjithëpërfshirës, rilindjes, vazhdimësisë dhe ndryshueshmërisë. Vendet komuniste përhapen parimet dhe idetë e tyre në vendet myslimane në mënyra të ndryshme.

Ata nganjëherë pretendojnë që parimet marksiste e komuniste janë të njëjta me parimet islame. Ata thonë që Muhamedi a.s. ishte i pari që thirri për barazinë mes të pasurit e të varfrit dhe kështu thirri në komunizëm. Kështu, ai është i dërguar i Markzizmit dhe profet i komunizmit.

Gjithashtu ata thonë që marksizmi pajtohet me parimet dhe sistemet islame.

Nganjëherë, thonë që nuk ka problem nëse përvetësojmë parime komuniste si një sistem ekonomik, duke mbetur besimtarë të Islamit.

Gjithashtu thonë që feja ndryshon nga sistemet ekonomike, prandaj, nuk duhet të lidhim fenë me politikën e sistemeve ekonomike dhe teorive shkencore.

Në shumë raste, shfrytëzuan teoritë shkencore për të përhapur parimet e tyre ateiste. Për shembull, shfrytëzuan teorinë e Darvinit për origjinën e jetës, për evolucionin e tij nga poshtë lart, dhe evoluimin e njeriut nga një shtazë e ulët në majmun, e pastaj në njeri.

Gjithashtu përdorën teorinë e Frojdit, e cila lidh çdo gjë me seks e epsh.

Shfrytëzuan historinë për të interpretuar revolucionet dhe zhvillimin e kombeve që t'i bëjnë njerëzit të kenë dyshime në Krijuesin dhe parimet islame.

Shfrytëzuan çdo rast të mundshëm që haptazi të sfidojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, për shembull, duke pretenduar që All-llahu, fetë, feudalizmi, kapitalizmi, pasuria dhe të gjitha vlerat që pushtuan shoqëritë e mëparshme janë vetëm kukulla të balsamosura në muzetë e historisë. Apo duke thënë që nuk ka zot në botë dhe jeta është materiale. Apo duke thënë që profetët ishin hajdutë e gënjeshtarë.

Nga këto mënyra e mjete dinake që i përdorën, kuptojmë që Marksizmi, i cili është i bazuar në ateizëm, i përdor intrigat e përshtatshme për çdo situatë dhe di se si t'i bindë çdo grup dhe se si t'i mashtrojë. Kur i mashtuari bie në kurthin e tyre dhe hyn në derën e tyre, thirrësit e Marksizmit ua zbukurojnë idetë e ateizmit dhe parimet e komunizmit.

Nëse besimi i ndokujt është i dobët, ai do të jetë pre e arritshme për ta dhe do të bjerë në errësirën e humbjes së tyre e ateizmit. Kështu, do të bëhet renegat dhe jobesimtar në All-llahun, mësimet islame dhe parimet morale. Madje, ai deklaron mosbesimin e tij dhe bëhet prej atyre që All-llahu xh.sh. iu drejtohet në ajetin kur'anor vijues:

“Të tillët janë që All-llahu i mallkoi, i bëri të shurdhët dhe ua verbëroi të parit e tyre”. (Muhamed: 23)

“E atë (dënim) për shkak se ata ndoqën rrugën të cilën All-llahu e urren, kurse e urrejtën atë që Ai e pëlqen, prandaj Ai ua asgjësoi veprat e tyre”. (Muhamed: 28)

Ateizmi, megjithëse gjendet nën nocionin e braktisjes së fesë, është shumë më i keq dhe më i rrezikshëm ndaj individëve e shoqërisë se çdo lloj mosbesimi tjetër, siç është konvertimi në hebreizëm dhe Krishterizëm.

Pse ateizmi është shumë më i rrezikshëm?

Sepse e largon nga ateisti ndjenjën e përgjegjësisë.

E bën ateistin që të mos besojë në të Padukshmen dhe parimet morale.

E shtyn atë drejt mëkatit dhe epshit të shthurur.

E asgjëson në të shpirtin e ambicies për lartësimin e njeriut të dalluar.

E dobëson vetëbesimin dhe personalitetin e tij.

Prandaj, All-llahu xh.sh. i përqesh anëtarët e grupit ateist, të cilët besojnë në përjetshmërinë e kohës. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ata edhe thanë: “Nuk ka tjetër, vetëm se kjo jetë jona në këtë botë, po vdesim dhe po lindemi dhe asgjë nuk na shkatërron tjetër pos kohës. Ata për këtë nuk dinë asgjë, ata vetëm fantazojnë”. (el-Xhathije: 24)

Ndëshkimi për ateistin dhe renegatin

Islami ka urdhëruar dënimin kapital për ata të cilët janë të vendosur në mosbesim apo ateizëm. Buhariu dhe Ahmed i transmetojnë se i Dërguari a.s. ka thënë, “Kushdo që nuk beson në Islam dhe pranon fe tjetër duhet të vritet”. Buhariu dhe Muslimi transmetojnë që i Dërguari a.s. ka thënë, “Ndalohet të vritet myslimani përveç se në tri raste: kur bën tradhti bashkëshortore derisa është i martuar, apo vranë ndonjë mysliman tjetër, apo braktis Islamin dhe konvertohet në ndonjë fe tjetër dhe braktis shoqërinë”.

A duhet t'i jepet mundësia të pendohet?

Nuk ka mospajtim në mendimin mes juristëve islamë, që djali pasi të arrin adoleshencën, i çmenduri pasi të kthen gjendjen normale dhe i dehuri pasi të kthjellët duhet të pyetën të pendohen.

Ndërsa për të rriturin dhe të çmendurin, nuk pajtohet rreth asaj se a duhet t'i kërkohet të pendohet.

Juristët hanefit dhe disa nga juristët hanbelit janë të mendimit që kjo lejohet, por nuk është e obligueshme që renegati i rritur dhe i çmenduri të pyeten për pendim, pasi që thirrja e Islamit u ka mbërri.

Juristët Shafi'i dhe Malikij thonë se kërkimi që të pendohen është i obligueshëm, dhe duhet t'i jepet tre ditë për këtë ashtu siç ka vepruar Omer ibn Hatabi r.a. Është e ndaluar të vritet para tre ditëve, sepse femohimi i një myslimani zakonisht rezulton nga ndonjë dyshim, prandaj duhet t'i jepet kohë që të mendojë përsëri për këtë. Imam Maliku transmeton se një i dërguar nga Ebu Musa el-Ash'ari erdhi te Omeri duke i treguar për një njeri që kishte braktisur fenë dhe nuk i ishte kërkuar të pendohet dhe nuk i ishte dhënë kohë të mendojë. Ata e kishin vrarë menjëherë. Omeri i fajësoi ata duke i thënë, "Pse nuk e dërguat në burg për tre ditë, duke i thënë ushqim e ujë, kështu që ai mund të pendohej". Pastaj, tha: "O All-llah, unë nuk isha prezent dhe as nuk kam urdhëruar, e as nuk kam qenë i kënaqur kur kuptova lajmet".

Mosmiratimi i Omerit për veprat e tyre e bën të domosdoshme që t'i jepet kohë prej tre ditëve. Nëse renegati pendohet, atëherë lirohet, dhe nëse nuk pendohet, atëherë vritet menjëherë pas kalimit të afatit të dhënë.

Hasan Basriu mbron mendimin që renegatit nuk duhet t'i kërkohet të pendohet, por duhet të vritet menjëherë.

Ata thotë që renegati, nëse është i lindur në Islam, nuk duhet t'i kërkohet të pendohet, por duhet të vritet menjëherë. Por, nëse është lindur si jobesimtar e pastaj është konvertuar në Islam, e pastaj ka braktisur fenë, atëherë duhet t'i kërkohet të pendohet.

Ibn Tejmije është i mendimit që kushdo që mallkon Muhamedin a.s. kurrë nuk duhet t'i kërkohet të pendohet, por duhet të vritet menjëherë, qoftë ai mysliman apo jomysliman.

Sipas juristëve Shafi'ij dhe Malikij, gratë trajtohen njësoj si meshkujt, lidhur me vendimin mbi braktisjen e fesë.

Imam Ebu Hanife thotë: "Burgosni gratë dhe mos i vritni ato".

Shqyrtimi i këtyre mendimeve

Sot, jetojmë në kohën e fuqive kombëtare e ndërkombëtare, parti-ve politike e fetare, dhe qeverive sekulare e jofetare. Këto forca publike thërrasin për parime të gabuara të ateizmit dhe për besime destruktive të sekularizmit me qëllim të konvertimit të myslimanëve nga udhëzimi e besimi në udhëzim të gabuar e ateizëm, dhe nga mësimet islame në sistemet e mosbesimit.

Fatkeqësisht, gjejmë shumë qeveri myslimane që nuk luftojnë kundër ateizmit apo kundër atyre që thërrasin në të. Madje, disa nga qeveritë jofetare i lejojnë të thërrasin në ateizëm, dhe i lejojnë të kundërshtojnë All-llahun xh.sh. dhe të Dërguarin e Tij a.s., dhe lirshëm sajojnë gënjeshtër kundër mësimave islame.

Qëndrimi ndaj ateistëve dhe armiqve të All-llahut xh.sh.

Myslimanët duhet të qëndrojnë fuqishëm dhe me ashpërsi para atyre që thërrasin për ateizëm e braktisje të fesë. Myslimanët duhet të kenë përkushtim të besimit në zemrat e tyre dhe trimërinë e Islamit në kokat e tyre në mënyrë që të zmbrapsin intrigat e liga të ateistëve dhe të kufizojnë çoroditjen e tyre.

Mjetet kundër braktisjes së fesë dhe ateizmit

Mjetet më të rëndësishme që myslimanët duhet t'i përdorin në luftën e tyre kundër atyre që thërrasin për braktisje të fesë e ateizëm janë këto: myslimanët duhet të përhapin informimin, të kundërshtojnë çështjet e dyshimta, të demonstrojnë fuqinë kulturore të Islamit dhe të udhëheqin aktivitet serioz për hir të Thirrjes Islame. Ata duhet të hapin xhami për mësimin e Kur'anit dhe parimeve Islame, të qarkullojnë tregimet islame, librat shkencorë dhe botimet edukative mes fëmijëve myslimanë, të mbajnë fjalime e sesione publike në xhami që t'i prezantojnë faktet Islame dhe t'i njohin me të vërtetat historike kudo.

Këto janë mjetet pozitive dhe planet racionale me të cilat umeti islam mund të rikthejë Islamin dhe të kuptojë pikëpamjen islame në tërësi për kozmosin, jetën e njeriut.

Qëndrimi ndaj kundërshtimit brenda shoqërisë

Cili duhet të jetë qëndrimi i myslimanëve në rast të ekzistimit të dikujt në shoqërinë islame që kundërshton All-llahun xh.sh. dhe Islamin?

Myslimanët duhet të vrasin një njeri të tillë menjëherë duke mos i kërkuar të pendohet, çfarëdo rasti që të jetë. Këtë duhet bërë në mënyrë që të jetë shembull për të tjerët. Në këtë rast, ne kemi përvetësuar mendimin e Hasan Basriut, që renegati duhet të vritet menjëherë dhe nuk duhet kërkuar nga ai që të pendohet; nga ata që kushdo që lind në Islam dhe pastaj braktis fenë duhet të vritet; dhe nga Ebu Hanife që është e preferuar, por jo e obligueshme të kërkohet nga renegati të pendohet. Sipas kësaj, nëse një mysliman vret një renegat apo ateist menjëherë, ai nuk do të jetë mëkatar, pasi që kërkimi që ai të pendohet është vetëm gjë e preferuar.

Për ata të cilët mendojnë që nga renegati duhet të kërkohet të pendohet, ne i përgjigjemi, kush duhet të kërkojë nga renegati apo ateisti të pendohet?

Ai duhet të jetë udhëheqësi mysliman apo gjykatësi, i cili është i caktuar nga udhëheqësi mysliman.

Ku është sot udhëheqësi mysliman, i cili gjykon sipas asaj që ka zbritur All-llahu xh.sh.?

Ku është gjykatësi mysliman, i cili ka lirinë dhe kompetencën e plotë?

Pasi që këto ligje nuk zbatohen në umetin islam, atëherë nuk ka nevojë për shtyrje afati apo kërkim pendimi nga ata, sepse nuk ka asnjë udhëheqës apo gjykatës mysliman për t'i zbatuar ligjet e All-llahut xh.sh.

Myslimanët dhe dijetarët duhet të përpiqen shumë për të bashkuar fjalën e tyre që të zhdukin rrënjët e ateizmit dhe braktisjes së fesë sa më shpejt që është e mundur. Gjithashtu, ata duhet të përdorin mjetet e lejuara dhe planet pozitive të cilave iu referuam më lart dhe të vrasin renegatin e ateistin, nëse e kundërshton All-llahun xh.sh. dhe mohon Islamin publikisht. Ata do të pyeten, nëse e neglizhojnë këtë përgjegjësi, në Ditën e Gjykimit.

Kur myslimanët e kategorive të ndryshme e mbajnë këtë përgjegjësi, renegatët dhe ateistët do të largohen nga umeti islam, dhe nuk do të ekzistojë askush që do të deklarojë braktisjen e fesë apo të sfidojë All-llahun xh.sh. e Islamin.

A e mbajnë myslimanët këtë përgjegjësi gjithkund?

Partitë e renegatëve brenda shoqërisë

Cili është qëndrimi islam nëse renegatët formojnë një parti brenda shoqërisë myslimane?

Udhëheqësi mysliman duhet t'i luftojë derisa të pendohen. Përndryshe, duhet t'i vrasë të gjithë, që të jenë shembull për të tjerët të cilët e kundërshtojnë All-llahun xh.sh.. Udhëheqësi duhet të pranojë njërën prej dy gjërave: ose t'i nënshtrohen Islamit ose të vriten.

Halifi Abasit, Mehdiu luftoi kundër njeriut të quajtur Mukana, të cilët pretendonin, që All-llahu është në Hurasan (Iran) dhe u lejuan

njerëzve të lënë namazin, zekatin e agjërimin. Gjithashtu u lejoi pasurinë dhe gratë.

Kur Mukana pësoi disfatë, i dha flakën kalasë në të cilën ishte fortifikuar dhe dogji gjithë kafshët, rrobat dhe të mirat tjera. Gjithashtu mbledhi familjen e pasuesit e tij dhe u kërkoi që të hidhen në zjarr, në mënyrë që të ngrihen në qiell. Ai deklaroi, “Unë po ngjitem në qiell. Kushdo që dëshiron të më pasojë duhet të pijë nga kjo”. Ata pinë një pije të helmuar që i mbyti. Pastaj, i hodhi në zjarr dhe i pasoi ata që të parandalojë armiqet e tij nga gjymtimi i tij apo kufomave të familjes së tij. Kjo ndodhi në vitin 169 hixhrij.

Pas vdekjes së tij, njerëzit ishin të sigurt dhe u larguan nga idetë e tij destruktive dhe mosbesimi i tij.

Nëse nuk ekziston udhëheqësi mysliman që t’i çrrënjosë ateizmin dhe braktisjen e fesë kolektive, myslimanët duhet të luftojnë kundër drejtuesve të ateizmit dhe udhëheqësve të renegatizmit apo të rebelohen kundër këtyre udhëheqësve që t’i dëbojnë, ashtu siç ndodhi në Afganistan¹ dhe në vendet tjera islame. Ata duhet të mundohen që të pastrojnë shoqërinë myslimane nga padrejtësia e çoroditja e tyre dhe të lirohen nga mosbesimi e ateizmi. Atëherë, myslimanët do të gëzojnë me fitoren e dhuruar nga All-llahu xh.sh.

Dikush mund të pyesë: Pse Islami urdhëron këtë dënim mizor për renegatët dhe ateistët?

Për këtë janë tri përgjigje:

1. Që t’i largojë joshjet materiale dhe interesat personale të kësaj bote nga ata që kanë besim të dobët. Këto joshje mund t’i inkurajojnë ata që t’i përgjigjen ateizmit dhe braktisjes së fesë.
2. Që t’i pengojnë hipokritët nga pranimi i Islamit. Ekzistojnë shumë hipokritë, të cilët e pranojnë Islamin, pastaj e braktisin atë me qëllim të përhapjes së braktisjes së fesë e ateizmit dhe mbjelljes së dyshimeve, parregullsive dhe rebelimit në shoqërinë myslimane.

3. Të dobësojë mosbesimin dhe ateizmin, që të mos i lejojë të bëjnë fuqi dhe t’i sulmojnë myslimanët. Ata mund të formojnë rrezikun më të madh në shoqërinë myslimane, nëse do të gjejnë mundësi.

Ky qëndrim i vendosur i Islamit nuk është kufizim i lirisë së fjalës. Ai i jep jomyslimanit, para pranimit të Islamit, lirinë të zgjedhë fenë. Pas pranimit të Islamit dhe bërjes anëtar i shoqërisë islame, atij i ndalohet të braktisë fenë çfarëdo rasti që të jetë.

Gjithashtu, kushdo që lind në Islam i ndalohet që pas arritjes së moshës madhore të braktisë fenë apo të pranojë ndonjë fe tjetër. Këtë ngase All-llahu xh.sh. e ka nderuar atë me Islam kur ishte fëmijë, prandaj si mund të braktisë fenë ai dhe të ndërrojë mirësinë e All-llahut, pasi që ka arritur moshën e pjekurisë? Gjithashtu, si mund të lëvizë nga një shkallë e lartë në një shkallë më të ulët pasi që ishte besimtar?

Sipas mendimit tim, kur fëmijës mysliman i jepet një edukim i shkëlqyer, rritet në një mjedis të mirë dhe i takon një grupi islam të udhëzuar, sigurisht se ai do të ketë besim të vendosur, besim të palëkundur dhe do të përkrahë Islamin si fe të tij, Kur’anin si kushtetutë dhe Muhamedin a.s. si udhëheqës e shembull.

Taberaniu transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë, “Mësoni fëmijët tuaj të duan tri gjëra: të duan të Dërguarin e All-llahut (a.s.), të duan familjen e tij dhe të duan leximin e Kur’anit, pasi që lexuesit e Kur’anit do të jenë nën hijen e All-llahut kur do ketë hije përveç hijes së Tij, dhe do të jenë me profetët dhe të zgjedhurit në xhenet”.

Muhamedi a.s. na ka treguar se prindërit janë përgjegjës për rritjen e fëmijëve të tyre me besim dhe sipas mësimave islame, dhe i ka paralajmëruar ata nga edukimi në mosbesim e udhëzim të gabuar. Buhariu transmeton se Muhamedi a.s. thotë: “Çdo fëmijë lind në pastërtinë e tij fëmijërore (fitreh – besimi në monoteizmin Islam), por prindërit e tij e kthejnë në hebre, të krishterë apo zjarrputistë”.

¹ Ky artikull është shkruar në vitin 1993. autori i referohet dëbimit të rusëve dhe komunistëve.

Shembuj të veprimeve të tyre kundër myslimanëve

Këtu do t'i përmendim disa shembuj të paganëve dhe ateistëve kundër myslimanëve, kur kishin fuqi mbi ta.

Kur tatarët paganë sulmuan myslimanët në Bagdad, bënë një masakër të përgjakshme që nuk është shënuar në histori. Do të citojmë një pjesë nga libri i ibn Kethirit "Fillimi dhe Fundi" (el-Bidaje ve en-Nihaje), të ngjarjeve të vitit 656 hixhrij:

Ata sulmuan Bagdadin dhe vranë burra, gra, fëmijë, pleq e të rinj... Shumë njerëz u fshehën në puse të thella, kopshte dhe grumbuj mbeturinash ku mbetën për një kohë. Gjithashtu, disa u fshehën në shtëpi dhe mbyllën portat. Megjithëkëtë, tatarët i hapën qoftë duke i thyer apo duke u dhënë zjarrin dhe i ndoqën në shtëpi duke i vranë, sa që gjaku rridhte në rrugë. Të All-llahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi. Gjithashtu ata bënë të njëjtën gjë në xhami. Vetëm "dhim-mitë", të krishterët e çifutët,² dhe ministri tradhtar i quajtur ibn el-Alkam ishin të sigurt. Disa nga tregtarët, të cilët paguan shuma të mëdha gjithashtu shpëtuan.

Në Bagdad, i cili ishte plot me njerëz, mbetën vetëm një grup jo vogël, të cilët ishin të frikësuar, të uritur e të turpëruar.

Historianët nuk pajtohen me atë se sa u vranë në këtë pushtim. Disa thonë se u vranë 800 000 myslimanë. Të tjerët thonë se u vranë një milion myslimanë.... Ata e pushtuan Bagdadin në muajin Muharrem, dhe ky pushtim zgjati për katërdhjetë ditë. Vranë halifin Mu'tesim Bil-lah, dy djemtë e tij, dijetarët myslimanë, oratorët dhe lexuesit e Kur'anit. Xhamitë në Bagdad u mbyllën, dhe ligjëratat e hytbet e xhumasë u ndaluan për disa muaj... Kur pushtimi mori fund, Bagdadi ishte shkatërruar, dhe askush nuk banonte në të përveç njerëzve të çmendur. Rrugët ishin të mbushura me kufoma, që lëshonin kutërbim

² Të krishterët dhe çifutët ishin të sigurt, sepse ata u kishin dërguar mesazh tatarëve duke i nxitur që të pushtojnë Bagdadin, kryeqytetin e shtetit islam në atë kohë. Ata ua treguan një korridor sekret që i shpiente në qytet. Ata praktikisht morrën pjesë në këtë pushtim dhe i mirëpritën tatarët pagan. Ata i tradhtuan muslimanët, të cilët i mbrojtën dhe i siguruan dhe bënë marrëveshje me ta.

dhe ndryshonin erën e ajrit si rezultat i të reshurave që kishin rënë mbi ta. Çmimet e larta, epidemitë dhe murtaja mbizotëroi qytetin. Të All-llahut jemi dhe te Ai do të kthehemi.

Kur Bagdadi u bë i sigurt, njerëzit, të cilët ishin fshehur në vende të fshehta në tokë, puse e varreza dolën. Ata dukeshin sikur të vdekur të zhvarrosur. Ata nuk e njihnin njëri-tjetrin, dhe babai nuk e njohte djalin e tij apo vëllai vëllain e tij. Ishin goditur nga epidemi e ashpër që e vriste çdokënd.

Dëshmori i Islamit, Sejid Kutbi në tefsirin e tij të Kur'anit, "Nën Hijen e Kur'anit" (Fi dhil el-Kur'an) (vëll. 4, fq. 132) thotë:

"Pamja e ngjarjeve në historinë moderne nuk ka ndryshim nga pamja e ngjarjeve në historinë e vjetër! At, që paganët hindusë bënë kundër myslimanëve në Pakistan, kur këta të fundit u ndanë nga India, nuk është më mizore se ajo që tatarët bënë kundër myslimanëve në Bagdad. Në Indi, jetonin 8 milionë emigrantë myslimanë. Ata ishin të frikësuar nga mizoria dhe sulmet barbare ndaj myslimanëve në Indi, prandaj preferuan që më mirë të emigronin se sa të mbetnin në Indi. Vetëm tre milionë arritën në kufijtë e Pakistanit, dhe pjesa tjetër prej pesë milionëve u therën si qengja në rrugë të organizuar nga bandat induse. Ata gjymtuan mizorisht kufomat myslimane dhe ua lanë kafshëve të egra e zogjve, ashtu siç vepruan tatarët në Bagdad."

Pas kësaj, çka bënë pasardhësit e tatarëve kundër myslimanëve në Kinën komuniste dhe në Rusi? Vranë 26 milionë myslimanë gjatë 25 vjetëve, që është e barabartë me një milion në vit. Në pjesë të Kinës, bënë më shumë gjenocid në Turkistanin mysliman sesa që bënë tatarët në Bagdad. Gjithashtu vendosën një udhëheqës mysliman në një grupë dhe i urdhëruan myslimanët të sjellin fekalet e tyre dhe t'ia hidhnin udhëheqësit. Ky aksion zgjati për tre ditë derisa vdiq.

Jugosllavia e bëri të njëjtën gjë kundër myslimanëve. Ata vranë një milion myslimanë gjatë periudhës komuniste pas Luftës së Dytë Botërore. Ata ende janë duke bërë krime të tilla mizore dhe gjenocid edhe në ditët e sotme. Për shembull, i vendosën myslimanët në grirëse mishi që t'i grinin si mish lope.

Gjithashtu, komunistët masakruan myslimanët në Irak gjatë sundimit të Abdul Kerim Kasimit. Të njëjtën gjë e bënë në Jemenin Jugor dhe në Afganistan.

Ata bënë vrasje, krime, tortura dhe gjymtime ndaj myslimanëve e thirrësve të Islamit në gjithë botën.

All-llahu xh.sh. thotë:

“Ata nuk respektojnë asnjë besimtar as farefisninë as marrëveshjen, si të tillë ata janë përdhunues”. (et-Tevbe: 10)

“...Ata do t’ju luftojnë juve vazhdimisht për t’ju zmbarsur, nëse munden nga feja juaj...”. (el-Bekare: 217)

Në fakt, nuk ka zgjidhje tjetër në kundërshtimin e komunistëve dhe bllokut të ateistëve përveç deklarimit të xhihadit dhe bashkimit nën një udhëheqje politike e besnike kundër ateizmit, ateistëve dhe agjentëve të tyre deri që All-llahu xh.sh. ta përmbushë urdhrin e Tij.

All-llahu xh.sh. i mbrojti popullin e Afganistanit, të cilët luftuan kundër komunistëve dhe mercenarëve të tyre. Ata ishin në gjendje të rifitojnë autoritetin dhe rolin e Islamit. Këtë e bënë ngase besuan që luftimi i ateizmit dhe komunizmit nuk mund të arrihet përveç se përmes xhihadit dhe sakrifikimit të vetvetes e pasurisë së tyre për hir të All-llahut xh.sh.

Ata do të triumfojnë me dëshirën e All-llahut xh.sh.. Umetet tjera arabe, të cilat janë të udhëhequra nga pushtetet komuniste do të marrin shembullin e tyre në xhihad, çlirim dhe fitore. Kjo nuk është e vështirë për All-llahun xh.sh.

“E tashmë fjala (premtimi) e jonë u është dhënë më parë robërve tanë të dërguar. Se ata, pa dyshim do të jenë të ndihmuar. Dhe se ushtria jonë do të jenë ata ngadhënjësit”. (es-Safatë: 171-173)

“...All-llahu është mbizotërues i punës së vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë (fshehtësinë e çështjeve)”. (Jusuf: 21)

“Nëse All-llahu dëshiron t’ju ndihmojë, s’ka kush që mund t’ju mposhtë...”. (Ali Imran: 160)

- vijon -

Abdullah Ulvan

THE STANCE OF ISLAM TOWARDS PAGANS

(Summary)

Who are the pagans?

The pagans are people who adore a god other than Allah. This definition includes Arab polytheists, those who worship fire, the stars, idol worshippers, etc.

In order to analyze this topic we must classify polytheists and pagans in two groups:

1. Arab polytheists
2. Pagans (non-Arabs), who worship fire and the stars

Arab polytheists

Islam does not accept the payment of jizya from such people. Therefore, they have two options, to accept Islam or to be killed. This is the view expressed by the largest number of Islamic jurists, including Abu-Hanifa, Malik, Abu Ubaida and Zejdin. The latter are of the opinion that jizya must be taken from all non-Muslims, except the Arab worshippers of idols.

A number of Islamic jurists (Evzai, Thevri) as well as members of the Maliki Madhhab are of the opinion that jizya must be paid by all non-Muslims, be they Arabs or non-Arabs, “People of the book” or idol worshippers.

عبد الله ناصح علوان

موقف الاسلامي من الوثنيين (خلاصة البحث)

من هم الوثنيون؟

حسب التصور الاسلامي الوثني هو كل من يعبد غير الله أو الالهة غير الله و هذا يشمل المشركون العرب و عبدة النار و الصابئين و بقية الوثنيين.

و لكي ندرس هذا الموضوع بنوسع أكثر يجب ان نقسم المشركين إلى قسمين:

1- المشركون العرب

2 - الوثنيون العرب كما هم عبدة النار و الصابئين.

المشركون العرب:

الاسلامي لا يقبل الجزية من هؤلاء و لذلك أمامهم خياران: إما ان يقبلوا الاسلام أو يقاتلهم الحدة. و هذا الحكم تنفق عليه جميع الائمة بما في ذلك الامام أبو حنيفة و الامام مالك، و لديهم قول مشهور يقول: "الجزية تؤخذ من كل غير مسلم ما عدا عبدة النجوم من العرب".

AKTUALITETE

Angela Milo & Hajjah Liza Abdullah

ZBATIMI I KUR'ANIT NË JETËN TONË TË PËRDITSHME

Parathënie

Në forumin e organizuar nga Asociacioni Islam, qesh ftuar të flisja në temën: “**Unë dhe Islami**”. Një zotëri parashtroi këtë pyetje: *Si të zbatojmë Kur'anin në jetën tonë të përditshme apo si ta jetojmë jetën tonë bazuar në mësimet kuranore?* Koha për t'u përgjigjur në pyetjen e shtruar, ishte shumë e shkurtër; pyetja vërtet ishte tërheqëse, prandaj nuk ishte edhe lehtë për t'iu përgjigjur dhe atë për arsye të kohës shumë të shkurtër që më ishte dhuruar.

Kohën kur unë prezantova temën në fjalë, posedoja diplomën nga Universiteti Islamik Ndërkombëtar (IIUM) në degën e Shkencave Islame, ku edhe isha duke i vijuar mësimet, prandaj edhe vendosa që të shkruaj një punim përmes të cilit do të isha në një gjendje më të mirë për t'iu përgjigjur pyetjes së lartpërmendur.

Jam shumë e gëzuar që propozimi im për të shkruar mbi këtë çështje u pranua, prandaj, jam orvatur që me mundin tim të jap përgjigjen mbi mësimet kuranore.

I. Zbatimi i Kur'anit jasht shtëpisë

Po startojmë me mëngjesin. Pasi që të dalim nga shtëpia, e me këtë synojmë realizimin e punëve, shoppingut apo obligimeve tjera të jetës së përditshme. Si shembull më i bukur që do ta ilustronte këtë, mund të marrim tregimin e “As'habul Kehf – Banuesit e Shpellës”¹ ata të cilët i besuan Allahut dhe nga frika e devijimit u larguan nga vendi duke e lutur Allahun e Madhërishëm për ndihmë, siç ka ardhur edhe në Kur'anin Famëllartë:

إِذْ أَوَى الْفِتْيَةُ إِلَى الْكَهْفِ فَقَالُوا رَبَّنَا آتِنَا
مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً وَهَيِّئْ لَنَا مِنْ أَمْرِنَا رَشَدًا

Kur djelmohat u strehuan në shpellë e thanë: “O Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë!”²

Këto fjalë janë shumë të thjeshta për t'i kuptuar, fjalë të cilat na dhurojnë mbështetjen tonë te Krijuesi i Gjithësisë.

Banuesit e shpellës qëndruan në një gjumë të thellë, afro 300 vjet; iknin me vrap nga njerëzit, të cilët Allahut i kishin bërë rivalitet. Kërkuan nga i madhi Allah që t'i mëshirojë dhe t'i udhëzojë në rrugë të drejtë; t'i rregullojë çështjet e tyre që kishin të bënin me besimin e çiltër.

Në ditët tona, ne jemi të lirë që të besojmë Allahun e Plotfuqishëm, së këndejmi, neve nuk posetojmë problemet me të cilat u ballafaquan banuesit e shpellës “As'habul Kehf”.

Megjithatë, me të dalë nga shtëpia, takojmë njerëz të lloj-llojshëm, mu për këtë jemi të obliguar që nga Sunduesi i kësaj Gjithësie, të kërkojmë ndihmë, udhëzim dhe mëshirë, dhe atë më shumë se kurrë.

¹ Banuesit e Shpellës, apo As'habul Kehf, ishin disa djelmohat të rinj, me besim të fortë në Allahun e Madhërishëm. Ata u larguan nga vendlindja e tyre vetëm e vetëm për ta ruajtur besimin e tyre. Ata u strehuan në një shpellë, që në gjuhën arabe quhet Kehf. Qëndrimi i tyre në të kaloi në gjumë. Koha e qëndrimit të tyre në shpellë siç e cek edhe Kur'ani, ishte treqind e nëntë vjet. (shënim i përkthyesit).

² Kaptina El-Kehf : Ajeti; 10.

Unë sa herë që të zgjohem në mëngjes, lexoj ajetin e lartpërmendur dhe atë para se të dal nga shtëpia.

II. Përshëndetja

Edhe përshëndetja në këtë rast ka të bëjë me aplikimin dhe zbatimin e mësimave kuranore në jetën tonë të përditshme, kështu që, kur të takojmë ndokënd, jemi të obliguar që ta përshëndesim në mënyrën më të mirë.

Allahu i Gjithëmëshirshëm në Librin e tij Famëlartë thotë:

وَإِذَا حُيِّتُمْ بِتَحِيَّةٍ فَحَيُّوا بِأَحْسَنَ مِنْهَا أَوْ رُدُّوهَا
إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ حَسِيرًا

Kur përshëndeteni me ndonjë përshëndetje, ju ktheni përshëndetje edhe më të mirë, ose kthejeni ashtu. All-llahu llogarit për çdo send.³

Ky ajet Kur'anor na bën të kuptojmë se Allahu xh.sh. llogarit për çdo gjë, pra, edhe përshëndetja merret për konsideratë. Ka të ngjarë ku shumë jomyslimanë i përshëndesin myslimanët me përshëndetjen islame “Esselamu Alejkum” (Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju) dhe më bën të mërzhitem pa masë, kur shoh myslimanët duke mos e kthyer përshëndetjen.

Kur pata rastin t'i pyes për shkakun e sjelljes se tyre lidhur me këtë problematikë, mu përgjigjën duke thënë: “Kemi frikë se ata janë duke u tallur me ne.”

Për ne nuk është me rëndësi të merremi se a mos janë duke u tallur apo janë të singertë në dhënien e selamit. Në fakt, nuk mund të themi se kjo është e vërtetë, për arsye se, nuk posedojmë mundësinë e të lexuarit të qëllimeve të tyre; nuk jemi përgjegjës dhe as nuk mbajmë kompetencë mbi këtë çështje, ne kemi përgjegjësi për veprat dhe punët tona, pra, kurdo qoftë që dikush të na përshëndet, jemi të obliguar t'i kthejmë selamin, dhe atë duke u bazuar në ajetin e sipërpërmendur,

i cili na mëson se në rast se nuk kthejmë përshëndetjen më të mirë, atëherë, t'i kthejmë një përshëndetje të ngjashme me të tyren.

III. Mirësjellja

Duke lundruar me anijen e Kur'anit, arrijmë te porti i mirësjelljes, dhe ja, duke vizituar të afërmit, miqtë, shokët, dhe duke mos i hedhur vështrim vizitave të shpeshta dhe në kohë të ndryshme, shohim se nuk jemi në gjendje të vërejmë sjelljet tona aq të këqija, ja se si na mëson Allahu i Plotfuqishëm;

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ بُيُوتِكُمْ حَتَّى تَسْتَأْذِنُوا وَتُسَلِّمُوا
عَلَى أَهْلِهَا ذَلِكَ خَيْرٌ لَكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ فَإِنْ لَمْ تَجِدُوا فِيهَا أَحَدًا
فَلَا تَدْخُلُوهَا حَتَّى يُؤْذَنَ لَكُمْ وَإِنْ قِيلَ لَكُمْ ارْجِعُوا فَارْجِعُوا هُوَ أَزْكَى لَكُمْ
وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ لَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَنْ تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ
مَسْكُونَةٍ فِيهَا مَتَاعٌ لَكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تُبْدُونَ وَمَا تَكْتُمُونَ.

O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju, në mënyrë që të merrni mësim. Po nëse nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t'u jepet leje, e nëse u thuhet kthehuni, ju pra kthehuni. Kjo është më e ndershme për ju. All-llahu di çdo gjë që vepron ju. Nuk është për ju ndonjë mëkat, nëse hyni në shtëpi të pabanuara, e që në to keni ndonjë përfitim. All-llahu e di atë që e shfaqni haptas dhe atë që e mbani fshehtë.⁴

Nga ky ajet kuranor mësojmë se, gjithsesi jemi të obliguar të kërkojmë leje për të vizituar shtëpinë e ndokujt, dhe nuk duhet të hyjmë në të, përveç nëse na lejohet një gjë e tillë. Me këtë tregohet respekti ndaj çështjeve private të të tjerëve.

Unë kam bindjen se gjithmonë para se të vizitojmë ndonjë të afërm apo këdo qoftë, mund t'i bëjmë një telefonatë dhe t'i informojmë

³ Kaptina En-Nisa, Ajeti: 86.

⁴ Kaptina En-Nur, Ajeti; 27 – 29.

ata për vizitën tonë, dhe me këtë mund të shohim se a janë të zënë apo të lirë për të na pritur. Në këtë mënyrë, mund t'i mënjanojmë sjelljet e këqija që të mos i marrim njerëzit për së lehti. Sa më shumë që t'i njohim njerëzit aq më shumë duhet të rritet respekti ynë ndaj tyre, dhe nëse nuk na lejohet për të hyrë në shtëpitë e tyre dhe urdhërohem për t'u kthyer, atëherë duhet të kthehem.

Përktheu:

Fehim Xhafer Dragusha

Angela Milo & Hajjah Liza Abdullah

THE QUR'AN IN OUR EVERYDAY LIFE

(Summary)

At a forum organized by the Islamic Association I was invited to speak on the topic "Islam and I". A Scottish gentleman asked: "How to apply the Qur'an in our everyday life or how to live our everyday life according to the teachings of this holy book?" As I had only a limited period of time to answer this question, which was a very interesting one, I decided to write a book through which I would be in a better position to answer it properly.

انجيلا ميلو و حاجه ليزا عبدالله

تطبيق القرآن الكريم في حياتنا اليومية

(خلاصة البحث)

مقدمة

لقد كنت مدعوا لحضور الاجتماع المنظم من قبل الجمعية الاسلامية و طلب مني أن أتحدث عن الموضوع: "أنا و الاسلام". و هناك وجه إلى احد الحاضرين هذا السؤال: كيف نطبق القرآن في حياتنا اليومية أو كيف نعيش حياتنا طبقا لتعاليم القرآن الكريم:

و الوقت الذي حدد لي للإجابة على هذا السؤال كان قصيرا جدا، و السؤال لم يكن سهلا و لذلك لم يكن من السهل الجواب على السؤال الموجه إلى.

DOKUMENTE

Mr. Aliriza Selmani

BI e Gjilanit gjatë Luftës së Dytë Botërore

Të dhëna dokumentare për BI të Gjilanit gjatë Luftës së Dytë Botërore

Pas okupimit fashist më 1941, pjesa më e madhe e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore, mbeti nën okupimin italian, iu bashkua Shqipërisë londineze duke u themeluar administrata civile me emrin Komisariati i Lartë Civil për “*Tokat e Liruar*” me qendër në Prizren, me në krye Fejzi Alizotin, i cili bën organizimin administrativ dhe në fillim themeloi dy prefektura: Prefekturën e Prizrenit dhe të Prishtinës, kurse në shtator 1941 edhe Prefekturën e Pejës.

Në kuadër të Prefekturës së Prishtinës hynte Nënprefektura e Gjilanit dhe Nënprefektura e Ferizajt. Në Gjilan ishin vendosur organet e administratës së Nënprefekturës me në krye nënprefektin dhe Bashkia (Komuna) e qytetit me në krye kryetarin. Nënprefekti ishte organi më i lartë i pushtetit civil në nënprefekturë, kurse kryetari në bashki apo komunë. Nënprefekti emërohej nga Ministria e Punëve të Brendshme në Tiranë dhe kishte nën mbikëqyrje administratën, gjyqet, ekonominë, arsimin dhe kulturën. Në krye të bashkisë së qytetit dhe të komunave në fshatra ishte kryetari dhe këshilli i bashkisë (komunës), i cili kontrollonte administratën e pushtetit lokal.

Sipas Marrëveshjes së Vjenës, nga gjysma e majit 1941, Rrethi i Gjilanit ishte ndarë në zonën okupuese italiane, respektivisht shtetit shqiptar me 206 fshatra dhe zonën okupuese bullgare, me 20 fshatra të komunës së Vitisë dhe 5 fshatra të Dardanës. Kurse vija e demarkacionit ishte caktuar përgjatë Moravës së Binçës. Kështu, pjesa më e madhe e Rrethit të Gjilanit, gjegjësisht Anamoravës, iu bashkua Shqipërisë nën administrimin italian, ku u vendos administrata sipas modelit të administratës në Shqipërinë londineze

Para Luftës së Dytë Botërore kompetencat e Ulema-Mexhllisit të Shkupit shtriheshin edhe në Kosovë, ku vepronte Myftinija e Prizrenit, rrethveprimi i së cilës shtrihej edhe në Rrethin e Gjilanit. Në një listë nxjerrë nga raporti i Këshillit të Ulemave të Rretheve të Shkupit për popullsinë myslimane për vitin 1938/39, shihet se prej 14 rretheve të Këshillit të Ulemave të Shkupit nën numrin 1, është shënuar Rrethi i Gjilanit, i cili atëbotë ishte Rrethi më i madh në Kosovë, me 8.357 shtëpi myslimane; me 33.101 meshkuj dhe 30.682 femra, gjithsej: 63.783 banorë të besimit islam.¹

Vlen për t’u cekur se organet e BI-së imamatet e xhematit, komisionet e Vakëf mearifeve dhe më vonë Ulema-mexhli i Shkupit ishin institucione të vetme legale për shqiptarët mysliman të viseve të okupuara, ku ata mund të komunikojnë jozyrtarisht në gjuhën amtare, shqip. Këto organe janë të njohura për rolin e tyre në ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar dhe për krijimin e mundësive të rezistencës së organizuar shqiptare kundër pushtuesit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore të gjitha kompetencat e Bashkësive Islame, nga “*Tokat e Liruar*”- të pjesës më të madhe të Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore kaluan nga Ulema Mexhli i Shkupit në kompetencë të Kryesisë së Komunitetit Mysliman me qendër në Tiranë. Në Kosovë u formuan Kryemyftinija e Zonës së Prizrenit dhe ajo e Prishtinës, të cilat korrespondonin me Kryesinë e Këshillit të Ulemave në Tiranë. Kryemyftinija e Zonës së Prishtinës përfshinte Myftininë e

¹ Arkivi Qendror i Shqipërisë, fondi, Komuniteti Mysliman, nr. 882, dosja, 80, viti 1944, fq.17.

Gjilanit, Ferizajt dhe Drenicës, kurse Kryemyftinia e Zonës së Prizrenit përfshinte myftinjtë e Pejës, Gjakovës, Suharekës Rahovecit dhe Dragashit.²

Për derisa të bëhej organizimi i administratës fetare e financiare dhe me qëllim të mirëvajtjes së punëve, Dr. Behxhet Shapati-kryetar i Kryesisë së Komunitetit Mysliman në Tiranë, më 1941, do të kërkojë nga të ngarkuarit zyrtarë islamë, në “Tokat e Liruar”, që të vazhdojnë me aktivitetin e tyre fetar, administrimin dhe ruajtjen e pasurive vakëfnore dhe të akteve zyrtare të myftinisë e të vakëfeve, dhe se për çdo çështje zyrtare duhej të korrespondojnë me Kryesinë e Komunitetit. Një shkresë të tillë, më 21.06.1941, ia kishte dërguar edhe Shaip Rexhepit në Gjilan, me anën e së cilës kërkohej që të vazhdojë me detyrën e Myftiut.³ Pothuaj se e njëjta gjendje do të vazhdojë gjatë gjithë kohës, për këtë flitet edhe në përgjigjen e kërkesës nr.19, të datës 30.01.1944, të kryemyftiut të Zonës së Prishtinës Rexhep Remziut, nga ana e Kryesisë së Këshillit të Ylemave në Tiranë, nr.36, më 10.02.1944, me arsyetimin se “rrethanat e sotshme nuk lejojnë që të merret një masë pranë P.T. Qeverisë shqiptare, se asht një send i vështirë me vu në vijë e në rregull mejtmin t’uaj me anën e Shtetit,” dhe shton “Mbasi në Tokat e Lirue me ende vazhdojnë veprimi i ligjeve si fetare e civile të ish-Mbretnisë Jugosllave, tash për tash duhet të vazhdoni e të veproni si ma përpara”.⁴

Bashkësia Islame, që vepronte në kuadër të “Tokave e Liruar”, përveç parullës fetare, kishte dhe atë atdhetare. Imamët dhe nëpunësit fetarë do të qëndrojnë në krye të detyrës që u ishte ngarkuar dhe njëkohësisht do të japin vazhdimësi (predikimet) me përmbajtje fetare dhe atdhetare. Kështu, me rastin e festës së 28 Nëntorit u përgatitën manifestime të ndryshme. Në kuadër të këtyre manifestimeve, që për herë të parë po bëheshin në këto vende, Komisariati i Lartë Civil për Koso-

vë, Dibër e Strugë me anë të një telegrami nr. 20, të datës 8-XI-1941-XX, kërkon nga Kryesia e Këshillit të Ministrave (Sekretaria e Përgjithshme) në Tiranë që Komuniteti Mysliman të dërgonte një grup kuadrosh, të cilat “lutjet fetare të zakonshme ndër xhamia do t’i bënin në gjuhën shqipe”, meqenëse kishte nevojë për këto kuadro sidomos në Strugë, Tetovë, Gostivar, Kërçovë dhe Rekë-Rodush.

Një rol të rëndësishëm në këtë detyrë me fjalën e shkruar do ta luajë kryetari i Kryesisë së Komunitetit Mysliman në Tiranë, dr. Behxhet Shapati. Më 17 nëntor të vitit 1941, kryetari i Komunitetit Mysliman, shkel. e tij dr. Behxhet Shapati, i shoqëruar prej hirësisë së tij Muharrem Mullahi, kryemyfti i Zonës së Tiranës, prej z. Sadik Bega, z. Sulejman Bakalli, llogaritar i përgjithshëm i Drejtorisë së Vakëfeve, z. hafëz Muhameti, imami i Xhamisë së Vjetër, z. Hasan Tahsini, z. Vexhëhi Buharaja etj., do t’i bëjë një vizitë Kosovës dhe qendrave të saj, gjatë së cilës ata do të zhvillojnë takime me zyrtarë të BI-së dhe me autoritetet e organeve qeveritare. Qëllimi i vizitës ishte të njihen me punën e efektivave të organeve të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe me gjendjen e popullatës së këtushme, siç thuhet, “për t’ardhur në kontakt së afërmi, me prijësit fetarë dhe me popullsinë myslimane, për të observuar Vakufet, Xhamitë dhe pasuritë e tyre dhe për të fituar një ide të gjallë e të vërtetë mbi të gjitha problemet fetare që do të rregullohen në të ardhmen, si pasojë e bashkimit të tokave të liruar me Shqipërinë”. Në këtë udhëtim do të vizitohen Prizreni, Gjakova, Peja, Ferizaj, Prishtina dhe Gjilani.

Kjo vizitë ka rëndësi shumë të madhe, sepse, siç thuhet në shtypin fetar të asaj kohe, do të zhvillohen kontakte “me vendet t’ona të liruar si edhe me vëllezërit t’onë, të një gjaku, të një feje dhe të një Atdheu me ne. Do të vihen kontakte me vendet t’ona më të bukura të Kosovës Kreshnike, e cila vuejti për një kohë të gjatë nga shtypja e thundrës së një armiku çnjerëzor. Ishte e para herë që do t’i shihnim këto vise deri dje të robëruara, këto toka të shenjta shqiptare, të cilat vuejtën nën një robëri të egër tridhjetëvjeçare që ua kishte marrë frymën, lirinë e fjalës, lirinë e zotërimit të vatrave të tyre, pranë të cilave

² Mr. Haki Kasumi, Qëndrimi i Bashkësisë Fetare Islame ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945, “Kosova” 12, Prishtinë 1983, f.47.

³ AQSH, f. KM, nr. 482, d.12, v.1941, shkresa e Dr. Behxhet Shapatit dërguar Myftiut në Gjilan, më 21.06.1941; Po aty, f.482, d.12, v.1941, f.47 (21.08.1941)

⁴ AQSH, f. KM, nr.882, d. 31, v.1944, fq. 5

banonin dhe banojnë burra fatosa e heronj”⁵. Duke e përshkruar gjendjen e mjeruar që kish përjetuar populli shqiptar i Kosovës, ndër të tjera, thuhet: ” *Armiku s’njihnte as të drejtat më elementare të tyre*.

Më datën 25. 11. 1941, Kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar së bashku me suitën e Tij do ta vizitojë Gjilanin, qytet ky, për të cilin autori i këtij reportazhi thotë se ishte “*hambar i Kosovës*”. Në hyrje të qytetit të Gjilanit delegacioni pritet prej një grumbulli të madh të popullatës shqiptare me prijësit fetarë e qeveritarë në krye, që i kishin dalë për ta përshëndetur. Myderrizi i Medresesë “*Atik*” në Gjilan, Haki Taibi, mban fjalën e rastit të mirëseardhjes. Ai foli me një gjuhë të mprehtë, të pastër, thjesht shqipe, i cili, ndër të tjera, përmend ajetin Kur’anor: “*Ve lekad ketebna fiz-zeberi min ba’didh-dhikri ennel-arda jerithuha ibadijes-salihune*”. Një mesazh i qartë, që shprehte ndjenja, shumë emocione dhe zotime, shprehte pikëpamjen universale të islamit lidhur me jetën e kësaj bote domethënien e të cilit e kuptuan si delegacioni dhe ulematë tjerë. Fjalimi i Haki Myderrizit ishte mjaft i bukur dhe i thekshëm. Na bëri përshtypjen më të madhe të gjithëve, thotë autori i këtij reportazhi, dhe vazhdon të tregojë se urime dhe lavdërime iu bënë Myderrizit të ri nga të gjitha anët. Shihet se populli e donte. Ky zotëronte një kulturë të shëndoshë⁶.

Sipas të dhënave memoriale për nder të delegacionit, në oborrin e shtëpisë së Mustafë Agës, Sabit efendiu shtron një drekë, ku, përveç Haki myderrizit dhe mulla Idris Gjilanit, ishte edhe Halim Orana, Sabit efendiu, Aqif Tetova, Sulejman Ashkija, Ibrahim Orana etj. Pasi drekuan, kryetari i Komunitetit, i shoqëruar nga krerët fetarë dhe qeveritarë vizitojnë medresenë “*Atik*”, ku, siç thotë autori i këtij reportazhi, takohen me shumë studentë të kësaj medreseje. Një djalë i ri, 12-vjeçar, i cili e kishte bërë hifzin (kishte mësuar tërë Kur’anin përmendsh) këndon një ashër të “Kur’anit”, të cilit, Shkël. e Tij, kryetari i Komunitetit, nga kënaqësia e madhe që ndien prej këtij djaloshi nxo-

ri dhe i jep një dhuratë. Mandej i vizitojnë edhe katër xhamitë e qytetit.⁷

Siç merret vesh nga dokumentet arkivore, me rastin e kësaj vizite në Gjilan, titullarit të Komunitetit Mysliman popullsia e qytetit i ankohet për pazotësinë e z. Shaip Rexhepit për detyrën si myfti. Pazotësinë e myftiut ata e bazojnë në disa fetva të lëshuara gabimisht, me ç’rast kërkojnë shkarkimin e tij nga detyra e myftiut. Në bazë të ligjit të komuniteteve, Shaip Rexhepi ishte shkarkuar nga pozita e myftiut në Gjilan dhe sipas urdhëresës së nënshkruar nga kryetari Dr. Behxhet Shapati, më 19.12.1941, në vend të tij ishte emëruar Idriz Hajrullahu. Për këtë ndryshim e kishin njoftuar edhe nënprefektin nga i cili kishin kërkuar zbatimin e këtij vendimi. Mirëpo, siç flasin të dhënat dokumentare të kohës, Idriz Hajrullahu edhe pse lëshonte fetva nga zyra e tij, të nënshkruara dhe të vulosura me vulën e tij- shqiponjë dykrenore, kurse populli e pranonte si myfti, megjithatë aplikimi zyrtar i tij do të shtyhet deri në gjysmën e dytë të vitit 1943, kur edhe do ta japi betimin. Për evitimin e parregullsive të shfaqura në Myftinin e Gjilanit, Dr. Behxhet Shapati kishte angazhuar myftiun e Gjakovës, Fahri ef. Ilazin për të zhvilluar hetime.⁸

Për shkak të shkarkimit të tij nga detyra e myftiut, Shaip Rexhepi do ankohet në Ministrinë e Tokave të Liruar në Tiranë, e cila me shkresën nr. 17, të 17.01.1942, do të kërkojë sqarime për këtë nga Kryesia e Komunitetit Mysliman. Në përgjigjen e tij nr. 21/1, të 26.01.1942, dërguar kësaj ministrie, Dr. Behxhet Shapati pos tjerash shkruan: “*Popullata e qytetit kishte parashtruar pazotsitë e kryetarit, për detyrën e Myftiut. Kjo pazotësi e ti u vërtetue në disa fetfana që kishte lëshue. Por i përmenduni që nuk iu bind urdhrat të kësaj kryesie tue mbajt arbitrarisht, në baz të ligjit të komuniteteve i kemi shkru Nënprefekturës për t’a largue nga zyra dhe me ia dorzu zyren Myftiut të riemnum...*”⁹ Mirëpo për habinë ky edhe ma tej për një kohë do të mbetet në krye të Zyrës së Vakëfit në Gjilan. Vlen për të shtuar se

⁵ AQSH, f. Ministria e P. të Brendshme, nr. 2896, rezervat, shkresë dërguar Kryesisë së Këshillit të Ministrave në Tiranë, më 11.11.1941; Po aty, nr.482, d.19, v.1941, fq.3

⁶ Reportazh mbi vizitën e kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Kosovë, “Kultura Islame”, Tiranë, 1941, nr. 3-4, fq.74.

⁷ Po aty, fq.82.

⁸ AQSH, f. KM,nr.882, d.14, v.1943, fq.131.

⁹ AQSH, f. KM, nr. 166, d. 178, v. 1942, nr. 21/I-d.

Shaip Rexhepi edhe para Luftës së Dytë Botërore kishte ushtruar detyrën e Myftiut në Gjilan, detyrë të cilën për një kohë do ta ushtrojë edhe pas luftës, kur edhe ishte anëtarë i Këshillit të Rrethit.

Përkundër rrethanave të vështira për shkak të okupimit fashist dhe gjendjes së luftës, gjatë gjithë kohës ishin bërë përpjekje të vazhdueshme për një konsolidim të aktivitetit fetar islam midis Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman, me qendër në Tiranë dhe BI në “Tokat e Liruar”. Kjo shihet edhe nga mesazhi i kryetarit të Komunitetit Mysliman Hafiz Sherif Langut dhënë përmes Radio Tiranës, më 12 qershor 1942, drejtuar besimtarëve myslimanë në tokat Shqiptare, ku në kuadër të programit të paraqitur, paraqiti edhe vështirësitë e organizimit dhe veprimi të këtij këshilli. Në kuadër të çështjeve kryesore ishte pika e katërt e programit, në të cilën thuhej: *“Të bëhen përpjekje për të gjetur një mënyrë logjike të shkrirjes më të shpejtë shpirtërore, vëllazërore ndërmjet vëllezërve mysliman që jetojnë në “Tokat e liruar” me vëllezërit që jetojnë në “nënën Shqipëri”*¹⁰.

Vëmendje të veçantë Komuniteti Mysliman do t’i kushtojë rrezikut nga depërtimi i ideologjisë komuniste në trevat shqiptare. Kjo e shtyri kryetarin e Kryesisë së Këshillit të Ulemave në Tiranë me në krye H. Sherif Langun, që t’i drejtohet me një Qarkore nr. 694, të datës 6.10.1942, e cila ka një përmbajtje të thukët, me anën e së cilës do t’i bëhej apel të gjitha Kryemyftinive e Myftinive të Komunitetit Mysliman Shqiptar që me predikimet e tyre nëpër xhami, në korniza të mësimeve islame, t’i bëjnë me dije myslimanët shqiptarë, për rrezikun e tmerrshëm që i kërcënohet atdheut e fesë prej rrymës bolshevike, ateiste dhe të fillojnë, pa humbur kohë, menjëherë, me rastin e Bajram Sherifit, meqë është në prag dhe të vazhdojnë gjithnjë duke shfrytëzuar çdo rast të volitshëm. Sepse siç thuhet në Qarkore, *“Kulshëfra moskovite bolshevike, anmike e njerzis, mohuese e Perëndis, shtypse të çdo ndiesije fetare e morale po përpiqet me derdhun helmin e vet edhe në popullin t’onë të pastër me anën e agjentave të shitun ose të verbuem”* dhe vazhdon *“Autoriteti qeveritar asht tue ba detyrën e vet me*

*të tana mjetet e forcës pa lanë mbas dore as mëshirën ku e lyp rasa e as këshillën bindëse as fjalën e ambël. Por është detyra jonë ma tepër, detyra e kujdestarve të shpirtërve, me i ndriçue vllaznit t’onë myslimanë mbi rrezikun e tmerrshëm qi i kërcënohet Atdheut e fes s’onë prej rrymës bolshevike e me i dhanë dorën Qeverisë me autoritetin t’onë fetarë, me fjalën t’onë këshilluese e bindëse, me vazët (predikimet) t’ona ndër xhamia.”*¹¹

Rrethanat e krijuara dhe “koha delikate”, në të cilën po kalohej shtruan nevojën para Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman me në krye Hafëz Sherif Langun që të marrë hapa konkretë rreth rregullimit dhe organizimit të mirëfilltë të degëve fetare në “Tokat e Liruar”. Për këtë qëllim më 10. 05.1943, do të kërkoj nga Ministria e Drejtësisë së shtetit, të dhëna të hollësishme për rregullimin administrativ të Prefekturave, Nënprefekturave dhe Komunave në këto vise. Nga përgjigjja e shkresës dhe lista e dërguar nga ana e kësaj ministrie, më 10.06 1943, shihet se në Rrethin e Gjilanit pos Nënprefekturës vepronin 14 komuna dhe ato: Komuna e Qendrës, Ajnovc, Boston, Vaganesh, Partesh, Parallovë, Pozhoran, Velekinçë, Ropotovë, Rogocicë, Ranilluk, Sllatinë, Kamenicë dhe Hogosht.¹²

Këshilli i Ulemave të Komunitetit Mysliman Shqiptar, në mbledhjen e mbajtur, më 21.07.1943, duke pasur parasysh nevojën urgjente të emërimit të Kryemyftive në “Tokat e Liruar”, pasi shqyrtoi gjendjen në ato vise, mori Vendimin nr.398, për krijimin e dy Kryemyftinive të Zonave me qendër në Prishtinë dhe në Prizren dhe zgjodhi Rexhep Remziun kryemyfti për Prefekturën e Prishtinës dhe Hasan Islamin për Prefekturën e Prizrenit, për të cilët thuhej se janë të pajisur me cilësi të larta për atë detyrë. Njëherësh kishte ngarkuar Kryesinë e këtij Këshilli për t’ia parashtruar Qeverisë Mbretërore për dekretim sipas nenit 24 të Statutit të Komunitetit Mysliman Shqiptar.¹³

Përkundër përpjekjeve të Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman me qendër në Tiranë, për t’u vënë një rregull i plotë i organizi-

¹¹ AQSH, KM, nr.482, d. 109, v.1942, fq.1.

¹² AQSH, f.KM, nr.482, d.23, v.1943, (12.06.1943), FQ. 1,2, 5

¹³ AQSH, KM, nr.482, d.11, v.1943, (21.07.1943)

¹⁰ Ali M. Basha, Islami në Shqipëri gjatë shekujve, Tiranë, 2000, fq.169-170.

mit fetar në “*Tokat e Liruar*”, nga të dhënat dokumentare të kohës shihet se gjatë gjithë kohës pos Statutit të komunitetit, ishin në aplikim edhe ligjet dhe rregulloret e vjetra fetare islame të ish-Ulema Mexhllisit të Shkupit. Kjo aplikohet në rregullat e pranimit të nëpunësve dhe të imamëve në Kosovë, në sigurimin e të ardhurave të tyre nga arka e komunitetit etj. Kështu derisa kryemyftiu i Zonës së Prishtinës Rexhep Remziu, me shkresën nr.19, të datës 10.01.1944, kishte kërkuar ndryshime, mori përgjigjen ashtu me shkrim nr.36, më 10.02.1944, nga ana e Kryetarit të Këshillit të Ulemave Sherif Langu, se tani për tani duhet të vazhdoni si më parë duke porositur “*që t’i urdhëroni të gjithë funksionarët fetarë për të vazhduar në predikimet e tyre me një vullnet dhe energji të plotë*”.¹⁴

Nga korrespondenca e Zyrës së Vakëfit të Komunitetit Mysliman në Gjilan me Komunitetin Mysliman Shqiptar në Tiranë, shihet për parregullsitë që e kishin përfshirë këtë zyrë. Sipas Shkresës së lëshuar nga Zyra e Vakëfit në Gjilan, nr. 217/II të dt. 6.10.1943, me të cilën sekretari i Vakëfit, Hilmi Kallaba, i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme Financiare dhe Vakëfnore - Tiranë, se Këshilli i Vakëfit Mysliman në Gjilan nuk funksionon, nuk mban mbledhjet e nevojshme, ndonëse anëtarët e tij thirren nga “*dhjetë herë, prandaj mbeten veprimet e Vakëfit gjithherë mbrapa...*” Anëtarë të këtij këshilli atëbotë ishin: Abdullah Okllapi, Hasan Sherifi, Tahir Rama-Krça dhe Ibrahim Meha.¹⁵

Me marrjen e kësaj shkrese, Drejtoria e Përgjithshme Financiare Vakëfnore e Tiranës, duke kuptuar se si qëndron gjendja “*n’at Zyrë*”, me një shkresë të veten nr. 242/II, të datës 8.XI. 1943 v., me qëllim të përmirësimit të gjendjes, do t’i drejtohet Kryesisë së Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman-Tiranë, duke e njoftuar se “*n’at Zyrë vazhdon një-çrregullim ndër veprime*”, me lutje “*të shpejtohet emnimi i Myftiut i cili mandej duhet të marri masa për zgjedhjen e një Këshilli të ri*”. - siç thuhet në shkresën e nënshkruar nga Salih Vuçiterni dhe, ai do të jetë Idris Hajrullahu, më parë Bash Vaiz i Ylema Mexhllisit të

¹⁴ AQSH, KM, f.882, d.31, v.1944, fq.5; përgjigje shkresës nr. 19, të 10.01.1944, Kryetari i Kryemyftinisë së Zonës së Prishtinës

¹⁵ AQSH, f. KM, nr.482, d.62., v.1943, fq.4, dhe nr. 882, d. 77, v.1943.

Shkupit. Mulla Idris Gjilani, me vendimin e Këshillit të Ulemave nr. 548, datë 10.XI.1943, emërohet myfti në Gjilan dhe në bazë të Aktit 26 të Statutit të Komunitetit Mysliman, në zyrën e Kryemyftinisë së Zonës së Prizrenit u betua si vijon:

“I nënshkruemi Idris Hajrullahi betohem në emër të Perëndisë se do të jem besnik i shtetit Shqiptar, i Statutit, i Atdheut e se do të kryej detyrën t’eme me ndërgjegje të pastër Kombëtare, tue ruejt besnikriën kundrejt urdhname fetare dhe tue respektue plotsisht Statutin e gjithë rregulloret e Komunitetit.” Akt betimi është bërë më 5 dhjetor 1943 sipas urdhrit të Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman të Tiranës nr. 361/I datë 17.XI.1943.¹⁶ Duhet cekur se detyrën e Myftiut të Gjilanit, Idriz Hajrullahu e ushtronte edhe më parë, për çka flasin shkresat e lëshuara nga zyra e tij me nënshkrim dhe vulën në të cilën është gdhendur shqiponja dykrenore. Ky njëherësh ushtronte edhe detyrën e Vaizit-Predikuesit shëtitës.

Tani e tutje Këshilli i Vakëfit i Gjilanit është më aktiv, fiton cilësi të re të punës, organizimi i tij ngrihet në nivelin e duhur. Në krye të tij qëndrojnë ulematë e dëshmuar, mbrojtësit e kauzës kombëtare për Shqipërinë Etnike. Mulla Idris Hajrullahu si myfti dhe kryetar i Vakëfit në Gjilan së bashku me Haki Taipin-anëtar i Këshillit dhe Myderriz i Medresesë “*Atik*” në Gjilan, së bashku me anëtarët tjerë të Këshillit, i cili ishte i plotë dhe me ndikim, ndërsa besimtarët do të jenë gjithnjë e më pranë tyre.

Po ashtu, këta patriotë kulturëdashës së bashku me sekretarin e Vakëfit të Gjilanit, Hilmi Kallaba, ishin angazhuar në përhapjen në rrethe sa më të gjera të revistës “*Kultura islame*” të Tiranës, në nën-prefekturën e Gjilanit. Për aktivitetin shembullor të tyre dhe të bujarisë së pajtimtarëve, revista në fjalë në numrin e mars-prillit 1944, kishte falënderuar këta dhe 37 abonentë të tjerë të kësaj ane.¹⁷

Për të mënjeluar çdo çrregullim ndër veprime, Kryesia e Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman në Tiranë, i drejtohet me një

¹⁶ AQSH, f. KM, nr. 482, d.14, v.1943, fq.78,79

¹⁷ “*Kultura Islame*”,nr.78, mars-prill 1944

Qarkore Kryemyftinive, Myftinive dhe Zyra të Vakëfit në “*Tokat e Liruar*”, duke i porositur që sa më parë të dërgojnë listat me të dhëna për numrin e popullsisë myslimane të çdo xhemati, numrin e xhamive, teqeve, medreseve dhe mesxhideve, kohën e ndërtimit të tyre etj.¹⁸

Pas pak Inspektoria e Komunitetit Mysliman në Tiranë, më 23.06.1944, kishte përgatitur listat e nevojshme, të përkthyer në gjuhën shqipe, me të dhëna për Këshillat e Xhemateve dhe numrin e shtëpive myslimane, nga rrethveprimi i Këshillit të Ulemave në Shkup, bazuar në raportet të marra nga zyrat e rrethveprimit për vitin 1935.

Nga këto lista shihet se Zyra e Vakëfit e Rrethit të Gjilanit, kishte 25 Këshilla të Xhematit dhe ato ishin:

Këshillat e Xhematit	Nr. i shtëpive	Gjatë LDB
1. “Atik” (Gjilan)	129	Shqipëri
2. Çarshi (Gjilan)	270	-/-
3. Lagja Vis (Deremëhallë)	364	-/-
4. Pidiq	332	Bullgari
5. Bresalc	348	Shqipëri
6. Cërrnicë	334	-/-
7. Sllakovc	283	-/-
8. Pozhoran	327	-/-
9. Smirë	312	Bullgari
10. Lubishtë	381	-/-
11. Llashticë	344	-/-
12. Caravajkë	399	-/-
13. Sllatinë	399	Shqipëri
14. Malishevë	278	-/-
15. Pogragjë	315	-/-
16. Dobërçan	329	-/-
17. Zarbincë	305	Gjysma nën bullgari
18. Rogojicë	408	Shqipëri

19. Hogosht	296	-/-
20. Desivojcë	333	-/-
21. Koretin	286	-/-
22. Kremenat	360	-/-
23. Svirçë	341	-/-
24. Krrilevë	347	-/-
25. Marevc	408	-/-

E njëjta Inspektori, më 27.06.1944, i solli Këshillit të Ulemave tri lista që paraqitnin të dhëna të hollësishme për xhamitë dhe teqet në “*Tokat e Liruar*” në Kosovë. Listat ishin të nxjerra nga raporti i Këshillit të Ulemave të rrethveprimit të Shkupit për vitin 1938/39.¹⁹

Sipas këtyre të dhënave Rrethi i Gjilanit kishte gjithsej 64 xhami; të mbajtura në gjendje të mirë ishin 53 xhami; të rrënuara ishin 10 xhami; gjysmë e rrënuar ishte një xhami; 19 xhami ishin me minare nga guri, kurse 7 minare ishin nga druri; pa minare ishin 28 xhami. Të ndërtuara me material të fortë ishin 52 xhami; prej materialit më të dobët ishin 11 xhami. Qyteti i Gjilanit kishte 4 xhami, ndërsa fshatrat 60 xhami. Qyteti i Gjilanit kishte 4 xhami, ndërsa fshatrat 60 xhami. Xhami të ndërtuara deri në vitin 1912 ishin 45, kurse prej vitit 1912-1930 ishin ndërtuar 7 xhami; prej 1930-40 janë ndërtuar edhe 12 xhami. Nëpunës –imamë ishin 62 veta.

Sipas listës në fjalë Rrethi i Gjilanit kishte gjithsej 7 teqe, nga të cilat 3 teqe të sektit Sadi; 2 teqe Bektashi; 1 teqe Rufai dhe 1 teqe Kaderi. Të gjitha të materialit të dobët. Nga to 5 teqe ishin private dhe 2 të vakëfit.²⁰

Në bazë të urdhëresës nr.150, të datës 18.04.1943, të Kryesisë së Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman në Tiranë, Zyra e Vakëfit të Komunitetit Mysliman në Gjilan, së bashku me shkresën përcjellëse nr.119, më 21.05.1943, i kishte përcjellë për Tiranë dy lista me të dhënat e kërkuara, për imamët e xhemateve që paguheshin nga

¹⁹ Po aty, fq. 21, 24, 25.

²⁰ AQSH, f. KM, nr.482, d.80, v.1944, fq.16,17,18.

¹⁸ AQSH, KM, f.882, d.80, v.1944, fq.19, 32.

arka e komunitetit mysliman dhe listën e xhematëve që paguhen nga populli. Lista mbante datën 21.05.1943, XXI, të përgatitura dhe të nënshkruara nga ana Kryeimamit (Imami disiplinor) të Vakfit Sylejman Jakubi, dhe të vulosura dhe vërtetuara nga Kryetari i Vakfit Shuajib (Shaip)Rexhebi.

Në listën e Xhemateve, që paguheshin nga arka e Komunitetit Mysliman figurojnë 18 imamë dhe këta ishin:

Nr. Xhemati	Emri e mbiemri i imamëve	Emëruar nga	Nr.i dekretit	data e emër.
1. "Atik"-Gjilan	Sylejman Jakubi	Ul. M. i Shkupit	3303/35	14.12./35
2. Dobërçan	Emin Shaqiri	-/-	3090/33	3.11.33
3. Rogoçicë	Shevki Kallaba	-/-	3097/33	3.11.33
4.Derem-Gjilan	Omer Bajrami	-/-	3102/33	3.11.33
5. Malishevë	Mehmed Behluli	-/-	3138/33	27.11.33
6. Koretin	Muharrem Hasani	-/-	3317/35	14.12.35
7. Marevc	Sejfedin Ademi	-/-	3099/33	3.11.33
8. Desivojcë	Tefik Jakubi	-/-	4083/34	6.01.34
9. Hogosht	Faik Behluli	-/-	6201/37	10.03.37
10.Krilevë	Ismail H. Jakupi	-/-	3295/35	14.12.35
11. Pozhoran	Shuqri Sylejmani	-/-	3296/35	14.12.35
12. Cernicë	Vehbi Ilijasi	-/-	3091/33	3.11.33
13. Meshinë	Fetah Rexhepi	-/-	3289/35	14.12.35
14. Çarshi Xh.Gjilan	Ismail Ramushi	-/-	3092/334	27.11.33
15. Sllatinë	Ukshin Hajrullahi	-/-	1558/35	22.07.45
16. Bresalc	Adem Shabani	Ndodhet në shërbim-i propozuar për emërim		
17. Svirçë	Hamza Jakupi	-/-		
18. Sllakovc	Rizah Jusufi	-/- ²¹		

Në shkresën përcjellëse të kësaj liste të xhematëve zyrtare, jepen të dhëna për transferimin e disa imamëve nga një vend në një vend tjetër. Kështu nën numrin 1, dekreti për Sylejmon Jakubin, i cili flet për dekretim në Xhematin Smirë, pas një kohe ishte i transferuar me

²¹ AQSH, f. KM, nr.882, d. 14, fq.73, Zyra e Vakfit në Gjilan, nr.119, (21.05.1943)

nr.3881, të datës 17.10.1938 në Xhematin "Atik" në Gjilan; nën numrin 8, Tefik Jakupi dekreti i të cilit flet për dekretim në Xhematin Krrilevës, pas afër një viti ishte transferuar, me nr.3881, të datës 13.01.1938, në Xhematin e Desivojcës; nën numrin 9, Faik Behluli dekreti i të cilit shkruante për Xhematin e Svirçës, ishte transferuar me nr.3574, të datës 21.09.1937, në Xhematin e Hogoshtit; nën numrin 10, Ismajl Jakubi, dekreti i të cilit këndonte për imam në Xhematin Desivojcë, ishte i transferuar me nr. 3881, të datës 13.01.1938, në Xhematin e Krrilevës dhe numri 13, Fetah Rexhebi dekreti i të cilit shkruante për imam në Xhematin Pidiq, ky pas afër pesë vitesh do të transferohet, me nr. 5599, të datës 30.05.1940, në Xhematin e Meshinës. Ndërkaq, në numrin 16, 17 dhe 18, janë akoma të pa emëruar, por ndodhen me shërbim në këto xhemate zyrtare.²²

Në listën e imamëve të xhematit-imamëve privatë, që paguheshin nga populli, të po kësaj date, figurojnë emrat e 29 imamëve dhe këta ishin:

Xhemati	Emri e mbiemri	Emëruar nga	Nr. i dekretit
1. Xhedid Xhmi-Gjilan	Ndodhet pa imam		
2. Uglarë	Kurtsh Zejnullahu	Ul. Mexh. i Shkupit	8399/10.01.40
3. Bukovik	Ramadan Ejubi	i pa emëruar i vend. me pëlqim të fshatit	
4. Capar	Bejtullah Sylejmani	-/-	
5. Velekincë	Iljas Salihi	Kësh. i Ul.të Tiranës,	nr. 41/d.23.01/43
6. Busavatë	Nevzad Hoxha	i pa emëruar, i vend. me pëlqim të fshatit	
7. Shipashnicë	Ramadan Sallahi,	-/-	
8. Hodonovc	Shevki Rexhepi	Ul. Mexh. i Shkupit,	nr. 3635/40
9. Muqivërc	Fehmi Hasani	i pa emëruar i vend. me pëlqim të fshatit	
10. Kranidell	imami i vdekur dhe ndodhet pa imam		
11. Dajkovc	Kamber Muslia	i pa emëruar i vend. me pëlqim të fshatit	
12. Karaçevë e Epër.	Shauajib Aliu	-/-	
13. Karaçevë e Posht.	Destan Salihi	-/-	
14.Xhed. Xh.Dobërçan	Hafiz Vehbiu	-/-	
15. Topanicë	Rexheb Ademi	-/-	
16. Tërpezë	Ramadan Avdiu	-/-	

²² AQSH, f. KM, d.882, d.14, v.1943, fq.72.

17. Aajkobillë	Ali Osmani	-/-	
18. Tugjec	Ramadan Azemi	-/-	
19. Kopernicë	Ali Idrizi	-/-	
20. Poliçkë	Riza Osmani	-/-	
21. Vriçevc	Ajet Selimi	-/-	
22. Novobërdë	Idriz Ademi	-/-	
23. Makresh	Hasan Januzi	-/-	
24. Verbicë	Avdulla Neziri	-/-	
25. Komogllavë	Asllan Sherifi	-/-	
26. Terstenik	Riza Luta	-/-	
27. Sadovinë	Arif Sherifi	-/-	
28. Zhujë	Islam Hysejini	-/-	
29. Zajçevc	Ed-hem Hoxha	-/- ²³	

Sipas kësaj liste, vetëm numri 2, 5 dhe 8, atëbotë kishin dekretin (vendimin), dy nga Ulema Mexhlisi i Shkupit dhe njëri nga Komuniteti Mysliman në Tiranë.

Nga listat e cituar, të përpiluara më 1943, shihet se në kuadër të Nënprefekturës së Gjilanit, 47 xhami të fshatrave dhe qytetit ishin aktive në të cilat ishin vendosur imamët.

Në këto lista nuk bëhet fjalë për Medresenë “Atik” në Gjilan dhe Myderrizin e saj Haki ef. Sermaxhaj. Në një listë të mëhershme, me nr. 38/41, të datës 16.08.1941, të kërkuar nga Komuniteti Mysliman në Tiranë, të lëshuar nga Zyra e Vakëfit në Gjilan nënshkruar nga Shaip Rexhepi-Myfti, janë të shënuar emrat e 23 imamëve të xhamive si imam zyrtarë të rrethit të Gjilanit dhe të dy myderrizëve të Medresesë së këtushme Haki Taibit dhe Mehmet Sadikut të Groshinës së Shkupit. Në formularët e veçantë pasojnë të dhënat biografike për të gjithë imamët dhe dy myderrizë. Lidhur me biografitë e myderrizëve të këtushëm thuhet: “*Merhmet Sadiku është i lindur më 1907, ka të kryer 4 vjet të shkollës fillore dhe 12 vjet të Medah Medresesë në Shkup, të kryer më 1934. Ky edhe më parë ka qenë Myderriz në Medresen në Gjilani, vendimin e punës e kishte deri më 1.06.1941, kurse rrogën më parë e ka patur nga direksia e Shkupit kurse tani e ka rrogën 500*

dinarë”. Ndërkaq në formularin për myderrizin tjetër Haki Taibin thuhet: “*I lindur më 1914 në Hogosht, me vendbanim në Gjilan, shkolla fillore dhe diploma e medresenë në Shkup (Medah A.S). Studimet i ka mbaruar më 1940. Shërbimin ushtarak e ka të kryer më 1938/39. Edhe më parë ishte myderriz i medresesë në Gjilan. Rroga mujore 1000 dinarë. I pa martuar*”. Pasojnë nënshkrimet.²⁴ Për të gjithë këta thuhet se marrin rroga nga fondi i Komunitetit Mysliman në Tiranë, mirëpo nga shkresat e mëvonshme të Zyrës së Vakëfit në këtë qytet, shihet se si Haki Taibi si Myderriz por edhe disa të tjerë, nuk merrnin të ardhura nga arka e Komunitetit dhe punonin pa kurrfarë pagese, pa kurrfarë shpërblimi.

Të gjithë imamët dhe nëpunësit të emëruar nga ana e Komunitetit Mysliman kishin për obligim me e dhanë betimin e besnikërisë ndaj Perëndisë, Shtetit Shqiptar dhe Statutit të Komunitetit.

²⁴ AQSH, Ministria e Tokave të Liruar, f. nr.167, d.152, v. 1941, Zyra e Vakëfit-Gjilan, nr.38/41 (16.08.1941), Kryetar Shaip Rexhepi.

²³ AQSH, KM, nr. 882, d.1, v. 1943.

Aliriza Selmani

THE IC IN GJILAN DURING WWII

(Summary)

In 1941 most of Kosova and western Macedonia fell under Italian occupation. These territories were annexed to Albania. Fejzi Alizoti was appointed High Commissioner (civil governor) in the “liberated territories”. Initially, two prefectures were established (one in Prishtina and one in Prizren). In September 1941 a third prefecture was established in Peja.

The prefecture of Prishtina contained the sub-prefectures of Gjilan and Ferizaj. The sub-prefect was the highest organ of the civil government in the sub-prefecture. On the other hand, the mayor was the highest organ in the municipality. The sub-prefect was appointed by the Ministry of the Interior in Tirana. The sub-prefect was in charge of the administration, courts, economy, education and culture.

على ريزا سلمان

الوقف الاسلامي في جيلان خلال الحرب العالمية الثانية

(بعض الوثائق عن الوقف الاسلامي في جيلان خلال الحرب العالمية الثانية)

(خلاصة البحث)

بعد احتلال كوسوفا و مكدونيا الغربية من قبل ايطاليا سن 1941 ثم هذه الاراضى الالبانية إلى البانيا المستقلة حسب اتفاقية لندن و تم تكوين ادارة باسم الرابطة العليا للاراضى المحرة و عاصمتها مدينة بريزن و كان على راس هذه الرابطة فيزي على زوتي الذي كان على رأس هذه الادارة. و قد قام بتقسيم الادارة إلى قسمين: بلدية بريزن و بلدية بريشتينا و في شهر سبتمبر من عام 1941م كون بلدية أخرى و هي بلدية بيبا.

TRASHËGIMI

Dr. Hasan Kaleshi

VEZIRI I MADH KOXHA SINAN PASHA – PËRSHPIRTËNIMET DHE VAKËFNAMEJA E TIJ

Në Kosovë ekzistojnë dy xhami që mbajnë emrin “*Xhamia e Sinan Pashës*”: njëra, më e madhja dhe më e njohura në Prizren, dhe tjetra më e vogël dhe më pak e përmendur, në Kaçanik. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me dy objekte shumë të rëndësishme të arkitekturës islame në Kosovë, ngaqë ndërtuesit e tyre kanë qenë personalitete mjaft të njohura, që në kohën e tyre kishin luajtur rol të rëndësishëm në historinë e Perandorisë Osmane - ndërtuesi i xhamisë në Kaçanik ka qenë *Koxha Sinan Pasha*, Vezir i Madh, kurse i asaj në Prizren - *Sofi Sinan Pasha*, bejlerbe i Budimit, për ta në historiografinë tonë, madje edhe në shtyp, është shkruar mjaft. Mirëpo, rreth tyre është krijuar një konfuzion, dhe kështu janë ndërthurur faktet historike dhe legjendat, sa që sot nuk dihet kush është kush, madje është shkruar deri te ajo që ndërtimi i njëres xhami t’i përshkruhet tjetrit, ose të dy këta të merren si një person. Për këtë arsye, konsiderojmë se është e nevojshme që këtë çështje ta sqarojmë, dhe sidomos pasi kam ardhur deri te disa të dhëna të reja, deri tani të panjohura ose të mënjanuara nga shkenca, veçan pasi në dorë më ka renë *Vakëfnameja e Koxha Sinan Pashës*, tekstin kritik të së cilës, së bashku me përkthimin e ko-

mentuar, do ta botojmë këtu. Ç’është e drejta, vetë Vakëfnameja, deri tani e panjohur dhe e pabotuar, meriton të botohet për shkak të rëndësisë së saj të madhe dhe të dhënave të ndryshme që ofron. Duhet theksuar po ashtu se nga numri i shumtë i vakëfnameve të botuara te ne, asnjëra nuk është e Vezirit të Madh. Andaj, si e tillë kjo është e para.

Që kjo çështje të jetë sa më e qartë, në fillim do të ofroj një biografi të shkurtër të *Sofi Sinan Pashës*, ndërtuesit të xhamisë në Prizren, duke mos u ndalur te përshkrimi i xhamisë nga këndvështrimi arkitektonik, sepse për këtë është bërë fjalë.¹

Rrallë për ndonjë xhami dhe ndërtuesin e saj të jenë thurur aq shumë legjenda, tregime e mendime kundërthënëse, sikur për Xhaminë e Sinan Pashës në Prizren dhe në Kaçanik. Udhëpërshkrues të ndryshëm, diplomatë, historianë, studiues të çështjeve kulturore dhe kishtarë, madje edhe gazetarë, duke filluar nga vitet e pesëdhjeta të shek. XIX e deri më sot, kanë shkruar, madje shkruajnë edhe sot, për Sinan pashën dhe përshpirtënimet e tij në Prizren. Mirëpo, personaliteti i tij deri më sot nuk është sqaruar në tërësi. Vetëm Jastrebovi ka bërë përpjekje më serioze që këtë çështje ta sqarojë², edhe pse jo mjaft objektivisht, dhe sukseset e tij pozitive për thyerjen e legjendës, si duket, kanë mbetur akoma të pavërejtura, e sot edhe të harruara, që mund të konstatohet edhe nga artikujt dhe shkrimet më të reja për këtë çështje.³

A thua, vallë, kush është ky Sinan Pasha, për të cilin janë thurur kaq legjenda, dhe si erdhi deri tek ajo që rreth tij të shfaqet konfuzion?! Sipas mendimit tim, shkasin duhet kërkuar kryesisht në faktin se në të njëjtën kohë kishin jetuar dy Sinan Pasha, të lindur në Lumë, në Shqipëri, prej të cilëve njëri, - disa vjet më i moshuar, ka qenë pesë

¹ Husref Redzic, *Pet osmanlijskih gradevina na Kosovu i Metohiji*, “Starine Kosova i Metohiji”, I, Prishtinë, 1961, f. 97-98.

² I. Jastrebov, *Sinan-pasa i Kukli-beg*, Glasnik, SUD XLIII, f. 1-51, Beograd 1876; I njëjti, *Stara Srbija i Albanija*, Spomenik SAN XLI, klasa II, f. 36, Beograd, 1904; I njëjti, *Podaci za istoriju srpske crkve*, Beograd, 1875. Në të vërtetë, në të tre këta artikujt gjenden të dhënat e njëjta.

³ *Spomenici kulture*, Beograd, 1951; Dushan Kostic, *Prizrene stari, kapije otvori*. “Politika” e datës 18 nëntor 1951; Dragan Vukobradović, *U lepom starom Prizrenu*, “Borba”, dt. 13 korriku 1958.

herë *Vezir i Madh* dhe pesë herë *serdar* (komandant suprem i ushtrisë), prandaj ky e kishte lënë në hije famën e Sinan Pashës së dytë, ndërtuesit të vërtetë të xhamisë në Prizren (por jo edhe të asaj në Kaçanik), ndërtuesi i së cilës kishte qenë vetëm *bejlerbe* dhe anëtar i Divanit në rang veziri.

Së pari, të shohim shkurtazi se kush është Sinan Pasha, ndërtuesi i xhamisë në Prizren, që më pastaj të kthehemi te Veziri i Madh, Koxha Sinan Pasha, ndërtuesi i xhamisë në Kaçanik.

Sinan Pasha, i mbiquajtur Sofi Sinan Pasha, është i lindur në fshatin Vilë në Lumë (Shqipëri)⁴, që i takonte sanxhakut të Prizrenit. Për këtë flet qartë “*Kronika*” e Tahir efendiut, e cila ruhet në Zyrën e Vakëfit në Prizren.⁵ Jastrebovi me të drejtë konsideron se fshati Vilë është vendlindja e Sofi Sinan Pashës,⁶ e duke u mbështetur në të, edhe P. Kostiq⁷ thotë se ai është me prejardhje shqiptare. Si arriti Sinan Pasha në Stamboll, këtë nuk e dimë, por nuk duhet mohuar mundësinë që ai të jetë caktuar si devshirmë. Detyra e parë më e madhe e tij kishite qenë pozita e *agait të Stambollit*, e më vonë e *sekban-bashit*.⁸ Sipas Zambaurit⁹, ky Sinan Pasha në vitin 997 (fillon më 20. XI. 1588) kishte qenë për herë të parë *bejlerbe i Budimit*, kurse sipas Syrejasë¹⁰, pasi që u largua nga pozita e sekban-bashit, në vitin 996 (fillon më 10.XI.1589) qe caktuar për *mirahor të dytë*, më pastaj për *koll-qehaja* dhe vetëm në vitin 1003 (1594) kishte fituar pozitën e *bejlerbeut të Kajros*. Por është e sigurt se në vitin 1003 ishte *bejlerbe i Budimit*.

⁴ Ky fshat shtrihet gati dy orë ecje këmbë nga ish kështjella e Dukagjinit, afër malit Korab, jo larg fshatit Kalis. Në shekullin XIX, Kalisi së bashku me fshatrat përreth, përbënin nahi të veçantë në kuadër të sanxhakut të Prizrenit.

⁵ Më gjerësisht për Mehmed Tahir efendiun dhe “*Kronikën*” e tij, shih: Hasan Kaleshi, *Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda*, “Gjurmime Albanologjike”, nr. 1, Prishtinë, 1962, f. 112-113.

⁶ I. Jastrebov, *Sinan Pasha i Kukli-beg*, vep. CIT., f. 6.

⁷ P. Kostic, *Crkveni život pravoslavnih srba u Prizrenu i njegovoj okolini u XIX veku*, Beograd, 1928, f. 24.

⁸ Mehmed Süreyya, *Sicil-i Osmanî*, II, Istanbul, 1890, f. 112.

⁹ E. De Zambaur, *Manuel de Genealogie et de Chronologie pour l'histoire et l'Islam*, Hannover, 1927, f. 168.

¹⁰ Po aty, f. 112.

Përveç Zambaurit, këtë e vërteton edhe Naimi, sipas të cilit, në fillim të muajit dhul-hixhe të viti 1003, biri i Koxha Sinan Pashës, Mehmed Pasha, në cilësinë e serdarit të ushtrisë turke dhe bejlerbeu i Budimit, Sofi Sinan Pasha, ai i Tmishvarit, Mihalixhli Ahmed Pasha, i Sigetvarit, Terjak Hasan Pasha, i Halepit Mahmud Pasha dhe bejlerbeu i Janikut, Osman Pasha, me 10.000 ushtarë kishin arritur në Ostrogon. Ata kishin zënë pozitën përballë armikut, kurse në ditët e mëpastajme qe zhvilluar beteja. Ushtrinë osmane e komandonte Koxha Sinan Pasha.¹¹ Osmanët e humbën Ostrogonin dhe për këtë arsye Koxha Sinan Pasha qe ndërruar.¹² Në vitin 1005, Sofi Sinan Pashën e gjejmë si bejlerbe të Jegrit. Në gjysmën e muajit muharrem të vitit 1007, me rastin e një caktimi të bejlerbeve, Sofi Sinan Pasha nga Jegri qe caktuar bejlerbe i elajetit të Anadollit.¹³ Mirëpo, ka shumë të ngjarë që Sofi Sinan Pasha të mos ketë shkuar atje. Dy muaj pas këtij shtegtimi, osmanët kishin rrethuar Varadin. Që ta pushtonin atë kishin nevojë për topa, sepse me vete kishin vetëm tre sosh. Për këtë arsye, bejlerbeut të Jegrit, Sofi Sinan Pashës, i qe dhënë fermani që t’i bashkëngjitej ushtrisë dhe nga Jegri të merrte me veti dhjetë topa me municion. Mirëpo, kjo ndihmë nga Jegri nuk kishte arritur me kohë, andaj ushtria osmane kishte ndërprerë rrethimin e Varadit, dhe në mënyrë që ta mbronin Budimin, qe-në drejtuar kah Selnuku. Shirat kishin rënë pandërprerë dyzet ditë, urat dhe rrugët ishin shkatërruar, andaj topat nguleshin në baltë. Topat i bartnin përmes lumenjve, duke i tërhequr me trapa. Bejlerbeu i Dija-

¹¹ Naima, *Tarih-i Naima*, I, Istanbul, 1866, f. 194. Ndonëse O. A. Knezheviq (në: *Carsko-turski namjesnici u Bosni i Hercegovini*, Sinj, 1887, f.33-34) thekson se Sofi Sinan Pasha ka qenë bejlerbe i Bosnjës në vitin 1006 (fillon më 14. VIII.1597) dhe se në atë detyrë ai kishte qëndruar gjashtë muaj, me gjithë që, këtë të dhënë nuk kemi mundur ta vërtetojmë. Mirëpo, një pjesë më e madhe e të dhënave që ai përmend janë të pasakta. Duke u bazuar në atributin Sofi, Sufi, ai gabimisht pohon se ka lindur në Sofje.

¹² Këtë fushatë të përbashkët të Sofi Sinan Pashës dhe Koxha Sinan Pashës, Jastrebovi e vendos në vitin 1008, që është e pamundur, sepse Koxha Sinan Pasha kishte vdekur katër vjet më parë.

¹³ Naima, op. cit., I, f.194.

rbakirit, Koxha Murat Pasha, bejlerbeu i Halepit, Mamud Pasha dhe Sofi Sinan Pasha kishin hipur në nga një trap dhe i tërhiqin topat.¹⁴

Nuk e kemi të qartë se çfarë aftësish kishte treguar Sofi Sinan Pasha në këto luftëra në Hungari dhe si bejlerbe i Jegrit, por pas pushimit të Kanixhës, serdari i ushtrisë osmane e kishte dërguar bejlerbeun e Bosnjës, Dervish Pashën, që ta ruante Jegrin, kurse bejlerbeu i atjeshëm, Sofi Sinan Pasha, qe emëruar bejlerbe i Bosnjës. Në këtë detyrë, Sofi Sinan Pasha qëndroi vetëm disa muaj, sepse e kishte zëvendësuar Tahir Mehmed Pasha.¹⁵

Sipas “*Sicil-li-i osmani*”, Sofi Sinan Pasha në vitin 1010-1601 qe shkarkuar nga pozita e bejlerbeut, por, ka shumë të ngjarë që ai edhe më tutje të ketë qëndruar në pozita të larta lidhur me luftërat që qenë zhvilluar në Hungari. Në vitin 1011-1602, pas pushtimit të Stoni Beogradit, serdari i ushtrisë osmane, Jemishxhi Hasan Pasha¹⁶, duke me-

¹⁴ Naima, vep. cit., I, f. 194. Peçevi po ashtu e përshkruan këtë ngjarje. Mirëpo kjo, sipas tij, ka ndodhur në vitin 1008 (fillon më 24.VII.1559), e atëherë Sofi Sina Pasha ka qenë bejlerbe i Anadollisë, në rang veziri.

¹⁵ S. Basagic, *Kratka uputa u proshlost Bosne i Hercegovine*, Sarajevë, 1900, f.53. Se Sofi Sinan Pasha ka qenë bejlerbe i Bosnjës, pajtohen edhe Zambauri dhe Süreyya.

¹⁶ Jemishxhi Sinan Pasha. Të gjitha burimet osmane pajtohen se ai është me prejardhje shqiptare. Mirëpo, ku është i lindur, kjo askund nuk është shënuar. Edhe në “*Islam Ansiklopedisi*” (fasc.V, s. v. Hasan Pasha Jemishxhi), ku deri më tash është botuar artikulli më i vëllimshëm dhe më analitik për të, është thënë se vendi i tij i lindjes nuk është i njohur. Mirëpo, në “*Kronikën*” e Tahir efendiut nga Prizreni (bejti 150), shkruan: “*Jemishxhi-Hasan Pasha badaa min diyarina (Jemishxhi-Hasan Pasha rrjedh nga vendi ynë)*”. Në qoftë se kjo është e saktë, e nuk kemi arsye të mos e besojmë këtë, sepse të dhënat e tij janë tërësisht të sakta, kjo do të thotë se vendin e tij të prejardhjes duhet kërkuar rreth Prizrenit ose në Shqipërinë Veriore. Madje, këtë deri diku e vërtetojnë raportet e Jemishxhi Hasan Pashës me Koxha Sinan Pashën, i cili mjaft e kishte favorizuar. Për këtë gjejmë fakte te Peçeviu (II,145), i cili madje ia sheh për të madhe Koxha Sinan Pashës përse ka treguar përkrahje të madhe ndaj Jemishxhi Hasan Pashës vetëm për faktin se ky ka qenë shqiptar. Funkcioni i parë më i lartë i Jemishxhi Hasan Pashës ka qenë *qeshnegir bashi* (epor i shijuesve të ushqimit), dhe kjo në vitin 1590. Në vitin 1599 qe emëruar *kapuxhi-bash*. Gjatë kohës së luftërave kundër Hungarisë në vitin 1002 (fillon më 27.VII.1593), që i kishte komanduar Koxha Sinan Pasha, Mehmed aga ishte shkarkuar nga pozita e agës së jeniçerëve dhe në vend të tij qe emëruar Jemishxhi Hasan aga. Në këtë pozitë e emëroi Koxha Sinan Pasha. Në vitin 1004 (fillon më 14.08.1597), Jemishxhi Hasan Pasha i udhëhoqi me sukses luftërat në Detin e Kuq. Më vonë e gjejmë se si me shpejtësi përparon. Në vitin 1009 (fillon më 13.07.1600) bëhet kajmekam i Vezirit të Madh. Kur në vitin 1010 (fillon më 2.VII.1601) vdiq Veziri i Madh, Ibrahim Pa-

nduar të shkonte në Erdel, kishte arritur në Budim. Ushtria armike gjendej në vendin Xhigerdelen, përballë Ostrogonit dhe kështu rrezikonte Budimin. Asokohe Sofi Sinan Pasha ishte emëruar për komandant suprem (bashbug) i forcave osmane për ta mbrojtur Budimin.¹⁷ Në vitin 1012-1603, Sofi Sinan Pashës i qe dhënë grada e *vezirit* dhe qe ftuar në Stamboll. Mirëpo, këtë pozitë ai nuk e gëzoi deri në ramazan të të njëjtit vit (shkurt 1603. - shën. përk.), kur me rastin e emërimeve qe ftuar të shkonte në Divanin sulltanor si *vezir i Divanit* (vezir-i kubbe neshin).¹⁸ Kur në fillim të vitit 1013, Veziri i Madh, Ali Pasha, qe nisur për Beograd në luftë kundër austriakëve, ai e kishte emëruar Sofi Sinan Pashën për zëvendës të tij. Mirëpo, ky së shpejti qe shkarkuar nga kjo pozitë, megjithëse sërish qe emëruar, në kohën kur qe likuiduar Saturxhi Mustafa Pasha. Arsyen e shkarkimit të tij nga kjo pozitë, nuk e dimë, edhe pse Jastrebovi, të dhënat e të cilit duhet pranuar me rezervë¹⁹, mendon se kjo qe bërë për shkak të dyshimit se mbante lidhje me kryengritësit në Azi.²⁰

Në periudhën e mëvonshme, për jetën dhe veprën e Sofi Sinan Pashës, kemi të dhëna gjithnjë e më të pakta. Sipas “*Sicil-li-i osmani*”, ai ishte liruar nga detyra për shkak të sëmundjes. Sipas Zambaurit, në vitin 1016-1607 ai ishte emëruar bejlerbe i Bosnjës, por për këtë nuk

sha, Hasan Pasha bëhet Vezir i Madh dhe menjëherë vazhdon luftërat kundër Hungarisë. Asokohe për një farë kohe qëndroi edhe në Beograd. Nga aty qe nisur për në Stoni Beograd, por nuk arriti ta pushtonte. Në fund të të njëjtit vit kishte lënë një pjesë të mirë të ushtrisë në Beograd dhe ishte nisur për në Stamboll, që atje ta rregullonte gjendjen, sepse kishin filluar rebelimet, komplotet dhe intrigat kundër tij. Mirëpo, në vitin 1603, ai qe likuiduar. Të gjithë kronistët osmanë theksojnë se ka qenë mjaft kokëfortë dhe hakmarrës, por theksojnë edhe meritat dhe aftësitë e tij. (“*Islam Ansiklopedisi*”, Hasan Pasha Yemishci; Sami Frashri, “*Qamus al-a’lam*”, III, f.1946-7; disa të dhëna për të ka edhe te Hameri, Jorgu dhe Zinkeiseni).

¹⁷ Naima, vep. cit., I, f.133.

¹⁸ Naima, po aty, I, f.381; Sicil-I-Osmani, vep. cit., III, f. 112.


¹⁹ Të dhënat e Jastrebovit jo vetëm se duhet marrë me rezervë, por as nuk duhet të mbështetemi në to dhe as në citimet e veprave të ndryshme. Kështu, ai thotë: “sipas Hamerit”, duke mos theksuar më asgjë. Ai në punimet e veta shpesh thirret në historinë e Naimit, por si duket as që e ka pasur në duar, por e citon sipas një burimi të tretë. Ai nganjëherë citon librin edhe faqen e historisë së Naimit, e ajo në libër fare nuk ekziston. Ai citon vetëm librin e vetë të dytë, e aty nuk ka asnjë të dhënë për Sofi Sinan Pashën.

²⁰ I. Jastrebov, *Sinan Pasha i Kukli beg*, vep. cit., f. 7.

kemi ndonjë konfirmim tjetër. Sa ka qëndruar në Bosnjë këtë nuk e dimë, por gjithsesi jo më shumë se një vit, sepse në vitin 1017-1608 ai qe emëruar vali në Damask.²¹ Që nga ajo kohë, Sofi Sinan Pashës i humbet çdo gjurmë. Sipas “*Sicili-i osmani*”, ai vdes në të njëjtin vit në Damask, por kjo duhet të jetë e pamundshme, sepse ndërtimi i xhamisë së tij në Prizren përfundon shtatë vjet më vonë. Nuk kemi kurrrfarë arsyesh të besojmë se xhamia është ndërtuar pas vdekjes së tij. Sipas Jastrebovit, ai vdiq gjatë rrugës për në Stamboll, në vitin 1615. Është varrosur nga një mijë hapa larg Galipolit, në vendin Tophane, ku ekziston një tyrbe.²²

Të shohim tani se cilat ishin shkaqet që na shtynë të pohojmë kategorikisht se xhaminë e Sinan Pashës në Prizren e ka ndërtuar Sofi Sinan Pasha dhe jo Veziri i Madh, Koxha Sinan Pasha, siç rëndom thuhet. Para së gjithash, xhaminë nuk ka mundur ta ndërtonte Koxha Sinan Pasha, sepse ajo është ndërtuar në vitin 1024-1615, sa kohë që Koxha Sinan Pasha kishte vdekur njëzet vjet më parë - më 1004-1596. Viti i ndërtimit të xhamisë shihet nga kronovargu “*Misâl-i Xhennet*” (*I ngjanë Xhenetit*), që jep vitin e përmendur më lartë. Ky kronovarg, si edhe vet viti, janë shkruar mbi *mihrab*. Kronovargu është dhënë në “*Kronikën*” e sipërpërmendur të Tahir Efendiut. Përveç kësaj, autori i “*Kronikës*”, Tahir Efendiu, në mënyrë të prerë thekson se këtë xhami e ka ndërtuar Sofi Sinan Pasha. Si duket, edhe në kohën e tij (rreth vitit 1875) ekzistonte një huti rreth ndërtimit të xhamisë, sepse duke dhënë biografinë e shkurtër të Koxha Sinan Pashës, autori i “*Kronikës*” thekson se ky ka lënë vakëfe në Prizren, por “*nuk ka ndërtuar objekte bamirësie në qytetin tonë*”. Dhe fare në fund, në dokumentet zyrtare osmane, kjo xhami njihet vetëm si xhamia e Sofi Sinan Pashës. Kështu në dokumentin nr. 43 të vitit 1281-1864 të një *Sixhili të Prizrenit*, i cili ruhet në Arkivin e Akademisë së Shkencave në Beograd, lexojmë se njëfarë Javuz Mehmed Efendiu, i cili kishte qenë anëtar i Këshillit të Madh të sanxhakut të Prizrenit, “vakëfnon një medr-

ese, të cilën vet ai e kishte ndërtuar, dhe kjo medrese gjendet përballë xhamisë Sofi Sinan Pasha”, sa kohë që në dokumentin nr. 34 përmendet vakëfi i Sofi Sinan Pashës. Kjo medrese quhej “Medreseja e Sinan Pashës”.²³



Xhamia e Sinan Pashës në Prizren

²¹ Mehmed Süreyya, *Sicil-i Osmani*, III, vep. cit., f. 112.

²² I. Jastrebov, vep. cit., *Stara Serbija*, f. 213.

²³ *Salname-i Nezaret-i Ma'arif-i Umumiye III*, 1318, f.1512-3.

Ka shumë të ngjarë që me rastin e ndërtimit të kësaj xhamie të jenë përdorur edhe gur nga Manastiri i Shën Arkangjelit.²⁴ Mirëpo, shtrohet pyetja: A e kishte rrënuar manastirin Sofi Sinan Pasha apo jo? Shumë shkencëtarë dhe disa gazetarë serbë, duke u mbështetur në një farë legjende, pohojnë se Sofi Sinan Pasha e kishte rrënuar atë manastir dhe se gjoja ai kishte urdhëruar që në vend të tij dhe nga gurët e tij të ndërtohej xhamia. Ajo legjendë duket kështu:

“Sinan Pasha i paskësh shkruar një padi sulltanit, në të cilën kishte treguar se në atë manastir fshiheshin plaçkitësit, të cilët vrisnin ushtarët që kalonin atypari. Që t’i argumentonte këto pohime të tij, Sinan Pasha e kishte ftuar anëtarin më me nam të familjes Vujiq në fshatin Llokvicë dhe me të qenkësh marrë vesh që për një shek dukat të grumbullonte nënshkrimet e fshatarëve të krishterë se ata po kërkonin që manastiri të rrënohej. Me të lexuar këtë padi, Sulltani i paskësh lejuar Sinan Pashës rrënimin e manastirit. Por, Sinan Pasha nuk e kishte mbajtur fjalën, dhe në vend të një sheke dukat, ai kishte dërguar Vujiqit një shek me mel të mbuluar me një shtresë dukati. Për këtë arsye, serbët qenë revoltuar, ngaqë kishin “shitur Shën Arkangjelin për një shek mel”, andaj e kishin akuzuar Sinan Pashën te sulltani. Kur sulltani kishte vërejtur se Sinan Pasha e kishte mashtruar, i kishte dërguar një gajtan prej mëndafshi me urdhrin: ”Ose ta rrëronte xhaminë dhe ta rindëronte manastirin, ose le të varej me gajtanin prej mëndafshi që ia kishte dërguar sulltani. Sinan Pasha më me qejf do të varej sesa të rrëronte xhaminë e vet dhe të rindëronte manastirin. Legjenda thotë edhe se xhamia është ndërtuar në formën çfarë e kishte pasur manastiri me një kube të thjeshtë”.²⁵

²⁴ Manastirin e Shën Arkangjelit kishte filluar ta ndëronte Dushani në vitin 1348 dhe ia kishte dedikuar vetit për varr. Manastiri qe përfunduar në vitin 1353. Në vendin ku Dushani kishte muruar përshpirtënimin e vet, ka ekzistuar manastiri bizantin që kishte pasur po të njëjtin emër. Këtij manastiri, Dushani i kishte përshpirtënuar rreth 50 fshatra serbe dhe 10 shqiptare, si dhe 7 kisha me të gjithë njerëzit dhe pasuritë (P. Kostic, vep. cit. f. 121-123; I. Jastrebov, *Stara Serbija*, f. 47-8.

²⁵ Shih, P. Kostic; D. Kostic, artikulli i theksuar nga “Politika”; Dragan Vukobratovic, artikulli nga “Borba”

Sipas mendimit tonë, nga kjo legjendë del një fakt gjithsesi i saktë, dhe ai është se një pasha nuk ka mundur lehtë të rrëronte një manastir të njohur pa lejen e pushtetit qendror. Por, është tjetër gjë nëse manastiri ka qenë i rrënuar dhe i lënë pas dore. Se manastiri në ato vite nuk do t’i këtë shërbyer dedikimit të vet, nuk kemi kurrfarë të dhënash, porse ka qenë i rrënuar dhe i lënë pas dore, kemi të dhëna. Jastrebovi thotë se manastiri në atë kohë ka qenë i rrënuar. Sipas tij, edhe manastiri i Deçanit më se dyzet vjet ka qenë i lënë pas dore, njësoj kishte qenë edhe ai i Graçanicës. Në vazhdim, Jastrebovi, thotë: ”Sofi Sinan Pasha, duke kaluar nëpër Prizren, kishte menduar se do të ishte më mirë që gurët (e manastirit – vër. përkth.) t’i përdorte për vepra të mira, dhe se ai e dinte fort mirë se të krishterët asokohe nuk ishin në gjendje ta rindërontin manastirin, ngaqë ata nuk e kishin ruajtur as nga rrënimi. Kupola e manastirit ishte rrëzuar, kushtet e papërshtatshme gjithnjë e më shumë e kishin ndryshkur”.²⁶ Nga një shkrim i vitit 1519 shihet se manastiri që nga ajo kohë kishte filluar materialisht të rrënohej, sepse igumeni i tij kishte filluar t’i shiste librat e manastirit dhe të vetat, ndërsa murgjit e tjerë ishin përgatitur për ta lëshuar manastirin.²⁷ Ndërkaq, Radomir Grujiq thotë se manastiri kishte filluar të shkatërrohej që nga shek. XV.²⁸ Sipas tregimit të një prizrenasi (myteveli i vakëfit të Kukli begut), të cilin e kishte regjistruar Jastrebovi, Sinan Pasha i kishte blerë gurët, sepse manastiri veç kishte qenë i rrënuar. Sa ka të pavërteta në këto legjenda dhe sa është e rrezikshme të mbështetesh në to, shihet nga fakti se xhamia nuk ishte ndërtuar në vendin ku ishte manastiri dhe se Sofi Sinan Pasha nuk ishte furur (me gajtanin e mëndafshit), por kishte vdekur natyrshëm, se xhamia nuk ishte ndërtuar sipas modelit të manastirit, por sipas modelit të një xhamie në Edrene, tamam siç thotë autori i “Kronikës”, Tahir Efendiu.

E thëna se në ndërtimin e kësaj xhamie janë përdorur gurë të Manastirit të Arkangjelit, i ka dhënë shkas pushtetit të Jugosllavisë së Vjetër që ta rrëronte këtë xhami. Dhe rrënimi vërtet kishte filluar,

²⁶ I. Jastrebov, *Stara Serbija*, vep. cit., f.48.

²⁷ P. Kostic, vep. cit. f. 124.

²⁸ Gërmimi i Shën Arkangjelit tek Prizreni, GSND, I. III, 1, 1926, f. 239.

ishte rrënuar një hajat i madh që ka qenë i mbuluar me tri kupola. Mirëpo, atëherë që ngritur në këmbë populli i Prizrenit, andaj rrënimi që pezulluar. Pas Luftës së Dytë Botërore, kjo xhami është vendosur nën mbrojtjen e shtetit, kurse në vitin 1952, kishte filluar konservimi i saj nga Enti për Mbrojtjen e Përmendoreve të Kulturës të RP të Serbisë. Punët në atë kohë kishin përfshirë fasadën dhe meremetime të vogla në kulmin e xhamisë.²⁹ Punët e mëtutjeshme për konservim i kishte marrë Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të KSA të Kosovës, i cili nuk ka bërë shumë. Para 5-6 vjetëve, restaurimin e këtij monumenti të rëndësishëm e ka marrë mbi vete Enti për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prizren, i cili kreu punime të domosdoshme restaurimi dhe xhaminë e shtroi me qilima. Me qëllim të ruajtjes së dorëshkrimeve orientale me vlerë, të cilat gjendeshin në Tyrben e xhamisë Mehmed Pasha, Enti nga Prizreni kishte ndërtuar disa rafte të mira dhe në xhami kishte ekspozuar dorëshkrimet më të vlefshme, duke synuar që xhaminë më vonë ta shndërronin në koleksion të dorëshkrimeve orientale, të cilat do të grumbulloheshin gjithandej territorit të Kosovës. Mirëpo, si të thuash, sikur është bërë traditë që rreth kësaj xhamie të zhvillohen konteste gjyqësore. Kështu, Bashkësia Islame ka nisur kontestin gjyqësor, duke kërkuar që të largoheshin dorëshkrimet dhe përdorimi i xhamisë t'i kthehej destinimit të vet. Kontestin e ka fituar Bashkësia Islame, edhe pse gjithë çështja akoma nuk është larguar nga rendi i ditës.

Pasi përfunduam ekspozenë për Sofi Sinan Pashën dhe xhaminë e tij në Prizren, kalojmë te Koxha Sinan Pasha, monumentet e tij në Kaçanik, vakëfet dhe vakëfnameja e tij.

Koxha Sinan Pasha, Gazi Sinan Pasha ose Sinan Pasha, "pushtues i Jemenit" (Fatih-i Yemen) është personalitet për të cilin, ndoshta në historiografinë tonë, është shkruar më së shumti. Kjo ka ndodhur sepse ai kishte qenë pesë herë Vezir i Madh, se kishte komanduar shumë fushata ushtarake kundër Austrisë përtej Danubit, se xhamia në

Prizren gabimisht i është përshkruar atij dhe se gjoja ai kishte djegur eshtrat e Shën Savës në Vraçar të Beogradit. Rreth këtij Sinan Pashe janë hartuar shumë legjenda, të cilat mund të dëgjohen edhe sot.

Një ndër të parët që ka shkruar për Koxha Sinan Pashën dhe që e ka futur shkencën në rrugë të gabuar, është P. Srečković.³⁰ Në veprën e tij "Sinan Pasha", ai për Koxha Sinan Pashën tregon legjenda që janë shkruar në kronikën e igumenit të Shën Markut, Aksentiut, sipas tregimit të igumenit të këtij të fundit që kishte dëgjuar nga nëna e tij Jana, së cilës ia kishte treguar nëna e saj, Naranxha (lindur në vitin 1699)! Sipas kësaj legjende, Koxha Sinan Pasha është lindur në fshatin Shajne (më herët Sokolovac) rreth vitit 1530.³¹ Si fëmijë, e që quhej Sinadin (d.t.th. paskësh qenë serb!) ruante bagëtinë në bjeshkë. Një ditë, atypari, i veshur si dervish, kishte kaluar sulltan Selimi I, së bashku me katër dervishë të tjerë, të cilëve iu paskëshin turrur qentë e Sinanit. Por, Sinani u kishte bërtitur qenve të tij dhe ata qenkëshin ulur për tokë si të ishin të groposur. Kjo gjë e paskësh habitur sulltanin dhe kur sulltani e kishte pyetur se si është e mundur që qentë ta dëgjonin kështu, Sinani qenkësh përgjigjur: "Për Zotin, o dervish, më dëgjojnë, që ç'ke më të, dhe jo sikur vezirët e pashallarët që nuk e dëgjojnë sulltanin e tyre, andaj ai nuk mund ta qetësojë vendin dhe kështu kudo është anarki e njëjtë".³²

³⁰ I. Jastrebov, *Sinan pasha*, Beograd, 1865.

³¹ Është e qartë se Berković këtu nuk dallon Sinan pashën prej Kukli-begut. Për Kukli-begun shih: Hasan Kalesi i Ismail Rexhep: *Prizrenac Kukli beg i njegove zadubine*, "Prilozi za orijentalnu filologiju", fl. VIII-IX, 1958-9, Sarajevë, 1960.

³² Të njëjtin tregim për Sinan pashën dhe sulltanin e kamufluar, e ka shënuar edhe Anton Çetta në Drenicë ("*Tregime populllore*", I, Drenicë, Rilindja, Prishtinë, 1963). Ekziston edhe varianti i dytë i kësaj legjende, të cilën e kam shënuar dhe të cilën këtu do ta theksojmë për shkak të disa dallimeve në mes tregimit të Srečkovićit dhe atij të Çettës. "Në pyetjen e sulltanit të kamufluar se si qentë janë aq të dëgjueshëm, Sinani i qenkësh përgjigjur: "Këta janë qentë e Sinanit, e jo ushtarët e sulltanit". Sulltanin kjo e kishte çuditur, andaj kishte kërkuar nga Sinani që t'i bashkohej atij. Sinani qenkësh pajtuar, por me kusht që sulltani ta bënte pashë dhe t'ia lente duart e lira, me të cilat kushte sulltani qenkësh pajtuar. Të parën gjë që Sinani kishte bërë me të arritur në Stamboll, paskësh qenë likuidimi i të gjithë të krishterëve që kishin qenë në pozita të larta në Perandorinë Osmane, kurse nënës së sulltanit, e cila kishte në tepe të kresë kryqin, ia kishte prerë kokën. Sipas kësaj legjende, Sinan Pasha me sulltan Selimin, kishte pushtuar Egjiptin. Por

²⁹ Arh. D. St. [Pavlovic], *Konzervacija spomenika culture muslimanske arhitekture, punime konservuese dhe testuese*, I, I, f. 113.

Kjo përgjigje i paskësh pëlqyer sulltanit, andaj e kishte marrë Sinanin me vete në Stamboll, e paskësh shpallur pasha dhe me 40.000 ushtarë e paskësh dërguar për në Prizren që t'i turqizonte vëllezërit e vet! Kur e paskëshin dëgjuar prizrenasit këtë, me të shpejtë kishin përgatitur një ushtri po ashtu me 40.000 ushtarë dhe i paskëshin dalë para Sinan Pashës, por ky i kishte mundur te Përroi i Zi. Që nga ajo kohë ky përrua kishte filluar të quhej Kara Potok. Ai i paskësh mbytur të gjithë priftërinjtë në Opojë, kurse populli duke mbetur pa klerikë qenkësh turqizuar. Atëherë ai paskësh urdhëruar që nga gurët e kishës së Shën Arkangjelit të ndërtohej xhamia, në mënyrë që kjo kishë të mos u përkujtonte serbëve se kanë pasur perandorinë e vet.³³

Pasi Sreçkoviqi i ofron disa të dhëna historike për Sinan Pashën, shpesh të gabuara e ndokund të ngatërruara me Kukli-begun, dhe duke u thirrur në kronikën e igumenit të sipërpërmendur, thotë se kur Sinan Pasha kishte rënë në pakënaqësi, ka jetuar në sarajin e vet në Opojë,³⁴ se ka vdekur në Prizren dhe se është varrosur pranë xhamisë

edhe atje qenkësh vvarë. Thonë se sulltan Selimi, asokohe paskësh thënë: "Misirin e pushtuam, por Sinanin e humbëm" (Misri fet'h ettik, Sinani kayb ettik)".

Sa është e rrezikshme mbështetja në legjenda, në të cilat personalitetet aq shumë përzihen, tregon edhe kjo fjalë e fundit. Kur sulltan Selimi pushtoi Egjiptin, Sinan Pasha sapo i kishte dhjetë vjet. Në pushtimin e Egjiptit ka marrë pjesë një tjetër Sinan Pashë. Dhe sepse Koxha Sinan Pasha ka vdekur nga vdekja natyrale.

Jastrebovi thekson një tjetër legjendë, sipas të cilës Sinan Pasha ishte duke i ruajtur bagëtinë së bashku me dy shokë. Ata kishin hedhur shortin me kusht që atij që do t'i binte shorti, do të varej. Shorti i paskësh rënë njërit, kurse të tjerët morën litarin dhe e varën. Që të mos vdiste, ata paskëshin dashur që ta lironin, por atëherë paraqitet një ujk dhe nga frika ata paskëshin ikur. I frikësuar për shkak të kësaj vrasjeje, Sinan Pasha paskësh ikur në një vend tjetër, e nga aty paskësh shkua në Stamboll, ku qenka bërë njeri me pozitë të lartë. (Jastrebov, *Sinan Pasha i Kukli beg*, f.11). Legjenda të njëjta për Sinan Pashën mund të gjenden edhe te V. Kacanski, *Bratsvo XXI*, 1927, f. 290-96. Është interesant një pjesë në tregimin që ka shkruar A. Çetta. Sipas asaj, Sinani rrobato i tij prej bariu i kishte ruajtur me zili në një dhomë të vetën dhe kohë pas kohe kthehej në atë dhomë dhe i shikonte, që të evokonte se dikur kishte qenë bari, kështu që të mos krenohet shumë me pozitën e vet.

³³ Vep. cit., f. 79. Është e qartë se këtu përzihet Koxha Sinan Pasha me Sofi Sinan Pashën.

³⁴ Vep. cit. f. 82. Këtu Sreçkoviqi ka përzier Koxha Sinan pashën me Kukli-begun, për se ka konstatuar drejtë edhe Jastrebovi.

së vet. Kurse në vitin 1762 kishte vërshuar Bistrica dhe e kishte marrë varrin e Sinanit.³⁵

Natyrisht që e gjithë kjo nuk ka kurrfarë lidhje me të vërtetën historike. Qysh herët, Jastrebovi ka vërtetuar se Koxha Sinan Pasha ose Sinan Pasha "Pushtues i Jemenit" (Fatih-i Jemen) është lindur në fshatin Topojan të Lumës (Shqipëri)³⁶ dhe jo në Prizren, siç pohohej deri atëherë. Në bazë të çfarë të dhënave ka ardhur Jastrebovi deri te ky konstatim, këtë nuk e dimë, por ne për këtë kemi disa të dhëna të reja. Në "*Kronikën*" e përmendur të Tahir Efendiut në kreun "*Kronika e Vezirit të Madh, gaziut dhe pushtuesit të Jemenit, Sinan Pashës*", shkruan: "*E quajnë Sinan Pasha. Është me prejardhje nga Topojani. E ka pushtuar Jemenin...*"³⁷

Në Vakëfnamenë e birit të Koxha Sinan Pashës, Mehmed Pashë Kaçanikut, e cila është legalizuar në Shkup në vitin 1609, shihet se djali i Sinan Pashës sonë, Mehmed Pasha, kishte vakëfnuar pasuri në Topojan,³⁸ nga se mund të përfundohet se aty (në Topojan –shën. përk.) ata kishin pasur pasuri të tyre, gjithsesi të trashëguar, sepse pasi që Sinan Pasha ishte bërë Vezir i Madh, nuk do të blinte pasuri në një vend të tillë të paperspektivë të Lumës. Përveç kësaj, Mehmed Pashë Kaçaniku në fshatin e vet e përmend edhe axhën e tij, d.t.th. vëllanë e Koxha Sinan Pashës, me emrin Hysen beg, nga i cili kishte blerë çifligun që tani e vakëfnonte. Në këtë fshat (Topojan) ishte ndërtuar edhe *mesxhidi*, kurse Mehmed Pasha imami dhe myezinit i caktonte pagën ditore prej tri, respektivisht dy akçeve. Kjo do të thotë se këtë mesxhid e kishte ndërtuar vetë Mehmed Pasha ose babai i tij, Koxha Sinan Pasha. Nga ana tjetër, fshati Topojan i takonte sanxhakut të Prizrenit, edhe pse i qe bashkuar kadillëkut të Dibrës. Kjo, me siguri e ka shtyrë Jorgun që vendin e lindjes së Sinan Pashës ta shpinte në Di-

³⁵ Vep. cit. f. 83.

³⁶ Ky fshat gjendet në rrethin e Lumes, në anën lindore të malit Golesh, pesë orë këmbë në juglindje të Kullës së Lumes, e cila gjendet në rrugën Prizren-Ura e Vezirit (Jastrebovi, *Podaci*, f. 100).

³⁷ Teksti arabisht thotë: *Yukalu Sinan Pasha ve asluhu Topoyan wa qad fataha l-Yaman...*

³⁸ Hasan Kalesi-Mehmed Mehmedovski, *Tri vakufnami na Kacanikli Mehmed pasa*, Skopje, 1958, f. 73.

bër,³⁹ mendimin e të cilit e kishte pranuar edhe Babingeri.⁴⁰ As njëri dhe as tjetri nuk janë larg të vërtetës. Në “*Kronikë*” thuhet se afër fshatit të tij ka ndërtuar ujësjellësin, e në rrethinë ka lënë shumë vakëfe.

Natyrisht, menjëherë shtrohet çështja e prejardhjes së Koxha Sinan Pashës. Në bazë të një fermi, me të cilin Sinan Pasha lironte nga tatimi rajën e fshatrave Qajle, Flura (Lura) të Topojanit, Kalimashit dhe Baleshqit, Jastrebovi nxjerr përfundimin se Sinan Pasha është me prejardhje sllave, sepse osmanët vetëm ortodoksët i kanë quajtur rajë.⁴¹ Ky pohim i Jastrebovit, është tërësisht jo i saktë, sepse osmanët i kanë quajtur rajë të gjithë shtetasit e vet pa marrë parasysh besimin. Kështu, pikërisht te Naimi, në historinë e të cilit thirret Jastrebovi, kemi një varg rastesh se si populli i Egjiptit mbiquhej ra’aya-i Misr, edhe pse egjiptianët ishin myslimanë. Vetëm nga shekulli XVII lind në një masë diferencimi. Duke e ndjekur Jastrebovin, në të njëjtin gabim kanë rënë edhe të tjerë që kanë shkruar për Sinan Pashën.⁴² Nga ana tjetër, të gjithë historianët turq,⁴³ të hershëm e bashkëkohorë, dhe ata evropianë,⁴⁴ e kanë të qartë se Sinan Pasha është me prejardhje

³⁹ *Geschichte des Osmanischen Reiches*, III, f.170. Ai thotë se Sinan Pasha është biri i një fshatari nga Dibra.

⁴⁰ *Enzyklopaedie des Islam*, IV, f. 463-4, pjesa: Sinan Pasha (1 Koxha Sinan Pasha). Përndryshe, kur kam shkruar në një punim në të cilin kam ofruar argumente se Sinan Pasha ka lindur në Topojan, me se kam demantuar pohimet e Jorgos dhe Babingerit, prof. Babingeri më ka shkruar dy letra, mbase të ashpra, duke kontestuar kështu konstatimet e mia. Por kur i kam botuar dy argumente (Gjurmime albanologjike, nr.2, Prishtinë, 1965), Babingeri më ka dhënë të drejtë dhe më ka thënë se rezultatet e mia do t’i fus në botimin e ri të Enciklopedisë Islame. Pohimet e mia po ashtu janë pranuar edhe në artikullin për Sinan pashën në Islam Ansiklopedisi.

⁴¹ I. Jastreov, *Sinan Pasha i Kukli beg*, vep. cit., f.15. Jastrebovi shkon aq larg sa që pohon se Sinan Pasha rrjedh nga një familje fisnike serbe dhe se ka sunduar me ato fshatra mbi të drejtën që kishte trashëguar nga të parët. Për respekt që ua kishte falur atyre fshatrave, raja kishte kaluar në Islam (Jastreov, *Stara Srbija i Albanija*, f. 216).

⁴² P. sh. B. Nusic, *S Kosova na sinje more*, Novi Sad, 1902, f. 38.

⁴³ Peçevi, vep. cit., II, f. 16 dhe më tutje; Sh. Sami Frashëri, *Qamus al-a’lam*, IV, f.2635; Mehmed Süreyya, *Sicil-i-i Osmani*, III, f.109.

⁴⁴ Hammer, *Geschichte des Osmnischen Reiches*, Regjistri IV, 897; Jorga, vep. cit. III, f. 170; Babinger, vep. cit., f. 463.

shqiptare. Edhe Glisha Elezoviq pohon se ai është shqiptar.⁴⁵ Është e guximshme të pohosh se osmanët nuk kanë ditur t’i dallonin shqiptarët prej serbëve, siç mendon Jastrebovi.⁴⁶ Sepse, që nga kronikat më të vjetra osmane, sa herë që përmenden serbët, përmenden edhe shqiptarët, ngaqë osmanët i kishin mbajtur mend mirë shqiptarët që nga Skënderbeu.

Mirëpo, në qoftë se kjo çështje është e qartë, nga ana tjetër, nuk është e sigurt nëse Sinan Pasha është marrë si i krishterë apo si mysliman. E pamë se versionin serb i legjendës e tregon si një të krishterë (Sinadin), kurse ai shqiptar si mysliman (Sinan). Gati të gjithë historianët janë të mendimit se ai është marrë si i krishterë dhe është sjellë në Stamboll. Në këtë mendim deri vonë kam qenë i bindur edhe unë, por nga momenti që kam gjetur Vakëfnamenë e tij, kam ardhur te konstatimi tjetër. Në të vërtetë, në Vakëfname theksohet qartë emri i babait të tij, i cili është quajtur Ali, që do të thotë se ky ka qenë mysliman.⁴⁷ Po të kishte qenë i ati i Sinan Pashës i krishterë, atëherë në këtë dokument, që është hartuar gjatë kohës së tij, ose nuk do të ishte përmendur emri i tij ose do të ishte mbiquajtur Abdullah (rob i Zoti), siç ka qenë zakoni ta shkruanin për prindërit e tyre ata që ishin marrë si devshirme, kurse prindërit i kishin të krishterë. Me këtë rast, vetëm mund të supozohet se babai i Sinan Pashës e kishte pranuar fenë islame, kur biri i tij tashmë kishte arritur deri te një pozitë aq e lartë, por do të ishte edhe më e besueshme se ai është marrë devshirme si mysliman, sepse raste të tilla ka mjaft në mesin e shqiptarëve. Mirëpo, nuk duhet përrjashtuar mundësinë që ai të jetë marrë nga saraji drejtpë-

⁴⁵ G. Elezovic, *Nekretna dobra Ahmed paze Hercegovica*, Prilozzi za orijentalnu filologiju I, Sarajevë, 1950, f. 80.

⁴⁶ Vep. cit., f.15.

⁴⁷ Në një artikull të shkencëtarit turk Tahsin Ozi për arkivin e Koxha Sinan Pashës në Topkapi Saraj (Topkapi Sarayı Müzesinde Yemen fatihi Sinan Pasha Arsivi, Belleten X, Ankara, 1946, f.171-193) ku është dhënë lista e dokumenteve të Koxha Sinan Pashës, gjejmë po ashtu se babai i tij është quajtur Ali dhe se ka pasur titullin beg. Edhe këtu emri i tij përmendet në vakëfname, në origjinalitetin e së cilës nuk mund të dyshohet.

rdrejt, sepse për këtë ka mund ta përkrahte vëllai i tij më i vjetër, Ajas Pasha, i cili ishte bejlerbe.⁴⁸

Përveç kësaj, nuk dimë se çfarë pozite ka pasur Koxha Sinan Pasha në administratën dhe ushtrinë osmane. Gjatë kohës së sulltan Sylejman Kanuniut ka qenë *qeshnegir-bash* (*shef i kontrolluesve të ushqimit*), kurse më vonë qe bërë *sanxhakbej* i Malatisë, Kastamunit, Gazës, Tripolit të Sirisë, Erzurumit dhe Halepit. Në pranverë të vitit 1568 ishte caktuar mëkëmbës i Egjiptit. Për qeverisjen e tij në Egjipt, nga kishte nisur fushatën pushtuese kundër Jemenit të rebeluar dhe të cilin serish ia nënshtroi Perandorisë, ekzistojnë një serë veprash në gjuhën arabe dhe osmane në dorëshkrim, nga të cilat më të rëndësishmen e ka botuar Hamed al-Xhesir në Riad të Arabisë Saudite.⁴⁹ Sipas këtij burimi, Sinan Pasha në të njëjtin vit (1571) qe nisur për në Medinë, e nga këtu për në Jemen. Nga Jemeni e kishte dërguar një kontingjent ushtarak për në Aden dhe më pastaj e kishte pushtuar atë. Për vali të këtij qyteti e kishte caktuar djalin e vëllait, Hasanin. Më pastaj, njërën pas tjetrës, kishte filluar pushtimin e disa krahinave: Tazin, Sanën në viset malore, i kishte nënshtuar fiset arabe dhe Jemenin në tërësi. Kah mesi i vitit 1571, përmes detit, qe kthyer në Xhide, e nga këtu kishte vazhduar për në Mekë, ku kishte kryer haxhillëkun dhe kishte ndërtuar një seri vakëfesh, prej të cilave disa janë ruajtur edhe sot. Në të njëjtin vit ishte kthyer në Kajro dhe kishte dhënë urdhrin që të pastrohej kanali për ujitje nga Kajroja deri në Aleksandri, i cili kishte dalë nga përdorimi. Në të njëjtin vit po ashtu kishte përfunduar ndërtimin e xhamisë së tij në paralagjen Bulak të Kajros, e cila ekzistonte edhe sot. Xhamia ka një kube të madhe, tri dyer dhe tri galeri. Për dallim nga minaret arabe, në këtë xhami është ndërtuar minarja e tipit

⁴⁸ Të dhëna më të qarta për vëllain më të vjetër të Koxha Sinan Pashës, Ajas Pashën, nuk kam mundur të grumbulloj. Dihet se ishte bërë vali i Bagdadit në vitin 1545 dhe në atë cilësi ndërmori fushatën ushtarake kundër Basras. Më pastaj kishte fituar titullin vezir, kurse në vitin 1549 qe bërë vali në Dijar Bekir. Meqë gjatë rebelimit të Shehzade Bajazidit, si vali i Erzurumit, i kishte ndihmuar rebelët, ai qe likuiduar në vitin 1559. Bijtë e tij kanë qenë Mehmed Pasha dhe Mustafë Pasha. (*Peçeви I*, 32; *Sicil-I-i Osmani I*, 447).

⁴⁹ Qutbu d-Din Muhammad ad-Dahrwaili al-Makki, *Gazawat ul-Garakisa wa l-Atrak fi gunubi l-Gazira*, ar-Riyad, al-Mamlaka al-Arabiya as-Su'udiya, 1967.

osman.⁵⁰ Si duket, xhaminë e ka ndërtuar me pasurinë që kishte grumbulluar në Jemen, sepse kur pas Jemenit kishte arritur në Stamboll, ai kishte sjellë pasuri të mëdha, ishte pritur si hero dhe i qe dhënë titulli *gazi*.⁵¹ Në pranverën e 1574 kishte komanduar ushtrinë osmane në fushatën kundër Tunizisë, së bashku me kapitenin Këllëç Ali Pasha. Gjatë rrugës kishin pushtuar disa vende dhe kishin zbarkuar në bregdetin e Tunizisë. Spanjollët ishin fortifikuar në fortifikatën Halk ul-vad (La Goleta). Ushtria osmane e kishte rrethuar atë fortifikatë dhe një muaj, ditë e natë, e kishte bombarduar dhe më në fund e kishte pushtuar me sulm. Me këtë edhe Tunizia i qe bashkuar Perandorisë.⁵² Në Stamboll Sinan Pasha qe kthyer si vezir. Në pranverën e 1580 kishte udhëhequr ushtrinë osmane kundër Gjeorgjisë. Në të njëjtin vit (më 25 gusht) qe caktuar kryeministër (Vezir i Madh), në vend të Ahmed Pashës, i cili vdiq. Gjeorgjia ishte pushtuar, por mbeti e panënshtuar, kështu që pikërisht para përfundimit të luftës, qenë paraqitur vështirësi që ishin bërë shkas që Sinan Pasha të shkarkohej dhe të ndiqej në Dimotok (më 5 dhjetor 1582). Me përkrahjen e grave dhe me ryshfetin prej 100.000 dukateve së shpejti kishte arritur sukses dhe në vend që të ishte dëbuar në Malgarë, ai qe bërë vali në Damask, nga i cili në prill 1589 qe kthyer në Stamboll si Vezir i Madh.⁵³ Edhe pse larg nga vendlindja - Luma, ai kurrë nuk e kishte harruar atë. Me lutjen e tij, në dekadën e parë të muajit rebiul-ahir të vitit 994 (22-31. III. 1586) Sulltan Murati III, kishte lëshuar një ferman, me të cilin banorët e pesë fshatrave, që ishin pronë e Sinan Pashës, liroheshin nga të gjitha tatimet. Ajo pjesë e fermanit, thotë:

“Ish-Veziri im i Madh, tani nga ana ime i caktuar vali i vilajetit të Damaskut, Sinan Pasha, me qëllim që të bëjë vepër të mirë për fshatrat e tij: Qajle, që për çdo vit i sjell të ardhura 6.000 akçe, Fluri 4.000 akçe, Topojani 5.000 akçe, Kalimashi 8.000 akçe, Beleshqeja, të cilën e ka blerë Sinan Pasha nga spahiu Lutfi me të ardhura prej 3.000 ak-

⁵⁰ Wizaratu-l-awqaf masagidiha, al-Qahira

⁵¹ Sh. S. Frashëri, *Qamus al-a'lam IV*, f.2634, 52; Peçeви I, vep. cit., f. 502.

⁵² Peçeви I, vep. cit., f. 502.

⁵³ *Enzyklopaedie des Islam*, IV, f. 464-5; Jorga, GOR III, f. 171.

çeve, me të gjitha malet, arat, kopshtet, pyjet, që janë në kufij të atyre fshatrave, - ua dhuron në shfrytëzim të përhershëm banorëve të këtyre fshatrave, rajës. Për vërtetimin e kësaj, e lëshoj këtë ferman dhe urdhëroj që nga banorët e fshatrave të lartpërmendur askush të mos guxojë të marrë yshyrin, as tatim në dele dhe kurrfarë tatimi tjetër nga tokat, të cilat tani janë bërë pasuri e rajës”.⁵⁴

Në “*Kronikë*” shkruan se këto fshatra Sinan Pasha i kishte blerë nga arka shtetërore (Bejtu-I mal).

Pasuria e madhe i kishte dhënë mundësi Sinan Pashës që të harxhonte dhe me të t’i blente shumë personalitete.⁵⁵ Ai sërish i qe përveshur punës që, me ndihmën e një kanali që do të gropohej nga deti te vendi Sabanxhë kah Gjiri i Nikomedisë, të realizonte planin e vjetër për vendosjen e lidhjeve mes Detit të Zi dhe të Gjirit të Nikomedisë. Për shkak të luftërave, kjo ndërmarrje e tij kolosale nuk qe realizuar, për ç’arsye më 20 gusht 1591 Sinan Pasha sërish kishte rënë në mëshirën e sulltanit dhe qe shkarkuar nga pozita. Mirëpo, më 29 janar 1593, me rastin e një rebelimi të jeniçerëve, qe ftuar për të tretën herë në pozitën e Vezirit të Madh. Nga ajo kohë, Sinan Pasha kishte bërë përpjekje që të gjahtonte në perëndim të Perandorisë, para së gjithash në Hungari. Në pranverën e 1593, kishte komanduar ushtrinë në betejën në Hungari. Këtë luftë e kishte përfunduar duke pushtuar një varg qytetesh dhe kështjellash. Asokohe e kishte pushtuar Pollatën dhe në të njëjtin vit kishte kaluar dimrin në Beograd. Si duket, me këtë rast e kishte kallur Zemunin dhe kishte vendosur tatim për mullinjtë e Beogradit.⁵⁶ Në Beograd kishte qëndruar deri në pranverën e vonë të vitit 1594.

Një muaj pas vdekjes së Sulltan Muradit III (27. I. 1595), Sinan Pasha qe detyruar serish që të largohej nga pozita dhe me 300.000 akçe të pensionit vjetor qe detyruar që përsëri të largohej për në Malga-

rë, por vetëm për disa muaj. Sepse, më 7 korrik të të njëjtit vit Sinan Pasha e kishte zëvendësuar bashkëvendësin, rivalin dhe familjarin e tij, Ferhat Pashën,⁵⁷ kurse disa javë më vonë kishte filluar fushatën ushtarake kundër Vllahisë, e cila ishte rebeluar.⁵⁸ Në atë kohë, Koxha Sinan Pasha për serdar të ushtrisë osmane e kishte emëruar birin e vet, Mehmed Pashën, dhe me një ushtri e kishte dërguar në Kran. Mirëpo, ushtria osmane aty kishte pësuar humbje të plotë, të cilën Sinan Pasha ia veshte qëndrimit qyqar të Mehmed Pashës, i cili ishte tërhequr dhe kthyer në Budim.⁵⁹ Për më tepër, në gjithë atë fushatë në Vllahi nuk ishte arritur kurrfarë suksesi. E gjithë kjo u bë shkak që Koxha Sinan Pasha më 19 nëntor 1595 sërish të shkarkohej dhe të internohej në Malgar. Mirëpo, kur pasuesi i tij, Lala Mehmed Pasha vdes disa ditë pas emërimit, sërish qe ftuar Koxhai i Vjetër - Sinan Pasha dhe kështu atij për të pestën herë i qe dorëzuar vula e Vezirit të Madh. Edhe pse tetëdhjetëvjeçar, ky “*shqiptar i pazbutur*”, siç e quan Hameri, kishte menduar që serish të nisej në fushatë luftarake kundër Habzburgeve, por ishte vdekja ajo që e pengoi më 3 mars 1596.⁶⁰ Sinan Pasha u varros në tyrben e tij, në lagjen Sifiler në Stamboll.⁶¹

Kronistët turq nuk shkruajnë mirë për shumë çështje të Koxha Sinan Pashës, edhe pse i përmendin meritat e tij të mëdha për Perandori-

⁵⁷ Ferhat Pasha me prejardhje është shqiptar. Ka qenë dy herë Vezir i Madh. Detyra e vërtetë më e madhe e tij ka qenë kapuxhibash, pastaj mirahor i parë, bejlerbe i Rumelisë, kurse në vitin 1578, në luftën kundër persianëve u bë serdar. Në këtë luftë ai i mundi persianët. Kur në vitin 1591 për të dytën herë Koxha Sinan Pasha u shkarkua nga detyra e Vezirit të Madh dhe në vend të tij erdhi Ferhat Pasha. Pas tetë muajsh edhe ky u shkarkua. Me ardhjen në fron të sulltan Mehmedit III (1595), Ferhat Pasha për të dytën herë u bë Vezir i Madh. Asokohe u nis në luftë kundër Hungarisë. Ai ndërtoi urën mbi Danub. Por pikërisht kur duhej të nisej për në luftë, u shkarkua nga detyra, u kthye në Stamboll dhe pas një kohe u likuidua. Duket se kishte rënë pre e rivalitetit me Koxha Sinan Pashën.

⁵⁸ Enciklopedia Islame, në të njëjtin vend.

⁵⁹ Në të vërtetë, ky është Mehmed Pashë Kaçanikliu, për të cilin do të bëhet fjalë më poshtë.

⁶⁰ Peçevi II, vep. CIT., f. 165, kurse sipas disa burimeve evropiane më 3 prill 1596.

⁶¹ Në *Qamus al-a'lam*, shkruan Sedefqiler (IV, f.2634). Pikërisht në lidhje me vdekjen e tij mund të shihet se sa mund të jenë legjenda të pabesueshme. Sipas legjendës, ai është varrosur pranë xhamisë së vet në Prizren dhe uji ia ka bartur kufomën.

⁵⁴ Përkthimin e këtij fermi e ka bërë Jastrebovi (në veprën: *Sinan Pasha i Kukli beg*, f. 14). Pasi nuk e kemi këtë ferman, atëherë përkthimin e kësaj pjese e kemi dhënë sipas tij, me disa ndryshime gjuhësore.

⁵⁵ Hammer, GOR IV, f. 187.

⁵⁶ Peçevi, I, f. 15.

në Osmane. Ata thonë se ka qenë i ashpër, mendjemadh e hakmarrës. Peçevi, nganjëherë e quan “*Arna’ud na’ud*” (*shqiptari kokëfortë*).⁶² Jorga konsideron se ai ka qenë i fundit nga më të mëdhenjtë e periudhës së shkëlqyeshme të Perandorisë Osmane.⁶³ Peçevi po ashtu ia sheh për të madhe përse i ka ngritur shqiptarët në pozita të ndryshme. Kështu, ai në një vend, shkruan: “Në luftërat në Hungari, para rrethimit të Janikut, agallarët jeniçerë u caktuan si suitë të Sinan Pashës, që kjo deri atëherë nuk kishte qenë adet. Ai, pas rënies së Kështjellës së Tatës, e shkarkoi agën e jeniçerëve, Mehmed agën, dhe në vend të tij e emëroi Jemishxhi Hasan Pashën, i cili ishte nga radhët e shqiptarëve”.⁶⁴ Duke iu falënderuar atij, shumë shpejt përparoi edhe djali i tij, Mehmed Pashë Kaçanikliu.

Koxha Sinan Pasha, si përfaqësues tipik i qarqeve më të larta feudale të Perandorisë, në mënyrë të veçantë ka tërhequr vëmendjen e disa historianëve perëndimorë, për shkak të pasurisë së tij dhe shfrytëzimit të pushtetit për pasurim personal. Kështu p.sh., në tregimet e Dicës, është vështirë të pohosh se ç’është realitet e ç’është legjendë.⁶⁵ Duke u gjetur rreth dyzet vjet në pozitat më të larta shtetërore, nga ato rreth pesëmbëdhjetë vjet Vezir i Madh dhe komandant suprem, ai ka mundur të arrinte pasuri të mëdha. Haset e tij shtriheshin në sanxhaqet e Pashës (Manastir, Kesri, Demir Hisar, Serez, Lerin, Plovdiv), Nikopol, More, Janinë, Tirhali, Vlorë, Smederevë, Krushec, Silistri, Konjë, Akshehir, Aksaraj, Nigde, Agribozu, Marash dhe Ajdin. Këto hase i sillnin 2.263.680 akçe në vit, natyrisht, derisa ishte Vezir i Madh.⁶⁶ Sipas burimeve, Sinan Pasha kur ka vdekur ka lënë 600.000 dukatë ari dhe 29 milionë akçe argjendi.⁶⁷ Që të kuptohet se sa është kjo shumë,

⁶² Duket se Hammeri shprehjen “der halstarrige Albaneser” (Shqiptari kokëfortë) e ka marrë nga Peçevi.

⁶³ GOR III, f. 171.

⁶⁴ Peçevi II, vep. cit., f. 145. Kronisti arab për Sinan pashën po ashtu thotë se ka qenë i ashpër por i drejtë. “Njëra prej cilësive më të mira të tij ka qenë mbajtja e fjalës së dhënë dhe plotësimi i premtimit”. (Gazawat-al-Garakisda, f. 230).

⁶⁵ Shih: *Diez Denkwürdigkeiten von Asien*, Bd. I, Berlin, 1811, f. 101-103.

⁶⁶ B. P. Mutaftchieva, *Opis hasov velikogo vezira Sinan pashi*, Vostoqnie istocnicke po istorii narodov Jugo-vostocnoj i cantralnoj Evropi, Moskë, 1964, f. 238.

⁶⁷ Po aty, f. 102.

do të përmendim se në vitin 1592, sipas pohimit të Lorn Bernardit, të ardhurat e përgjithshme të Perandorisë arrinin 10 milionë dukatë ari.⁶⁸

Emri i Koxha Sinan Pashës është i lidhur ngushtë me Kaçanikun dhe ndërtimin e tij. Të dhënat për këto i kemi që nga Evlia Çelebiu, i cili thotë se Koxha Sinan Pasha e ka ndërtuar Kalanë e Kaçanikut.⁶⁹ Përveç Kalasë, nga Vakëfnameja, që këtu po e botojmë, kuptojmë se Sinan Pasha në Kaçanik ka ndërtuar një xhami, - atë që ekziston edhe sot, një imaret (kuzhinë popullore), dy hane, një shkollë dhe një hamam.⁷⁰ Ajo që është më e rëndësishme, për të funksionuar xhamia, shkolla dhe kuzhina, ai i ka përshtetur jo vetëm objektet (dy hane dhe hamamin) në Kaçanik, po edhe pasuri të mëdha në vende të tjera. Ç’është e vërteta, tërë Vakëfnameja, të cilën këtu po e botojmë, ka të bëjë me këto objekte fetare-sociale në Kaçanik. Nga të gjithë vakëfet, nuk është ruajtur asgjë dhe për to asgjë nuk dihet, kështu që kjo Vakëfname është burim i vetëm.

Është e domosdoshme të ofrojmë disa të dhëna edhe për djalin e Sinan Pashës, Mehmed Pashë Kaçanikun, i cili ka pasur shumë vakëfe në vendin tonë, të cilin, në bazë të Vakëfnameve të tij, ne jemi të parët që e identifikuar si djali i Koxha Sinan Pashës.⁷¹ Në të gjitha kronikat turke, e përmes tyre edhe te historianët evropianë, Mehmed Pasha përmendet si djali i Koxha Sinan Pashës, por për Mehmed Pashë Ka-

⁶⁸ E. Alberi, *Realizioni degli ambasciatori veneti al senato*, seria III, Vol. I, Firenze 1840, f. 349-350.

⁶⁹ Siyatname V, f. 552: “Aty në grykën e lumit Lepenc, pushtuesi i Jemenit, Sinan Pasha, ka ngritur një kala katërkëndëshe të fortë dhe madhështore që ka tetëqind hapa në perimetër”. Se Sina Pasha është ndërtues i Kaçanikut, kemi argumente edhe në Vakëfmenë e Mehmed pashë Kaçanikliut, ku shkruan: “Në grykën me emrin Kaçanik (kam vakëfnuar) mullirin prej tre gurëve në lumin e përmendur të Lepencit, i cili rrjedhë mespërmes vendbanimit të quajtur Kaçanik, të cilin (vendbanim) e ka ndërtuar bamirësi im dhe shkaktari i përparimit tim, i ndjeri dhe nga Zoti i falur, Sinan Pasha...”. (H. Kalesi - M. Mehmedovski, *Tri vakufnami na Kacanikli Pasha*, vep. cit., f. 27).

⁷⁰ Përveç xhamisë, Evlia Çelebiu nga përmendoret e rëndësishme në Kaçanik përmend edhe një teqe bektashiane, shkollën fillore, hanin e madh dhe hamamin e vogël, por ai nuk thotë se i ka ndërtuar Sinan Pasha. Shumë objekte i ka ndërtuar edhe Mehmed Pashë Kaçanikliu, por Evlia Çelebiu aspak nuk e përmend Mehmed pashë Kaçanikliun, dhe as ndonjë prej vakëfeve të tij në Kaçanik.

⁷¹ Hasan Kalesi i Mehmed Mehmedovski, *Tri vakufnami...*, vep. cit., f. 6.

çanikun nuk gjejmë ta përmend kush. E përmend vetëm G. Elezoviq, por ai konstaton gabimisht se Mehmed Pasha është djali i Këllëç Arslan begut, nip i Mehmed begut, e stërnip i Jahja Pashës, kurse bij të tij ishin Maksud begu, Abdyl Bakiu dhe Murad begu.⁷² Është e qartë se G. Elezoviq nuk e ka lexuar Vakëfnamenë e Mehmed Pashë Kaçanikut, sepse në të do t'i gjente të dhënat që kanë të bëjnë për djalin e Koxha Sinan Pashës. Kështu, në një vend në këtë Vakëfname, qëndron: *"Bamirësi im dhe shkaktari i përparimit tim, i ndjeri dhe nga Zoti i mëshiruar, Sinan Pasha"*.⁷³ Në disa vende shohim se Mehmed Pashë Kaçaniku vakëfnoi pasurinë që ia kishte lënë në trashëgim babai i tij, e në një vend shprehimisht thotë se është biri i Koxha Sinan Pashës. Ai po ashtu vakëfnoi pasuri në Kaçanik dhe në Topojan, siç kishte bërë edhe Sinan Pasha. Prandaj, nuk ka vend për dyshim se Mehmed Pashë Kaçaniku është djali i Koxha Sinan Pashës.

Kronikat turke ofrojnë shumë pak të dhëna për Mehmed Pashën. Pozita e parë më e madhe e tij ka qenë *kapuxhibash*. Në vitin 999 (fillon më 30. X. 1590) e gjejmë si *aga të jeniçerëve*, kurse në vitin 1592 ai bëhet *bejlerbej i Rumelisë*. Në këtë detyrë e kishte emëruar babai, i cili asokohe ishte Vezir i Madh. Një vit më vonë, ai është *vali i Sirisë*, kurse nga viti 1004 (duke filluar nga 27. IX. 1593) bëhet *serdar* me gradën vezir. Mirëpo, në luftërat kundër Hungarisë, Mehmed Pasha i biri i Koxha Sinan Pashës, nuk kishte treguar aftësi ushtarake, siç kishte treguar babai i tij, për ç'arsye qenë shkarkuar ai dhe babai i tij. Kur në muajin sheval të vitit 1004 (fillon më 29. V. 1595) sulltani ishte nisur në luftë kundër Hungarisë, atë (sulltanin) pranë Batoçinës e kishte pritur Mehmed Pasha. Sulltanit i qe kujtuar humbja që kishte pësuar Mehmed Pasha te Krani, andaj kishte urdhëruar burgimin e tij dhe konfiskimin e pasurisë e tij. Por, vetëm pas tre ditëve, ai qe liruar dhe qe emëruar *muhafidh (komandant) i Kalasë së Beogradit*. Më vonë e gjejmë në pozitën e valiut të Konjës dhe Damaskut. Kur në vitin

⁷² G. Elezovic, *Turski spomenici I*, Beograd, 1940, f. 309. Nuk përjashtohet që autorin ta këtë shtyrë në këtë lajthitje lista e mytevelive që e kishte marrë në Shkup.

⁷³ Veliyyi ni'metim ve bais-i rif'atim olan merhum ve magfur leh Sinan Pasha. Shprehja "veilyi-i ni'metim, përdoret edhe për babanë.

1599 në lindje të Perandorisë qenë rebeluar kurdët dhe turkmenët me Karajazixhiun e njohur në krye, kundër këtij të fundit qe dërguar vali Karaman Hysen Pasha, por ky u qe bashkuar rebelëve. Sipas disa të dhënave, ky Hysen Pasha kishte qenë në lidhje familjare me Sinan Pashën, e rrjedhimisht edhe me Mehmed Pashën.⁷⁴ Në fund, kundër këtyre dy rebelëve të sipërpërmendur qe dërguar Mehmed Pasha, i cili i kishte rrethuar në Rohë. Pasi rebelët nuk kishin mundur dot të çanin rrethimin, Karajazixhiu kishte filluar bisedimet me Mehmed Pashën, duke i ofruar dorëzimin e Hysen Pashës, me kusht që Karajazixhiut t'i ndahej pushteti në Amasia. Propozimi i tij ishte pranuar, kurse Hysen Pasha qe dërguar në Stamboll, ku edhe ishte likuiduar. Mirëpo, kur Karajazixhiu edhe më tej nuk ishte qetësuar, atëherë, si duket, qe shkarkuar Mehmed Pasha.

Të gjithë kronistët pajtohen se Mehmed Pasha, përveç përkrahjes nga babai, ka pasur edhe përkrahjen e oborrit perandorak, sepse ka qenë i martuar me motrën e sulltan Selimit II, princeshën Xhemile. Rreth vitit të vdekjes së Mehmed Pashës po ashtu ekziston konfuzion i vërtetë. Sipas Peçeviut (II, f. 31), versionin e të cilit e pranon edhe Hameri, Mehmed Pasha ishte vrarë në Stamboll me urdhër të sulltanit, në vitin 1012 (fillon më 11 qershor 1603), kurse sipas Syrejasë,⁷⁵ supozimin e të cilit e ka pranuar turkologu i Vjenës, Herbert Duda,⁷⁶ Mehmed Pasha kishte vdekur në vitin 1014 (fillon më 19. V. 1605). Mirëpo, ne konsiderojmë se të dy datat janë të gabuara. Siç edhe kjo shihet nga Vakëfnameja e tij, e cila është hartuar në Shkup midis datës 10.XI.-20.XII.1608, e kurrësi si është konsideruar deri më tani.

Duke ndjekur rrugën e babait të tij, edhe Mehmed Pashë Kaçaniku ka ndërtuar në Kaçanik disa objekte, kështu që Kaçaniku rreth vitit 1600 kishte një pamje të një vendbanimi të zhvilluar me një serë insti-

⁷⁴ A. S. Tveritina, *Vostanie Kara-Jazixhi-Deli Hasana v Turcii*, Moskva-Leningrad, 1946, f. 58.

⁷⁵ Mehmed Süreyya, *Sicil-i Osmani*, IV, vep. cit., f. 139.

⁷⁶ *Balkantürkische Studien*, Wien, 1949, f.39-40. Herbert Duda-it i është e njohur se Mehmed Pasha kishte zgjedhur Shkupin, që në të të kalonte vitet e pleqërisë dhe se në Shkup është varrosur.

tucionesh publike. Në të vërtetë, në Vakëfnamenë e Mehmed Pashë Kaçanikut gjejmë të shënuar: “Në grykën e quajtur Kaçanik po ashtu kam vakëfnuar tre mullinj të tjerë...”

“... Edhe në kasabanë me emrin Kaçanik (kam vakëfnuar) urën e ndërtuar në lumin Nerodime, e cila rrjedh kah Kalaja, kroin dhe katër hane të ndërtuara rishtazi, të cilët gjenden në lagjen e jobesimtarëve të kasabasë së përmendur”.⁷⁷

Nga ana tjetër, vakëfet e mëdha në Shkup, Kërçovë, Dibër, në shumë fshatra të Shqipërisë, në mesin e tyre edhe në Topojan, vendin e babait të tij, tregojnë se njerëzit e ndryshëm e me dinjitet kurrë nuk e kanë harruar vendlindjen e tyre, por janë përpjekur që në një farë mënyre ta shpaguejnë atë. Mirëpo, këto vakëfe të mëdha tregojnë se si pasuria e arritur me mund, që të ruhej nga ndonjë konfiskim eventual, ishte shndërruar në *evladijet-vakëf*, me se trashëgimtarëve u siguroheshin privilegje dhe një forcë e konsiderueshme ekonomike.

Siç ka ekzistuar konfuzion rreth xhamisë së Sinan Pashës në Pri-
zren, e cila i është përshkruar Koxha Sinan Pashës, e jo ndërtuesit të vërtetë - Sinan Pashës, njësoj ka ndodhur edhe rreth kësaj xhamie (xhamisë së Koxha Sinan Pashës në Kaçanik – shën. për.), sepse ajo i përshkruhet Sofi Sinan Pashës, e jo ndërtuesit të vërtetë Koxha Sinan Pashës.⁷⁸ Mirëpo, të gjithë ata që e pohojnë këtë nuk e kanë pasur në dorë Vakëfnamenë e Koxha Sinan Pashës dhe nuk e kanë lexuar mbishkrimin, i cili pa mëdyshje flet se xhaminë e ka ndërtuar Veziri i Madh, Gazi Sinan Pasha.

Mbishkrimi në xhami, thotë:

صدر عالی اول درر منبع جود	حضرت غازی سنان پاشا کیم
تا عبادت ایدہ اصحاب شہود	اتدی بو جامع لله بناء
معبد خوب مقام محمود	والهي داعی ددی تاریخین
سنة ۱۰۰۳	

⁷⁷ Hasan Kalesi-Mehmed Mehmedovski, vep. cit., f. 27.

⁷⁸ Jastrebov, *Podaci*, op. cit., f. 98; I njëjti, *Sinan Pasha i Kukli beg*, vep.cit., f. 7; Nusic, *S Kosova na Sinje More II*, vep. cit., f. 101-102.

Përkthimi:

Gaziu madhështor, Sinan Pasha, i cili është
Vezir i Madh, ai inxhi burim i bamirësisë,
Për hir të Allahut ka ndërtuar këtë xhami
Që gjithnjë (të shërbejë) derisa njerëzit të falen.
Lutësi Valihi⁷⁹ në vargun thotë:
“Faltore e bukur, vend i bekuar”.⁸⁰
Viti 1003 (fillon më 16. IX. 1594).



Mbishkrimi original në xhaminë e Sinan Pashës në Kaçanik

Përshpirtënimet dhe vakëfet e Koxha Sinan Pashës në vendin tonë

Koxha Sinan Pasha, siç e pamë, në Kaçanik ndërtoi përshpirtëni-
met e veta: xhaminë, imaretin dhe shkollën. Për funksionimin e tyre,
për pagat e shërbyesve, për ushqimin në imaret dhe për nevoja të tjera
të vakëfeve, ai përshpirtënoi vakëfe të mëdha, të cilat, një nga një,
përmenden në Vakëfnamenë e tij. Ato vakëfe janë:

⁷⁹ Autori i vargut kronik, Valihi, është emër poetik (mahlas) i poetit nga Shkupi, Evlia Çelebiu. Për të ka të dhëna të pakta. Dihet se ka qenë kadi i Shkupit, se i ka takuar një rendi dervishësh, nga se edhe dervishët kanë vizituar varrin e tij në Shkup. Nga ai ka mbetur një divan (koleksion komplet i poezive). Ka vdekur në vitin 1008 (fillon më 24 korrik 1599).

⁸⁰ Këtë mbishkrim Evlia Çelebiu nuk e ka përcjellë në tërësi, por vetëm bejtin e fundit (distik), që është i njëjtë. Megjithatë, ky është argument për origjinalitetin e mbishkrimit. H. Shabanoviq po ashtu e ka përcjellë vetëm këtë distih, dhe nuk e ka marrë gjithë mbishkrimin, edhe pse ne e kemi botuar në tërësi në “Gjurmime albanologjike”, 2, vep. cit., f. 119.

2 hane në Kaçanik

1 hamam në Kaçanik

12 lokale në Shkup

1 konak i përbërë prej disa shtëpive dhe pasurisë tjetër në fshatin Akbash, në Shkup

1 konak në fshatin Jenixhe, në kadillëkun e Shkupit

5 mullinj te fshati Janixhe, në Vardar, në kadillëkun e Shkupit

3 mullinj në kufijtë e fshatit Ismixhe, në Shkup

1 konak në fshatin Tabanoc, në kadillëkun e Kratovës

1 kullos verore (yaylik) në fshatin Tabanoc, në kadillëkun e përme-
ndur

2 mullinj në fshatin Tabanoc

1 konak në fshatin Jezercë, në kadillëkun e Prishtinës

Gjithë fshati Janoshticë, në kadillëkun e Vrajës

Gjithë fshati Qajle, në kadillëkun e Gorës

Pasuria e quajtur Delan, në lumin Dollovë, në nahinë e Muzakës

6 mullinj në lumin Dollovë

2 mullinj në lumin Dumovë (Muzakë)

1 hamam në Prishtinë

2 mullinj afër fshatit Kamenicë, në kadillëkun e Novobërdës

Vendi “Ulema-pasha - kullos dimërore” në kadillëkun Tikvesh


Vendi “Jahja Pasha - kullos verore” në kadillëkun e Ulqinit

12.000 dele në fshatin Kamenicë, në kadillëkun e Novobërdës.

Përveç këtyre përshpirtënimeve dhe vakëfeve në vendin tonë, ai ka ndërtuar edhe objekte të tjera të shumta përshpirtnuese dhe themeloi shumë vakëfeve në anë të ndryshme të Perandorisë Osmane. Përveç xhamisë në Kaçanik, ai ndërtoi xhami në Stamboll, Kajro dhe Selanik.⁸¹ Nga artikulli i përmendur i Tahsin Ozit, vëmë re se në Vakëfnamenë e Sinan Pashës, e cila është gjetur në arkivin e Sinan Pashës, përmenden vakëfet e tij në Bilexhik, Bursë, Plovdiv, Stamboll (Ysky-

⁸¹ Evlia Çelebiu (në “*Siyahatname*”, VIII, f. 720) e përmend edhe xhaminë e Gazi Sinan Pashës në Elbasan, por nuk e di se a është kjo xhamia e këtij Sinan Pashës, dhe mbase me siguri është e tij.

dar, Kasimpashë, Gallatë, Atmejdani, pastaj në Malgarë, Mihaliç, Kajro, Dimjat (Egatt), Selanik, Damask, në Tripolin e Sirisë, Jenishehir, si dhe vakëfet te ne. Si duket këtu kemi të bëjmë me Vakëfnamenë e tij të përgjithshme, në të cilën janë përfshirë të gjitha vakëfet e Sinan Pashës në të gjitha territoret, e cila është legalizuar në Stamboll. Kurse, përveç të përgjithshmes, ai ka hartuar edhe vakëfname veç e veç për disa vakëfe në disa krahina, sikur që është vakëfameja që ne kemi marrë në shqyrtim, e cila përfshin vetëm vakëfet në territorin tonë, ose ndoshta brenda një ejaleti. Një numër të madh të vakëfeve Sinan Pasha i kishte ndërtuar edhe në Jemen dhe Mekë.



Xhamia Koxha Sinan Pasha në Kaçanik


Vakëfnameja e Koxha Sinan Pashës

Në duart tona është *Vakëfnameja* e Koxha Sinan Pashës, tekstin kritik të cilës së bashku përkthimin me komentim po e botojmë këtu. Kjo në të vërtetë është përshkrim i vërtetuar shkruar sipas Vakëfnamesë origjinale. Përshkrimi është i datës më të re, andaj në bazë të letrës unë nuk kam mundur të vërtetoj se nga ç'periudhë është. Në fund ka disa vula vërtetuese, prej të cilave njëra është me datë, po ato vërtetime janë nga periudha të mëvonshme. Ky përshkrim nuk është në formë rolne, siç janë origjinalet e vjetra ose vakëfnametë e përshkruara, ose, thënë më mirë, siç ka qenë adet të hartoheshin vakëfnametë,⁸² por është një fletore me gjatësi 28,5 cm dhe gjerësi 14,5 cm. Shihet qartë se dimensionet kanë qenë më të mëdha, por dikush i ka shkurtuar me gërshtë. Fletorja në mes është e qepur me pe të bardhë. Letra është e zverdhur dhe me vija që mezi vërehen. Ka gjithsej 26 fletë (52 faqe), prej të cilave 37 faqe të papaginuara i përfshin Vakëfnameja. Në faqen e parë, në këndin e majtë, shkruan: Waqfiyya ithnay ashara waraqa 21 (Vakëfnameja nr. 12, fletë 21). Nën të vjen një verifikim i gjatë në formë të trekëndëshit, i cili është shkruar në gjuhën arabe me rastin e hartimit të parë të Vakëfnamesë, kurse më vonë është bartur edhe në këtë përshkrim, kurse nën të, nga ana e majtë, qëndron verifikimi tjetër në gjuhën arabe, respektivisht verifikimi i përshkrimit. Në pjesën e tretë të fundit, faqes së parë i është vënë një ngjitëse e Ministrisë së Financave të Perandorisë, nga e cila shihet se ka të bëjë me përshkrim zyrtar dhe se kjo vakëfname konsiderohet dokument i besueshëm. Në faqen në vazhdim është ngjitur një pullë administrative me vulën e asgjësuar, por nuk mund të lexohet vlera e saj dhe as përmbajtja e vulës, ngaqë dy të tretat e pullës janë prerë. Pranë pullës është edhe një verifikim në gjuhën arabe, shkruar në formën e turrës. Tekst-

in e këtyre verifikimeve dhe përkthimin do ta ofrojmë në tërësi më poshtë.

Në fund të Vakëfnamesë gjenden dy verifikime të shkruara me dorë, një tjetër shkrim nga ai i Vakëfnamesë dhe nga ai i verifikimeve. Të dy këto verifikime janë në gjuhën osmane. Njëri verifikim thotë: *Eld e bulunan vakfiye ile mukabele olunmushdur (Është njëjtësuar me vakëfnamenë që është në duar)*. Nën këtë verifikim është vënë vula. Kurse tjetri verifikim thotë: *Aslile mukabele olunmushdur. Ismail Hakki (Njëjtësuar me origjinalin. Ismail Hakki)*.

Në këndin e majtë, poshtë faqes së fundit, është pulla administrative, mbi të cilën është shkruar diçka e palexueshme, e nën të data 16 mayis 1326 (29 maj 1909). Nën këtë datë është një nënshkrim i palexueshëm. Më pastaj vazhdojnë faqet në të cilat nuk ka kurrfarë teksti.



Faksimili i dy faqeve të vakëfnamesë të Koxha Sinan Pashës

Në faqet e plotësuar me tekst nuk është numri i njëjtë i rreshtave. Kështu në faqen 2, sipas paginimit tonë, ka 10 rreshta, në faqen 13 ka 13 rreshta, në disa faqe nga 12, e në disa edhe nga 14 rreshta. Gjerësia e tekstit të shkruar arrin midis 8-9 cm. Është shkruar me shkrimin

⁸² Kështu, p.sh. në Zyrën e Vakëfit në Prizren, gjendet Vakëfnameja e Mahmud pashë Rotllës, e shkruar në formë rolne, edhe pse ajo është legalizuar para Gjyqit në Prizren në vitin 1831.

arab *nes'h*, kryesisht lexueshëm dhe me shkronja mjaft të mëdha. Verifikimet janë të përziera me shkrim *nes'h* dhe *rik'a*.

Në tekst ka mjaft gabime gjuhësore dhe ortografike. Gabimet në tekst i kam përmirësuar dhe në to me vërejtje kam treguar.



Faksimili i vakëfnamesë së vërtetuar të Koxha Sinan Pashës

PËRKTHIMI I VAKËFNAMESË SË KOXHA SINAN PASHËS

Stamboll, 23 korrik 1566

Verifikimi I

Ajo që është shkruar në këtë dokument sheriati dhe në librin fetar për parimet e vakëfit, harxhimet e tij, kushtet, dhuratat, rregullat dhe përcaktimet, tek unë është e qartë dhe para meje është vërtetuar në Gjyqin e ndritshëm të Sheriatit dhe në tubimin e fesë së shkëlqyeshme e të vërtetë, andaj unë kam gjykuar për rregullsinë dhe parevokueshmërinë e tij në tërësi dhe në pjesë, kështu që është i paprekshëm nga ana fetare dhe e Sheriatit, duke ditur për vendet kur kanë dallim (juristët), duke marrë parasysh ato që duhet vlerësuar në rregullat për vakëfet. Prandaj, me rastin e këtij gjykimi kam marrë dëshmitarë, grupin e njerëzve të drejtë, të besueshëm dhe të sigurt.

Këtë e ka shkruar qenia më e varfër njerëzore, Aliu i biri Jusufit, kadi i ushtrisë fituese⁸³ në vilajetin e lulëzuar të Rumelisë. Iu faltë të dyve!

Verifikimi II

Kopja e bartur nga origjinali. Këtë e ka shkruar i ngrati, të cilit i duhet ndihma e të Madhëruarit dhe të Lartësuarit, Haxhi Mehmedi, kadi në qytetin e Shkupit. Le t'i jenë të falura!

Verifikimi III

(Këtë) E ka shkruar i ngrati, të cilit i duhet ndihma e të Lartësuarit, zotëri Osman Qamil efendiu, biri i Mehmed Nuri Medenit (?), kadi i Gjykatës së Vakëfit. Të dyve ju faleshin mëkatet!

⁸³ D.m.th.: Kadiu suprem ushtarak i Rumelisë, kadiasker.

Përkthimi i tekstit të Vakëfnamesë

Kjo është Vakëfnameja e Gazi Sinan Pashës.

Me më të bukurat fjalë fillon secila bisedë, kurse në krye të çdo gjejë më të rëndësishme vendoset përmendja më e lartësuar.

Faleminderit Allahut, Sunduesit të Lartësuar, kurse lavdërimi Poseduesit të Madhështisë dhe Lartësisë. Atij që është pa kurrfarë shembulli, Atij që me forcën e vet ka krijuar gjithçka që ekziston dhe sipas dëshirës së vet magjepse ka krijuar pa farë rregulli që do të mund ta pasonte, gjithçka që është e krijuar. E rregulloi gjithësinë në mënyrën më madhështore, kurse qiejt i krijoi me rregull magjepsës. Ai ka shtrirë dhuntitë e Tij magjepse mbi gjithçka që ekziston, kurse Mëshirën e Tij e ka shtrirë deri në atë shkallë që i ka tejkaluar të gjithë kufijtë e njohur. Shenjat e forcës së Tij i ka qartësuar në anët e botës, kurse parimet e unitetit të Tij i ka ndërtuar në çdo gjë pa esencë dhe me esencë. Andaj, e krijoi njeriun në mënyrën më të mirë dhe e qerasi me mendjen që njeriu vetë t'i kuptojë dhe tjerëve t'ua mësojë: e udhëzoi në rrugën e drejtë që si dëshmitar t'i marrë ato shenja dhe me ato shenja e damka e ka udhëzuar kah Poseduesi i argumenteve (Allahu).

Qoftë Lartësuar Ai, Madhështia e bukurisë, I lartësuar në atë mënyrë aq sa syri i njeriut nuk mund ta hetojë dhe tendat e madhështisë i ka ngjitur aq lartë sa që duart e të menduarit nuk mund t'i prekin. E falënderojë me falënderimin e atij që nxjerr nga shumësia e pa masë e Bamireshës së Tij.

Dhe lutemi për atë që ka hapur peygamberinë dhe ka përfunduar misionin e pajgamberisë, për të fundit nga lajmëtarët dhe peygamberët, për udhëzuesin e njerëzve në rrugën më të drejtë, të respektuarin zotëri dhe Peygamberin më të bukur, lajmëtarin që nuk ka ditur shkrim as lexim, emri i të cilit është shkruar në Bibël⁸⁴ dhe Ungjill,⁸⁵ zotëriun tonë Muhammedin, i cili është dërguar me ajetin vendimtar,⁸⁶ i konfir-

⁸⁴ Në origjinal: Taurat.

⁸⁵ Në origjinal: Ingil.

⁸⁶ Ajet, d.m.th. shenjë, shenjë e Zotit, fenomen i Zotit. Në Kuran ajeti është një rresht.

muar me vepra fenomenale, (lutem) me lutjen ndriçimi i së cilës ndriçon në anët e horizontit gjithnjë derisa të shkruhet në letër.

(Le të jetë bekimi) Mbi familjen dhe shokët e tij, gjithnjë derisa të zëvendësojnë ylli yllin dhe ta pasojnë, njëra-tjetrën, errësira dhe drita, dhe ndaj atyre që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

E më pastaj: Është e vërtetë për të mençurit se kjo botë është shtëpi e humbjes dhe vend i shkatërrimit, begatia e Tij është huazuar, e gëzimi i saj është dritëshkurtër, kjo botë nuk është krijuar që në të njeriu të kënaqet dhe të mjaftohet me ëmbëlsirat, por është huazuar që t'i shërbejë si mjet për te pozita e përhershme dhe të arrijë te kënaqësia e përhershme, në mënyrë që pasojat t'i ketë më të mira dhe t'i mundësohet që të realizojë shpresat e Ahiretit, siç ka thënë edhe Allahu xh.sh.: *“Dhe përpiqu me sa të ka dhënë Allahu të fitosh botën tjetër...”*⁸⁷ Andaj, Ai i ka udhëzuar në ato robërit e Tij, që të arrijnë sevape të shumta.

Allahu xh.sh. e ka bërë të denjë që të ecë në këtë rrugë shembullore dhe të arrijë fatin madhështor, poseduesin e kësaj shkrese sheriatit dhe dokumenti të vlefshëm e të drejtë, ekselencën e respektuar, mbrojtësin e njerëzve, atë që zgjeron bazat e Sheriatit të qartë, atë që ndërton shtyllat e fesë së fortë, atë që i ngre lart flamujt e së drejtës dhe drejtësisë, atë që largon errësirën, dhunën e të padrejtën, atë që e mpreh shpatën e kalitur dhe heroin fisnik, atë që dritën e drejtësisë e shtrin në vendet e Lindjes dhe Perëndimit, veprat e të cilit janë të njohura në trasetë dhe rrugët e vendeve, i cili është unik në kohën e tij, i cili është i pakalueshëm sipas madhështisë, i cili është i vetmi në kohën e tij, fisnikëria e të cilit krijon fjalë të urta, kurse tregimet për veprat e tij të famshme tregohen në secilën gjuhë, gjurmët e veprave të tij janë regjistruar në anët e botës; atë që është i besueshëm për perandorinë e famshme dhe hilafetin e vetëm, atë që ka shijuar, njërën pas tjetrës, pozitën më të larta të kësaj bote, Mareshalin më të famshëm dhe Vezirin e Madh, zotëri Sinan Pashën, të birin e Aliut. Pasi Allahu xh.sh. i kishte dhuruar begati dhe e kishte bërë më të mirën, ai kishte

⁸⁷ Kuran, XXVIII, 77.

dëshiruar të ecte rrugës së bamirësisë, andaj ndërtoi xhaminë e ndershme dhe faltoren madhështore me emrin e Allahut xh.sh. Ai ndërtoi këtë objekt të tij në nahinë e quajtur Kaçanik, njëra nga nahitë e kadillëkut të Shkupit në vilajetin e lulëzuar të Rumelisë. Ai atë (xhaminë) e vakëfnoi për ata besimtarë të cilët falen dhe Allahun xh.sh. e përmeandin në këmbë e ulur dhe u përkushtohen lutjeve në xhami, duke u përlulur dhe duke rënë në sexhde.

Atje ai ndërtoi një imaret të bukur,⁸⁸ ndërtesa e të cilit është renditur e forcuar dhe është shumë e madhe dhe e dekoruar.

Prandaj, aty ndërtoi dy hane,⁸⁹ të njohura për banorët, dhe ata i vakëfnoi në dobi të njerëzve të varfër dhe nevojave të udhëtarëve të tjerë.

Atje ndërtoi po ashtu shkollën madhështore⁹⁰ të ndërtuar në mënyrën më të bukur dhe atë e vakëfnoi për fëmijët e varfanjakëve.

Më pastaj bamirësi i rangut të lartë dhe i pozitës së lakmueshme, ka vakëfnuar e përshpirtënuar në dobi të atyre që u përmendën (d.t.th. të objekteve të cekura) dhe për harxhimet që janë regjistruar, gjatë kohës kur të gjitha dhuratat e tij kanë bazë të drejtë Sheriati dhe kur janë të plotfuqishme veprat e tij me fjalë dhe me punë, me qëllim të pastër dhe me dëshirë të plotë. Për hir të Allahut xh.sh. dhe duke dëshiruar të fitojë përkrahjen e Zotit të Gjithëmëshirshëm, nga grupi i asaj që është regjistruar nga pasuria hallall dhe është vendosur në disa të drejta të cekura, - gjithë hamami⁹¹ i ndërtuar atje (d.t.th. në Kaçanik) në mënyrën më të mirë, kufijtë e të cilit është e tepërt të caktohen e të ekspozohen, sepse ai i takon zotërisë së tij, mirëbërësit me pozitë të lartë.

⁸⁸ Për këtë imaret të Sinan Pashës, në Kaçanik sot nuk dihet asgjë. Ky imaret (kuzhinë publike) ka qenë mjaft i madh, gjithsesi një nga më të mëdhenjtë në këto vise, për se shihet qartë edhe nga vetë Vakëfnameja, respektivisht nga sasia e gjellëve që janë përgatitur për çdo ditë për udhëtarë të ndryshëm si dhe për varfanjak.

⁸⁹ Një han që mjaft gjatë i ka përballuar dhëmbit të kohës. Ka qenë jo larg xhamisë. Është rrënuar gjatë kohës së Jugosllavisë së Vjetër. Për hanin tjetër nuk kam mundur të di asgjë.

⁹⁰ Kjo shkollë ekziston edhe sot prapa xhamisë. Por është vështirë të thuhet a është e tillë çfarë ka qenë, apo gjatë kohës është riparuar dhe meremetuar.

⁹¹ Ky hamam ka pushuar së punuari që nga koha turke. Ka ekzistuar lartë ndërtesës komunale të sotme.

Dhe të gjitha lokalet të ndërtuara përballë hamamit, të cilat gjenden në qytetin e Shkupit, - e ato janë njëzet, - së bashku me një shtëpi të madhe të quajtur “Kahve-han”, kufijtë e të cilës është e tepërt të përrshkruhen, sepse janë të njohura për çdo kënd, qoftë i afërt ose i largët, për shkak të përkatësisë së mirëbërësit;

Dhe gjithë konakun e quajtur “Çifllëk”, i cili gjendet në fshatin Akbash,⁹² që i takon kadillëkut të cekur të Shkupit dhe i cili (konaku) është i përbërë prej disa shtëpive me gjithë shërbëtorët, buajt, qetë, të ardhurat e të cilëve janë qartësuar në huxhetin (dokumentin) perandorak, kufijtë e të cilëve është e tepërt të përcaktohen e të ekspozohen, sepse janë të njohur në vendin e tij se i përkasin mirëbërësit;

Dhe gjithë konaku i quajtur “Çifllëk i Hasan begut”, i cili gjendet në fshatin Jenixhe,⁹³ që i përket kadillëkut të përmendur me gjithë shërbyesit dhe shërbyeset, me buajt dhe qetë, të gjitha të regjistruara në huxhetin (dokumentin) e Sheriatit;

Dhe gjithë mulliri që punon në lumin Lepenc në kadillëkun e përmendur, kufijtë e të cilit është e tepërt të caktohen e të ekspozohen, për shkak të përkatësisë së mirëbërësit me pozitë të lartë;

Dhe gjithë pesë mullinjtë të mbuluar me një kulm, të cilët gjenden në atarin e fshatit të sipërpërmendur Jenixhe, të cilët punojnë në lumin Vardar;

Dhe gjithë tre mullinjtë, të cilët gjenden në atarin e fshatit Isimxhe,⁹⁴ që i takon kadillëkut të sipërpërmendur, të cilët punojnë në lumin e atjeshëm, kufijtë e të cilëve janë të njohur për banorët dhe fqinjët;

⁹² Ky fshat sot quhet Gorno Lisiçe, kurse përmendet edhe në Vakëfnamenë e Mehmed pashë Kaçanikliut. Në një arë, në jazin e fshatit, Mehmed pashë Kaçanikliu ka ndërtuar gjashtë mullinj dhe të gjithë ata i ka vakëfnuar. Është interesant se në shumë vende ku hasim vakëfe të Koxha Sinan Pashës, hasim vakëfe edhe të Mehmed pashë Kaçanikliut. Kjo gjë nuk duhet të na çudit, sepse kemi të bëjmë me babanë dhe të birin. (Më gjerësisht: Hasan Kalesi-Mehmed Mehmedovski, *Tri vakufnami na Mehmed Kacanili Pasha*, vep. cit.).

⁹³ Se si quhet sot ky fshat, nuk e di. Në të vërtetë, gjatë kohës së Jugosllavisë së Vjetër shumë fshatrave që mbanin emra shqip, u janë ndërruar emrat. Këtë fshat nuk e përmend as Jovan Haxhi-Vasiljeviq në veprën e tij, *Skoplje i njegova okolina*, Beograd, 1930.

⁹⁴ Cili fshat është quajtur Isimxhe ose Ismixhe, nuk kam mundur ta vërtetojë.

Dhe gjithë konaku i quajtur “Çifllëk”, i cili gjendet në fshatin Tabanoc,⁹⁵ që i takon kadillëkut të Kratovës, i cili është i njohur me emrin “Çifllëku i Koxha begut”, së bashku me vendin të quajtur “Jajllëk” (kullos verore) dhe me dy mullinj që aty gjenden e punojnë në lumin e atjeshëm dhe me gjithë shërbyeset, shërbyesit, buajt dhe qetë që i takojnë atij (konaku), me gjithçka që i takon, që është regjistruar së bashku me kufijtë në huxhetin perandorak;

Dhe gjithë konakun e quajtur po ashtu “Çifllëk”, që gjendet në fshatin Jezercë,⁹⁶ që i takon kadillëkut të Prishtinës, (konak ky) i njohur si “Çifllëku i Ulema Pashës”. Me gjithçka përmban dhe përfshin, me gjithë shërbyeset e shërbyesit, me buajt e qetë; të gjitha të regjistruara në huxhetin e Sheriatit;

Dhe gjithë fshati që është pasuri (mylk) i tij, i cili gjendet në kadillëkun e Vrajës, në sanxhakun Qystendil, i njohur si Janostinçe,⁹⁷ me gjithçka i takon, që i është aneksuar, me të ardhurat, të gjitha të regjistruara në huxhetin perandorak;

Dhe gjithë fshati që gjendet në kadillëkun e Gorës, i njohur si fshati Qajle,⁹⁸ me të gjitha të ardhurat, tatimet e të drejtat e Sheriatit; të gjitha të regjistruara në huxhetin perandorak;

Dhe gjithë pasuria ime e quajtur Delyan që gjendet në lumin e madh të quajtur Dellovë, të bashkuar me fshatin e quajtur Orman,⁹⁹ i cili gjendet në nahijen e njohur me emrin Muzaka, pasuri të cilën e ka

⁹⁵ Fshati Tabanovci në kadillëkun e Kratovës sot nuk ekziston. Ekziston fshati Tabanoc në veri të Kumanovës.

⁹⁶ Fshati Jezero i takon komunës së Vushtrrisë, kurse fshati Jezercë është afër Ferizajt. Mbase fjala është për të parin.

⁹⁷ Fshati Janostinci ose Janostica nuk ekziston në rrethinën e Vrajës. Me siguri fjala është për fshatin Jelashnica, i cili gjendet afër Vladiçin Hanit.

⁹⁸ Fshati Qajla gjendet në Shqipëri. Ai që përmendet në mesin e atyre pesë fshatrave që i kanë takuar Sinan Pashës, e të cilët me kërkesën e tij e me ferman të sulltanit, qenë li-ruar nga të gjitha tatimet.

⁹⁹ Assesi nuk kam mundur ta vërtetojë se ku gjendet lumi Dollova dhe fshati Orman në nahinë e Muzakës. Dyshoj se ka të bëjë me Myzeqenë në Shqipëri. Në komunën Gjorgje Petrov tek Shkupi ekziston fshati Orman (shih. Jovan Haxhi Vasilevic, vep. cit. në disa vende).

blerë nga trashëgimtarët e të ndjerit të njohur me emrin Rara, me të gjitha që i takojnë, të gjitha të njohura për banorët vendës;

Dhe gjithë gjashtë mullinjtë, të mbuluara me një kulm, të njohur me emrin Daxhove, të cilët gjenden në lumin e përmendur afër fshatit të përmendur, kufijtë e të cilëve është e tepërt të caktohen, sepse janë të njohur për të gjithë banorët;

Dhe të dy mullinjtë, të mbuluar me një kulm, të cilët gjenden afër mullinjve të përmendur në lumin e përmendur, të njohur si Dumovë, kufijtë e të cilëve është e tepërt të përmenden;

Dhe gjithë hamami, i cili gjendet në qytetin e Prishtinës,¹⁰⁰ një prej qyteteve të vilajetit të përmendur, që kufizohet me sheshin e Sulltanit, me rrugën e veçantë dhe atë publike nga tri anë, së bashku me tetë lokalet që gjenden pranë hamamit të përmendur, kufijtë e të cilëve janë të njohur për banorët;

Dhe dy mullinj që gjenden afër fshatit Kamenicë,¹⁰¹ i cili i takon kadillëkut të Novobërdës, që punojnë në lumin e njohur me emrin Egri Dere;¹⁰²

Dhe gjithë vendi i njohur me emrin “Dimërori i Ulema Pashës”,¹⁰³ që gjendet në kadillëkun Tikvesh, të cilin është e tepërt ta përshkruajmë, sepse është i njohur edhe te të afërmit edhe te të largët;

Dhe gjithë vendin e njohur si “Kulloja të Jahja pashës”, që gjendet në bjeshkët e njohura të Sharrit, kufijtë e të cilit është e tepërt të përshkruhen, sepse është i njohur për fqinjët;

Dhe gjithë vendin e njohur si “Këshla”, që gjendet në kadillëkun e Ulqinit, kufijtë e të cilit është e tepërt të përshkruhen, sepse është i njohur për vendësit;

Dhe të gjitha delet (12.000 krerë), të cilat gjenden në fshatin e përmendur të Kamenicës me të gjitha që janë përmendur më herët dhe që

¹⁰⁰ Ka shumë të ngjarë që ky hamam, për të cilin deri më sot s’kemi ditur asgjë, ka qenë pranë ndërtesës së Kuvendit Krahinor, aty ku sot gjendet përmendorja (trekëmbëshi). Me rastin e gërmimeve aty janë gjetur gjurmë të hamamit. Aty ka ekzistuar edhe tregu i sulltanit.

¹⁰¹ Fshati Kamenicë është në rrugën nga Gjilani për në Vranë, pranë lumit Moravë.

¹⁰² Si quhet sot ky lum, nuk kam mundur ta vërtetojë.

¹⁰³ Në original: Ulema Pasha kishlasi.

do të përmenden nga ajo që i takon, që i bashkëngjitet, me të ardhurat dhe me ato që shkojnë, qoftë të jenë përmendur apo nuk janë përmendur, të jenë shkruar apo jo.

Të gjitha këto i ka vakëfnuar mbi bazën e Sheriatit dhe në mënyrë të qartë (janë) dhurata që jepen me kënaqësi.

Pastaj mirëbërësi i përmendur, - Allahu e shpërbleftë me mëshirën e Tij, - ka venë kusht që për udhëheqjen e punëve të të gjitha vakëfeve, të emërohet myteveliu i njohur për të mirë dhe i kualifikuar që të udhëheqë llogaritë për çështjet e vakëfeve, ndërmarrës, që me vetëdije të ruajë atë që i është besuar, të jetë i përmbytur nga shpërdorimet, keqpërdorimet, i përkryer, i kthjelltë nga mendja dhe me mendime të drejta e të qëndrueshme, të jetë i dalluar në kohën që jeton.

Dhe të emërohet një nazir (mbikëqyrës) i devotshëm dhe me frikë-respekt ndaj Zotit xh.sh., që do të ketë mendjemprehtësi në shfrytëzimin e vakëfit, me përvojë që të dallojë ndërmjet koprracisë dhe harxhimeve të tepruara, që do të ketë mbikëqyrje të plotë në të gjitha vakëfet.

Dhe një noter të aftë llogaritar, njohës të rregullave të kontabilitetit dhe mënyrës së të shkruarit, që do të ketë një fletore në të cilën do t'i regjistrojë të hyrat e të dalat, kryesoret e sekondaret, qofshin pak apo shumë, të parëndësishme e të pavlefshme.

Dhe dy xhabi (mbledhës të tatimeve) të denjë e me aftësi të cekura më lart, që do të shërbejnë drejt dhe me besueshmëri, që i ikin pakujdesisë, të grumbullojnë prodhimet bujqësore dhe të ardhurat nga pasuria e vakëfeve. Ai ka venë kusht që xhabitë të jenë të liruarit shërbëtorë të mirëbërësit të cekur, - Allahu xh.sh. ju dhëntë jetë që t'i rregullojnë punët! Dhe të ardhurat e vakëfit të grumbullohen mbi bazën e mendimit të mytevelisë, duke e njoftuar mbikëqyrësin dhe, me ndihmën e noterit, t'i kryejnë dy xhabitë.

Pasi janë marrë parasysh këto kushte dhe rregulla të respektuara, nga ajo që Allahu xh.sh. ka përcaktuar që të fitohet nga korja dhe të ardhurat, t'u jepet përparësi mirëmbajtjes dhe riparimit (të objekteve) mbi të gjitha harxhimet.

Pastaj, myteveliu t'i marrë nga të ardhurat tridhjetë dhërmë gjatë ditës.

Po ashtu, përsëritësi, i cili e ka njohur Allahun xh.sh. - le të vazhdojë hija e tij e këndshme, - ka venë kusht që në xhaminë e theksuar të emërohet një hatib i aftë, që njeh Sheriatin, që është i arsimuar, orator, me zë të mirë,¹⁰⁴ të mbajë hytben në mënyrën tradicionale për çdo të premtë dhe bajrameve:

Edhe një imam i arsimuar me veti lakmuese, me përvojë në respektimin e kushteve për namaz me xhemat për secilin namaz, të jetë i drejtë dhe i këndshëm. Le të jetë paga e tij gjashtë dhërmë në ditë. Ai ka venë kusht që hatib dhe imam të jetë i njëjti person.

Edhe dy myezinë, që secili prej tyre do të thërret ezan, duke u kujdesur për pastërtinë dhe duke hipur në minare. Paga e secilit prej tyre le të jetë pesë dhërmë në ditë.

Edhe një njeri që do t'i ndihmojë myezinit të premtën në këndimin e sallës,¹⁰⁵ me kusht që zërat t'u akordohen. Paga e tij le të jetë një dhërmë në ditë.

Edhe gjashtë njerëz, - lexues të Kuranit, - të aftë të lexojnë Kurani Famëllartë me melodi dhe me texhvid,¹⁰⁶ me kusht që secili prej tyre ta lexojë të premtën në mahfil,¹⁰⁷ duke zëvendësuar njëri-tjetrin me nga një ashër¹⁰⁸ nga Kurani Famëllartë, në mënyrën që meriton respekt dhe vlerësim. Njëri nga ata do të jetë shef. Paga e secilit lexues do të jetë dy dhërmë në ditë, kurse paga e shefit të tyre katër dhërmë.

¹⁰⁴ Në origjinal: Dawidiyyu l-alhan, d.m.th. me zë të bukur si Davidi. Sipas transmetimit Davidi ka pasur zë të bukur.

¹⁰⁵ *Sala* është lutje, ftesë nga minarja (jo ezani), që bëhet rëndom para ezanit. Sal-la këndohet me rastin e vdekjes së dikujt, po ashtu edhe me rastin e ndonjë zjarri, përmbytjeje dhe të ngjashme.

¹⁰⁶ *Texhvidi* është shkencë që përfshin rregullat se si duhet të këndohet Kurani, d.m.th. që se cilës bashkëtingëllore t'i jepet vlera e plotë, se a do të lexohet fortë a butë, emfatikisht a në mënyrë të rëndomtë. Në texhvid po ashtu janë përfshirë rregullat për gjatësinë e vokaleve, pauzat, theksimi etj.

¹⁰⁷ *Mahfil* është galeria në xhami, një ngritje speciale në brendi të xhamisë ku rëndom ulën myezinët. Mahfili po ashtu është ngritje speciale ku sulltani ka falur namazin.

¹⁰⁸ *Ashër* është pjesë nga Kurani, e cila rëndom lexohet pas namazit. Me rastin e këndimit të mevludit dhe me rastin e ceremonive të ndryshme fetare po ashtu këndohet ashër e pastaj bëhet dua.

më në ditë. Ai ka vënë kusht që edhe dy myezinët të inkuadrohen në këtë lexim të Kuranit.

Edhe një njeri që do të jetë muarrif¹⁰⁹ në mahfil para faljes së namazit ditën e xhuma. Paga e tij do të jetë dy dërhëmë në ditë.

Edhe të caktohet një muvekit,¹¹⁰ i cili e njeh shkencën për përcaktimin e kohës, i aftë që të caktojë kohët e namazit, që t'ua tërheqë vërejtjen myezinëve për kohën e namazit, sikur që është rregull nëpër qytete. Paga e tij ditore do të jetë pesë dërhëmë argjendi.

Një njeri le të jetë kandilar (kandilndezës) që do t'i ndezë llambat dhe kandilat jo me flakë të shumtë dhe as të pakët. Paga ditore e tij do të jetë dy dërhëmë në ditë.

Edhe një njeri le të jetë pastrues, i cili do t'i shkundë hasrat dhe që do ta kryejë me zell detyrën dhe pa mungesë. Paga e tij ditore do të jetë dy dërhëmë.

Edhe një njeri le të jetë kajum,¹¹¹ i cili do të shërbejë në xhami për t'i ruajtur llambat, kandilat, mus'hafat dhe hasret. Paga e tij ditore do të jetë pesë dërhëmë.

Ai (vakëflënësi) ka përcaktuar që për çdo ditë para ikindisë të lexohet kaptina "En-Nebe",¹¹² kurse pas akshamit kaptina "El-Mulk",¹¹³ të gjitha këto i ka paraparë si kushte për imamin, paga ditore e të cilit, si kompensim për lexim, do të jetë tre dërhëmë.

Edhe shkolla e përmendur le të këtë një mësues (mualim), i cili e njeh mirë Kuranin dhe texhvidin, që është njohës i mirë i Kuranit Famëlartë, me tipare pozitive, me moral të fortë që do t'i mësojë fëmijët e myslimanëve që të lexojnë Kuran. Atij për çdo ditë do t'i paguhet nga pesë dërhëmë.

¹⁰⁹ *Mu'arrif* është shërbyesi i xhamisë, i cili në një interval të duarë e përmend emrin e bamirësit. Këtë detyrë rëndom e kryejnë hatibët ose myezinët, të cilët duke e përmendur bamirësin, i drejtojnë Zotit lutje për shpëtimin e shpirtit të tij. Vet akti quhet *ta'rif*.

¹¹⁰ Në origjinal: Njeriu që njeh shkencën për caktimin e kohëve të namazit.

¹¹¹ *Qajjum* është personi i cili kujdeset për diçka. Në vakëfname gati rregullisht do të thotë shërbyes xhamie, personi që pastron xhaminë dhe ndezë kandilat, në qoftë se për këtë nuk është caktuar dikush tjetër, sikur që është rasti këtu.

¹¹² Surja "En-Nebe" është e XXX sure e Kuranit.

¹¹³ Surja "El-Mulk" është e XXIX sure e Kuranit.

Në të (në mekte, në shkollë) le të jetë një njeri i mirë dhe i ditur, i cili do të jetë zëvendës (i mësuesit) dhe le të vazhdojë kjo formë. Ai me fëmijët do t'i përsërisë leksionet. Atij për çdo ditë do t'i paguhet nga tre dërhëmë.

Ka caktuar edhe një kusht tjetër: që të tubohen në xhami dhjetë lexues të Kuranit pas namazit të sabahut, drekës dhe ikindisë dhe secili prej tyre të lexojë nga një xhuz nga Kurani Famëlartë me vlerësim e respekt dhe se për çdo ditë nga një herë të tërin ta kryejnë, përveç ditëve të premte dhe bajrameve. E secilit prej tyre (lexuesve) t'u paguhet nga gjashtë dërhëmë në ditë.

Ai ka caktuar kusht që imami dhe myezini të lexojnë nga një xhuz.¹¹⁴

Vakëfnuesi, i cili di të ndaj shpërblim të madh, - le të jetë e pranuar te Allahu përpjekja e tij, - ka vënë kusht që kujdestar për interesat e imaretit të cekur të emërohet një shejh¹¹⁵ i mirë, i pastër, i besueshëm, i drejtë, i devotshëm, i cili mjaftohet me pak dhe mbështetet tek Allahu, që e di Sheriatin, që nuk është grykës, që është i qetë, me moral të lartë, i thjeshtë ndaj të gjithë njerëzve në përgjithësi. Paga e tij ditore do të jetë pesë dërhëmë.

Dhe po ashtu le të caktohet një njeri i njohur për ndershmëri, i devotshëm, që do të udhëheqë blerjen e ushqimeve jetësore dhe nevojave të tjera si dhe gjërave të domosdoshme që harxhohen në imaret, dhe i cili quhet i besueshmi i harxhimeve. Paga e tij ditore le të jetë tre dërhëmë.

Edhe një njeri tjetër i ndershëm, i devotshëm, që do t'i ruajë hambarët, i quajtur kilerxhi. Paga e tij ditore do të jetë dy dërhëmë.

Edhe një noter që do t'i regjistrojë të ardhurat e të dalat, primaret e sekondaret. Paga e tij ditore do të jetë po ashtu dy dërhëmë.

Edhe një njeri tjetër, që do t'i ruajë hambarët me drithë, që quhet hambarxhi. Paga e tij ditore do të jetë dy dërhëmë.

¹¹⁴ *Xhuz* është pjesa e tridhjetë e Kuranit. Kurani është i ndarë në tridhjetë xhuza.

¹¹⁵ *Shejh* do të thotë plak, prijës i fisit a familjes, udhëheqës, udhëheqës shpirtëror. Në vendin tonë kryesisht përdoret për ndonjë udhëheqës të një rendi shoqëror ose për kujdestar të teqeve.

Edhe dy bukëpjekës që do të gatuajnë bukë në imaret dhe që do ta ndërrojnë njëri-tjetrin. Paga ditore e secilit prej tyre do të jetë dy dërhëmë. Ata do t'i kenë edhe dy nxënës (ndihmës), paga e secilit prej tyre do të jetë nga një dërhëm.

Edhe dy korrierë të ndershëm që do të kryejnë me përkushtim punën e bartjes, njëri do të jetë me detyrë për sigurinë e bukës, kurse tjetri për sigurinë e mishit. Paga ditore e secilit do të jetë nga një dërhëm.

Edhe një njeri që do të pastrojë kazanin dhe enët dhe ato t'i mbajë përherë të pastra. Atij do t'i paguhet nga dy dërhëmë në ditë.

Edhe katër njerëz, të cilët quhen qanakxhinj. Secilit prej tyre do t'i paguhet nga një dërhëm.

Edhe dy njerëz që do të pastrojnë drithin dhe orizin. Secilit prej tyre do t'i paguhet nga një dërhëm.

Edhe një portir, i cili do të jetë i angazhuar në kuzhinë rreth shërbimit në derë. Atij do t'i paguhet nga një dërhëm.

Edhe një bartës që do të sjellë dru dhe do t'i çajë ato dhe i cili do të sjellë mish nga mishtari. Atij do t'i jepet nga dy dërhëmë në ditë.

Edhe një njeri tjetër, që do t'i ndreqë çezmat dhe do t'i mirëmbajë kanalet e ujërave. Atij do t'i jepet nga tre dërhëmë në ditë.

Edhe një njeri tjetër, zdrukthëtar, murator dhe gurgdhendës që do të punojë në meremetimin, mirëmbajtjen dhe riparimin në tërësi të objekteve vakëfnore, duke ndërhyrë me të shpejtë aty ku e do nevoja, në mënyrë që të mos shkaktohet dëm më i madh. Atij do t'i jepet nga një dërhëm në ditë.

Po ashtu le të emërohen për secilin nga hanet e cekura nga dy hanxhi të drejtë dhe që e duan punën. Pagesa për secilin prej tyre do të jetë nga tre dërhëmë në ditë.

Pastaj ekselencia e tij, - e mëshiroftë Allahu xh.sh., - ka vënë kusht që në imaret të përgatiten gjella për çdo ditë, dy herë gjatë ditës, dhe ato të jenë me oriz për darkë, përveç të premtes dhe ditëve të tjera të festave, kur do të përgatiten gjella më të mira. Ditëve të festave do të përgatiten gjella prej gruri në drekë dhe gjella të lezetshme në darkë.

Për çdo ditë ka caktuar nga njëzet okë mish, prej të cilit gjysma do të zihet për drekë, e gjysma tjetër për darkë, përveç netëve të muajit Ramazan, sepse atëherë përgatitet i tëri për darkë; po ashtu një kilogram¹¹⁶ të grurit të pastër dhe pesë kilogramë miell për bukë, sipas sasisë, katër okë kripë për gjella dhe për bukë, një okë e gjysmë qepë dhe një okë miell për gjellën e orizit, një okë kimë për gjellën e grurit, që kushton njëzet e dy dërhëmë, një dërhëm për biber, kurse për dru aq sa është e nevojshme.

Andaj, ka vënë kusht që për çdo të premtë dhe për çdo natë të Ramazanit të përgatitet gjella e quajtur “dana”, duke i shtuar kësaj për çdo natë ushqimin e quajtur “zerde”.

Për ushqimin e parë të quajtur “dana”, ka caktuar pesë kg grurë dhe pesëmbëdhjetë okë tëlyen, dy dërhëmë për nahut dhe një dërhëm për qepë.

Për ushqimin e dytë të quajtur “zerde” dy kg oriz dhe dhjetë okë mjalhtë, dy okë tëlyen dhe nëntë dërhëmë shafan. Ka vënë kusht që në Natën e Regaibit¹¹⁷, Natën e Beratit¹¹⁸ dhe në Ditët e Ashurës¹¹⁹ si dhe për festa, të zihet ajo gjellë që zihet të premtëve dhe gjatë Ramazanit, as më pak dhe as më shumë.

Pastaj mirëbërësi i përmendur ka caktuar që nga ushqimet e para-paga ditore, për çdo mëngjes dhe mbrëmje, t'u jepet për tryezë dy haneve të cekura për udhëtarët që gjinden në hane, qofshin të varfër apo të pasur, nga një ushqim i cili do të përbëhet nga pjesë mishi dhe dy bukë dhe ushqim i rëndomtë prej një pjate. Pësja e secilës bukë do të jetë dyqind dërhëmë.¹²⁰

¹¹⁶ Termi arab “*kajl*”, të cilin osmanët e shkruajnë përherë “*kile*”, është masë për drithëra, vëllimi i së cilës ka qenë i ndryshëm në vende të ndryshme dhe në kohë të ndryshme. Kila e Stambollit, për të cilën këtu bëhet fjalë, ka peshuar 18-22 okë.

¹¹⁷ Kjo është nata e mbarësimit të Muhamedit a.s. në barkun e nënës së tij. Kjo natë bie të premtën e parë të muajit rexheb.

¹¹⁸ Nata e Beratit (arabisht: “*Layla al-bara'a*”, turqisht: “*Berat gecesi*”), festohet si festë fetare dhe bie në gjysmën e muajit shaban, sipas kalendarit islam.

¹¹⁹ Ashura është nata në prag të 10 Muharremit sipas kalendarit islam. Një lloj i natës për pastrimin e mëkateve. Për këtë festë rëndom përgatitet ushqimi i quajtur *ashura*. (Më gjerësisht: *Enzyklopaedie des Islam*, pjesa: Ashuar).

¹²⁰ *Dirhemi*, masë peshe prej 3.12 gramë.

Pastaj secilit që është në shërbim në imaret dhe në të dy hanet do t'i jepet nga një shujtë, sasia e së cilës do të jetë e rëndomtë: një pjatë gjellë, një copë mish dhe katër pjesë bukë, e ata shërbyes janë: myteveliu, noteri, mbikëqyrësi, shejhu i imaretit, financieri dhe shërbyesit e tjerë që më herët detajisht u përmendën.

E në qoftë se tepron diçka nga ushqimi, nga gjithë këto harxhime, do t'u ndahet të varfërve dhe sakatëve të fshatrave, dhe sidomos pleqve dhe plakave të paafta.

Është konfirmuar gjithë ajo që është shkruar në këto fletë, në tërësi dhe në detaje, dhe për gjithçka që është vendosur në faqe nga fillimi deri në fund lidhur me themelimin e vakëfit dhe me renditjen e kushteve, dhe janë sqaruar format e të harxhuarit në mënyrë të zgjeruar. Këtë e ka deklaruar dhe e ka pranuar mbështetësi i shkencëtarëve të së vërtetës, shembull i studiuesve të vyeshëm, posedues i vlerave dhe pozitës, zotëriu ynë, Abdurrahman efendiu i biri i Sylejmanit, pasi është konfirmuar autorizimi i tij,¹²¹ që të japë deklaratën për vakëfnim e përshtetësi dhe të shprehë dëshirën që nga kjo deklaratë e vakëfnimit të mos bëjë farë revidimi, - Allahu le ta mbulojë me mëshirën e Tij, - **dëshmojnë** mbështetësi i shkencëtarëve, dhe studiuesit e së vërtetës, shembull i fisnikëve e të saktëve, posedues i virtyeteve të ndritshme dhe i vlerave të shkëlqyeshme, Mustafë efendiu i biri i Aliut, profesor në një medrese të Sylejmanisë, si dhe krenaria e profesorëve e ligjëruesve, thesar i fisnikëve dhe të diturve, zotëriu ynë shejh Muhamed efendiu i biri i Sylejmanit, profesor në medresenë Sulltanije Ismihan, - se mirëbërësi i cekur, - le ta mëshirojë Allahu, - pasi në tërësi ka vakëfnuar të gjitha vakëfet që u cekën dhe ka paraparë kushtet e theksuara dhe ka përcaktuar rregullat e lartëtheksuara, ka vënë po ashtu kusht që të gjitha gjërat e vakëfeve dhe të gjitha punët varën nga mendimet e tij (d.t.th. të bamirësit) dhe se i janë besuar ekselencës së tij, kështu që ai disponon me to si të dëshiron, duke mos iu kundërvënë në atë askush. Ai është i pavarur në rregullimin e kushteve të vakëfnimit, në përcakt-

¹²¹ Në të vërtetë vakëfin mund ta themelojë vetë bamirësi ose atë ta përfaqësojë i autorizuari. Vakëfi madje mund të themelohet edhe pas vdekjes së ndokujt, ose nëse sa ka qenë gjallë ka dhënë deklaratën para gjyqit.

imin e harxhimeve, shtimin a zvogëlimin e tyre një apo më shumë herë si dhe me punët e tjera të Sheriatit dhe problemet që duhet respektuar.

Pastaj i autorizuari i sipërpërmendur ka deklaruar se bamirësi i cekur, - përpjekja e tij të vlerësohet, - pasi janë përfunduar kushtet dhe janë plotësuar të gjitha përcaktimet, i ka nxjerrë të gjitha ato vakëfe nga duart e tij fisnike dhe vakëfet e veta në mënyrë të drejtë të Sheriatit ia ka dorëzuar myteveliu të madh, e kjo është krenari në mesin e të njëjtëve dhe elitës, Jusuf aga i biri i Abdylmenanit, anëtarë i njësisë së myteferrikëve¹²² në Portën e Lartë - le të jetë ajo (Porta) qendër e të lavdishmëve dhe madhështorëve! Ai e ka pranuar nga ai në mënyrë të qartë që moti me kusht që me të të sillet sipas parimeve për vakëfe të bazuara në Sheriat, ashtu si veprojnë mytevelitë e tjerë, sipas ligjeve që i kënaqin rregullat e Sheriatit. Përfaqësuesi në mënyrë të drejtë dhe ligjore, në përputhje me normat e Sheriatit, ka deklaruar qartë dhe vendosmërisht, duke iu përmbajtur parimeve të fesë, gjë që ka gjetur përkrahjen nga ana e myteveliu të cekur dhe pajtueshmëri të të dy palëve në të gjitha çështjet e theksuara. Kur çështja ka arritur deri te kjo shkallë, përfaqësuesi i cekur ka qenë i prirë të heqë dorë nga vakëfnimi i tij dhe t'i kthejë në posedimin e tij (bamirësit), duke theksuar si argument se nuk ekziston parevokueshmëri në vakëfnimin e patundshmërive dhe se nuk është e lejueshme vakëfnimi i pasurive të tundshme, sipas imamit më të madh dhe udhëheqësin më të njohur, malit më të lartë, detit më të gjerë dhe më të madh, shtyllës së fortë, fanar i popullit dhe prijës i imamëve, ndaj atij që zbulon të vërtetat e fshehta nga faqja e Kuranit, atij që ndriçon të fshehurat më të mëdha të teksteve të tij, e ai është Ebu Hanifja, Nu'man ibni Thabit al-Kufi - Allahu xh.sh. e mëshiroftë!

Myteveliu i përmendur iu kundërvu, duke iu përmbajtur fjalës së imamëve të mëdhenj dhe madhështorëve të zgjedhur, të cilët thonë se

¹²² *Muteferrika* janë bijtë e fisnikëve të lartë osmanë në shërbim të Divanit të sulltanit ose të beglerbegut, të cilët përgatitën për funksione të larta. Më vonë, (në shek. XVII-XVIII) myteferrika është titull i fisnikëve të ndryshëm të sulltanit

është i parevokueshëm vakëfnimi i pasurive të paluajtshme dhe është e lejueshme vakëfnimi i pasurisë së luajtshme.

Shqyrtimi dhe kontesti rreth kësaj ka shkuar shumë larg, derisa nuk i ka kaluar të gjithë kufijtë.

Dhe pasi kanë zhvilluar kontest para mullait fisnik e të devotshëm dhe shkencëtarit fetar, mbrojtësit të shkëlqyeshëm të Sheriatit, atij që udhëzon në argument të qartë, atij që ngre nivelet e shkencës deri në shkallën më të lartë, atij që i sqaron fjalët e Allahut xh.sh., gjyqtarit të drejtë që është nënshkruar në krye të këtij dokumenti, me nënshkrimin e bukur dhe fisnik, - gjurmët e aftësive të tij le të jenë gjithmonë të shtrira në faqet e viteve e shekujve dhe flamujt e tij le të valojnë në faqet e ditëve dhe muajve, - ai ka kontrolluar lëndën kontestuese me shikim të qartë dhe vërtet ka logjikuar për të, andaj ka qenë dëshmitar se vaga më shumë po rëndon në anën e mytevilut dhe në duart e tij kishte parë argument të qartë, andaj me vendim të fortë dhe të drejtë dhe me aktvendim të përkryer e të qartë, ka gjykuar për rregullsinë e këtyre vakëfeve dhe parevokueshmërinë e tyre në pjesë dhe në tërësi, sipas mendimeve të këtyre imamëve të udhëzuar, - le të jetë i kënaqur Allahu me të gjithë ata, - që kështu mendojnë. Kështu gjithë ajo që është theksuar është legalizuar dhe është shndërruar në vakëf të parevokueshëm, pas të cilës nuk është e lejueshme të ndërrohet dhe të ndryshohet, që do të ishte në kundërshtim me përmbajtjen e këtij dokumenti, as është e lejueshme të gjymtohet dhe të shtyhet zbatimi për kurrfarë arsye.

Dhe askujt që beson në Allahun xh.sh. dhe në Ditën e Gjykimit, qoftë pushtetmbajtës, kadi, trashëgimtar i pranishëm ose jo i pranishëm, nuk i lejohej ta ndryshojë këtë vakëf, pasi ai është konfirmuar në formën e shkruar dhe të hartuar. Në qoftë së dikush ndërmerr diçka të ndryshojë ose të ndërrojë, dhe kush përpiket ta falsifikojë dhe ta shkatërrojë, atëherë mbi të le të jetë mallkimi i Allahut xh.sh., engjëjve dhe gjithë njerëzve; le të jetë ferri vend i tij në të cilin do të pijë dje-rset dhe gjakun e vet.

E kush ndryshon një nga kushtet që i ka venë dhe ndryshon diçka nga caktimet e tij ose vendos ta shkatërrojë, ose të mos e plotësojë, ai

ka bërë mëkat, andaj do të jetë i ndëshkuar atë ditë kur mëkatarët kapen për këmbë dhe për shalli,¹²³ E shpërblimin për bamirësin fisnik të përmendur do ta japë Allahu i Gjithmëshirshëm dhe Mëshirëplotë.

Shkrimi i këtij (dokumenti) ka ndodhur ditën e gjashtë të muajit rexhep të vitit nëntëqind e njëzet e katër.¹²⁴

Dëshmitarët e aktit:

Krenaria e të lavdishmeve dhe fisnikëve: Ahmed Kethuda, i biri i Mustafës, pensionist

Krenaria e madhështorëve dhe liderëve: Dervish aga i biri i Hysen Kethudës, myteferrik

Krenaria e njerëzve për hartimin dhe shkrimin: Mahmud efendiu i biri i Mustafë Er-reni (?)

Krenari e të mëdhenjve dhe të parëve: Hakim Kethuda i biri i Abdyl Menanit, myteferrik

Krenaria e të parëve: Ridvan aga i biri i Abdyl Mehmedit, myteferrik

Perla e të parëve: Haram aga i biri i Abdylkerimit, myteferrik

Krenaria e njerëzve: Mehdi efendiu, repetitor

Perla e njerëzve për hartimin e llogarive: Hidër efendiu, repetitor

Krenaria e të parëve Mehmed aga bir i Abdylkerimit, myteferrik

Perla e të parëve: Pervan aga i biri i Abdyl Menanit, myteferrik

Krenar në mesin e të njëjtëve dhe moshatarëve: Musa aga i biri i Abdurrahimit, myteferrik

Perla e të parëve: Kivan aga i biri i Abdurrahmanit, myteferrik

Krenaria e ushtrisë: Sinan Çausi i biri i Abdullahut, çaus (oficer) i oborrit perandorak

Krenaria në mesin e të njëjtëve dhe të parëve: Ahmed aga i biri i Ferhatit, një nga çausët e oborrit perandorak.

Krenaria e moshatarëve: Dervish Çausi i biri i Abdyl Menanit, njëri nga çausët e oborrit perandorak.

¹²³ Kuran, kaptina LV, ajeti 42.

¹²⁴ Më 23 korrik 1586, sipas erës sonë.

Krenaria e njerëzve që shkruajnë me laps: Hasan Hilmiu, notari i Divanit të lartë

Krenaria e të parëve: Ali aga i biri i Abdurrahmanit, njëri nga portirët (?) e oborrit perandorak.

Shkruesi i shkronjave: Ahmedi i biri i Sylejmanit, profesor në medresenë “Emir Kadi” dhe të tjerë pjesëmarrës.

Marrë nga: Dr. Hasan Kaleshi

“Najstariji vakufskih dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku”, Prishtinë, 1972, s. 257 – 308.

Përgatiti:

Ismail Rexhepi

Sadik Mehmeti

Hasan Kaleshi

THE GRAND VEZIR – KHOJA SINAN PASHA – HIS ENDOWMENT

(Summary)

In Kosova there are two mosques, which carry the name of Sinan Pasha. One is in Prizren and the other in Kaçanik. These two are very important objects of Islamic architecture in Kosova. Those who built these mosques were distinguished personalities, who played a very important role in the history of the Ottoman Empire. The mosque in Kaçanik was built by Khoja Sinan Pasha, the Grand Vezir of the Ottoman Empire, whereas the one in Prizren by Sofi Sinan Pasha, the Beylerbey of Budim. Despite the fact that much has been written about them (by historians and the press) a veil of confusion still surrounds them. Very often, their identities are mixed.

د. حسن كاليشي

الوزير الكبير كوجا سنان باشا و أوقافه

(خلاصة البحث)

هناك في كوسوفا مسجداً يحملان اسم "جامع سنان باشا" أحدهما وأكثرها شهرة موجود بمدينة بريزن و الثاني أصغر و أقل شهرة موجود بمدينة كاتشانيك. و بما أنهما من الآثار المهمة للمعمار الإسلامي في كوسوفا لأن بانيهما كانا من الشخصيات المهمة في تلك الفترة الزمنية و لعبا دوراً مهماً في تاريخ الدولة العثمانية، و يجدر بالذكر بأن باني جامع كاتشانيك كان كوجا سنان باشا بيلربيه بمدينة بوديم، و هما غير معروفين عندنا. و يمكن القول بأن حولهما تم اختراع حكايات و تم الخلط بينهما بحيث لا يمكن التفريق بينهما بصورة جيدة.

Në faqen e parë të zbrazët shkruan se këtë Kur'an e vakufoi Mehmed Seid Pasha, mutesarraf i Prizrenit për hir të shpirtrave të prindërve të tij më 15 xhumad-eth-thani 1222 h. (21.07.1807).

-2-

Komenti i Kur'anit në gjuhën persiane me titull: "El-Mevahibul-'alijje" të cilin e shkroi Husejn Kashifi (ka vdekur rreth vitit 1484).

Këtë ekzemplar e ka përshkruar Hasani i biri i Alauddin Shexheri Husejnija. Përshkrimin e përfundoi më 22 muharrem 984 h (28.06.1576), do të thotë njëqind vjet pas botimit të veprës.

Letra është e vrazhdë dhe shumë e hollë, madhësia 31,5x 19 cm.

Faqet janë të ndotura, me disa vija dhe shumë ngjyra. Teksti Kur'anit është i shkruar me ngjyrë të kuqe, kurse komenti me ngjyrë të zezë. Kopertinat janë prej lëkurës. Shkrimi është shumë i bukur i imët "nes-h". Faqet e para dhe të fundit janë të plota dhe të zbukuruar. Ky dorëshkrim është i ruajtur jashtëzakonisht mirë dhe është një ekzemplar me vlerë.

Në faqen e parë shkruan se dorëshkrimin e vakufoi Sinan Pasha, vezir i Sulltan Muratit në Xhaminë e Mehmet Pashës në Prizren. Në original shkruan në pjesën e parë të rebiu-th-thani 997h (28.01.1589).

-3-

Shqyrtimi nën titullin "Rikujtimi i të vdekurve dhe çështjet e ahiretit", shkruar nga Abdullah el-Kurtubi, ka vdekur më 1272 të erës së re.

Madhësia 30x21 cm. Lidhja e kartoni.

Në faqen e fundit gjendet shkrimi, nga i cili shihet se njëfarë Jahja i biri i Jahjas, më 8 dhil hixh-xhe 1071 h (04.08.1662) e ka mbaruar studimin e këtij ekzemplari në atë mënyrë, i cili ka pasur vlerë në kohën e halifit Mensur Bil-lah.

TRASHËGIMI

Mehmed Mujezinoviq

DORËSHKRIMET E XHAMISË SË MEHMET PASHËS NË PRIZREN

-1-

Kur'ani:

- Është i shkruar me një dorë shumë të shkathët. Ky ekzemplar i zbukuruar është i shkruar në një mënyrë jo të rëndomtë. Rreshti i parë, i shtatë dhe i fundit të çdo faqeje janë të shkruar me shkronja të mëdha me shkrimin "thuluth" (me ngjyrë të portokalltë) e në mes tyre nga gjashtë rreshta me shkronja më të imta janë të shkruar me ngjyrë të zezë me shkrimin "nes-h" dhe diçka pak më të tërhequr në të dyja faqet. Këto hapësira janë po ashtu të mbushura me ornamente të ngjyrave të ndryshme, ku mbizotëron ajo e arit. Ajetet (versetet janë të ndara me pika dhe janë të theksuar edhe xhuzet (pjesët) si dhe ndonjë sure (kaptinë).

Madhësia e tij është 26,5x20 cm. Letra e verdhë dhe e trashë.

I mungon fillimi i tri faqeve të para. Kopertinat me siguri nuk janë origjinal, sepse janë bukur të vrazhda dhe pa kurrfarë zbukurimi.

Në faqen e fundit ekziston shkrimi nga i cili shihet se ky ekzemplar është përshkruar nga Aliu, i biri Mahmud Merviut, nga Herati në Afganistan, në pjesën e parë të muajit rexheb 28.03-6.04.1560.

-4-

Vepra e mbi **ceremoninë fetare** e Muhamed Feramerzit. Shkruar me shkrimin "nes-h". Lidhja e lëkurës. Madhësia 26x15 cm. Fillimi është me shumë ngjyra dhe me zbukurime.

Në faqen e parë të zbrazët gjendet shkrimi, nga i cili kuptohet se pronari i këtij ekzemplari ishte Alija, i biri Halilit, gjykatës i përko-hshëm në vendin e quajtur Horishkë /?/, në vitin 1056h (1646/47).

-5-

Komenti i Kur'anit në gjuhën arabe.

I mungon fillimi. Në fund gjendet shënimi se ky fashikull është kryer më 19 shev-val 718 h (15.12.1318).

Në këtë fashikull është komentuar Kur'ani deri në kaptinën "Kehf". Madhësia 18,5 x 27 cm. Lidhja e lëkurës. Vepra është e ruajtur shumë mirë.

Në faqen e parë të zbrazët gjendet vula, nga teksti i të cilit shihet se dorëshkrimi i përket Bibliotekës së Medresesë së Mehmet Pashës në Prizren.

-6-

Fjalori arabisht-arabisht, i njohur me emrin "Taxhul-lugat ve sahi-bul-arabijje" nga Hamad Xhevheri. Ka vdekur në vitin 1002 sipas erës së re.

Madhësia 31 x 20 cm. Letra e trashë dhe e bardhë. Shkrimi "nes-h". Teksti është shkruar me ngjyrë të kuqe dhe të zezë. Lidhja me karbon.

Në faqen e parë të zbrazët janë shkruar emrat e dy pronarëve të kësaj vepe: Muhamedi i biri i Alijes, i biri i Hasanit, i biri i Ali Curqinit si dhe Ahmed Nazifit, nipit të haxhi Ahmed Samakovit, profesor në Edrene, me nënshkrimin dhe vulën e tij, por pa datë.

-7-

Vepra "E drejta e Sheriatit" nga Burhanudin Marginani. Ka vdekur më 1196 h (1782).

Përshkrimi i këtij dorëshkrimi është bërë më 10 rexhep 996 h (03.06.1588).

Madhësia 31x20 cm. Dorëshkrimi është i ruajtur shumë mirë. Lidhja e lëkurës.

Libri ishte pronë e Ahmedit, të birit të Husejnit prej Dibrës, më 1101 h (1689/90). Pastaj ka ardhur në Bibliotekën e Mehmet Pashës në Prizren, që shihet nga shënim i Abdul Halimit, profesorit të atëherëshëm të Medresesë së Mehmet Pashës në Prizren.

-8-

Fjalori i gjuhës arabe, i autorit Muhamed Nexhmudini Shirazit.

Madhësia 30x20 cm.. Lidhja e lëkurës. Dorëshkrimi është i dëmtuar nga insektet.

Përshkroi: Ebu Bekri, i biri i Abdurrahmanit, i biri i Ebu Bekrit, i biri i Abdulatifit, i biri Omer Avaxhes, ditën e diel, më 14 sefer 968 h (06.11.1560).

Në përfundim të tekstit në faqen e fundit me shkronja të mëdha shkruan se ky ekzemplar është vakuf i Husejn Agës, qehaja i Hasan Pashës në Jemen.

Po ashtu në të njëjtën faqe shkruan: Vakuf i Mehmet Pashës, kurse shënimi është shkruar nga kadiu i Prizrenit, Nesuhi, i biri i Sinanit.

-9-

"Vepër e të drejtës së sheriatit" e autorit Hasan e Averenxhendit.

Në fund të tekstit shkruan se vepra është përfunduar në muajin Ramazan 966 h (07.06- 07.07.1559). Përshkruesi i veprës është Mahmudi i biri i Durgutit.

Në fillim ka një titull të bukur dhe shumë ngjyra. Është e shkruar me një shkrim të bukur "nes-h", madhësia e faqeve 27x17 cm. Lidhja e lëkurës. Dorëshkrimi i ruajtur mirë.

-10-

"El-Kanun fit-tibbi" (Ligji i mjekësisë) i ibni Sinait, të shkencëtarit më të njohur arab në lëmin e mjekësisë, i njohur në Evropë me emrin Avicena (980-1037) sipas erës së re.

Madhësia 26x17 cm. Fletët dhe faqet nuk janë të numëruara. Lidhja e lëkurës me ngjyrë ari. Insektet e kanë dëmtuar në veçanti faqet e para të këtij dorëshkrimi tejet të çmuar. Teksti është i vokalizuar dhe mjaft i madh me shkrimin "nes'h". Nuk ka vit të përshkrimit e as emër të përshkruesit, mirëpo në bazë të llogarisë së shkrimit dhe sipas letrës mund të supozohet se dorëshkrimi është shumë i vjetër.

Në faqen e parë shkruan se ky ekzemplar i "Kanunit" ka qenë në pronësi të Sajid Mustafë Mes'udit, profesor dhe mjek specialist.

-11-

"Mutavveli", komenti në veprën "Talkhis el-miftah" (Retorikë e gjuhës arabe) e autorit Sa'dudin Taftazanit. Vepra në origjinal mban datën e vitit 1347 sipas erës së re.

Përshkrimi i veprës nuk ka datë. Madhësia 28x19 cm. Lidhja e kartonit. Shkronjat janë shumë të imëta me shkrimin "nes'h". Dorëshkrimi është i dëmtuar.

-12-

"Tarihi Xhelali" (Historia e Xhalalit).

Nis me krijimin e botës.

Në faqen e fundit shkruan se ky ekzemplar është shkruar më 1151 h., (1738/39) nga ana e Muhamedit, të birit të Ahmedit në ujdhesën e Kretës, ku i përmenduri ishte në shërbim si aga.

Në margjina gjendet kronogrami i vdekjes apo ardhja në pozita të personaliteteve të caktuara, të cilët përmenden në tekst.

Është vepër interesante dhe me vlerë të madhe.

Madhësia 29x16 cm. Është shkruar me shkrimin "nes'h" e shkruar bukur me ngjyrë të kuqe dhe të zezë. Lidhja e lëkurës. Vepra është e ruajtur.

-13-

Pjesa e dytë e volumnit të veprës "Durer" nga lëmi i të drejtës së sheriatit.

Në faqen e fundit shkruan se vepra është përfunduar në vitin 880 h.(1475).

Përshkruar nga Ahmed i biri i Haxhi Rexhepovit, myfti i Sofjes dhe profesor në Medresenë Sofi Mehmet Pasha 1017 h. (1608/09).

Madhësia 27x17 cm. Lidhja e kartonit. Shkrimi shumë i dobët "nes'h".

-14-

Vepër mbi traditën Islame (hadith). Është shkruar në muajin Ramazan 939 h. (27.03-26.04.1533).

Madhësia 26x17 cm. Lidhja e lëkurës. Dorëshkrimi i ruajtur. Ky ekzemplar është vakuf i Ibrahim Hakiut nga Qystendili.

-15-

Vepër mbi traditën e të drejtës së sheriatit. Nis me librin e Vakëfit.

Është përshkruar më 10 Ramazan 863 h (1-11.07.1459).

-16-

"Sherhul-Menar" (mbi principet dhe burimet e të drejtës së sheriatit) nga ibnu Meleku. Vdiq përafërsisht më 1480.

Madhësia 20x15. Lidhja e lëkurës. Shkrimi i bukur "nes'h". Ekzemplari i ruajtur mirë.

Në faqen e fundit nën tekstin e origjinalit gjenden shënime se këtë ekzemplar e ka përshkruar në vitin 1063 h. (1653) në Vidin, Ahmed, i biri i Uveysit.

Në faqen e parë të zbrazët gjendet shkrimi nga i cili shihet se dorëshkrimi ishte pronësi e Sulejmanit, të birit të Rustem Kilixhes në Medresenë e Prizrenit, dhe nën të viti 1228 h (1813).

-17-

"Sherhul Menar" e njëjta vepër, sikur ajo nën numrin 16.

Në fund të tekstit të veprës shkruan se ky ekzemplar është përshkruar në muajin shaban 1071 h (1-29.04.1661) në vendin e quajtur Kasnisa (?) në Medresenë e Bajram Pashës.

Dorëshkrimi është testament i Haxhi Husein Takbashi 1201 h (1792).

Madhësia 13x21 cm. Lidhja e lëkurës. Dorëshkrimi është i ruajtur mjaft mirë.

-18-

"Tahsisu- miftah", (vepër nga lëmi i stilistikës arabe) .

Përshkroi Abdullahu, i biri i Omerit nga Pozhega, më 20 ramazan 1045 (27.11.1636).

Dorëshkrimi është testament i Haxhi Husein Takbashit, më 1201 h (1792)). Shkrimi është "nestalik". Lidhja e lëkurës. Madhësia 20x13 cm. Ekzemplar i ruajtur.

-19-

Komenti i veprës "Faneri" (në lëmin e logjikës).

Në fletën e fundit të dorëshkrimit nën tekst gjendet shënimi se këtë ekzemplar e shkroi Aliu, i biri i Osmanit nga Kostamoni, më 1235 h (1819).

Madhësia 20x14 cm. Lidhja e kartonit.

-20-

Komenti në veprën e Taftazanit mbi akaidin islam.

Përshkrimi nga viti 1227 h (1812).

Lidhja e kartonit.

Shkrimi shumë i bukur "nes'h".

Madhësia 20x15.

I ruajtur mjaft mirë.

-21-

"Fetavi Ali efendi" (Fetfat e Mufti Ali efendiut) .

Në fund nën tekst gjendet shënimi se këtë ekzemplar e përshkroi Xhani Abdullahu, i biri i Muhamed Karamaniut në Konstantinopol (Stamboll), në Medresenë e Pajazidit, në muajin rebiil-evvel 1117 h (17.12.1705- 15.07.1706).

Në fillim gjendet një titull i bukur në shumë ngjyra. Shkrimi i bukur "nes'h". Madhësia 22x12 cm. Lidhja e lëkurës. I ruajtur në tërësi.

-22-

"Isagoxhi"(vepër nga lëmi i logjikës).

Përshkrimi i vitit 1248 h (1832). Madhësia 23x15 cm. Në fillim ka titullin e bukur. Ekzemplar i ruajtur mirë.

-23-

"Fetavi Behxhetul-muin" (nga lëmi i fikhut).

Në fund të tekstit shkruan se këtë përshkrim e përfundoi Mustafa Xhilizade në pjesën e dytë të muajit muharrem 1147 h (12-21.04.1734).

Madhësia 20x14 cm. Lidhja e lëkurës. Shkrimi i bukur "nes'h". Kopje e ruajtur mirë.

-24-

"Dinkos" (vepra nga lëmi i logjikës).

Përshkroi: Sadullah Celebiu, i biri i Abdullahut në medresenë Ula-kli dhe në medresenë e Mustafa efendiut në vitin 1120 h (1708/09).

Ky dorëshkrim ishte në pronësi të Ibrahimit të birit Osman Dokuz Dolma Zades nga Prizreni, më 1213 h (1798).

Madhësia 19x14cm. Lidhja e kartonit.

-25-

Komenti mbi veprën e të drejtës së trashëgimisë sipas sheriatit të ibnu Kemalit. Përshkroi më 25 safer 985 h (14.04.1577), Ibrahim i biri Abdullah Kerimit në Shkup.

Në faqen e parë të zbrazët shkruan se dorëshkrimi ishte në pronësi të një Sejde, kadi i Kajasarli më 1147 h (1734).

Madhësia 18x12 cm. Lidhja e kartonit.

-26-

"Vafija" koment i veprës "Kafija" nga lëmi i sintaksës së gjuhës arabe, i autorit Ruknuddin Muhamed Esterabadis (vdiq më 717 h (1317).

Në fund, prapa tekstit të dorëshkrimit shkruan se këtë ekzemplar e përshkroi ditën e premte më 11 shev-val 757 h (08.10.1356) Ahmedi, i biri i Abdullah Kejlekut (?) në universitetin e njohur të Bagdadit.

Në fillim janë shënuar emrat e pronarëve të këtij libri: Hafiz Ahmedi nga Sivasi dhe Hivzi Hafizudin nga Mosuli.

Madhësia 12x21cm. Dorëshkrimi nuk është i lidhur. Shkrimi "nes'h".

-27-

"Isamudin" (vepër nga lëmi i akaidit).

Është përshkruar më 883 h (1478) në Medresenë "Alak" në kohën e Selim Giraj Hanit në Krime.

Madhësia 20x14 cm. Shkrimi "nes'h". Është i ruajtur mjaft mirë.

-28-

"Makamatu Hariri" (Letërsia e bukur arabe).

Përshkroi: Omeri, i ibiri Abdurrahimit, i biri i ibni Kemalit, në pjesën e parë të muajit xhumaduth-thani 741 h (22.11.02.12.1340).

Shkrimi nes'h. Madhësia 24x17 cm. Lidhja e kartonit.

-29-

Komenti i "Xhulistanit" (vepër filozofike dialektike në gjuhën arabe).

Përshkroi: Halili i biri i Halilit 939 h (1532).

Madhësia 20x12 cm. Lidhja e lëkurës. Në fillim e ka titullin e bukur me ngjyra. Ekzemplar i ruajtur mjaft mirë.

-30-

Vepër nga lëmi i të drejtës së sheriatit nga Feramerzi, i biri Alijes. Përshkroi Husejn Halife, i biri i Mustafes në Srrajevë, në mesin e muajit xhumaduth-thani 1171 h (20.02-01.03.1758).

I mungon fillimi. Madhësia 21x14 cm.

-31-

Vepër nga lëmi i mjekësisë, i autorit të panjohur "Kitabun fit-tt-ibbi". Madhësia 20x15 cm.

-32-

Komenti mbi veprën "Multekal-ebhur" (e drejta e sheriatit) të autorit Ajniut.

Përshkrimi i vitit 1062 h (1652)

Madhësia 20x14 cm.

Pronësia e Abdul Aziz Hivzi efendiut, myderriz në Medresenë e Mehmet Pashë në Prizren, pa datë.

-33-

"Kitabul-lejthi" (vepër nga lëmi i të drejtës së sheriatit).

Përshkroi: Abdul Azizi në Medresenë e Mehmet Pashës në Prizren më 1320 h (1902).

Pronari: Mustafa, i biri i Ahmed Gumulxhines.

-34-

Fashikulli i katërt i përkthimit të Kur'anit të Ebu Lejth Samarkandit.

Pronar: Haxhi Mustafë Misri.

Madhësia 21x13 cm.

-35-

"Shekaiku en-Nu'man" (Biografia e Imam Azamit, Ebu Hanifes nga Ebul Kasim Ahmed kerije.

Përshkroi: Mustafa, i biri Seidit, i biri Mahmudit, më 13 xhumadu th-thani 989 h (15 .07.1581).

Në këtë ekzemplar gjenden shënimet për pronarët që vijojnë: Muhamedi, i biri Mehmed Dagistanit, nga viti 1161 h (1748).

Abdullahu, i biri Zaim Muharrem, begut të Mehmed Remziut.

Sejid Ali Nexhmudin Mektumit.

Hivziu, myderrizit nga Prizreni dhe të njëfarë haxhi Mustafës.

Madhësia 21x15 cm. Shkrimi i bukur "nes'h". Ekzemplari i ruajtur mirë. Lidhja e kartonit.

-36-

Vepra nga lëmi i logjikës të Mir El-Fet'hit.

Përshkroi: Muhamedi, i biri Abdullah Kastamunit në vitin 1230 h (1815).

Madhësia 18x21 cm. Lidhja e kartonit. Libri ishte në pronësi të Abdul Aziz Hivziut nga Prizreni dhe Abdullah efendiut.

-37-

Poezi në gjuhën persiane.

Në fillim titulli i bukur. Poezitë janë të shkruara në shkrimin "tal-ik". Faqet janë të dekoruara me një vijë të arit dhe tri vija me ngjyrë të zezë.

Madhësia 18x14 cm. Lidhja e kartonit.

-38-

"Gjulistani" (vepër filozofike-didaktike) nga Sadiu në gjuhën persiane. Madhësia 17,5x12cm. Dorëshkrim shumë i vjetër. Pa datë të përshkrimit dhe pa emrin e përshkruesit. Shkrimi "nostalik". Lidhja e kartonit.

-39-

"Kitabu Hajali"

Në faqen e parë të zbrazët gjendet shënimi i testamentit të dorëshkrimit nga ana e Mehmet Emin Pashës, të birit të Tahir Pashës për bibliotekën e Mehmet Seid Pashës, **mustahfiz** në Prizren më 1223 h (1808).

Në fund të tekstit thuhet se veprën e përfundoi Mahmudi, i biri i Hasan Vardarit, në muajin ramazan 961 h (31.07.-29.08.1554).

Madhësia 20x14 cm. Shkrimi "nes'h". Lidhja e kartonit. Dorëshkrimi është në gjendje të mirë.

-40-

Komenti i veprës "Shemail" (biografia e Muhamedit a.s.) e Ali el-Karijes.

Shkrimi i bukur "nes'h". Madhësia 18x12. Lidhja e lëkurës. Dorëshkrimi është në gjendje të mirë.

-41-

Përmbledhje poezish në gjuhën turke.

Në fillim është një titull shumë i bukur. Shkrimi tejet i bukur "nes'h talik". Nuk ka datë të përshkrimit, mirëpo në bazë të mënyrës së shkrimit mund të vijmë në përfundim se është dorëshkrim shumë i vjetër. I mungon përfundimi.

Madhësia 19,5x11 cm. Lidhja e lëkurës.

-42-

"Mashijetuk Kadi" e Shejh Zades.(Komenti i pjesës së fundit të Kur'anit). Përshkrimi i vitit 1085 h (1674).

Madhësia 19,5x13 cm. Shkrimi i bukur "nes'h". Lidhja e kartonit.

-43- T

Vepër nga lëmi i logjikës. I mungon fillimi.

Në faqen e fundit nën tekst hasim shënimin se autor i veprës është Aliu, i biri Osman Kastamunit në Medresenë Unxhi në vitin 1237 h (1821).

Madhësia 21x15 cm. Shkrimi i bukur "nes'h". Lidhja e kartonit.

-44-

"Sadrush-sheria" (vepër mbi të drejtën e shariatit).

Përshkroi: Muhamedi, i biri Huseinit, hatib në xhaminë e Sofi Si-nan Pashës në Prizren.

Madhësia 21x14,5 cm. Shkrimin "nes'h". Dorëshkrimi i ruajtur mirë.

-45-

Vepra mbi ceremonitë fetare dhe moralin.

Në fund të tekstit shkruan se vepra është përfunduar më 1051 h (1649) në Mekë në Medresenë Eshrefije në Babus-selam.

Përshkroi: Haxhi Ismaili, i biri Muhamedit, në vitin 1074 h (1664).

Në faqen e parë të zbrazët shkruan se dorëshkrimin e vakufi Husejini, **xhabia** i xhamisë së Osman Pashës në Nish për Hasanin, imamin dhe hatibin e xhamisë së lagjes, të quajtur Porta e Beogradit në Nish.

Shkrimi i bukur "nes'h". Madhësia 21x14 cm. Lidhja e lëkurës, i ruajtur.

-46-

"Fevaidi vafije li hal-li mushkilatil-kafije" nga Abdurrahamani Xhamia. (Sintaksa e gjuhës arabe).

Përshkruar në pjesën e fundit të muajit rebiu-th-thani 994 h (10-19.04.1586).

Në faqen e parë të zbrazët gjenden të dhëna për pronarin e dorëshkrimit, haxhi Mehmetin, të birin e Ahmedit prej Tunisit, myderriz në Prizren, më 1195 h (1781).

Madhësia 20x13 cm. Lidhja e lëkurës. Dorëshkrim i ruajtur shumë mirë.

-47-

"Kanuni xhedid" (Kodi i ri).

Në gjashtë faqet e para gjenden fetfat të myftiut të Prizrenit, Sjid Muhamedit. Në fund, shënim se dorëshkrimin e ka përshkruar Ibra-

him Dokuz Dolma Zade nga Prizreni, në muajin muharrem, 1218 h (23.04-22.05.1863).

Madhësia 20x13 cm. Lidhja e lëkurës. Dorëshkrim i ruajtur mjaft mirë.

-48-

"Kitabus-sarfi ven-nahvi" (Gramatika dhe sintaksa e gjuhës arabe).

Në fund të dorëshkrimit, nën tekst shkruan se veprën e përshkroi Salih efendiu në muajin rexhep 1019 h (19.09.-18.10.1610) në Medresenë e Mehmet Pashës.

Madhësia 20x13cm. Lidhja e kartonit. Shkrimi "nestalik".

-49-

"Tesavuret Mashijesi (logjikë).

Në fund të dorëshkrimit nën tekst shkruan se dorëshkrimi është përfunduar në Magnisi. Shkrimi i bukur "nes'h". Madhësia 20x12 cm. Lidhja e kartonit. Ruajtur mirë.

-50-

"Mutavvel" (mbi stilistikën e gjuhës arabe).

Në faqen e parë të zbrazët gjendet testamenti i Emin Pashës. Pronar i këtij dorëshkrimi ishte Mir Mustafa Pasha Zade Mehmet Seidi, gjykatës ushtarak në Anadoll.

Madhësia 20x14 cm. Shkrimi "nes'h". Lidhja e kartonit.

-51-

Komenti mbi veprën Fikhu i Kejdani nga Kunistani.

Në këtë ekzemplar gjenden disa vula të pronarëve të mëhershëm.

Madhësia 21x13 cm.

-52-

"Mutavvel" (mbi stilistikën arabe)

Këtë dorëshkrim e ka përshkruar Abdurrahmani, ditën e xhuma, në muajin rexhep 852 h (shtator 1448) në Medresenë e Daudisë në Tibriz.

Në fillim është titulli i bukur. Shkrimi "nestalik". Madhësia 22x14 cm.

-53-

"Tahisul-miftah" nga Taftazani (në lëmin e stilistikës).

Ka titull të bukur. Madhësia 17x10cm. Lidhja e lëkurës.

Në fund gjendet shënimi se dorëshkrimi është përshkruar më 1015h (1606).

-54-

Komenti i Kur'anit (fashikulli i njëmbëdhjetëi kaptinës "Nahl".

Përshkroi: Omeri, i biri i Muhamedit nga Bosnja në vitin 1009 h (1600).

Shkrimi i bukur "nes'h". Madhësia 29x19 cm.

Në faqen e parë të zbrazët shkruan se dorëshkrimin e vakufi Mahmud Pasha, i biri i Tahir Pashës, mutesarraf i sanxhakut të Prizrenit për bibliotekën e Prizrenit më 1227 h (1815).

-55-

"Kafija" e autorit ibnu Nexhib, (Gramatika dhe sintaksa e gjuhës arabe).

Dorëshkrimi është përshkruar në muajin xhumaduth-thani 984 h (26.08 – 23.09.1576).

Madhësia 20x14 cm. Lidhja e kartonit.

-56-

"Gjulistani" i Sa'diut (vepër filozofike-didaktike në gjuhën persiane).

Në faqen e fundit të dorëshkrimit gjendet shënimi se këtë ekzemplar epërshkroi në mesin e muajit dhul-ka'de të vitit 914 h (01.10.1509), Muhamedi, i biri haxhi Sinan Shkupjanit (Shkupi).

Madhësia 18,5x14 cm. Lidhja e kartonit.

-57-

Komenti mbi "Shahidiun".

Përshkroi Musli Uskupi (nga Shkupi) i njohur me emrin Isa begu nga Prishtina në vitin 1153 h (1740).

Madhësia 21x15 cm. Lidhja e lëkurës.

-58-

"Meani" (vepër mbi stilistikën).

Përshkruar më 940 h (1534) në kasabi Corli në kohën e myderriz Ferhit.

Madhësia 21x15. Lidhja e lëkurës. Dorëshkrim i ruajtur mirë.

-59-

"Ifitaf" komenti veprës "Misbah" nga lëmi i sintaksës.

Përshkroi Rexhepi, i biri Sheh Sulejmanit në Rahovec në kadillukun e Suharekës, më 1167 h (1753). Madhësia 22x15 cm.

-60-

Fetfa nga lëmi i akaidit. I mungon fillimi. Madhësia 21x15 cm. Shkrimi i bukur "nes'h".

- 61-

"Siraxhul-Mekasidi" (vepër mbi akaidin dhe apologjetikën). Madhësia 22x15 cm. Shkrimi i bukur "nes'h".

-62-

"Buhari" (Tradita islame e hadithit).

Në fillim titulli i bukur. Shkrimi i bukur "nes'h".

Madhësia 30x20 cm. Dorëshkrimi lënë testament nga: Mehmet Emin Tahir Pasha në vitin 1255 h (1837).

-63-

"Mesnevi" (Vepër filozofike-mistike në gjuhën persiane) nga Xhelaludin Rumi.

Madhësia 20x30 cm.

-64-

Koment i veprës nga lëmi i akaidit nga Xhelaludin Devanija.

Përshkroi: Ali Shevki, nxënës i Rexhep Hulusiut 1286 h (1869).

Madhësia 20x15 cm. Lidhja prej kartoni. Kopja e ruajtur.

-65-

"Risale huxhetul-vahde".

Në fillim titulli i bukur.

Madhësia 20x15 cm.

Pronësi e hafiz Abdullah Hzra, myderriz në Prizren.

-66-

Komenti i Kur'anit nga Bejdaviu "Envarut-tenzil ve asrarut-tevil".

Përshkroi: Abdullahu, i biri Ahmedit, i biri i Husejnit nga Pozhega, pa datën e përshkrimit. I mungon fillimi.

-67-

"Sherhu Esmat husna" (Shpjegimi i domethënies së emrave të Zotit) nga sheh Sa'dudini.

Titulli i bukur dhe dorëshkrimi i ruajtur mirë. Madhësia 20x14 cm.

-68-

Vepra me titull: "Sherhu hulasatul-miftah" (mbi stilistikën).
Përshkrimi i vitit 1308 h (1890). Me kopertina të zbukuruar.

-69-

Komenti i kaptinës "Nebe", (pjesës së fundit të Kur'anit).
Përshkroi: Abdul Halim, myderriz nga Prizreni 1124 h (1712).
Madhësia 28x19cm.

- 70-

Përmbledhje me përmbajtje të ndryshme në disa prej të cilave ka recete për barna të ndryshme.

- 71-

Kur'ani:

Formati 14x10,5 cm. Shkrimi shumë i bukur "nes'h". I mungon fillimi deri në fjalën "mustehziun". Faqet janë të dekoruara me një ngjyrë ari të gjerë dhe tri vija të ngushta me ngjyrë të zezë. Pikat janë të praruara dhe të ornamentuara me ngjyra.

Lidhja e bukur.

Përshkroi: Mustafa, i biri i Nesuhit nga Selaniku në fund të muajit shaban 711 h (1312) . Sipas kësaj, del se ky dorëshkrim duhet të jetë edhe më i vjetri në këtë bibliotekë, i cili tani ka 695 vjet (vër. Q.M.).

-72-

Vepra nga lëmi i traditës islame (hadithit).
Në fillim ka titullin e bukur.
I mungon fundi.

-73-

Vepër nga lëmi i traditës islame (hadith). Dorëshkrim shumë i vjetër. I mungon data dhe emri i përshkruesit.
Madhësia 25x18 cm.

-74-

Komenti i veprës së "Muslimit" (tradita islame e hadithit).
Madhësia 25x19 cm. Dorëshkrim i vjetër. I mungon emri i përshkruesit si dhe data e përshkrimit.

-75-

Vepër nga lëmi i të drejtës së sheriatit.
Përshkroi: Ibrahim, i biri i Hysen agës në medresenë e Veli efendiut në kohën e Giraj hanit, të birit të Selim Giraj hanit.
Dorëshkrimi është i dëmtuar.
I mungon fillimi.

Përfundon me numrin 75. Në raport autorit i janë përvjedhur dy gabime. Raporti përfundon me numrin 77, (vër. Q.M.)

Entit rajonal për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës – Prishtinë

Në bazë të kërkesës së titullit të lartpërmendur, nr. 02-47/1, të datës 12.04.1961, kam kontrolluar gjatë periudhës prej 18-29.04.1961 Bibliotekën e Bashkësisë Islame në Prishtinë, Bibliotekën e Xhamisë së Mehmet Pashës në Prizren dhe Arkivin e dokumenteve turke në Manastirin e Deçanit, me ç'rast paraqes këtë:

Raport

Biblioteka e Bashkësisë Islame në Prishtinë.

Biblioteka e Xhamisë së Mehmet Pashës në Prizren.

Biblioteka është vendosur në tyrben, e cila gjendet në oborrin e Xhamisë së Mehmet Pashës. Pasi që Mehmet Pasha nuk është varrosur aty, atëherë tyrbja është kthyer në bibliotekë.

Në këtë bibliotekë gjenden mbi 2.000 libra të shtypur dhe në dorëshkrim. Ajo në realitet është Biblioteka e Medresesë së Mehmet Pashës, me të cilën bibliotekë në radhë të parë janë shërbyer profesorët e kësaj medreseje. Kjo do të thotë se biblioteka ka shërbyer për përgatitjen e hoxhallarëve të rangut të lartë.

Bibliotekës së Mehmet Pashës, disa vite më parë iu ka bashkangjitur po ashtu edhe biblioteka me vlerë e të ndjerit Hafiz Abdullahut, po ashtu myderriz i Medresesë së përmendur. Librat e tij janë të vulosura me vulë të veçantë.

Xhamia e Mehmet Pashës si dhe biblioteka e Hazrovës nuk kanë inventar si dhe kurrfarë regjistri. Librat janë të vendosura në ormanë, xhamat e shumicës së të cilëve janë të thyer. Ormanët me libra nuk janë të mbyllur.

Dritaret e poshtme të Tyrbes janë të përforcuar me dërrasa, ndër kohë që dritaret e epërme nuk kanë fare xhama, por janë të hapura, kështu që pluhuri si dhe të reshurat tjera atmosferike ndikojnë shumë në libra. Përveç, kësaj librat i ekspozohen edhe lagështisë, sepse tyrbja është në katin përdhes dhe nuk është e izoluar prej lagështisë, për

këtë edhe të disa dorëshkrime shohim se fletët janë të ngjitura njëra me tjetrën, gjë që është vështirë që ato të ndahen. Dera e tyrbes mbyllet me dry, çelësi i të cilit gjendet në Këshillin e Vakfit në Prizren.

Për atë mund të them se kjo bibliotekë nuk është e siguar si duhet.

I kam shikuar të gjitha librat në bibliotekë prej fondit të së cilës i kam zgjedhur 77, (në realitet, ai ka numëruar gabimisht se numri është 75, vër. Q.M.) dorëshkrime nga thesari kulturo-historik dhe artistik. Regjistrin e tyre po ia bashkangjes këtij raporti dhe propozoj që kjo përmbledhje në mënyrë të veçantë të sigurohet dhe të regjistrohet.

Përveç kësaj është e domosdoshme që Biblioteka e Xhamisë së Mehmet Pashës në tërësi të jetë nën mbikëqyrje të Entit. Po ashtu, është e domosdoshme që kompetentët në Këshillin e Bashkësisë Islame të Prizrenit të marrin obligim që me ndihmën profesionale të Entit të bëjnë regjistrimin e të gjitha librave të kësaj biblioteke dhe një kopje të atij regjistri t'ia dërgojnë Entit krahinor në Prishtinë.

Sa u përket dorëshkrimeve të kësaj biblioteke, që janë përmendur në regjistër, mendoj se ato nuk duhet të mbahen edhe më tutje në hapësirën e tyrbes, por propozoj që ato dorëshkrime të ekspozohen në Xhaminë e Mehmet Pashës në Prizren. Me këto dorëshkrime mund të tubohet dhe të ekspozohet materiali kaligrafik, të cilin ende mund ta gjejmë.

Një ekspozitë e tillë do të sillte të mira materiale dhe me këtë për vizitorët mund të bëhej një prospekt i shkurtër me ilustrime.

Në fund, dëshiroj që me disa fjalë të përmend rëndësinë e përmbledhjes së përmendur të dorëshkrimeve dhe në të njëjtën kohë edhe arsyetimin e propozimit për mbrojtjen dhe shpjegimin tyre.

Nuk më është e njohur se kur është themeluar Biblioteka e Mehmet Pashës, mirëpo nga ajo që shihet në dorëshkrimin numër 2, shohim se në vitin **988** h (1576), se Sinan Pasha ia dhuron komentin e Kur'anit në gjuhën persiane për Xhaminë e Mehmet Pashës në Prizren.

Në këtë përmbledhje të dorëshkrimeve përveç veprave thjesht teologjike janë të paraqitura edhe vepra tjera nga disiplina tjera shke-

ncore si: filozofia, matematika, gjeometria, astronomia, historia, misticizmi, mjekësia etj. Po ashtu në këtë përmbledhje gjendet edhe përshkrimi i "Kanunit" nga shkencëtari më i njohur arab në mjekësi, Avicena. Ekzistenca e këtij libri në bibliotekat tona është gjë e jashtëzakonshme.

Në këtë përmbledhje ka disa dorëshkrime dhe përshkrues nga vende të ndryshme të botës: nga Arabia, (Mekka), Persia, Afganistani, Tibrizi, Anadoli, Stambolli, Greqia, Bullgaria, Hungaria, etj. Aty kemi një vepër të përshkruar para 700 vjetëve (vër. Q.M.), në universitetin e njohur të Bagdadit. Nga ana tjetër, përmbledhja përfshin dorëshkrime të përshkuara edhe në Kosovë si dhe vendet përreth si: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Shkup, Nish, Pozhegë, Manastir, Banja Llukë, Sarajevë si dhe vende tjera.

Duke u mbështetur në kohën e krijimit të këtyre dorëshkrimeve, shohim se përmbledhja përmban edhe dorëshkrime shumë të vjetra. Kështu për shembull, dorëshkrimi numër 71 është përshkruar para 695 vjetëve e shumë dorëshkrime tjera janë të shekullit gjashtëmbëdhjetë.

Është shumë me interes kur shohim në bazë të testamenteve të pronarëve në disa dorëshkrime se si librat barten prej një vendi në një vend tjetër.

Këto përmbledhje na ofrojnë të dhëna interesante për shumë kaliografë si dhe për institucionet arsimore-kulturore si dhe për objekte tjera.

Nga e tërë kjo që u përmend shihet se kjo përmbledhje e dorëshkrimeve paraqet një material tejet interesant dhe të çmueshëm përveç artistëve të arteve të bukura dhe historianëve edhe rretheve të ndryshme shkencore, andaj lypset të bëjmë çmos që t'ua bëjmë të arritshme publikut të gjerë.

3. Arkivi i dokumenteve turke në Manastirin e Deçanit në Deçan

Sarajevë, 6 maj 1961. Mehmed Mujezinoviq (d. v.)

Bashkëpunëtor i lartë profesional i Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Sarajevë

Se përshkrimi është autentik me origjinalin vërteton sekretari, Vojislav Petroviq

Se përshkrimi është autentik me përshkrimin, i cili gjendet në Entin për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Kulturës të Krahinës Autonome të Kosovës për nevojat e Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Natyrës të Komunës së Prizrenit, e vërteton

drejtori i Entit, Muhamed Shukriu
(nënshkrimi)

Përshkrimin e dokumentit
e bëri Shpresa Cela

Përktheu dhe përshtati:
Qemajl Morina

Mehmed Mujezinoviq

MANUSCRIPTS IN THE MEHMET PASHA MOSQUE IN PRIZREN

(Summary)

The Qur'an was written by a very skilled hand. This copy was not written in an ordinary way. The first, the seventh and the last line (in every page) were written using large orange letters (using the thuluth style). In between are six lines, which are written with smaller black letters (using the nesh style). A number of juz and suwar are highlighted.

محمد مويزينوفيش

المخطوطات بجامع محمد باشا في بريزن

(خلاصة البحث)

القرآن:

كتب من يد ماهرة و هذه النسخة من القرآن الكريم كتبت بصورة غير عادية. السطر الاول و السابع و الاخير من كل صفحة كتبت بحروف كبيرة بالخط الثلث (بلون برتقالي) و ما بينهما ستة اسطر بحروف اصغر كتبت بلون اسود بخط النسخ و مسحوبا من كلتا الصفحتين. و هذه المساحات مليئة باللون مختلفة حيث تسيطر عليه اللون الذهبي. الآيات منفصلة بنقط و تم التركيز على الاجزاء و كذلك على سورة معينة.

TRASHËGIMI

Ramadan Shkodra

XHAMIA “SULLTAN MEHMED- FATIH” (XHAMIA E MADHE) (1460/61) NË PRISHTINË- VEPËR MADHËSHTORE E TRASHËGIMISË ISLAME NË BALLKAN

Kosova paraqet një thesar të pasur të monumenteve kulturo-historike të periudhave të ndryshme, të cilat shquhen për llojllojshmërinë, cilësinë dhe rëndësinë historike të tyre. Në përbërjen e këtij thesari kulturo-historik bëjnë pjesë edhe ndërtimet pesëshekullore të periudhës osmane në këto territore.

Kultura materiale islame në Kosovë, po edhe në të gjitha trojet shqiptare, është shfaqur që nga depërtimi i Perandorisë Osmane në këto troje në shekullin XV, asokohe si bartëse kryesore e fesë, kulturës dhe qytetërimit islam. Krahas përhapjes së fesë e kulturës islame në këto troje, paraqitet nevoja edhe për objektet ku do të kryheshin ritet dhe obligimet e fesë islame, prandaj në shumë vende-lokalitete u ndërtuan objekte përkatëse për qëllime të ndryshme:

1. Objekte për kryerjen e obligimeve dhe riteve fetare: xhami, mesxhide, tyrbe, teqe etj.;
2. Objekte për nevojat arsimore: medrese, mektebe, biblioteka (kutubhane);

3. Objekte të karakterit publik e social: hamame, ura guri, kroje publike, shtëpi banimi, kulla të sahatit, shatërvane, hane, imarete, kala (kështjella);
4. Objekte që shprehin qytetërimin islam: nishane mbi varrezat e myslimanëve, çarshi, bezistane, objekte banimi; dhe me kalimin e kohës dhe me shtimin e ndikimit të kulturës islame në viset tona, u përhapën edhe ndërtime e vendbanime të tëra në stilin oriental.

II

XHAMITË - janë faltore kryesore islame dhe objektet më monumentale dhe për nga numri janë monumentet më të shumta të ruajtura nga përmendoret e kulturës islame në Kosovë. Ndër ne ndërtimi i tyre ka filluar menjëherë pas depërtimit osman.

Sipas të dhënave historike, ndërtimi i xhamive filloi menjëherë pas *Betejës së Kosovës më 1389* (Xhamia e Çarshisë në Prishtinë). Ky aktivitet u zgjerua sidomos gjatë shek. XVI dhe në gjysmën e parë të shek. XVII, kur gradualisht mbisundon popullata islame sidomos në qytete.

Xhamitë janë të ndërtuara me gurë a tulla. Kryesisht janë të mbuluara me kube plumbi, të mbështetura mbi pandantive a trompe, por edhe me çati druri e me qeramidhe. Karakteristikë arkitektonike të shumicës së xhamive, sidomos të atyre më të mëdhave, janë kubetë monumentale dhe minaret e holla e të larta.

Gjithashtu karakteristikë e këtyre xhamive është se brendia e mureve është pikturuar me arabeska, që kryesisht janë me vija gjeometrike dhe me motive bimore të gërshetuara e të stilizuara.

Në qendra të ndryshme të Kosovës kemi disa xhami që i takojnë mesjetës, që paraqesin vlerat arkitektonike të këtyre lloje të xhamive, siç janë p.sh.: në Prishtinë: Xhamia “Sulltan Murat” (Xhamia e Çarshisë) -(1444); Xhamia “Sulltan Mehmet - Fatih (Xhamia e Madhe) (1461); Xhamia “Ramadanije” (Xhamia e Llapit) (1470); në Gjakovë xhamia “Hadumë Agës” (1595); në Pejë “Bajrakli Xhamia” (1471); në Prizren Xhamia “Sinan Pasha” (1616)



Një ndër xhamitë më të rëndësishme jo vetëm për nga stili, por edhe për nga vlera s'ka dyshim se është xhamia "Sulltan Mehmed-Fatih" në Prishtinë, e cila nga populli njihet edhe si Xhamia e Madhe.

Estetika, madhësia, bukuria e kësaj xhamie është aq tërheqëse, sa që, më të drejtë, është quajtur "Xhami Sulltanore" ose "Xhamia e Sulltanit" dhe paraqet një ndër veprat më të bukura të artit Osman-Islam, jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

III

Xhamia "Sulltan Mehmet Fatih" është në rrugën "Nazim Gafurri", oborri i saj është në formë trekëndëshi dhe kufizohet me tri rrugë, dy rrugët anësore çojnë drejt tregut të gjelbër, ndërsa rruga në anën e kiblës në të djathtë shkon drejt qendrës së tashme të qytetit, ndërsa në anën e majtë drejt parkut "Gërmia".


Objekte të rëndësishme afër xhamisë:

Në pjesën lindore të xhamisë përtej rruge gjenden "Sahat Kulla", gjimnazi "Sami Frashëri", Teqeja e Kadirive dhe ndërtesa e ASHAK, kurse në jug të xhamisë është Hamami i Sulltan Mehmet Fatihut. Në oborrin e xhamisë është shatërvani nga mermeri. Shatërvani është i mbuluar me çati me qeramidhe dhe ka 16 çekzme që shërbejnë për marrjen e abdesit.

Historiku i xhamisë

Xhamia e Sulltan Mehmedit II (Fatihut) në Prishtinë, që njihet edhe si Xhamia e Madhe e Prishtinës, është ndërtuar me urdhër të Sulltan Mehmedit II në vitin 865 hixhri (1460/61), 8 vjet pas çlirimit të Stambollit.

Mbishkrimi i xhamisë gjendet mbi derën e xhamisë, mbi një copë të bukur mermeri me ngjyrë të zezë e përbërë prej katër rreshtave, në të cilin thuhet:



Me shpërblimin e Zotit le të jetojë gjatë sulltan Mehmedi

Sulltan Mehmed Fatihu baba i pushtimeve

Gjatë kohës së sundimit të vet ndërtoi xhaminë dhe zhvilloi kulturën në Perandori

Besimtarëve iu dha qetësia shpirtërore, duke u ndërtuar kopshti i Xhenetit.

Këtë ai e kishte quajtur si më të mirën vepër të tij, duke e thënë datën e ndërtimit me këto fjalë: "Ixhmai nehari" (mbledhja ditore) viti 865 hixhri".

Nga mbishkrimi shihet se sulltan Mehmet Fatihu e ka ndërtuar këtë xhami në vitin 865 sipas hixhrit, që i përgjigjet vitit 1461 të erës sonë.

Në realizimin e këtij objekti sakral si material ndërtimor konstruktiv është përdorur guri i latuar. Ndërkaq, faqet e brendshme të mureve janë me tulla dhe të suvatuara. Sa u përket dekorimeve plastike, këto janë mjaft modeste, sado që ato në një masë të vogël prezantohen në forma relievi të imët në minare si stalaktite në mihrab dhe në kapitole e shtylla të hajatit.

Xhamia është e ndërtuar sipas shkollës arkitektonike të Brusës. Xhamia është godinë njëhapësinore me kubënë me dimensione prej 14 m. Është ndërtuar me tulla nga brenda e me gurë të gdhendur nga jashtë.

Xhamia "Sulltan Mehmet Fatih" (Xhamia e Madhe) është e ndërtuar në stilin e "Ullu Xhamisë" që gjendet në Bursa, është e stolisur shumë bukur, dhe është ndër projektet me bukuri të rrallë të kohës kur është ndërtuar.

Xhamia është e ndërtuar me gurë të mëdhenj katrorë. Në mes ka kupolën kryesore në madhësi prej 13,50 m, kurse nga të katër anët gjinden kupolat me tre kënde.

Kupola kryesore dhe kupolat tjera mbulojnë këtë projekt madhështor. Minarja e lartë, e hollë dhe e bukur është e ndërtuar gjithashtu prej gurëve. Kapaku i minares, kupola kryesore dhe tre kupolat e vegjël përpara janë të mbuluara me plumb.

Sikurse xhamia po ashtu edhe minarja nuk janë të suvatuara. Maja e minares është e mbuluar me bronz. Kur shikohet minarja mund të vërehet se ballkoni dhe pjesa e epërme e minares është e rinovuar.

Në xhami gjatë viteve 1961 e 1962 u zhvilluan punimet në konservimin e tremes, ndërsa gjatë viteve 1964 deri 1967 punime mjaft të ndërlikuara në sanimin e minares, kur u rrënua dhe u rindërtua minarja në lartësinë prej 17 metrash.

Xhamia e Madhe përbëhet nga këto pjesë: salla e lutjeve (faljeve), hajati (portiku) dhe minarja.

1. Brendia e xhamisë (Salla për namaz)

Brendia e xhamisë (Salla për namaz) ka vëllim unik dhe është e mbuluar me kube. Kjo sallë ka planimetrin katrorë me përmasa 14 m. dhe në të hyhet nga porta, që është e mbuluar me arkitrach. Salla me vëllimin e saj unik është e mbuluar me kube të konstruktuar drejtpërdrejt mbi te nëpërmjet pandantivave në qoshe.

Xhamia është e shtruar me tepi bashkëkohore.

Dimensionet e xhamisë në matjen e jashtme janë 17.55 x 18.00 m. pa llogaritur hajatin, i cili ka 5.90 m. ndërsa brendia e sallës së xhamisë 14.00 x 14.00 m.

Madhësia e xhamisë mesatarisht thuhet se është 900 metra katrorë. Xhamia ka vend për 800 njerëz.

Mafili:

Mbi derën e hyrjes gjendet mafili nga druri, i cili është pak i thellë në lartësi prej 3.50 m. nga toka që mbahet nga 6 shtylla të drurit. Gjërësia e Mafilit është 2.55 m.



Në mafil hyhet nga dritarja e djathtë më anë të shkallëve. Shkallët janë brenda murit.



Mihrabi

Mihrabi i xhamisë është nga mermeri dhe është mjaft e zbukuruar. Mihrabi është në vend të lartë dhe në harmoni me stolitë e xhamisë.

Minberi:

Edhe minberi i xhamisë është një monumentale, është i ndërtuar sipas traditës dhe stilit osman. Minberi i xhamisë është i ndërtuar nga mermeri është mjaft i bukur. Tre qoshet e tij, bukuria e vendosjes së tyre dëshmon për mjeshtërinë e ndërtimit.

Hyrja e minberit është e stolisur me një kurorë të bukur. Në minber është i vendosur një dritare e vogël por mjaft e bukur. Tre qoshet janë të punuara me nga një rozetë. Minberi është i bojatisur me ngjyrë jeshile, por ka edhe disa ornamente të bukura që përshtaten me har-

monin e xhamisë, këtu duhet veçuar ornamentin që gjenden në dy anët e minberit. Minberi ka 10 shkallë ndërsa gjerësia e tij është 1.10

Dritaret

Xhamia ka 37 dritare në madhësi të ndryshme. Dritaret janë të vendosura në katër nivele.

Dritaret, e nivelit të parë, pos që janë më të mëdha, brenda kanë kapakun e bukur nga druri. Në të katër anët xhamia ka nga dy dritare të tilla që do të thotë 8 sish.



Pamja e brendshme e dritarës



Pamja e jashtme e dritarës

Ndërsa në dritaret e nivelit të dytë janë më të vogla dhe në tri anë ka nga tri dritare, ndërsa ana e hyrjes kryesore nuk ka këso dritare.

Dritaret e niveli të tretë janë më të vogla dhe në të katër anët ka nga 2 dritare, me të vetmin përjashtim që dritaret nga hyrja qendrore kanë formën e rumbullakët.

Punimet e kapakëve të dritareve të kiblës janë shumë të bukura. Kurse kapakët e dritareve tjera, edhe pse janë ndërruar, janë të bukur.

Dritaret e nivelit të katër janë ato të bazës së kupolës, ku janë 12 dritare, që do të thotë se kubja qendrore e xhamisë është në bazën 12 këndesh.

Dera hyrëse

Dera e xhamisë është ndërtuar me pllaka, të cilat në pjesën e epërme kanë formë të yllit 12 këndor. Sot, dera e xhamisë është e ngjyrosur me ngjyrë jeshile. Dera e xhamisë hapet në dy anët.

2. Kupola qendrore

Kupola kryesore mbahet nga qoshet trekëndëshe dhe nuk është shumë e lartë. Gurët të cilët e rrethojnë kupolën i japin një bukuri tjetër xhamisë. Kupolat e pjesës së fundit të vendit të xhematit përbëhen nga pesë pjesë dhe janë tetë këndesh.



3. Hajati

Hajati (portiku) i xhamisë ka një zgjidhje tradicionale të këtyre ambienteve. Hajati mbulohet me tri kube të vogla të njëjta. Kubet e hajatit janë në nivel më të ulët se kubeja kryesore dhe me dinamikën e me kontrastet e tyre ndikojnë në vlerën estetike të objektit. Kubetë janë të mbuluara me mbulesë të plumbtë.

4. Minarja

Si pjesë e pandarë dhe me rëndësi është edhe minarja, e cila zakonisht është në vend të djathtë të sallës së lutjeve. Minarja, si pjesë konstruktive-arkitektonike dhe funksionale, veçohet për poligonalitetin dhe elegancën e saj. Si element i minares është edhe sherifja, e cila shërben për kryerjen e ceremonive të caktuara fetare: thirrja e *ezanit*.

Minarja shumëkëndshe shpreh tendencën e hollësisë maksimale.

Hyrja për në minaret është jashtë xhamisë. Minarja e xhamisë është e lartë 120 shkallë, kurse në lartësi është shtathollë.

Maja e minares është e mbuluar me bronz.



Vlerat artistike të xhamisë

Brendia është e dekoruar me ornamentikë bimore. Duke marrë parasysh dimensionet (14,14 x 14,14 m.), konstruksionin, realizimin dhe elementet dekorative së bashku me kohën e ndërtimit, kjo xhami është një ndër objektet më të rëndësishme dhe më të vlefshme të periudhës osmane ndër ne.



Në këtë objekt monumental na prezantohen edhe dekorimet pikturale të realizuara në seko teknikë. Këto realizime të pikturave murale dekorojnë sallën e lutjeve me kube si dhe hajatin e xhamisë. Këtu,

pos luleve të stilizuara, prezantohen edhe figura gjeometrike, motive arkitektonike, selvi dhe motivi i rrushit. Piktura është përqendruar kryesisht në dritare të sallës së lutjeve, në harqe dhe në padantive në kurore, ku nga sistemi konstruktiv pandantiv kalohet në kube. Dekorime kemi edhe në vetë kubën e objektit. Në piktura murale të xhamisë dominon ngjyra e kaltër me nuanca të saj dhe e përhimëta. Rozeta si një tërësi kompozicionale është realizuar me ngjyrë të kuqe (qeramidhe) me të gjelbër, të përhimët dhe të zezë. E zeza kryesisht i konturon motivet florale dhe gjeometrike të rozetës.

Një "levha" origjinale në dorëshkrim në Xhaminë e Madhe

Brenda në xhami, në murin e djathtë, afër minberit dhe pranë dritares së nivelit të I, qëndron e varur një "levha" origjinale e dorëshkruar nga Beqir mulla Hyseni. Kjo "levha" është e formatit 68 x 50 cm dhe është e kurnizuar me një ram jo aq të veçantë. Në të, në formë të dëshmisë islame (Shehadetit) "La ilahe il-lAll-llah" janë të shkruar disa kaptina të Kuranit, si kaptina "Ja Sin", kaptina "El-Muxhadele", kaptina "El-Gashije" dhe disa ajete të kaptinave të ndryshme.

E veçanta e kësaj "levhe", - përveç se është shkruar në një mënyrë karakteristike dhe origjinale në formën e sintagmës "La ilahe il-lAll-llah", - qëndron edhe në faktin se ajo është një "levha", e cila, sikurse shkruan në shpinë të saj, është shkruar me dorë (tarihi jazi) më 15 rebiul-evvel 1315, përkatësisht ditën e xhuma më 13 gusht



1897, d.m.th. para 110 vjetve nga kaligrafisti i zhdërvjellët - Beqiri i biri i mulla Hysenit. Të theksojmë edhe se kjo "levha", sikurse edhe dy të tjera që gjenden në Xhaminë Jashar pasha (Xhamia e Mesme), ndonëse mjaftë karakteristike dhe me vlera artistike, deri më sot nuk janë marrë në shqyrtim.

Përgatiti: Sadik Mehmeti

Në mes të kupolës gjendet një rozetë. Pjesa e epërme e kupolës është e punuar me motive trëndafili dhe gjethe të bimëve. Figurat janë të punuara me një art mallëngjyes, figurat janë me ngjyrë të kaltër, të gjelbër dhe të kuqe dhe shtrihen deri te dritaret e poshtme.

Brendësia e dritareve në pjesën jugore është e zbukuruar me shkri-me të bukura. Në pjesën jugore dritaret e epërme janë në formë gjy-smë harku dhe xhamat i kanë në formë trëndafili.

Në sajë të elementeve konstruktive, formës arkitektonike, propo-cioneve dhe vlerës estetike të objektit, kjo xhami bën pjesë në rendin e ndërtimeve më të vjetra të realizimeve arkitektonike të konfesionit islam jo vetëm në Prishtinë e në Kosovë, por edhe më gjerë.

Gjendja e xhamisë sot



Me gjithë që xhamia “Sulltan Mehmet-Fatih” është një ndër monumentet e rralla të trashëgimisë islame jo vetëm në vendin tonë por edhe më gjerë, si për kah aspekti historik, ashtu edhe nga ana

arkitektonike dhe artistike, edhe pse xhamia prej kohësh është shpalluar si objekt monumental i mbrojtur Instituti Kombëtar për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, xhamia sot gjendet në një situatë shumë të rëndë, e për këtë kanë ndikuar shumë faktorë:


1. qasja joadekuate ndaj objekteve të trashëgimisë islame
2. mostrajtimi adekuat me masa restauruese dhe konservuese siç e kërkon një objekt i mesjetës
3. moskujdesi i duhur nga institucionet kompetente

4. dëmtimet nga koha

5. atakimi nga ndërtimet për rreth madje edhe në vetë oborrin e xhamisë

6. atakimi nga rruga përballë xhamisë, sidomos kur lëvizin mjetet me tonazh të madh

7. atakimi nga të reshurat atmosferike



Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar që xhamia sot është në një gjendje të vështirë, madje shtyllat që mbajnë kupolat e hajatit kanë lëvizur për disa centimetra dhe rrezikojnë që në një të ardhme të afërt të bijë, ndërsa në kupolën qendrore në disa vende depërtojnë të reshurat atmosferike, gjë që rrezikojnë stabilitetin e saj. Në gjendje të vështirë është edhe pjesa e poshtme e minares, ngase pjesa e epërme është res-tauruar në vitet e 60 të

shekullit të shkuar. Në gjendje hiq më të mirë nuk është as ana e jashtme e kbilës së xhamisë, e cila i nënshtrohet një atakimi të rëndë nga rruga-trotuari që kalon rreth xhamisë. Këtu xhamia atakohet nga të reshurat atmosferike që bien në trotuarin e çimentuar dhe nga mjeteve me tonazh të madh, të cilat atakojnë sidomos murin rreth tokës kjo mund të vërehet shumë qartë.

Edhe brendia e xhamisë lë shumë për të dëshiruar, është bërë elektrifikimi joadekuat me harminë e xhamisë, për çudi janë hequr ka-ndilat dhe janë zëvendësuar me një të ashtuquajtur llambander pos-

tmodern, ndërsa tash së fundi, megjithëqë objekt i mesjetës dhe objekt monumental në dy anët e xhamisë janë vendosur klimatizues modern.

Duhet thënë edhe këtë se edhe anës artistike të xhamisë nuk i është kushtuar kujdes meritore në shumë raste është dëmtuar duke vendosur në murin e xhamisë leva dhe gjëra të ndryshme. Ajo që bie në sy për të keq është se brenda xhamisë me të hyrë në anën e majtë tash e sa kohë është improvizuar një dhomë me material druri, kjo dhe veprime që përmendëm më lart mendoj se nuk duhet toleruar në një objekt monument.

Por, në përfundim duhet thënë se disa veprime që janë bërë në xhami janë të riparueshme, por duhet shtuar kujdesi institucional që xhamia sa më parë të restaurohet dhe të trajtohet sipas normave adekuate si objekt i një rëndësie të veçantë, si objekt kulture që në vete ngërthen vlera të çmuara nga e kaluara e jonë.

Literatura:

- Husref Redzic: Pet Osmanlijski Spomenika na Kosovi i Metohiji, Starine Kosova i Metohije, knjiga I, Pristina 1961, st. 97;
- Përmendoret e arkitekturës islame dhe dorëshkrimet orientale; Kosova dikur e sot, Beograd 1973, 467 -578
- Raif Virmiça: Fatih Sultan Mehmed Han Camii (Camii Kebir) 865/1460-1461), Kosova'da Osmanli mimarleri, Ankara 1999, sayfa 210-215
- Mr. Tefik Morina: Monumentet e Kulturës Islame në Kosovë dhe mbrojtja e tyre gjatë periudhës 1945-1992; Feja Kultura dhe Tradita Islame ndër shqiptar, Prishtinë 1995, fq. 518-527
- Mr. Fejaz Drançolli: Disa ndërtime arkitektonike islame në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX; Feja kultura dhe tradita islame ndër shqiptar, Prishtinë 1995, fq. 167-174.
- Nail Halimi: Xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut në Prishtinë, sipas përshkrimeve të Hajrullah ef. Zaimit më 1956, Dituria Islame nr. 154, fq. 52-53.

Ramadan Shkodra

THE SULTAN MEHMED FATIH MOSQUE (GREAT MOSQUE) (1460/61) IN PRISHTINA – AN OUTSTANDING WORK OF ISLAMIC HERITAGE IN THE BALKANS

(Summary)

Kosova is very rich in monuments, which are of great historical/cultural importance. These monuments were built in different periods of time and are renowned for their diversity, quality and importance. Part of this heritage are the monuments that were built during the Ottoman rule, which lasted more than 5 centuries.

The Islamic material culture in Kosova, as well as other territories inhabited by Albanians, dates back to the times of the spread of the Ottoman Empire in these territories (in the XV century). At that time, the Ottoman Empire was the main promoter of Islamic religion, culture and civilization.

In parallel to the spread of Islam (religion and culture) in these territories, the need arose for the construction of buildings in which religious rites were to be carried out. Consequently, such buildings were built in many locations.

رمضان شكودرا

جامع سلطان محمد الفاتح (الجامع الكبير) (1460/1) بمدينة

بريشتينا - عمل عظيم للتراث الاسلامي في البلقان

(خلاصة البحث)

تمثل كوسوفا تراثا غنيا للمعمار الثقافي التاريخي لفترات تاريخية مختلفة و التي تتميز بالتنوع الحضارى و الاهمية التاريخية، و تنتمى إلى هذه المجموعة من التراث الثقافي التاريخي اعمال المعمار التي امتدت لمدة خمس عصور أثناء حكم الدولة العثمانية بهذه المناطق.

ان الثقافة المادية في كوسوفا و كذلك نقيه الاراضى الالبانية ظهرت في حيز الوجود مع ظهور الدولة العثمانية في هذه الاراضى في القرن الخامس عشر كحاملة لرابة الاسلام و ثقافته و حضارته. و إلى جانب انتشار الدين الاسلامي و ثقافته بهذه الاراضى ظهرت الحاجة إلى المباني التي يتم فيها اداء شعائر الدنية و لتغطية هذه الحاجات تم بناء المساجد و الجوامع في قرى و مدن مختلفة لاداء هذه الشعائر.

DIASPORA

TË RIMENDUARIT E ISLAMIT: PERSPEKTIVA E DIASPORËS BRITANIKE

Pse shoqëritë myslimane kanë ngecur aq dukshëm në ixhtihad? Tri 'katastrofat metafizike' janë përgjegjëse për paaftësinë tonë që të marrim përsipër ixhtihadin: lartësimi (ngritja) e Sheriatit në sferën Hyjnore, transponimi (heqja) e veprimtarisë nga besimtarët, dhe barazimi i Islamit me Shtetin. Myslimanët duhet ta kuptojnë që kryesisht Ligji dhe Jurisprudenca e tyre janë të ndërtuar në mënyrë sociale dhe pak ka lidhje me shoqërinë bashkëkohore. Ne duhet ta rikonsrukojmë Ligjin dhe Etikën Islame që nga principet e para nga konceptet amë dhe nga vlerat e ngulitura në Kur'an, të cilat definojnë shpirtin e Islamit.

Të rimenduarit serioz brenda Islamit është gjatë i vonuar. Myslimanët kanë qenë në mënyrë të rehatshme të mbështetur, apo më mirë të kthyer mbrapa për interpretime të vjetra për shumë kohë. Për këtë shkak ne edhe ndjehemi aq të përhumbur në botën e tashme, të përhumbur me karakteret moderne. Dijetarët dhe mendimtarët kanë sugjeruar për të mirë për rreth një shekull që neve na duhet një përpjekje serioze rreth ixhtihadit, një rimendim dhe përpjekje e arsyetuar, për të reformuar Islamin. Në fillim të shekullit të kaluar, Xhemaludin Afgani dhe Muhammed Abduhu, udhëhiqnin thirrjen për një ixhtihad të ri; së bashku në rrugëtim me shumë intelektualë të shquar, akademikë, njerëz të urtë, të cilët ishin bashkangjitur thirrjes - jo më pak se Muhammed Ikbali, Malik bin Nabbi, dhe Abdul Kadir Audah. Megjithatë,

ixhtihadi është një çështje që shoqëritë myslimane në mënyrë të veçantë kanë ngecur ta ndërmarrin. Pse ?

Pse-ja ka shkaktuar një urgjencë të shtuar pas 11 Shtatorit. Çfarë ngjarjet fatale të asaj dite zbulojnë, më shumë se gjithçka tjetër, është distanca që kemi udhëtuar larg nga shpirti dhe rëndësia e Islamit. Larg nga të qenit një forcë liberale, një kinetikë sociale, dinamizëm kulturor dhe intelektual për barazi, drejtësi dhe vlera njerëzore, Islami duket të ketë fituar një tendosje patologjike. Me të vërtetë më duket mua se i kemi futur brenda të gjitha ato pasqyrimet historike e bashkëkohore perëndimore rreth Islamit e myslimanëve, që na kanë djallëzuar neve me shekuj. Faktikisht ne tani e kemi veshur rrobën, më duhet ta pranoj, me gjithë djallëzinë që Perëndimi e ka projektuar për personalitetin tonë të përbashkët.

Por të fajësohet Perëndimi, apo ndonjë nocion instrumental i modernitetit që është gjithçka. Por se i huaj për ne, do të ishte një nocion përtac. E vërtetë, Perëndimi, në veçanti Amerika, ka një pjesë të madhe përse të përgjigjet. Dhe myslimanët nuk hezitojnë të tregojnë gjithin e tyre drejt padrejtësive të shkaktuara nga politika e jashtme dhe tendencat hegjemoniste të Evropës dhe Amerikës. Megjithatë, ajo është vetëm një pjesë, dhe sipas opinionit tim, jo një pjesë e pakapërcyeshme e kësaj sëmundjeje. Hegjemonia nuk është gjithmonë e imponuar; ndonjëherë është e ftuar. Gjendja e brendshme brendapërbrenda Islamit, është një ftesë e hapur.

Ne kemi ngelur që të përgjigjemi në thirrjet e ixhtihadit për disa arsye shumë të thella. Primare në mesin e tyre është fakti që konteksti i teksteve tona të shenjta - Kur'ani dhe shembujt e të dërguarit Muhammed a.s, korniza e jonë absolute për referim- është ngrirë përgjatë historisë. Njëri mund të ketë një marrëdhënie interpretuese të një teksti-bile edhe më shumë nëse teksti është i perceptuar të jetë eternal (i përhershëm). Por, nëse konteksti interpretues i tekstit nuk është konteksti ynë, nuk është koha jonë, atëherë interpretimi i tij vështirë se do të ketë ndonjë kuptim apo ndonjë rëndësi për ne, sikurse ne jemi tani. Interpretimet historike vazhdimisht na ngatërrojnë ne prapa në histori, në kontekst të eshtëruar dhe të ngrirë para shumë kohësh; më

keq, në kontekste të perceptuara në mënyrë joshëse (glamuroze) e të cilat nuk kanë ekzistuar aspak në histori. Kjo është kështu përderisa myslimanët janë në mënyrë emocionale të lidhur për Islamin, Islami në fakt vetvetiu si një tërësi sistemi i etikës, ka shume pak lidhje edhe atë indirekte kundrejt jetës se tyre ditore mënjane nga interesimi i hapur për rituale dhe adhurim. Ixhtihadi dhe të menduarit e pastër ka qenë i pamundur për shkak se nuk kishte kontekst përbrenda asaj që faktikisht ato mund të zënë vend.

Të cinguarit (të ngririt) e interpretimeve, mbyllja e “dyerve të ixhtihadit” ka pasur një efekt rrënues në të menduarit e të vepruarit të myslimanët. Në veçanti, ajo ka prodhuar (shkaktuar) çfarë unë e përshkruaj si tri katashtrofat metafizike: lartësimi i Sheriatit në nivelin Hyjnor (të shenjtë), me një konsekuencë (rezultues) të heqjes së veprimtarisë (përpjekjeve) nga ana e besimtarëve, dhe barazimi i Islamit me Shtetin.

Më lejoni ta elaboroj:

Shumica e myslimanëve e konsiderojnë Sheriatin, sikurse rëndom i përkthyer ‘Ligji Islam’ si të shenjtë. Megjithatë, nuk ka diç të shenjtë rreth Sheriatit. Gjëja e vetme që në mënyrë legjitime mund të përshkruhet si e shenjtë në Islam është Kur’ani. Sheriati është një konstrukt human-njerëzor, një përpjekje për ta kuptuar urdhrin e shenjtë në një kontekst të veçantë. Kjo është pse edhe korpusi i Sheriatit konsiston në fikh apo jurisprudencë që nuk është më shumë se opinion legal i juristëve klasikë. Vetë termi fikh nuk ishte në modë para kohës së Abbasitëve kur edhe faktikisht ishte formuluar dhe kodifikuar. Mirëpo, kur fikhu mori formën e tij legale sistematike, atëherë fikhu inkorporoi tri aspekte vitale të shoqërisë myslimane gjatë periudhës së Abbasitëve. Në këto rrethana, historia myslimane ishte në periudhën ekspansioniste të saj, dhe fikhu inkorporoi logjikën e imperializmit mysliman të asaj kohe. Dhe rregullat fikh’ore të të hequrit dorë nga diç, për shembull, janë të derivuara (të nxjerra) jo nga Kur’ani, por nga një logjikë e tillë. Veç kësaj, bota ishte e thjeshtë dhe shumë lehtë mund të ndahej në të zezë dhe të bardhë: që këtej, në Darul Islam dhe Darul Harb. Për më tepër, ndonëse përpiluesit e ligjit sipas kësaj etape

nuk ishin menaxherë të kësaj shoqërie, ligji u shndërrua thjesht në teori që nuk mund të modifikohet - përpiluesit e ligjit ishin të paaftë të shihnin ku po shkaktoheshin fajet (gabimet) dhe çfarë aspekt i ligjit kërkonte mendim, rimendim dhe riformulim. Kështu që fik’hu, sikurse ne e njohim sot, ka evoluar mbi bazën e ndarjes mes atyre që ishin duke udhëhequr dhe e konsideronin veten të ndarë prej shoqërisë, dhe atyre që përpilonin ligjin; kapardisjet (supozimet) epistemologjike të kohës së ‘artë’ të historisë myslimane u futën në lojë gjithashtu. Kur ne e përshkruajmë Sheriatin si të shenjtë, ne faktikisht përdorim sanksione të shenjta të vendimeve të marrura nga një fik’h i së kaluarës.

Çfarë kjo nënkupton në realitet është se kur vendet myslimane e aplikojnë apo imponojnë Sheriatin – kërkesat (nevojat) e myslimanëve që nga Indonezia deri te Nigeria – kundërshtimet (kontradiktat) që ishin inherente në formulimin dhe evoluimin e fik’hut u shfaqën. Kjo është për shkak se kurdoherë që Sheriati imponohet – e ajo është, legjislatura fik’hore është e aplikuar, jashtë kontekstit në të cilin ishte formuluar dhe jashtë kontekstit të kohës sonë – shoqëritë myslimane fitojnë një dukje mesjetare. Ne mund ta vërejmë këtë në Arabinë Saudite, në Sudan dhe në Afganistanin Taliban. Kur zbatimi i ngushtë i fik’hut zë vend në diktimet e kësaj apo asaj shkolle të fik’hut, se nëse ka ndonjë lidhshmëri (relevancë) me realitetin apo jo, ajo bëhet një normë dhe kockimi (ashtërimi) ndihet. Sheriati do t’i zgjidh të gjitha problemet tona, bëhet sentiment (ndjenja) ynë i zakonshëm; dhe bëhet obliguese për një grup me një interes të ngjyrosur (të veshur me rroba) në këtë nocion të Sheriatit që të kaplojë territorin e tij, burimin e fuqisë së tij dhe prestigjin, në çdo çmim. Kështu që një trup i dalë mode i ligjit barazohet me Sheriatin, dhe kështu kritika është e shmanjur dhe e dëbuar me arsyetimin duke u referuar në të si i shenjtë.

Ngritja (lartësimi) e Sheriatit në sferën e shenjtërisë gjithashtu nënkupton që besimtarët nuk posedojnë ndërmjetësi (qasje për veprim): meqenëse Ligji është apriori i caktuar, njerëzit vetvetiu nuk kanë asgjë të bëjnë veçse ta pasojnë (zbatojnë) atë. Kështu që besimtarët bëhen perceptues pasivë në vend se kërkues aktivë të së vërtetës. Në realitet, Sheriati nuk është asgjë më shumë se një strukturë e

principeve, një kornizë e vlerave, që i pajis shoqëritë myslimane me udhëzime. Por, kjo kornizë e principeve dhe vlerave nuk është statike, por në mënyrë dinamike e nxjerrë përbrenda kontekstit, që mund të ndryshohet. Si i tillë, Sheriati më shumë është një metodologji zgjidhje - problemesh sesa Ligi¹. Ai kërkon nga besimtarët që të bëjnë përpjekje në mënyrë konstante ta riinterpretojnë Kur'anin dhe të shikojnë në jetën e Pejgamberit me një shikim që sjell ndryshime dhe përshtatshmëri gjithmonë. Në fakt, Kur'ani duhet të jetë i riinterpretuar nga epoka në epokë – që do të thotë Sheriati, dhe më gjerë Islami vetvetiu, duhet të jetë i riformuluar brenda kontekstit të ndryshueshmërisë². Gjëja e vetme që mbetet konstante në Islam është teksti i Kur'anit në vetvete – ndërsa kontekstet e tij na pajisin me spirancën e interpretimeve që ngërthejnë në vete gjithmonë frymë ndryshueshmërie.

Islami nuk është vetëm një religjion, por një botëkuptim integruar: për shkak se ai integron (bashkon) të gjitha aspektet e realitetit, duke pajisur me një perspektivë morale të çdo aspekti të përpjekjeve humane. Islami nuk dhuron përgjigje të gatshme të të gjitha problemeve njerëzore; ai dhuron një perspektivë të drejtë dhe morale përbrenda së cilës myslimanët patjetër duhet të bëjnë përpjekje t'i gjejnë përgjigjet (zgjidhjet) në të gjitha problemet e tyre. Por, në qoftë se gjithçka është apriori e dhuruar në mënyrë të gatshme, në formë të një Sheriati të Shenjtë, atëherë, Islami është i katandisur në një ideologji totalitare. Në të vërtetë, kjo është saktësisht çfarë lëvizjet Islame - në veçanti Xhemati Islam (si në Pakistan po ashtu edhe në variacionin Indian) dhe Vëllazëria Myslimane - e kanë reduktuar Islamin. Kjo është ajo që më sjell mua te katastrofa e tretë metafizike. Zëvendësoje këtë ideologji përbrenda një shteti, me Sheriatin e atribuuar si të shenjtë në qendër të tij, dhe kështu do të kesh një 'Shtet Islam'. Të gjitha shtetet islame (të sotme), që nga Irani, Arabia Saudite, dhe Sudani e deri tek

Pakistani ambicioz, janë të bazuara në këtë kapardisje (supozim) absurd. Mirëpo, në momentin kur Islami, si një ideologji, bëhet program i veprimeve (aksioneve) të një grupi (të ngjyrosur dhe të veshur me rroba fetare), ai humb humanitetin e tij, dhe bëhet fushëbetejë ku morali, arsyeja dhe drejtësia janë të gatshme të sakrifikohen vetëm në ndërrimin e emocioneve. Veç kësaj, hapi prej një ideologjie totalitare në një rend totalitar ku çdo situatë - njerëzore është e hapur para Shtet – Gjykim, është hap i vogël. Transformimi i Islamit në shtet - bazuar ideologji politike, jo vetëm që e privon atë (Islamin) nga të gjitha përmbajtjet e tij etike dhe morale, por gjithashtu e diskrediton (demashton) historinë Islame si anti-Islame. Pa ndryshim, kur Islamistët e rizbulojnë ndonjë të kaluar të "artë", ata veprojnë kështu vetëm në mënyrë që të përbuzin (neverisin) të tashmen dhe të qesëndisin (tallen përgënjeshtrojnë) të ardhmen. Krejt çka ne na ka mbetur është kaosi mesianik, sikurse ne pamë aq gjallërisht në regjimin Taliban, ku i gjithë sistemi politik si sferë e veprimit që paralizuar, dhe pseudobesimet e parëndësishme u bënë vërtetësi e krijimit të shtetit.

Vizioni totalitar i Islamit sikurse një shtet e transformon politikën myslimane në një metafizikë: në një iniciativë të tillë, çdo veprim mund të justifikohet si 'Islamik' sipas diktimeve dhe përshtatshmërive politike, sikurse ne ishim dëshmitar të kësaj në Iranin revolucionar.

Tri katastrofat metafizike janë të theksuara prej një degradimi të përgjithshëm që është bërë norm (model-standard) në shoqëritë myslimane. Procesi degradues në vetvete gjithashtu nuk është i ri, por tash ka arritur një gjendje të atillë absurde sa që vetë idetë që shoqëritë myslimane duhet t'i ndërmarrin drejt vlerave humane ato tani në fakt i drejtojnë në drejtim të kundërt. Prej bukurisë finesse (të lehtë subtile) të sfidës së përjetshme për të ndërtuar e vendosur drejtësi përmes mëshirës dhe dhembshurisë, ne fitojmë formula mekanike të fiksuara nga ekstremet (skajshmëri) të përsëritura nga njerëz të bindur që ata nuk kanë obligim të mendojnë (hulumtojnë), sepse të gjitha pyetjet kanë qenë përgjigje për ta nga dijetarët klasikë, njerëz tej kufijve të së mirës të vdekur shumë kohë më parë. Dhe për shkak se gjithçka mbart

¹ For a more elaborate exposition 'The Shariah as Problem-Solving Methodology' chapter 5 of Ziauddin Sardar, *Islamic Futures: The Shape of Ideas to Come*, Mansell, London, 1985.

² I first argued this thesis in *The Future of Muslim Civilisation*, Croom Helm, London, 1979; second edition, Mansell, London, 1987.

emrin (damkën) e Islamit, të dyshosh në të, apo të argumentosh kundër tij, është e barasvlershme me të votuarit për mëkat.

Procesi i degradimit (çoksidimit) ka filluar me vetë termin alim (dijetar). Vetëm të qenit një alim çfarë e bën atë një autoritet? Në Islamin e hershëm, një alim ishte gjithkush që fitonte (kërkonte) ilm, ose njohuri, që në vetvete ishte i përshkruar në një sens të gjerë (tolerant). Ne mund ta vërejmë atë në klasifikimet e hershme të dijetarëve të tillë sikurse el-Kindi, el-Farabi, ibn Sina, el-Gazali dhe ibn Halduni. Me të vërtetë, që të dyja, definimi i diturisë dhe klasifikimi i saj ishte një aktivitet i madh intelektual në Islamin klasik³. Kështu që të gjithë njerëzit e shkolluar, sikurse shkencëtarët dhe filozofët, ashtu edhe dijetarët dhe teologët, përbënin ulematë. Mirëpo pasi që 'dyert e ixhtihadit' ishin mbyllur përgjatë kohës së Abbasitëve, ilmi ishte reduktuar në dituri (njohuri) religjioze dhe 'ulema' prodhonte (përbehej) vetëm nga dijetarë religjiozë (fetarë).

Në mënyrë të ngjashme, ideja rreth ixhmait, opinionin (qëllim, ide, pikëpamje) kryesor i jetës së përbashkët në Islam, është zvogëluar në konsensusin e ca të zgjedhurve. Ixhma gjuhësisht ka kuptimin konsensusin e popullit. Koncepti daton qysh në kohën e Pejgamberit a.s. si lider i shtetit origjinal mysliman. Kur profeti Muhammed a.s. dëshironte të merrte ndonjë vendim ai e ftonte (thërriste) të tërë komunitetin mysliman - atëherë pa dyshim jo shumë i madh - në xhami. Diskutimi do të pasonte, argumentet për dhe kundër do të prezantoheshin. Finalisht, e gjithë turma do të arrinte një konsensus. Kështu, një shpirt demokratik ishte qendror në jetën komunale e politike në Islamin e hershëm. Mirëpo, përgjatë kohës klerikët dhe dijetarët religjiozë i kanë mënjeluar njerëzit nga barazia (nga e drejta për konsensus; I.R.) - dhe e kanë reduktuar ixhmain në 'konsensusin e dijetarëve fetarë (religjiozë)'. Jo çuditërisht, autoritarizmi, teokracia dhe despotizmi mbizotërojnë pushtetin në botën myslimane. Sfera (fusha, domeni) politike e gjen modelin e saj në çfarë është bërë praktikë e pranuar dhe zanat i kompetentëve (ekspertëve) 'religjiozë' autoritarë, ata që pohojnë monopolin e inter-

pretimit në Islam. Mullah Obskurantist, në maskë (paraqitje) të 'ulemave', dominojnë shoqëritë myslimane dhe i kufizojnë ata me fanatizëm dhe me një logjikë absurde e degraduese.

Koncepte tjera të shumta kanë kaluar nëpër të njëjtat procese të degradimit. Koncepti i 'ummetit', komuniteti global e spiritual i myslimanëve është degraduar në idealet e një shteti (nation – state): 'vendi im drejt apo shtrembër' është zhvendosur në 'ummeti im drejt apo shtrembër'. Kështu që edhe despotët (tiranët) sikurse Sadam Husein janë tashti të mbrojtur nën arsyen: ndërgjegjja e ummetit' dhe 'uniteti i ummetit'. Xhihadi tani është degraduar (kuptimi i tij është reduktuar, ndërruar; I.R.) në kuptimin e vetëm si: 'Luftë e shenjtë'. Ky përkthim është i çoroditur jo vetëm për shkak se shpirti, intelektualizmi dhe komponentët sociale të konceptit kanë qenë të shformuar, por, gjithashtu është degraduar në luftë me çdo mjet, duke përfshirë edhe terrorizmin. Kështu që tani çdokush mund të deklarojë xhihad mbi çdokënd pa kurrfarë të drejte etike dhe morale e pa kurrfarë arsye vitale. Asgjë nuk mund të jetë më e çoroditur, apo patologjikisht më larg se kuptimi i mëhershëm i xhihadit. Konotacionet e tij (xhihadit) të tjera përfshirë edhe orvatjet personale, përpjekjet intelektuale, dhe konstruksionet sociale janë avulluar. Istislah, zakonisht i përshkruar si: 'interesi publik', dhe një pjesë e madhe e Ligjit Islam janë zhdukur prej vetëdijes (ndërgjegjes) së myslimanëve. Dhe Ixhtihadi, sikurse Unë kam shpjeguar, është reduktuar në: diç më shumë se një lutje e devotshme.

Mirëpo dhuna e kryer ndaj koncepteve të shenjta të myslimanëve është e parëndësishme krahasuar me mënyrën degraduese që i është bërë Kur'anit dhe sunnetit të Pejgamberit a.s. çfarë dijetari i vonshëm mysliman Fazlur Rahman e quante trajtesë 'atomistike' e Kur'anit tashti është bërë rregull – normë, pothuajse çdo gjë dhe gjithçka është e justifikuar nën përmendjen dhe citimin individual të verseteve të përgjysmuara jashtë kontekstit⁴. Pas 11 shtatorit, për shembull, një numër i raportuesve të Talibanit, duke përfshirë edhe ca të tillë në Britani, i arsyetonin aksionet e tyre, duke cituar ajetin: **"Ne do të mbjellim**

³ See Franz Rosenthal, *Knowledge Triumphant*, Brill, Leiden, 1970.

⁴ Fazlur Rahman, *Major Themes of the Qur'an*, Biblioteca Islamica, Chicago, 1980.

frikën në zemrat e atyre që nuk besuan, sepse ata Allahut i trillojnë e i mveshin zotëra të tjerë, duke mos pasur kurrfarë fakti, ndaj vendbanimi i tyre do të jetë xhehenemi. Sa i shëmtuar është vendi i mizorëve.” (3.149). Megjithatë, dukshëm kuptimi i atribuuar i ajetit nuk mund të jetë nga shpirti i vërtetë i Kur’anit. Ky ajet i posaçëm i adresohet vet Pejgamberit a.s. Ishte zbritur përgjatë luftës së Uhudit, kur ushtria e vogël dhe e papajisur e Profetit a.s, kishte përball armikun shumë më të madh e të përgatitur. Ai (Pejgamberi a.s; I.R) ishte i brengosur me përfundimin e betejës. Kur’ani e bind atë dhe premton që ushtria armike do të jetë e tmerruar nga ushtria joprofesionale e Profetit a.s. Shikuar nga koncepti i tij (ajetit) nuk është një instruksion gjeneral për kreu myslihanët, por përshkrim çfarë po ndodhte në atë kohë. Në mënyrë të ngjashme, hadithe të ndryshme janë të cituara për të justifikuar sjelljet ekstremiste. Dhe madje vetë dukja e Profetit a.s, mjekra dhe rrobat e tij, janë shndërruar në fetish (idhull): kështu që tash nuk është e obligueshme për një ‘myslihan të mirë’ që vetëm të ketë mjekër, por gjatësia dhe forma e saj duhet patjetër të jenë konform diktimeve! Profeti a.s është shndërruar në shenja e simbole - shpirti i sjelljes së tij, dimensionet morale e etike të veprave të tij, përlësia dhe mëshira e tij, principet e përgjithshme që ai ka përkrahur që të gjitha janë përfshirë nën logjikën absurde të degradimit.

Efekti akumulues i katastrofave metafizike dhe degradimi i pafund i ka transformuar qiramarrësit e dashur të Islamit në militantë të përshtatur dhe falimentim moral. Përgjatë dy dekadave, unë kam qenë duke argumentuar se civilizimi myslihan tashti është aq i copëtuar e shpartalluar sa që ne tani duhet ta e rindërtojmë atë tullë për tullë⁵. Është e qartë tani se vetë Islami duhet të rimendohet sërish, ide për ide. Ne duhet të fillojmë me vetë faktin që myslihanët nuk kanë monopol të së vërtetës, për çfarë është drejtë e çfarë është gabim, për drejtësi, e as refleksat morale e intelektuale që i përkrah këto domoshmëri. Sikurse gjithë njerëzimi, ne duhet të përpiqemi që t’i arrij-

më ato duke përdorur pikëpamjet dhe konceptet tona të shenjta si mjete për ta kuptuar dhe riformësuar realitetin bashkëkohor.

Rruga për një vlerësim të gjallë dhe bashkëkohor të Islamit kërkon konfrontimin me katastrofat metafizike dhe një lëvizje nga degradimi në sintezë. Në rend të parë, kjo kërkon nga myslihanët, si individë dhe komunitete, të ripohojnë të drejtën për veprim: të insistojnë në të drejtat dhe detyrat e tyre, si besimtarë dhe njerëz të ditur, të interpretojnë dhe ri-interpretojnë burimet themelore të Islamit: të vënë në pikëpyetje çfarë tash zhvillohet nën rubrikën e Sheriatit, të deklarojnë që shumë nga fik’hu tani është e vjetruar dhe e rrezikshme, të ngrihen kundër idesë absurde të një Islami të izoluar nga kufij gjeografikë të një shteti. Ne nuk mundemi, nëse vërtet e çmojmë besimin tonë, ta lemë zgjidhjen e tij (Islamit) në duart e elitës së edukuar dhe dijetarëve religjiozë, mungesa e kuptueshmërisë së të cilëve për botën bashkëkohore gjithmonë koïncidon vetëm me nënçmimin dhe përbuzjen e të gjitha ideve dhe produkteve kulturore të saj. Islami është dobësuar si sferë profesionale e njerëzve përgjatë popujve të shekullit njëmbëdhjetë sesa të shekullit njëzet e një që ne tani e banojmë. Dhe ne nuk mund të lejojmë që kjo klasë ta varrosë idenë madhështore për ixhtihad në histori të largët e të ngrirë.

Myslihanët e rëndomtë përreth botës që merakosen, pyetjet dhe dilemat e konsiderueshme morale rreth punëve aktuale të shtetit Islam duhet patjetër t’i korrigjojnë përmes principeve themelore të Islamit dhe t’i rristrukturojnë në një kontekst më të gjerë. Ixhmai patjetër duhet të nënkuptojë konsensusin e të gjithë qytetarëve, duke çuar në një qeverisje participuese dhe përgjegjëse. Xhihadi patjetër duhet të kuptohet në kontekstin e plotë spiritual të tij, duke nënkuptuar si orvatje dhe përpjekje për paqe dhe drejtësi si një realitet i jetësuar për të gjithë njerëzit gjithkund. Dhe nocioni i Umetit duhet patjetër të përmirësohet në mënyrë që të shndërrohet në diç më shumë se një abstraktim degradues. Umeti nuk është thjesht vetëm komuniteti i atyre që kanë deklaruar të jenë myslihanë; më saktë, është një kuptim moral se si myslihanët duhet të bëhen komunitet për njeri-tjetrin, komunitetet tjera dhe botën natyrore. Kjo nënkupton që Umeti përfshin jo vetëm

⁵ Ziauddin Sardar, *The Future of Muslim Civilisation*, op cit.

myslimanët, por kërkimin e drejtësisë dhe njerëzit e shtypur gjithkënd. Në njëfarë kuptimi, lëvizja drejt sintezës është një avancim drejt mesazhit kryesor të Islamit – si një mënyrë morale e etike e të shikuarit të botës, si domen i një kulture paqësore qytetare, një përpjekje participuese, si modë (mënyre) e përgjithshme e të diturit, të qenit dhe të bërit.

Nëse ngjarjet e 11 shtatorit lejojnë qëllimet më të mira, vlerat esenciale të Islamit, feniksi (zogu feniks) vërtet do të ishte ngritur nga hiri i kullave binjake.

Nga anglishtja:
Imran Rasimi

*Ziauddin Sardar, shkrimtar, editor zhurnalistik,
transmetues dhe kritik letrar, profesor për studime pasuniversitare,
Departamenti i Arteve e Politikës dhe Menaxhimit,
The City University, Londër.*

RETHINKING ISLAM: THE PERSPECTIVES OF THE BRITISH DIASPORA

(Summary)

Why have Muslim societies failed to undertake ijtihad? The freezing of interpretation, the closure of “the gates of ijtihad”, has had a devastating effect on Muslim thought and action. In particular, it has produced what can be described as three metaphysical catastrophes: the elevation of the Shari’ah to the level of the Divine, with the consequent removal of agency from the believers, and the equation of Islam with the State. Muslims must understand that the bulk of the Shari’ah actually consists of fiqh or jurisprudence, which is nothing more than legal opinion of classical jurists and has little to do with contemporary society. We must reform Islamic Law and Ethics starting from its basic principles, which define the spirit of Islam.

اعاده التفكير في الاسلام فرصة المهاجرين في بريطانيا (خلاصة البحث)

لماذا تأخرت المجتمعات الإسلامية كثيرا في الاجتهاد؟ هناك ثلاث "مصائب روحية" هي مسئلة عن عدم كفاءتنا لكي نتحمل مسئولية الاجتهاد: رفع الشريعة الإسلامية إلى مستوى الوحي. و عدم تحمل المسئولية على المؤمنين و مساواة الاسلام بالدولة. المسلمون يجب عليهم ان يفهموا بان التشريع الاسلامي تم تينييه وفقا للمعايير و حاجيات المجتمع السابق ولديه روابط غير وثيقة بالمجتمع المعاصر. علينا ان نعيد بناء القانون و الخلق الاسلامي وفقا لمبادئ القرآن الكريم و التي تتمشى مع روح الاسلام.

FEMRA NË ISLAM

Emine Vezaj

TRAJTIMI I FEMRËS NË ISLAM* Femra në frymën e mësimave të Islamit

1. Kurani

Njeriu nuk është një qenie që e ka marrë trajtën aktuale si rezultat i evolucionit. Ai është krijuar si një lloj më vete dhe nuk ka ardhur në gjendjen e sotme duke fituar gradualisht cilësi të reja në rrugën e evolucionit të llojeve dhe duke iu nënshtruar seleksionimit natyror.¹

Kurani Famëllartë e paraqiti femrën si krijesë të respektuar, që i bashkëngjitet burrit në jetën e përditshme dhe luan rolin e vet pranë tij në jetën e përditshme, që ata ta rregullojnë jetën bashkërisht dhe të kenë fëmijë dhe nipër.²

Allahu xh.sh. thotë:

“Allahu krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja fëmijë e nipa dhe ju furnizoi me (ushqime) të mira. A besojnë ata të pavërtetën, e të mirat e Allahut i mohojnë?”³

Historia islame na jep raste të ndryshme në të cilat gruaja ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në historinë njerëzore. Në Kuran një sure e veçantë, njëra ndër më të mëdhatë, mban emrin e gruas “El-Nisa”, ose “Gratë”, ndërkohë që nuk ekziston një sure e tillë vetëm për burrat. Po ashtu në Kur’an gjendet edhe sureja “Merjem”, ku shihet personaliteti i një gruaje të ndershme, kujtimi i së cilës edhe sot e kësaj dite lartësohet edhe nga brezat e mëvonshëm. Merjemja, e bija e Imranit, ishte premtuar që në barkun e së ëmës që t’i shërbejë tempullit të shenjtë të Sulejmanit a.s., edhe pse një gjë e tillë ishte e paprueshme, pasi në tempull pranoheshin vetëm fëmijët meshkuj, duke qenë se rrinin dhe shërbenin aty qysh si fëmijë. Por, Allahu xh.sh. e pranoi lutjen e gruas së Imranit. Dhe ajo shërbeu për një kohë të gjatë duke u bërë kështu edhe shëmbëlltyrë e lavdishme e femrës myslimane. Allahu xh.sh. thotë:

“(Përkujto) Kur gruaja e Imranit pati thënë: “Zoti im, unë këtë që është në barkun tim vendosa ta kushtoj thjesht vetëm për shërbimin Tënd, pra pranoje këtë prej meje, vërtet Ti je Ai që dëgjon e di!” E kur ajo e lindi tha: “Zoti im, unë linda femër!” Po Allahu e di më së miri atë që ajo e lindi. E mashkulli nuk është si femra. “Dhe unë e emërtova atë Merjeme, e atë dhe pasardhësit e saj po t’i lë Ty në mbrojtje prej djallit të mallkuar.” Zoti i saj e pranoi premtimin e saj si është më mirë, e rriti me një edukatë të mirë e të plotë dhe e vuri nën kujdesin e Zekirjas. Sa herë që hynte Zekirja në mihrabin (dhomën) e saj gjente tek ajo ushqim e thoshte: “Ai është nga Allahu, se Allahu atë që do pa masë e furnizon!”

E vazhdojmë tregimin me nënën e Musait a.s., me motrën dhe me gruan Faraonit, të cilat luajtën një rol shumë të rëndësishëm në lindjen dhe përkujdesjen për Musain. Siç na është bërë e njohur:

Transmetohet nga Ibën Mes’udi dhe nga disa sahabë, se Faraoni kishte parë ëndërr se si nga Mesxhidi Aksa kishte ardhur një zjarr që i kishte djegur të gjitha shtëpitë në Egjipt dhe të gjithë koptasit, ndërsa pasardhësit e Israilit i kishte kursyer.

⁴ Kurani, Ali Imran: 35-37.

* Kjo temë është mbrojtur në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

¹ Fetullah Gylen, *Lëkundjet që solli shekulli 2*, Tiranë, 2004, fq. 136.

² Hadixhe Sabar, *El Islam Vel mer’e*, Darul Bejda, 1992. fq. 23.

³ Kurani, En-Nahl: 72.

Kur u zgjua, i frikësuar nga ëndrra tuboi të gjithë priftërinjtë, astronomët dhe magjistarët e tij dhe i pyeti se çfarë mendonin për ëndrrën. Ata i thanë se ëndrra do të thoshte se nga pasardhësit e Israilit do të lindte një foshnjë mashkull për shkak të të cilit do të shkatërroheshin të gjithë egjiptianët, prandaj faraoni urdhëroi që të vriteshin të gjithë djemtë e çifutëve, ndërsa vajzat të lireshin në jetë.⁵ Thotë Allahu xh.sh.:

“Që po t’i lexojnë ty nga lajmi rreth Musait, e që është e vërtetë për një popull që beson. Me të vërtetë, faraoni ka shkuar aq lart sa që dhe popullin e ka ndarë në grupe dhe një grup e shtyp, ashtu që djemtë e tyre ua vret e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet ai ishte prej më shkatërrimtarëve. E ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues.”⁶

Ndërkohë që nëna e tij frikësohej për birin e saj, Allahu xh.sh. e frymëzoi ta hidhte Musain a.s. në ujë duke i premtuar kthimin e tij në prehrin e saj dhe duke e bërë prej të Dërguarve të Allahut xh.sh..

Dhe këtu paraqitet roli i prerë i motrës së tij, e cila i udhëzoi shërbëtorët e Faraonit te nëna e tij, që ajo t’i jepte gji pasi foshnja i kishte refuzuar të gjitha gjidhënëset.

“Ne nënën e Musait e inspiruam t’i japë atij gji. E kur të kesh frikë për të, atëherë atë hidhe në lumë, e mos u frikëso as mos u pikëllo, se ne do ta kthejmë atë ty dhe do ta bëjmë atë nga të Dërguarit. E atë e gjeti familja e faraonit, ashtu që në fund ai t’u bëhet atyre armik e dëshpërim. Vërtet, faraoni, Hamani dhe ushtria e tyre ishin kundërshtarë (gabonin me qëllim). E gruaja e faraonit tha: “Shpresë gëzimi për mua dhe për ty, mos e mbytni atë, ndoshta do të na sjellë dobi ose do ta adoptojmë për fëmijë.” Pra, ata nuk e dinin rrjedhimin. E zemra e nënës së Musait agoi e zbrazët (kur kuptoi se ka rënë në duar të faraonit) dhe gati ta zbulojë atë (fëmijën), sikur të mos ia forconim Ne zemrën e saj që të bëhet e bindur (në premtimin e Allahut). E ajo i tha motrës së tij: “Gjur-

moje atë”, kurse ajo e shikonte atë prej së largu dhe ata nuk e hetonin (se ishte motra e tij që e përcjell). Ndërsa Ne ia patëm ndaluar atij më parë thithjen e gjurit, e ajo (motra e Musait) tha: “A doni t’ju tregoj për një familje që do të kujdeset për të dhe që do të jenë të singertë ndaj tij?” Dhe ashtu atë e kthyem te nëna e vet, që ajo të jetë e kënaqur e jo e pikëlluar dhe që ta kuptojë se premtimi i Allahut është i vërtetë e i sigurt, por shumica e tyre nuk e dinë.”⁷

U rrit Musai a.s. në pallatin e Faraonit dhe nuk e fshehu origjinën e tij, që ishte nga Beni Israilët, prandaj edhe ishte mbështetës i popullit të tij në shumë aspekte. Një ditë ai doli nga shtëpia dhe takoi dy persona duke u përleshur. Njëri ishte nga populli i tij, kurse tjetri koptas. Gjatë përleshjes koptasi vdes dhe lajmi i vrasjes së tij u përhap në tërë Egjiptin.⁸

Dhe kështu vazhdon historia e shpërnguljes së Musait nga Egjipti. **“Atëherë ai u dha ujë (kafshëve) të tyre, pastaj u largua anash nën një hije e tha: “O Zoti im, unë kam nevojë për çfarëdo që të më japësh!” E njëra prej tyre erdhi tek ai, ecte e turpëruar e tha: “Babai im të thërret që të të paguajë ty shpërblimin për atë që na u dhe (bagëtisë) ujë!” E kur shkoj (Musai) tek ai dhe ia tregoi atij ngjarjen, ai tha: “Mos ki frikë, paske shpëtuar nga populli zullumqar!” Njëra prej atyre të dyjave tha: “O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai, i fuqishmi e besniku!” Ai (Shuajbi) tha: “Unë dëshiroj të të martoj ty me njërën prej këtyre dy vajzave të mia, me kusht që të shërbesh tetë vjet, e nëse i plotëson dhjetë, ai është vullneti yt, e unë nuk dëshiroj të të rëndoj ty, e në dashtë Allahu, ti do të gjesh tek unë mirëkuptim!”**⁹

Kur Musai u ul nën hije dhe u lut: **“O Zoti im, çfarëdo mirësie të më japësh, unë kam nevojë për të!”**. Këtë e dëgjuan ato dy vajza dhe menjëherë vajtën t’i tregojnë babait të tyre. Disa thonë se ai u çudit se

⁷ Kurani, El-Kasas: 7-13.

⁸ Hadixhe Sabbar, *El Islam Vel mer’e*, fq. 24.

⁹ Kurani, El-Kasas: 24-27

⁵ Hafidh Ibën Kethir, *Rrëfime për të Dërguarit e Allahut*, Prishtinë, 2005, fq. 316.

⁶ Kurani, El-Kasas: 3-5.

sa shpejt u kthyen ato. Ato i rrëfye babit të tyre rastin me Musain a.s. dhe ai e urdhëroi njëren prej tyre që ta thërriste atë...¹⁰

Ibrahimit a.s. i erdhën mysafirët që ishin në rrugë për te populli i Sedumit (Lutit a.s.) dhe e përgëzuan **gruan e tij** me një fëmijë që do ta kishte emrin Is'hak. Më pas Is'haku do të ketë një fëmijë të quajtur Jakub, i cili do të jetë njeri i zgjedhur dhe nga pejgamberët e mëdhenj.¹¹

*“E gruaja (Sara) e tij (Ibrahimit) rrinte në këmbë dhe qeshi, e Ne e përgëzuam atë me Is'hakun, e pas Is'hakut Jakubin. Ajo tha: “E mjera unë, si do të lind unë kur jam e vjetruar, kurse ky burri im është i shtyrë më moshë, vërtet kjo është gjë e çuditshme.” Ata i thanë: “Si, mos po çuditesh me caktimin e Zotit?” Mëshira e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë me ju o familje e shtëpisë (së Ibrahimit)! Vërtet, Ai është meritör për falënderim, është bamirës i madh.”*¹²

Ibrahimit dhe Sarës këtë lajm të mirë ua sollën engjëjt, meqë Ibrahimi a.s. u tregua besnik lidhur me fljimin e të birit të tij të vetëm dhe si shpërblim Allahu xh.sh. do ta përgëzojë edhe me një tjetër djalë, megjithëse në pleqëri të shtyrë. Dhe gruaja e tij, Sara, habitet se si do të ketë fëmijë në këtë moshë. Asaj i kishin humbur të gjitha shpresat për të pasur fëmijë, pasi dihet se i kishte dhuruar Ibrahimit shërbëtorin e saj si bashkëshorte pikërisht për këtë qëllim, që t'i gëzojë Zoti me një fëmijë.

Po ashtu, në Kuran përmendet edhe Jusufi a.s. dhe roli i **gruas së fisnikut**, e cila e ruajti dhe u kujdes për të derisa ai u rrit dhe u bë i zoti i vetes.

“E ai që e bleu nga Misiri (Egjipti) i tha gruas së vet: “Bëji pritje të kënaqshme, se është shpresë t'ia shohim hairin ose ta adoptojmë për fëmijë!” Ja, kështu (siç e shpëtuam nga pusi), Ne i bëmë vend Jusufit në tokë (në Egjipt), e që t'ia mësojmë atij shpjegimin

*për disa ëndrra. Allahu është mbizotërues i punës së Vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë (fshehtësinë e çështjeve).”*¹³

Tregimi vazhdon duke përmendur gruan e fisnikut (Zulejhan):
*“E kur e arriti pjekurinë e tij, Ne i dhamë pushtet e dituri. E kështu Ne i shpërblejmë punëmirët. E ajo, në shtëpinë e së cilës ishte Jusufi, i bëri lajka atij dhe ia mbylli dyert e i tha: “Eja!” Ai (Jusufi) tha: “Allahu më ruajt, ai zotëria im (e burri yt), më nderoi me vendosje të mirë (si mund t'i bëj hile në familje)?” S'ka dyshim se tradhtarët nuk kanë sukses. Ajo e mësyu atë qëllimisht, e atij do t'i shkonte mendja ndaj saj sikur të mos i prezantohej argumenti nga Zoti i tij. Ashtu (e bëmë të vendosur) që të largojmë nga ai të keqen dhe të ndytën. Vërtet, ai ishte nga robërit Tanë të zgjedhur. Dhe që të dy ata u ngutën kah dera, e ajo ia grisi këmbishën e tij nga mbrapa dhe pranë dera ata të dy takuan burrin e saj, e ajo tha “Cili mund të jetë ndëshkimi i atij që tenton të keqen në familjen tënde, përpos të burgoset, ose dënim të dhembshëm! Ai (Jusufi) tha: “Ajo m'u vërsul mua!” Një dëshmitar nga familja e saj gjykoi: “Nëse këmisha e tij është grisur përpara, ajo ka thënë të drejtën, kurse ai gënjen. E nëse këmisha e tij është grisur prapa, atëherë gënjen ajo, kurse ai është i drejtë. E kur e pa ai (burri i saj) këmbishën e tij të grisur prapa, tha: “Kjo është dredhi juaja, vërtet dredhia juaj është e madhe!”*¹⁴

I Lartmadhërishtmi këtu na paraqet zhvillimin e ngjarjes, se si gruaja e atij dinjtari tentoi të tundojë Jusufin a.s. dhe se si kërkoi nga ai diçka që nuk i kishte hije pozitës dhe gjendjes së tij, ndërkohë që ajo ishte jashtëzakonisht e bukur, e pasur, e shquar dhe e re. Më pas tregohet se si ajo kyçi edhe derën, duke u stolitur dhe duke u zbukuruar paraprakisht për të duke veshur rrobat më të bukura dhe më të shtrenjta.¹⁵

¹⁰ Hafidh Ibën Kethir, *Rrëfime për të Dërguarit e Allahut*, fq.326.

¹¹ Hadixhe Sabbar, *El Islam Vel mer'e*, fq. 25.

¹² Kurani, Hud: 71-73.

¹³ Kur'ani, Jusuf: 21.

¹⁴ Kurani, Jusuf: 22-28.

¹⁵ Hafidh Ibën Kethir, *Rrëfime për të Dërguarit e Allahut*, fq. 255.

Në Kuran vjen edhe ndodhia e Sulejmanit a.s. me **Belkisën**, mbretëreshën e Sebeit.* Dihet se Sulejmani a.s. e dinte edhe gjuhën e shpendëve. Pasi i kontrolloi shpendët, nuk e gjeti pupëzën, por më pas ajo e lajmëroi se ishte te një popull që sundoheshin nga një grua dhe se ai popull adhuronte Diellin në vend të Zotit të Madhëruar.¹⁶ Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe vështroi shpendët e tha: “Ç’është që nuk e shoh pupëzën? Jo, ajo nuk qenka këtu!” Unë do të dënoj atë më një dënim të ashpër; ose do ta ther, ose ka për të më sjellë ndonjë argument të fortë (si arsyetim). Ajo nuk zgjati shumë e tha: “Unë kuptova atë që ti nuk je i njohur dhe të erdha nga Sebei me një lajm të sigurt.” Në të vërtetë unë gjeta një grua që po i sundonte ata (popullin e Sebe-it) dhe asaj i ishte dhënë çdo send e kishte një fron të madh. Madje takova atë dhe popullin e saj se adhurojnë Diellin e jo Allahun, po djalli ua kishte hijeshuar atë veprim të tyre dhe i kishte shmangur prej rrugës së drejtë, andaj ata nuk gjejnë udhëzim. (i kishte shmangur) Për të mos adhuroar Allahun që nxjerr në shesh (e di) të fshehtë në qiej e në tokë dhe që e di atë që fshihni dhe atë që publikoni. Allahu është një, nuk ka Zot tjetër pos Tij, Zot i Arshit të madh. Ai (Sulejmani) tha: “Do të shohim se a e thua të vërtetën apo je nga gënjeshtarët!””¹⁷

Sulejmani a.s. shkroi një letër që fillonte me “*Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim*” “Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit”, dhe e urdhëroi pupëzën që ta çojë tek ajo mbretëreshë. Dhe kur ajo e lexoi letrën, e çuditur me faktin se ai dëshironte të sulmonte vendin e saj, ajo mblodhi parinë dhe nuk vendosi e vetme. Që në fillim asaj i bëhej e ditur se ftohej për besim në Një Zot të vetëm, pasi letra fillohej me Bismil-lah.

“Shko me këtë letrën time e hidhja atyre, largohu (pak) nga ata dhe përgjo se çka bisedojnë!” Ajo (gruaja - Belkisa) tha: “O ju pari, mua më ka arritur një letër madhështore!” (e lexova) Kjo

është prej Sulejmanit (mandej e hapi, kur qe, në të) “Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!” (Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim!) (në vazhdim shkruan) “Të mos mbaheni në të madh kundër meje, po të më vini të dorëzuar (edhe besimtarë!)” Ajo tha: “O ju pari, më sugjeroni në këtë çështje timen se unë nuk do të vendos asgjë derisa edhe ju të jepni pëlqim!” Ata (paria) i thanë: “Ne jemi të fuqishëm dhe jemi luftëtarë të rreptë, por puna qëndron te ti, e ti mendo se çka do të na urdhërosh!””¹⁸

Ajo e kuptoi se populli i saj nuk i frikësohej luftës, por ishte e meçur dhe i analizonte përfundimet e luftës si dhe rrezikun për të humburin, prandaj tha:

“Ajo tha: “Kur sunduesit e pushtojnë ndonjë vend, ata e rrënojnë atë e parinë më të zgjedhur të atij vendi e nënshtrojnë. Kështu ata veprojnë!” Po unë do t’u dërgoj atyre një dhuratë (të madhe), e do të shohë se çka do të na sjellin të dërguarit (me dhuratë). E kur i erdhi ajo Sulejmanit, ai tha: “A me pasuri më ndihmoni mua? E atë që Allahu më ka dhënë mua është shumë më e dobishme nga ajo që u ka dhënë juve! Por ju krenoheni me dhuratat tuaja. Kthehu tek ata (i tha kryesuesit të deleguarve), se për Zotin ne do t’u vijmë atyre me një ushtri, së cilës ata nuk do të mund t’i bëjnë ballë dhe do t’i dëbojmë prej aty të nënshtroar e të poshtëruar!””¹⁹

Tregimi përfundon me sjelljen e fronit të mbretëreshës nga njëri prej xhinëve që ishin nën dominim e Sulejmanit a.s. dhe kur erdhi Belkisa, Sulejmani a.s. i tregoi asaj fronin. Ajo mbeti e habitur para tij, sepse kishte shumë shenja të fronit të saj. Pasi e shikoi mirë, u bind që me të vërtetë ishte froni i saj dhe e kuptoi që ajo ishte në të vërtetë një nga muxhizet e tij (Sulejmanit a.s.), prandaj përpara këtij fakti të gjallë iu drejtua Allahut xh.sh. duke thënë:²⁰

“Asaj iu tha: “Hy në pallat, e kur atë mendoi se është një ujë i madh dhe i përvol këmbët”. Ai (Sulejmani) tha: “Ky është një pa-

¹⁸ Kurani, En-Neml: 28-33.

¹⁹ Kur’ani, En-Neml: 34-37.

²⁰ Hadixhe Sabbar, *El Islam Vel mer’e*, fq. 27.

* Sebe është emri i një fisi në Jemen. Qyteti Sebe ishte kryeqendra ku sundonte Belkisa.

¹⁶ Hadixhe Sabbar, *El Islam Vel mer’e*, fq. 26.

¹⁷ Kurani, En-Neml: 20-27.

llat i lëmuar prej qelqi!” Ajo tha: ***“Zoti im, unë i kam bërë krim vetes e tani i dorëzohem (pranoj besimin) Allahut, së bashku me Sulejmanin, Zotit të gjithësisë”.***²¹

Islami i saj nuk ishte diçka tjetër përpos rezultat i mendjemprehtësisë së saj, e kjo u pa qartë kur ajo nuk mori vendim me kokën e vet dhe kur pa fronin e saj, kur u vërtetua se ai ishte froni i saj i vërtetë dhe se kjo ishte muxhize e Sulejmanit a.s.

Siç pamë, Kurani Famëlartë na e paraqet personalitetin e gruas në forma dhe pozicione të ndryshme gjatë historisë njerëzore. Besimi islam e trajton atë ashtu siç e meriton, në të gjitha sferat e jetës. Gjithë këto tregime për këto gra të mëdha na e çrrënjosin idenë e nëpërkëmbjes dhe përbuzjes së saj nën kamuflimin e besimit islam, i cili nxit në ngritjen e personalitetit të saj. Kjo u pa qartë kur melekët biseduan me Sarën kur e përgëzuan për fëmijë. Pastaj lexuam për Zylejhanë dhe Jusufin a.s., për lakminë ndaj së bukurës, ku u pa edhe barazia mes gjinive. Më pas lexuam tregimet e bukura kuranore për nënën e Musait a.s., se si me besimin e saj të fuqishëm ajo iu bind urdhrat të Allahut, duke u inspiruar që fëmijën e porsalindur ta hedhë në ujë.

Të gjitha këto sikur na e forcojnë ndjenjën e të qenit pjesëtare e besimit islam. Gruaja nuk mbeti vetëm me kaq, ajo u tregua e zonja edhe në rolin e udhëheqëses së shtetit dhe këtë më së miri e shohim te Belkisa, mbretëresha e Sebeit. Largpamësia politike e saj u pa në shpëtimin e vendit të saj. Ajo shpëtoi edhe nga injoranca- mosbesimi me pranimin e Islamit përmes pejgamberit të Allahut, Sulejmanit a.s..

Kurani Famëlartë na sjell edhe shembujt negativë të atyre grave që, edhe pse në ambiente të favorshme për besim të plotë, madje gra pejgamberësh, megjithatë ishin jobesimtare. Shembujt të tillë janë gruaja e Nuhut a.s. dhe gruaja e Lutit a.s. të cilat nuk ishin besimtare. Edhe pse gra të Pejgamberëve, kjo nuk do t’u bëjë kurrfarë dobie, pasi ato do të jenë në xhehenem, sepse asnjë lidhje tjetër përveç besimit nuk do të merret parasysh. Me këtë na bëhet e qartë se gruaja me personalitetin e saj nuk është e varur nga burri qoftë në besim, udhëzim,

²¹ Kurani, En-Neml: 44.

mirësi po ashtu edhe në devijim, mohim, (kufër) ligësi. Allahu xh.sh. thotë:

“Atyre që mohuan, Allahu u sjell shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato të dyja ishin në kurorë të dy robërve të mirë nga robërit Tanë, por ato të dyja i tradhtuan (në fe) ata të dy dhe këta të dy nuk mund t’i mbrojnë ato fare tek Allahu, e atyre të dyjave u thuhet: “Hyni të dyja në zjarr së bashku me ata që hyjnë!”²²

Shembull i ngjashëm është edhe gruaja e Ebu Lehebit, Ummu Xhemilja, e cila nuk mbetej aspak pas burrit të saj në armiqësinë ndaj Pejgamberit a.s.. Ajo e kishte zakon të mbledhte gjemba dhe t’i hidhte para derës së Pejgamberit a.s. dhe njëkohësisht ishte llafazane gojëkeqe dhe bënte shpifje të ndryshme ndaj Pejgamberit a.s. dhe i nxiste poetët ta përgojonin. Kurani e quan këtë grua Hammaletul-hattabi (bartëse e fortë e drunjve për ta penguar Pejgamberin a.s., si sinonim i thurjes së intrigave). Allahu xh.sh. thotë:

“...E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra). E në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur.”²³

Ndërsa ato që ishin shëmbëlltyrë e së mirës, si gruaja e faraonit Asija, edhe pse nën faraonin arrogant, do të jenë të shpëtuarat në xhehenet, njësoj si Merjemja e ndershme. Allahu xh.sh. thotë:

“E atyre që besuan, Allahu u solli shembull gruan e faraonit, kur ajo tha: “Zoti im, më bëj një vend pranë mëshirës Sate në xhehenet dhe më shpëto prej faraonit e brutalitetit të tij dhe më shpëto prej popullit mizor!”

“Edhe Merjemen të bijën e Imranit, që e ruajt i nderin e vet, e Ne prej anës sonë i frymëzuam një shpirt e ajo i besoi fjalët e Zotit të saj dhe librat e Tij dhe ishte e devotshme.”²⁴

²² Kurani, Et-Tahrim: 10.

²³ Kurani, El-Mesed: 4-5.

²⁴ Kurani, Et-Tahrim: 11-12.

Besimi islam e çliroi gruan nga robëria në të cilën ishte në kohën e xhahilijetit arab, duke e barazuar plotësisht me burrin. Thotë Allahu xh.sh.

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe keni frikë Allahun që me emrin e Tij përбетoheni, ruajeni farefisën (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.”²⁵

E barazoi edhe në krijim, duke thënë:

“Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten.”²⁶

Gjithashtu edhe në dinjitet, duke e ndaluar vrasjen e femrave të porsalindura, kur dihet se femra konsiderohej si plaçkë dhe asgjë më shumë.

“Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura për së gjalli, për çfarë mëkati ato janë mbytur.”²⁷

Në të njëjtën kohë, Islami e ndaloi nëpërkëmbjen e nderit të saj dhe shmangu të gjitha gjërat që e dëmtojnë atë, duke ia ruajtur kështu femrës njerëzinë.

Sa i përket angazhimit në besim, virtyteve morale dhe kërkesave shpirtërore, Islami i drejtohet asaj njësoj si mashkullit dhe e angazhon atë ashtu siç angazhon mashkullin. Allahu xh.sh. thotë:

“Nuk ka dyshim se për myslimanët e myslimanet, besimtarët e besimtare, adhuruesit e adhurueset, të singertit e të singertat, durimtarët e durimtare, të përvuajturit e të përvuajturat, sadakadhënësit e sadakadhënëset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumë përmendësit e Allahut e shumë

përmendëset e Allahut, Allahu ka përgatitur falje (mëkatesh) dhe shpërblim të madh.”²⁸

Prandaj, në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. gruaja falte namazin në xhami dhe bënte edhe haxhin. Po ashtu, gruaja u ndëshkua për shkak të besimit siç u ndëshkua edhe burri. Ishte Sumeja nga familja e Jasirit ajo që ra dëshmore nga kamxhikët dhe e para shehide në Islam. Femrat dhanë besën para Pejgamberit s.a.v.s. siç e dhanë besën edhe meshkujt, si dhe ishin të pranishme në Besëlidhjen e Parë të Akabesë, ku ishin të pranishëm 70 burra dhe dy gra.²⁹

Kurse në ditën e çlirimit të Mekës ata të cilët u ofrohej shkëlqimi i Islamit dhe sjellja e lartë e Pejgamberit vrapuan dhe dhanë besën për Islamin. Dhe Pejgamberi a.s. ua pranoi atyre dëgjimin dhe respektin ndaj Allahut xh.sh.. Kur Pejgamberi a.s. e kreu besën me burrat, erdhën gratë dhe i dhanë besën. Prandaj, zbriti shpallja për këtë çështje.³⁰ Allahu xh.sh. thotë:

“O Pejgamber, kur të vijnë besimtarët që të të japin besën se nuk do t'i shoqërojnë asnjë send Allahut; se nuk do të vjedhin; se nuk do të bëjnë kurvëri; se nuk do t'i mbysin fëmijët e tyre; se nuk do të gënjejnë me ndonjë shpifje për (fëmijën e huaj që kanë marrë) se është i tyre; dhe se nuk do të të kundërshtojnë në atë që i urdhëron, atëherë, prano zotimin e tyre dhe lute Allahun t'i falë ato, se Allahu është mëkatfalës dhe mëshirues.”³¹

Edhe sa u përket ndëshkimeve janë të barabartë. Allahu xh.sh. thotë:

“Vjedhësit dhe vjedhëset prejani duart, si shpagim i veprës që bën, (kjo masë është) dënim nga Allahu. Allahu është i fuqishëm, ligdhënës i urtë.”³²

Kurse sa i përket etikës e moralit, në ndëshkimet e përcaktuara dhe të papërcaktuara secili është përgjegjës i veprimeve të veta.

²⁸ Kurani, El-Ahzab: 35.

²⁹ Hadixhe Sabbar, *El Islam Vel mer'e*, fq. 29.

³⁰ Hadixhe Sabbar, *El Islam Vel mer'e*, fq. 29.

³¹ Kurani, El-Mumtehineh: 12.

³² Kurani, El-Maide: 38.

²⁵ Kurani, En-Nisa: 1.

²⁶ Kurani, Esh-Shems: 7-10.

²⁷ Kurani, Et-Tekvir: 8, 9.

Prandaj, as që ka dobi mirësia e burrit dhe anasjelltas. Nuk ndikon as mosrespektimi i burrit ose i gruas, por vetëm devotshmëria. Allahu xh.sh. thotë:

“Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër duke qenë besimtarë, të tillët hyjnë në xhenet dhe nuk u bëhet farë padrejtësie.”³³

“Atyre që mohuan, Allahu u sjell një shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato të dyja ishin në kurorë të dy robërve të mirë nga robërit Tanë, por ato të dyja i tradhtuan (në fëmijë) ata të dy dhe këta të dy nuk mund t'i mbrojnë ato fare tek Allahu, e atyre dyjave u thuhet: “Hyni në zjarr së bashku me ata që hyjnë!”

E atyre që besuan, Allahu u solli shembull gruan e faraonit kur ajo tha: “Zoti im, më bëj një vend pranë mëshirës Sate në xhenet dhe më shpëto prej faraonit e brutalitetit të tij dhe më shpëto prej popullit mizor!”³⁴

“... Çdo njeri është peng i asaj që ka punuar.”³⁵

Me besimin islam gruaja u bë e aftë për çdo aktivitet shoqëror, duke u bërë plotësisht e barabartë me burrin, si në urdhërimin për punë të mira po ashtu edhe në ndalesa. Allahu xh.sh. thotë:

“Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqa, e falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë Allahu. Allahu është ngadhënjyes, i urtë.”³⁶

Allahu xh.sh. i ka kërcënuar ata të cilët shpifin për gratë e ndershme dhe të pastra duke thënë:

“Vërtet, ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënim shumë i madh.”³⁷

³³ Kurani, En-Nisa: 124.

³⁴ Kurani, Et-Tahrim: 10,11.

³⁵ Kurani, Et-Tur: 21.

³⁶ Kurani, Et-Tevbe: 71.

³⁷ Kurani, En-Nur: 23.

Po ashtu, nën hijen e besimit islam asaj iu dha e drejta e trashëgimisë, pasi më parë ishte e privuar nga kjo e drejtë:

“O ju që besuat, nuk është lejuar për ju të trashëgoni gratë (e të vdekurve) në mënyrë të dhunshme, e as t'i shtrëngoni për t'u marrë diçka nga ajo që ju keni dhënë atyre...”³⁸

Besimi islam shkoi aq larg në mbrojtjen e ndjenjave të saj dhe në ruajtjen e dinjitetit të saj, saqë e ndaloi burrin të trokasë në derën e shtëpisë së vet natën nëse e ka zgjatur udhëtimin e vet, duke pasur frikë se burri mund ta gjejë gruan në situatë jo të mirë për gratë për të takuar burrat e tyre.

Vallë cila fe ia mbron femrës këtë ndjenjë të thellë njerëzore?

Cila fe orvatet ta ruajë këtë litar të hollë të dashurisë dhe i ngre bashkëshortët në syrin e njëri-tjetrit në gradën më të lartë të ndershmërisë njerëzore?

Islami vuri ligj për trashëgimin e grave, duke i sqaruar të drejtat e saj dhe duke e detajuar këtë si nënë, grua, motër dhe vajzë.³⁹ Thotë Allahu xh.sh.:

“Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave u takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që lënë, ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti).”⁴⁰

Në këtë kohë arabët i trashëgonin femrat me dhunë. Do të thotë, vinte trashëguesi dhe ia hidhte petkun në fytyrë të trashëgimisë së tij, duke i thënë “E trashëgoj këtë siç e trashëgoj pasurinë time” dhe atëherë kishte të drejta ndaj saj më shumë sesa ajo ndaj vetes. Në qoftë se donte, martohej me të, e në qoftë se donte e martonte me dikë tjetër dhe mehrin e merrte për vete. Ai mund ta ndalonte të martohej edhe në këmbim të një shume të caktuar, prandaj Islami e ndaloi këtë mënyrë mizore dhe këtë sjellje poshtëruese ndaj saj në ajetin vijues.⁴¹ Allahu xh.sh. thotë:

³⁸ Kurani, En-Nisa: 19.

³⁹ Hadixhe Sabbar, *El Islam Vel mer'e*, fq. 31.

⁴⁰ Kurani, En-Nisa: 7.

⁴¹ Hadixhe Sabbar, *El Islam Vel mer'e*, fq. 32.

***“O ju që besuat, nuk është lejuar për ju të trashëgoni gratë (e të vdekurve) në mënyrë të dhunshme, e as t’i shtrëngoni për t’u marrë diçka nga ajo që ju keni dhënë atyre...”*”⁴²**

Po ashtu, gratë e baballarëve trashëgoreshin me sendet që kishin lënë dhe bëheshin gratë e bijve të tyre. Islami e luftoi këtë gjendje të mjerë, e cila ishte kundër natyrshmërisë së njeriut. Thotë Allahu xh.sh.:

***“Mos u martoni me ato gra me të cilat qenë të martuar prindërit tuaj, me përjashtim të asaj që ka kaluar (para Islamizmit) pse ajo ishte turpëri, përbuzje e traditë e shëmtuar.”*”⁴³**

Islami ndaloi edhe martesën me të afërmet nga qumështi dhe nga gjaku.

***“Mos u martoni me ato gra me të cilat qenë të martuar prindërit tuaj, me përjashtim të asaj që ka kaluar (para Islamizmit) pse ajo ishte turpëri, përbuzje e traditë e shëmtuar U janë ndaluar juve (të martoheni me): nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezet tuaja, bijat tuaja, bijat e motrës, nënat tuaja që ju kanë dhënë gjë, motrat nga gjiri, nënat e grave tuaja (vjeçrrat) dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt, e nëse nuk kanë pasur kontakt me to (me gratë), atëherë s’ka pengesë (të martoheni me ato vajza), dhe (janë të ndaluara) gratë e bijve tuaj që janë të lindjes suaj (jo të bijve të adoptuar), dhe të bashkoni (përnjëherë në një nigjah) dy motra, përpos asaj që ka kaluar. Vërtet, Allahu fal shumë, është mëshirues i madh.”*”⁴⁴**

Përkrah kësaj pozite shoqërore të nderuar që i dha besimi islam gruas, ai i dha asaj të drejta civile dhe politike që nuk hasen as te popujt më tolerantë sot e kësaj dite. Islami i lejoi asaj të bënte ç’te donte me pasurinë e saj, duke shitur, blerë, marrë ose dhënë. Dhe këtë Islami nuk e la në dorë të lejes së babait, vëllait ose burrit. Këtë sjellje të

gruas nuk e kufizon asgjë tjetër përveç rregullave të përgjithshme për të gjithë. Në të njëjtën kohë ligjet pozitive, si p.sh., ligji francez, e përkufizonin gruan dhe e ndalonin të përdorte pasurinë e saj vetëm se me lejen e bashkëshortit të saj.⁴⁵

Kujdesi i Kuranit duket qartë në veçimin e femrës me sure të tëra si Bekare, Ali Imran, Nisa, Merjem, Nur, Muxhadele, Mumtehineh, Talak, Ahzab, Kasas dhe Neml.

Kujdesin për gruan e hasim në Kuran, në Sunet, në biografinë e sahabëve dhe në historinë islame, ku personaliteti dhe pozita e saj lartësohet.

Në këtë drejtim femra myslimane ka arritur një përparësi jashtëzakonisht të lartë këto katërmbëdhjetë shekuj, kurse motra e saj në Perëndim ka luftuar me shekuj për të arritur të drejta të njëjta, mirëpo pozita e saj shoqërore ende është më e ulët se pozita që Islami i dha gruas myslimane.

2. Hadithi

E dimë se sunet i Pejgamberit a.s. nuk janë vetëm porositë e tij, por edhe veprat dhe pëlqimi që ai ka dhënë për veprat e bëra nga dikush tjetër, qoftë edhe me heshtjen e vet.⁴⁶

Atëherë, ne shohim se në sunetin e tij a.s. gruaja e zë një vend tepër të gjerë. Gruan e hasim në jetën e tij të përditshme në çdo aspekt të jetës dhe të aktivitetit. Ajo ishte e pranishme gjithkund ku ishte nevoja, pa u dalluar nga burrat për shkak të gjinisë. Kjo shihet qartë nga pjesëmarrja e tyre në përhapjen e besimit islam si në fillim, por edhe në kohën e emigrimit. Ajo ishte e pranishme edhe në luftëra të ndryshme, madje mendimi i saj nuk mungonte edhe para Pejgamberit a.s..

Historia na tregon se besimtarja e parë e besimit islam ishte Hz. Hatixhja, bija e Huvejlidit, ndërkohë që ajo ishte edhe bashkëshorte e Pejgamberit a.s.. Ajo dha një kontribut të lartë duke e ndihmuar kau-

⁴² Kurani, En-Nisa: 19.

⁴³ Kurani, En-Nisa: 22.

⁴⁴ Kurani, En-Nisa: 22,23.

⁴⁵ Hadixhe Sabbar, *El Islam Vel mer’e*, fq. 33.

⁴⁶ Taxhedin Bislimi, *Hyrje në shkencën e usuli fikhut*, Shkup, 2003. fq. 58-60.

zën islame dhe duke e përforcuar dhe mbështetur Pejgamberin a.s. në çastet më të vështira- sidomos në fillim të thirrjes- me qëndrimet e saj dinjitoze, të cilat janë të paharrueshme për historinë. Kur ende nuk kishte asnjë besimtar dhe kur edhe vetë Pejgamberi a.s. ishte në hall të madh nga frika e cila e kishte kapluar prej ballafaqimit të tij të parë me engjëllin Xhibril, ajo që iu gjend pranë ishte gruaja e tij, Hz. Hatixhja.

Pas trysnive dhe persekutimeve ndaj Pejgamberit a.s. nga ana e mushrikëve të Mekës, nuk mbeti tjetër vetëm se shpërngulja e myslimanëve në vendet fqinje dhe për t'u siguruar nga dora armiqësore e armikut. Atëherë Pejgamberi a.s. urdhëroi që myslimanët të shpërngulen në Abisini, pasi kishte dëgjuar se mbreti i atij vendi, Nexhashiu, ishte njeri i drejtë dhe në vendin e tij të gjithë njerëzit trajtoheshin njësoj.

Në muajin Rexheb të vitit të pestë të pejgamberisë, grupi i parë i të shpërngulurve përbëhej nga dymbëdhjetë meshkuj dhe katër gra. Këtë grup e udhëhiqte Uthman b. Affani me bashkëshorten e tij Rukijën, vajzën e Pejgamberit a.s..⁴⁷

Historia nuk përfundon këtu, pasi gruaja ishte pjesëmarrëse edhe në Besëlidhjen e Parë në Akabe, ku myslimanët i dhanë besën Pejgamberit a.s. për aplikimin e parimeve të fesë së drejtë. Vlen për t'u përmendur se këtë besëlidhje, që u quajt edhe Besëlidhja e Grave, na e përmend edhe Kurani në suren El-Mumtehineh: 12. Më pas vjen edhe Besëlidhja e Dytë në Akabe, ku ishin besatuar edhe dy gra në mesin e 73 burrave.

Nga Ka'bi transmetohet: "Atë natë ramë të flinim së bashku me haxhilerët e tjerë nga Jethribi. Kur kaloi një e treta e parë e natës, u përvodhëm nga çadra një nga një dhe duke përgjuar arritëm në vendin e caktuar. Ne ishim shtatëdhjetë e tre meshkuj e dy gra, Nesiba, vajza e Ka'bit (nëna e Amarit), nga familja Mazin b. En- Nexhar dhe Esma, vajza e Amarit (nëna e Meniut), nga familja Beni Selem."⁴⁸

Kur Pejgamberi a.s. bëri shpërnguljen e tij të parë, fshehtësinë e vendit ia besoi Esmës, vajzës së Ebu Bekrit, e cila mori përsipër detyrën e dërgimit të ushqimit deri në shpellën Thevër çdo ditë. Kjo shpellë ishte dy orë e gjysmë në këmbë larg Mekës dhe gjendej në majë të kodrës. Megjithëse ishte në muajin e shtatë të shtatzënisë, ajo i përballonte të gjitha mundimet për hir të besimit, i cili duhet të përparonte. Edhe pse Ebu Xhehli i tmerrshëm dhe brutal e pyeti për babanë e saj, ajo e sfidoi atë kur këmbënguli që të mos i tregonte. Ai faqezi i paturp e ngriti dorën dhe i ra me shuplakë aq fuqishëm, sa që ia shkuli vathin prej veshi.⁴⁹

Në marrëveshjen e Hudejbijes, kur myslimanët u ndaluan të hynë në Mekë dhe arritën marrëveshjen, sipas së cilës myslimanët duhet të ktheheshin pa e bërë haxhin, Pejgamberi a.s. i urdhëroi sahabët që t'i therin kurbanet e haxhit dhe të qetheshin. Sahabët ngurruan, ndërsa Pejgamberi a.s. u hidhërua shumë. Kur hyri në çadrën e bashkëshortes së vet, te çadra e Umme Selemes, e bija e Ebu Umejjes, ajo e pyeti disa herë se pse ishte aq i hidhëruar, derisa Pejgamberi iu përgjigj "Mbaruan myslimanët! U thashë t'i therin kurbanet, por ata nuk po veprojnë." Atëherë Umme Selemeja i tha: "O i Dërguar i Allahut, mos i qorto pasi në brendinë e tyre kanë shumë hidhërim nga munda që i ke dhënë ti vetes nga marrëveshja dhe kthimi i tyre prapa pa e çliruar Mekën. O Pejgamber i Allahut, dil dhe mos fol me askënd, there kurbanin tënd dhe qethi flokët tua." Pejgamberi a.s. ashtu veproi e pas tij të gjithë besimtarët i therën kurbanet dhe i qethën flokët.⁵⁰

Hadithe në të cilat Pejgamberi a.s. porositi për kujdesin ndaj gruas kemi shumë, në të gjitha përmbledhjet e haditheve. Por këtu do ta cekim vetëm një hadith, ngase ky lloj punimi nuk na lejon t'i shtjellojmë të tërë grumbujt e haditheve, prandaj do të cekim vetëm një hadith, në të cilin Pejgamberi s.a.v.s. e ka barazuar përgjegjësinë e burrit dhe të gruas karshi roleve të tyre. Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.: "Çdokush prej jush është rojtar dhe do të përgjigjet për rojën e tij. Imami (udhë-

⁴⁹Po aty, fq. 191.

⁵⁰ Sefijurrahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhenetit*, fq. 393, 394. shih po ashtu: Muhammed M. Sha'ravi, *ElMer'etu fil Kur'anil Kerim*, f. 48-54. Kajro: 1990.

⁴⁷ Sefijurrahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhenetit*, Shkup, 1997. fq. 98.

⁴⁸ Sefijurrahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhenetit*, 157.

heqësi) është rojtar dhe do të përgjigjet për rojën e tij; burri është rojtar për familjen e tij dhe do të përgjigjet për atë; gruaja është rojtare në shtëpinë e burrit të saj dhe do të përgjigjet për rojën e saj; shërbëtori është rojtar në pasurinë e zotërisë së tij dhe ai është përgjegjës në rojën e tij. Të gjithë jeni rojtarë dhe të gjithë do të përgjigjeni për rojën tuaj.”⁵¹

Duhet theksuar se Pejgamberi s.a.s.v., sa herë që ka udhëtuar, ka marrë ndonjërrën nga bashkëshortet e tij me vete për të treguar vlerën e gruas, se ajo është pjesë e pandashme e jetës së njeriut, se ajo duhet të gjendet në të gjitha sferat e jetës e jo vetëm në vendbanime të rehatshme, por edhe në luftë e kudo ku gjendet edhe burri. Sa i përket nevojës fiziologjike të Pejgamberit s.a.v.s., ajo nuk ka qenë edhe aq e theksuar, siç dëshirojnë ta komentojnë disa, sepse ishte i shtyrë në moshë. Le t’i shtojmë kësaj edhe lodhjen që i shkakton udhëtimi njeriut, saqë Allahu xh.sh. edhe namazin e shkurtoi në gjysmën e namazit në vendqëndrimin e përhershëm. Por, këto veprime të Pejgamberit a.s. ishin mësim praktikë për besimtarët në jetën e tyre bashkëshortore dhe se kjo bashkëjetesë është e pandashme.

Madje Pejgamberi s.a.v.s. shkon edhe më larg, aq sa dikujt tjetër në vend të tij, sado burrë shteti të ishte, as që do t’i shkonte mendja ta porosiste popullin për kujdes të veçantë ndaj gruas. Në pozitën më të lartë të udhëheqësit, pas krijimit të shtetit në Medinë dhe pas shndërrimit të shteti islam në fuqi të pathyeshme nga fuqitë e asaj kohe, në ato momente kur gjendej përballë atyre që dikur e kishin dëbuar dhe ishin orvatur ta vrisnin, para më shumë se njëqind e njëzet e katër mijë besimtarëve, në Haxhin e Lamtumirës në Arafat ai nuk e harroi çështjen e gruas në fjalimin e tij historik. Ai i porositi besimtarët për përkushtim ndaj grave me fjalët: *“Kini frikë Allahun për sjelljet tuaja ndaj grave. Ju i keni marrë ato në besë të Allahut dhe me to keni marrëdhënie me lejen e Allahut,...ato kanë të drejtë që ju t’i ushqeni dhe t’i vishni ashtu siç është e drejtë...”*⁵²

⁵¹ Sahihul Buhari, nr. i had. 2232.

⁵² Sefijurrahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhenetit*, fq. 537.

Me këtë porosi të lartë të Pejgamberit s.a.v.s. kuptojmë se sa rëndësi dhe vlerë të lartë i ka dhanë besimi islam femrës. Islami nuk e harroi atë as në momentet kur masa e gjerë padyshim priste fjalë vetëm rreth pushtetit, shtetit dhe ligjeve që duheshin zbatuar.

Emine Vezaj

THE POSITION OF WOMEN IN ISLAM

(Summary)

THE QUR’AN

Humans are not a specie that have gained their current form as a result of evolution. Humans are a separate specie.

The Noble Qur’an has a very high opinion about women and their role alongside men.

“And Allah has made for you wives of your own kind, and has made for you, from your wives, sons and grandsons, and has bestowed on you good provision. Do they then believe in false deities and deny the Favour of Allah (by not worshipping Allah Alone)”?

أمينه وزاى

مكانة المرأة في الاسلام المرأة على ضوء تعاليم الاسلام (خلاصة البحث)

القرآن:

الانسان لم يتخذ شكله و كيانه الحالى نتيجة لنظرية التطور و الارتقاء، بل هو صنف خاص و مستقل جاء ليحمل رسالة خاصة به.

القرآن الكريم يقدم إلينا المرأة كمخلوق محترم تشارك زوجها في حياته اليومية و تلعب دورا مهما لكى يمكن لهما ان ينظما حياتها اليومية و بنجبا اطفالا و احفادا. يقول الله عز و جل في القرآن الكريم:

"وَاللّٰهُ جَعَلَ لَكُم مِّنْ اَنْفُسِكُمْ اَزْوَاجًا وَجَعَلَ لَكُم مِّنْ اَزْوَاجِكُمْ بَنِينَ وَحَفَدَةً وَرَزَقَكُمْ مِنَ الطَّيِّبَاتِ اَفَبِالْبَاطِلِ يُؤْمِنُونَ وَبِنِعْمَةِ اللّٰهِ هُمْ يَكْفُرُونَ" (النحل 72)

INTERVISTË E HUAZUAR

Intervistë me ish-diplomatin gjerman, prof. dr. Murad Hofman

MYSLIMANËT JANË VETËPËRGJEGJËS PËR IMAZHIN E KEQ TË ISLAMIT NË BOTËN PERËNDIMORE!!

Njëra prej dobive të haxhit është njohja, afërsia, këmbimi i mendimeve midis myslimanëve të ardhur nga vende të ndryshme të botës, të cilët u përkasin racave, kombeve dhe gjuhëve të ndryshme. Kështu në tokën e shenjtë dhe saktësisht në Selinë e mysafirëve të Ligës Islame, ku ishin prezentë me dhjetëra shkrimtarë, dijetarë dhe mendimtarë myslimanë, në mesin e tyre ish-diplomati gjerman mysliman prof. dr. Murad Hofman, i cili ishte njëri prej diplomatëve me të njohur të Gjermanisë. Ai për herë të parë erdhi në kontakt me Islamin gjatë shërbimit në Ambasadën Gjermane në Algjeri, ku më vonë edhe e pranoi Islamin. Rreth tregimit të Islamit të tij, mendimit të tij për problemet bashkëkohore me të cilat po ballafaqohen myslimanët dhe mundësinë e zgjidhjes së tyre në kuadër të Islamit, si dhe mundësisë që myslimanët ta rikthejnë krenarinë dhe thesarin e tyre civilizues dhe kulturor zhvilluam me të bisedën në vijim.

- Prof dr. Murad Hofman, para se të na flasësh për Islamin si alternativë dhe realitet të umetit, ju kisha lutur të na tregoni diçka për biografinë tuaj.

Emri im është Murad Hofman. Unë tani kam 73-vjet. Jam lindur në një familje katolike. Babai im punonte profesor i matematikës. Unë rrjedh prej një familjeje, e cila ishte inkuadruar në luftë kundër nazizmit. Unë jam specializuar në shkencat juridike dhe kam marrë diplomë të larta. Tërë jetën time kam punuar në diplomaci në vende të ndryshme të botës. Jam i martuar dhe kam djem dhe vajza. Pas përfundimit të Islamit e zgjodha një emër mysliman pra, Murad Hofman.

- Cili ishte perceptimi juaj për fetë në përgjithësi?

Për fat të keq, Islami nuk ishte prezent fare. Askush nuk na kishte folur për Islamin as për historinë dhe civilizimin e tij. Kjo çështje nuk ekzistonte askund në programet tona si shtet.

- Cila është ajo që tërhoqi vëmendjen tuaj në Islam?

Më kujtohet se kontakti im i parë me Islamin ishte në kohën, kur unë isha caktuar si ambasador i Gjermanisë Perëndimore në Algjeri, gjatë luftës për pavarësi. Gjatë asaj kohe fillova ta lexoj Kur'anin fisnik nga kureshtja për t'u njohur me fenë e vendit, ku do të shërbeja dhe do të jetoja si ambasador i vendit tim. Për herë të parë lexova përkthimin e Kur'anit në gjuhën frëngjishte. Disa net radhazi lexoja deri në orët e vona të natës për të mundur të mësoj sa më shumë që ishte e mundur. Gjatë leximit vëreja një fjali, apo një kuptim, i cili u përsërit shtatë herë, nga i cili kuptova se askush nuk e bart barrën e tjetërkujt mbi supet e veta, por asnjë i pafajshëm nuk e bart gabimin e tjetërkujt, i cili e bën atë. Kur'ani e përsërit dhe e vërteton se **"Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit"**, po ashtu ai thotë: **"Secili njeri është peng i veprës së vet"**. Gjithashtu thotë: **"Ai (Jusuifi) tha: "Allahu na ruajt, të marrim tjetër pos atij te i cili e kemi gjetur teshën tonë, ne atëherë do të jemi të padrejtë!"**, në tregimin e Jusufit a.s. kur ata i ofruan atij t'ia dorëzojnë një vëlla tjetër, i cili nuk ishte objekt i hetimeve....Në atë kohë hetova se një ndjenjë e thellë depërtoi në trupin dhe shpirtin

tim... Kësaj ndjenje iu bashkëngjit edhe një kuptim tjetër, të cilin e kisha hasur gjatë leximit të Kur'anit, e ai ishte se nuk ekziston kurrfarë ndërmjetësimi midis njeriut dhe Krijuesit të tij: ***"E kur robët e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua."***

Të gjitha këto ide të shkëlqyeshme dhe të reja për mua më shtynë të thellohem në studime dhe hulumtime për kuptime tjera të bukura në Islam, derisa shpirti im u ngop me besimin Islam, dhe kur u ktheva në Gjermani m'u shtua shija për të lexuar libra islam e në veçanti librat e Ibnu Haldunit, Ibnu Sinasë dhe Sahihun e Buhariut.

Në këtë periudhë isha bindur plotësisht për Islamin si fe e shpallur dhe e vërtetë. Për këtë shkova deri te një dijetar i el-Az-harit, i cili ishte nga Egjipti dhe punonte si imam dhe hatib në Gjermani. Bisedova me të një kohë bukur të gjatë dhe i shpreha dëshirën që ta shpalos Islamin tim dhe e falënderoj Allahun, i cili më udhëzoi në këtë rrugë të drejtë dhe u bëra mysliman.

- Si e ke bartur idenë tuaj të re për Islamin?

Më lejo në fillim të them se ky është obligim i çdo myslimani, i cili e di të vërtetën e Islamit. Ai ka obligim të shkruajë për të dhe ly-pset që ta paraqesë tolerancën, vlerën dhe parimet e tij të larta, të cilat qëndrojnë shumë lart mbi të gjitha vlerat tjera... Te ne në Perëndim, shumica prej nesh nuk besojnë në asnjë fe, ne jemi të hutuar midis ideologjive dhe mendimeve të ndryshme, prandaj, është më e arsyeshme që atyre t'u ofrohet thirrja në Islam nëpërmjet dikujt nga bashkë-kombësit e tyre. Po ashtu është më lehtë ta përqafojë fenë Islame dikush që beson ndonjë fe monoteiste sesa ai që nuk ka kurrfarë feje.

- A i është përgjigjur thirrjes suaj dikush nga të afërmit apo ndonjëri nga miqtë tu ose ndonjëri nga njerëzit e rëndomtë?

Unë vazhdimisht mbaj ligjëratat dhe mësimet për Islamin, në të cilat prezantojnë me dhjetëra mijëra njerëz dhe nuk mund ta dijë se kush sa ka pasur dobi dhe kush është bindur për shkak të numrit të madh.

Në veçanti kur dihet se unë vazhdimisht jam në lëvizje prej një vendi në vendin tjetër. Por, duhet ta dimë se udhëzimi është çështje e Allahut të Madhërishëm. Prandaj, obligimi im është t'i thërras njerëzit në Islam, ndërsa udhëzimi është çështje e Allahut të Madhërishëm. Ndërsa, sa i përket familjes sime, unë jam i martuar me një grua turke myslimane. Ndërsa fëmijët e mi janë në pozita të larta, ata janë shumë afër Islamit. Unë jam optimist për një përfundim të mirë me ndihmën e Zotit.

Islami dhe bota

- Si mund të kontribuojë Islami në vendosjen e paqes dhe të qetësisë në botën e sotme, kur vatrat e luftërave janë prezentë në shumë vende të botës?

Nëse i hedh një vështrim ti apo kushdo qoftë asaj se çka po ndodh në Perëndim, do të shohim se aty po ndodhin gjëra të tmerrshme, qoftë edhe në nivel të individit. Rinia në Perëndim po shkatërrohet prej drogës si dhe shthurja e familjes ka arritur kulmin e saj. Aty më nuk ekziston edukimi familjar dhe ngrohja prindërore. Këtë rol e ka marrë ekрани i vogël (televizioni). Ai është edukuesi numër një i fëmijëve dhe i rinisë, duke përfshirë këtu lakuriqësinë, skenat e dashurisë. Për këtë, mund të thuhet se edukimi plotësisht ka dështuar, por ka mbetur përparimi ekonomik. Prandaj, ekziston një problem njerëzor i edukimit në Perëndim dhe zgjidhja e vetme për këtë është Islami. Ai në vetë përmban vlerat e imanit (besimit), sepse e ndalon alkoolin, mbron familjen dhe prej institucionit të martesës krijon një lidhje të fortë dhe të shenjtë. Ky institucion siguron një familje të shëndoshë, me lidhje të forta, të cilës i siguron një jetë të ndershme, ndërsa fëmijëve u siguron edukatë të mirë, që është pika më e dobët e Perëndimit në kohën e tashme. Thënë shkurt, Islami është zgjidhja e vetme për të gjitha sëmundjet e Perëndimit. Por jo vetëm të Perëndimit, ai është alternativë e vetme për të gjitha sëmundjet e pashërueshme dhe problemet me të cilat po ballafaqohet bota bashkëkohore, si: terrorizmi, padrejtësia, okupimi, përdorimi i dhunës së pakontrolluar. Për të gjitha këto nuk

mund të ketë zgjidhje meritore dhe fatlume, përveç në kuadër të sistemit Islam, si fe, besim dhe kushtetutë.

Civilizimi do të mbisundojë

- *Dr. Hofman, a mendoni ju se myslimanët do të jenë në gjendje ta rikthejnë civilizimin e tyre të dikurshëm?*

Ndoshta ti e di, se është një numër shumë i vogël i atyre që dinë fare pak për historinë e Islamit, por, janë të shumtë ata që dinë për historinë para Islamit dhe për të ata janë krenarë dhe mendojnë se e tërë bota vrapon pas tyre dhe ka lakmi për ta. Nëse atyre ua përkujton civilizimin e myslimanëve të parë dhe kontributin që ata dhanë në lëmin e shumë shkencave prej të cilave pati dobi të madhe Europa në periudhën e Renesancës, ata përgjigjen se çdokush ka kohën e vet. Nëse ajo ishte periudha e përparimit të myslimanëve, tani ne kemi primatin në të gjithë lëmenjtë dhe kjo është koha e jonë. Ky është një shans i yni i madh. Unë jam thellë i bindur se Rilindja e re e civilizimit islam do të fillojë nga Amerika, në veçanti kur atje jetojnë më shumë se tetë milionë myslimanë. Ata kanë në besim të fortë në fenë e tyre, në mesin e tyre janë dy milionë afro-amerikanë, të cilët kanë një simpati të madhe ndaj Islamit dhe kanë një aktivitet shumë të madh në shoqërinë amerikane. Afro-amerikanët nuk kanë harruar se ata të cilët i morën prej Afrikës dhe ua shitën amerikanëve të krishterë ishin çifutët. Për këtë, ata nuk e duan as njërin e as palën tjetër, por dashuria dhe simpatia e tyre është për Islamin. Kështu, ata tani kanë në dispozicion katërqind shkolla islame në SHBA. Unë jam thellë i bindur se ata do të jenë bartës të dritës së civilizimit të ri islam si pararojë e Botës së Re Islame.

- *Dr. Murad Hofman, atëherë kush është përgjegjës për imazhin e keq të Islamit në Perëndim?!*

Vetë myslimanët janë përgjegjës për këtë çështje. Unë jam i njohur se Muhamedi Asadi, një mysliman amerikan ka thënë: "Falënderoj Zotin se unë e njohja Islamin, para se ta shoh realitetin e

myslimanëve, sepse sjelljet dhe veprimet e tyre nuk kanë të bëjnë aspak me moralin Islam, ashtu siç e dëshoi Allahu i madhërishëm dhe i dërguari i Tij.

- *A mendon se thirrësit nuk ishin në nivelin e përgjegjësisë së tyre?*

Duhet të ndryshohet metoda e thirrjes, të cilën po e zbatojnë thirrësit sot në të gjitha mjetet informimit. Duhet të kemi një kujdes të veçantë për myslimanët e Perëndimit dhe ata të Europës, që të përfitojmë nga veprimtaria dhe përvojat e tyre dhe t'u japim atyre rastin të jenë thirrës të Islamit. Unë jam thellë i bindur se rezultatet do të jenë të mira.

- *A keni ju koment për atë çka po ndodh me Islamin, në veçanti në botën arabe dhe në Lindjen e Mesme?*

Ashtu siç është e njohur për të gjithë ne se shteti më i fuqishëm tani në botë është SHBA dhe pastaj Kina. Unë po vërej se nuk ekziston një bashkëpunim mes myslimanëve dhe ata janë të përçarë. Hapi i parë që duhet bërë është bashkimi i tyre dhe forcimi i radhëve të tyre dhe uniteti i qëllimit të tyre. Ky është hapi i parë që duhet të ndërmarin myslimanët dhe arabët për ta mënjanuar rrezikun që u kanoset atyre nga europianët dhe amerikanët.

Fundi i Amerikës

- *Dr. Murad Hofman, cili do të jetë fundi i Amerikës dhe a do të ndodhë shpejt?*

Unë e njoh shoqërinë amerikane shumë mirë, sepse kam studiuar atje. Gruaja ime e parë ishte amerikane dhe me të kam një djalë. Nëse i hedh një vështrim shoqërisë amerikane do të shohësh se 90% të saj janë të krishterë. Ky është dallimi mes Amerikës dhe Europës, sepse shumica e europianëve janë ateistë. Amerikanët në përgjithësi janë fetarë dhe përpiqen t'i respektojnë parimet e fesë ashtu siç vepron edhe presidenti Bush dhe qeveria e tij. Por, ata e ndiejnë veten superiorë

ndaj popujve tjerë, për shkak të përparimit teknologjik dhe ekonomik dhe e konsiderojnë veten prijës të botës. Duke u mbështetur në këtë, në veçanti pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, amerikanët shfrytëzuan rastin për ta njollosur imazhin e Islamit dhe të myslimanëve, pasi që i fajësuan ata për shpërthimet, të cilat sipas mendimit tim janë lojë e shërbimeve sekrete, në të cilat myslimanët nuk kanë lidhje. Andaj, është obligim yni që ta rikthejmë imazhin tonë te populli amerikan.

Kurse sa i përket fundit të Amerikës, ashtu sikurse jeni në dijeni, bota sot pa kalon nëpër periudha të kthesave të mëdha. Ashtu siç përmenda më parë rinia amerikane po kalon nëpër fazën e kulmit të anarkisë dhe imoralitetit. Andaj, çdo shoqëri apo komb që kalon nëpër këtë fazë nuk ka dyshim se fundi i tij është shumë afër.

- Dr. Hofman, cila është kërkesa e juaj nga myslimanët?

Për fat të keq rreth ngjarjeve të fundit që kanë të bëjnë me shaminë dhe atë që e përmendi Shejhi i el-Al-az-harit, se gratë myslimane në Perëndim mund të shkojnë pa shami dhe se myslimanët në Perëndim mund të hanë mishin e kafshëve, që nuk është prerë sipas rregullave të sheriatit islam, me arsyetimin se ata jetojnë në një vend jomysliman dhe janë të detyruar ta bëjnë atë. Unë mendoj se Shejhi i el-Az-harit, Dr. Muhamed Sejid Tantavi, nuk kishte pasur të drejtë ta bënte një deklaratë të tillë. Sepse ai me siguri nuk është i njoftuar për luftën tonë të pakompromis, të cilën ne e bëjmë për t'i realizuar të drejtat tona si myslimanë. Me këtë fetva, ai ua lehtësoi qeverive europiane që të mos i përfillin kërkesat tona dhe ne t'i humbim të drejtat tona si myslimanë dhe qytetarë të këtyre vendeve. Unë kam frikë se kjo do të zbatohet në shumicën e vendeve europiane, duke përfshirë edhe Gjermaninë dhe nuk do t'u lejohet grave myslimane të bartin shaminë. Sa për informim, ekziston një numër i madh i lëndëve, të cilat i kanë ngritur myslimanët në gjyqe të niveleve të ndryshme. Andaj, do t'i kisha lutur dijetarët tanë që të mos japin fetva, kur janë në pyetje myslimanët e Perëndimit, para se të konsultohen me ne. Sepse ato kanë të bëjnë me të ardhmen tonë dhe të brezave që do të vijnë pas nesh në këtë pjesë të botës.

- Dr. Hofman, si e sheh kongresin e madh të myslimanëve këtu në Arafat?

Haxhi është një rast shumë i mirë për t'u njohur dhe universitet i madh për të mësuar pa profesor. Mirëpo, më vjen keq që ne myslimanët nuk po e shfrytëzojmë këtë sa duhet që të jemi faktorë aktivë në botën e sotme.

- A e ke vizituar Egjiptin dhe cilat janë përshtypjet tuja?

Po, Egjiptin e kam vizituar më shumë se dhjetë herë gjatë pjesëmarrjes sime në Kongresin vjetor të Këshillit të Lartë për çështje Islame. Jam magjepsur me Kajron dhe bukuritë e saj, në veçanti gjatë natës. Kam vizituar shumicën e xhamive monumentale të Kajros si dhe thesarin shumë të pasur të trashëgimisë së vjetër të Egjiptit. Me Egjiptin më lidhin kujtime, të cilat nuk mund t'i harroj asnjëherë.

Përktheu nga arabishtja:

Fuad Morina

*Marrë nga revista "Akher Saa",
nr.3618, 25 shkurt 2004, Kajro*

Interview with the former German diplomat Murad Hofman

**MUSLIMS THEMSELVES ARE RESPONSIBLE
FOR THE BAD IMAGE OF ISLAM
IN THE WESTERN WORLD!!**

(Summary)

One of the benefits of the hajj is that it provides the possibility for an exchange of views between Muslims from different parts of the world, people, who belong to different races, nations and speak different languages. It was during the hajj that we met professor Murad Hofman, a former German diplomat. He first came into contact with Islam, while serving at the German Embassy in Algeria. It was there that he converted to Islam. We spoke with him regarding contemporary problems affecting Muslims worldwide and the possibility to find a solution to them (within Islam), as well as the possibility that Muslims regain their pride.

المسلمون هم وحدهم مسئولون عن الصورة السيئة للإسلام في الغرب

(خلاصة البحث)

ان من اهم فوائد الحج هي المعرفة و التقرب و تبادل الآراء بين المسلمين الذين جاءوا من أماكن مختلفة من العالم و الذين ينتمون إلى اعراق و شعوب و لغات مختلفة. و هكذا في مقر رابطة العالم الاسلامي حيث كان عدد كبير من الكتاب و العلماء و المفكرين المسلمين كان من بينهم الدبلوماسي السابق من المانيا د. مراد هوفمان و الذي كان من أشهر دبلوماسي المانيا. و كانت لقاءه الاول بالاسلام اثناء عمله بالسفارة الالمانية في الجزائر و بعد فترة و جيزة اعتنق الاسلام. و حول كيفية اعناق الاسلام و قصته معه و حول رايه عن التحديات التي تواجه المسلمين في الوقت الحاضر اجرينا معه هذا الحوار.

MISTICIZMI

Ebu Sa'd el-Malini

DISA FJALË RRETH HISTORIKUT TË SUFIZMIT DHE ZHVILLIMIT TË TIJ

Ekzistojnë mendime të ndryshme të historianëve për sa i përket etimologjisë nga e cila ka rrjedhur fjala “sufi”. Disa thonë se ajo ka të bëjë me veshjen e leshit*. Të tjerët pohojnë se kjo fjalë ka lidhje me banorët e Sufes (Ehlu-s-suffe), të cilët ishin një grup të varfërish që banonin në xhaminë e Pejgamberit a.s.. Ka të tjerë që mendojnë se kjo fjalë rrjedh nga “Es-safa” (pastërtia), gjegjësisht pastërtia dhe dëlirësia e shpirtit.

Ka edhe mendime të tjera, mbase mendimi i parë është më i saktë, pikërisht siç thotë edhe Ibn Tejmije: “Fjala “sufi”* e ka prejardhjen nga veshja e leshit (es-suf) dhe ky është mendimi më i saktë”.¹ El-Ke-labadi përmend definicione të ndryshme rreth emërimit “sufizëm”*

* “Suf” në gjuhën shqipe do të thotë “lesh”. (vër. e përkthyesit).

* Këtu është interesant të ceket thënia e el-Fuxhajshit, një mistik nga shekulli X, i cili, i pakënaqur me kohën në të cilën jetoi, kishte deklaruar: “Në kohën e vjetër kishte mjaft sufi, mirëpo ata nuk kishin ndonjë emër të veçantë, ndërsa sot kemi mjaft emra, por nuk ka sufi të vërtetë”. (vër. e përkthyesit).

¹ “El-furkan bejne evlijai-r-rahman ve evlijai-sh-shejtan, fq. 24.

* Sufizmin si term për herë të parë e vuri në përdorim profesori gjerman, Tolluk në fillim të shek. XIX dhe atë nga gjuha latine. Ekuivalenti i tij në gjuhën arabe është “et-tesav-vuf” (tesavufi). (vër. e përkthyesit).

duke e lidhur atë me konceptin e askezës apo asketizmit (ar. ez-zuhd) dhe pastrimit (ar. et-tezkije). Kështu, ai thotë: “Një grup mendon se sufite u emërtuan kështu për shkak të pastërtisë së fshehtësive dhe dëlirësisë së veprimeve. Bishr ibn-ul-Harith el-Hafi ka thënë: “Sufiu është personi, zemra e të cilit i kullon vetëm për All-llahun”. Disa të tjerë kanë thënë: “ Sufiu është personi, sjellja e të cilit zbukurohet vetëm për All-llahun, andaj ai tek All-llahu gëzon nder dhe respekt”.

Grupi i tretë thotë se sufite janë emërtuar me këtë emër, ngase ata janë në rreshtin (ar. es-saff) e parë para All-llahut sa i përket lartësisë së qëllimeve dhe afrimit të tyre kah Ai si dhe qëndrimit të tyre me fshehtësitë që mbajnë para Tij.² Siç vërehet nga këto definicione, sufite i japin rëndësi mjaft të madhe shpirtit (ar. en-nefs), kalitjes së tij, mënyrës së pastrimit të tij, kthjellimit të fshehtësive të tij, përpjekjes së largimit nga veset e këqija dhe stolisjes me vetitë e mira siç janë: butësia (ar. el-hilm), durimi (ar. es-sabr), sinqeriteti (ar. el-ihlas), thënia e së vërtetës (ar. es-sidk), abstinenca (ar. el-verë) dhe cilësi të tjera të mira të këtij lloji.

Ibn Halduni, në veprën e tij, “El-Mukaddime”, shkëput një fragment të rëndësishëm të cilin e titulloi “Disiplina e tesavufit (ar. ‘Ilmu-t-tesavvuf).

Në të, ai flet mbi rëndësinë e tesavufit dhe zhvillimin e tij si dhe mbi metodologjinë dhe rregullat e tij. Në këtë fragment, autori ka përmbledhur në pika të shkurtra tërë ato mendime që kanë dhënë historianët e vjetër të tesavufit e njëkohësisht sjell edhe qëndrimin e tij personal mbi të.

Kështu, Ibn Halduni, rreth disiplinës së tesavufit, thotë:

“Kjo disiplinë është njëra nga disiplinat e sheriatit, e cila bazohet te mënyra e jetesës së gjeneratës së parë të myslimanëve (as’habëve dhe tabi’inëve) dhe atyre që erdhën më vonë, e që ishte rruga e së vërtetës dhe udhëzimit. Ajo mbështetet te të praktikuarit e adhurimit, kthimit tek All-llahu, largimit nga stolitë dhe bukuritë e kësaj bote, të përmbajturit nga gjërat kah të cilat vrapon bota, siç janë: kënaqësia,

² “Et-tearruf li medhhebi ehli-t-tesavvuf”.

pasuria, pozita e të ngjashme si dhe izolimi nga njerëzit në vetmi me qëllim që t'i përkushtohet adhurimit.

Të gjitha këto ishin gjëra të rëndomta dhe praktikoheshin lehtë nga të gjithë as'habët dhe selefët (gjenerata e parë e myslimanëve), ndërsa pas përhapjes së garimit për këtë botë dhe vrapimit pas saj, në shekullin e dytë e më pas, njerëzit që i dhanë prioritet adhurimit dhe përkushtimit të tij u veçuan me emrin "sufi" dhe "mutesavif".³

Nëpërmjet kësaj, qartësohet se tesavufi si term nuk u përmend para shekullit të parë hixhri, megjithatë, kjo nuk do të thotë se ai ka burim joislam, por mund të thuhet se ai është vazhdim i atij zuhdi shembullor të cilin e praktikonte i dërguari (paqja qoftë mbi të).

Zuhdi i tij fisnik pasqyron llojin më të lartë të zuhdit që ngërthente në vete kulminacionin e adhurimit, adhurim ky i cili arriti deri në atë shkallë sa që i Dërguari i All-llahut ngrihej natën për të falur namaz dhe qëndronte në këmbë aq gjatë derisa i mpiheshin këmbët, e kur pyetej për këtë dhe i thuhej se përse po e mundonte veten kur All-llahu ia ka falur të gjitha mëkatet e mëhershme dhe të mëvonshme, ai u përgjigjej duke u thënë: "E përse të mos jem rob falënderues?!".

Së këndejmi, hasim disa hadithe të të Dërguarit (paqja qoftë mbi të), në të cilat e këshillon besimtarin që të mos mbështetet në këtë botë, të mos e marrë atë për vendbanim të tij të përhershëm, t'i shkurtojë shpresat, të mos e mashtrojë veten me jetë të gjatë, të jetë në këtë botë si një i huaj apo kalimtar rasti, pa iu larguar rrugës së drejtë burimore, duke mos e tepruar në zbatimin e adhurimeve me forma të rënda që e tejkalojnë kufirin e së mundshmes.

Andaj, nga besimtari kërkohet që të marrë nga kjo botë aq sa i nevojitet pa teprim dhe indiferencë, me kusht që nga zemra ta largojë dashurinë ndaj kësaj bote që të mos ia prishë e dëmtojë çiltërsinë e besimit. Këtë edukatë të përsosur e posedonin as'habët fisnikë (All-llahu qoftë i kënaqur me ta), jeta e të cilëve përbëhej prej diturisë, punës dhe luftës (ar. el-xihad) në rrugën e All-llahut. Ata ishin mu ashtu siç u përshkruan: "Asketë gjatë natës, kalorës gjatë ditës, i shihje në xha-

mi, nëpër tubime të dijes, në fushën e tregtisë dhe industrisë, me gratë dhe fëmijët e tyre, në fushën e betejës...".

Thënë shkurt, ajetet dhe hadithet mbi qortimin e kësaj bote dhe pohimin se ajo është arë e botës tjetër (ar. el-ahire) u drejtoheshin dhe u lexoheshin atyre mëngjes e mbrëmje, kurse ata i kuptonin në formën e saktë me ç'gjë edhe e merituan kënaqësinë e All-llahut.

Pas tyre, erdhi gjenerata e dytë (ar. et-tabi'un), e cila eci rrugës së tyre dhe ishte ndjekës shembullor i prijësve të tyre (as'habëve) për sa i përket kuptimit të ajeteve dhe haditheve si dhe kthimit të plotë kah All-llahu i Lartësuar.

Siç thotë imam Ahmed ibn Hanbeli e të tjerë: "Kur përmenden robërit e mirë, zbret mëshira", prandaj do t'i përmendim disa dijetarë eminentë të kësaj gjenerate:

1. Imami shembullor dhe i devotshëm Er-Rebi' ibn Huthejm – ishte një nga shokët më të devotshëm të Abdullah ibn Mes'udit, i cili shpeshherë i thoshte: "Po të kishte parë i Dërguari i All-llahut, do të donte".
2. Zotëriu i tabi'inëve dhe asketi i tyre Ebu Muslim el-Havlani – ishte njëri nga më të devotshmit në kohën e tij. Ka rënë dëshmor në tokën e bizantinëve duke luftuar në rrugën e All-llahut.
3. Imami i përkryer, personalitet i veçantë Mesruk ibn-ul-Exhde' – ishte një dijetar dhe asket i shquar. Falte namaz aq shumë derisa iu mpiheshin këmbët. Ishte një nga shokët e dalluar të Abdullah ibn Mes'udit.
Mori pjesë në betejën e Kadisijes, ku iu paralizua një dorë.
4. Imami i devotshëm El-Esved ibn Jezid en-Nah'i – konkurrent i Mesrukut në adhurim, dituri dhe bindje. Adhurimi i tij merret për shembull.
5. Asketi shembullor, zotëria i tabi'inëve Uvejs el-Kareni, për të cilin i dërguari i All-llahut (paqja qoftë mbi të) ka thënë: "Do t'ju vijë një person me emrin Uvejs ibn 'Amir së bashku me njerëzit e Jemenit..." dhe ka vazhduar: "... ai ka nënën, së cilës i bindet. Sikur të betohej në All-llahun, Ai do t'ia përmbushte atë". Më pas i tha

³ "El-Mukaddime" nga Ibn Halduni, 3/1063.

Umerit r.a. : “Nëse arrin t’ia kërkosh të bëjë lutje për ty, atëherë bëje këtë”.⁴

6. Imami i shquar, fekih, muxhtehid, asket shembullor El-Hasen el-Basri - ishte zotëria i kohës së tij për nga dituria, puna dhe adhuri-mi.

Këtu hyjnë edhe shumë të tjerë, të cilët u dalluan me zuhdin e tyre të mrekullueshëm, largimin nga bukuritë dhe stolitë e kësaj bote mashtruese, pa ia ndaluar vetes gjërat e mira, ngase “zuhdi”, siç thotë El-Hasen el-Basri “nuk është të ndaluarit e hallallit e as të shkapërderdhurit e pasurisë, por të qenit i sigurt në atë që gjendet në dorën e Zotit më tepër sesa në atë që gjendet në dorën tënde si dhe të qenit i kënaqur me shpërblimin e fatkeqësisë kur të të godasë më tepër sesa sikur po të mos të kishte goditur fare.”⁵

Pas këtyre, erdhi gjenerata tjetër, e cila u njoh me zuhd dhe devotshmëri. Këta u bënë të njohur me emrin “zahidë” dhe “abidë” (adhuruesë). Ndodhi kjo në shekullin e dytë hixhri dhe, si duket, shkaktari i paraqitjes së këtij grupi ishte gjendja sociale dhe politike që çoi deri tek animi i disa myslimanëve kah kjo botë dhe vrapimi pas kënaqësive të saj, andaj edhe reaksioni i disave ishte largimi total nga ajo. Në vazhdim do t’i përmendim disa dijetarë të njohur të kësaj periudhe:

1. Imami i shkëlqyer Muhammed ibn Vasi’ (ka vdekur rreth vitit 120 hixhri) – njëri nga dijetarët e shquar të kohës. Ishte i devotshëm dhe asket.
2. Malik ibn Dinar (ka vdekur në vitin 127 hixhri) – ishte njëri nga më të devotshmit në kohën e vet dhe i besueshëm në hadith.

⁴ Transmeton Muslimi në kapitullin “Fedailu-s-sahabe”, nr. 225.

⁵ Ibn-ul-Kajjim el-Xhevziye e citon këtë në veprën e tij “Medarixhu-s-salikin”, 2/13 dhe shton: “Kjo është fjalja më përmbledhëse dhe më e bukur lidhur me zuhdin”. Imam Ahmed ibn Hanbeli thotë: “Zuhdi është tri llojesh:

1) Largimi nga ajo që është e ndaluar (haram) – është zuhdi i njerëzve të rëndomtë;
2) Largimi nga tepricat që janë të lejuara (hallall) – është zuhdi i njerëzve të veçantë;
3) Largimi nga çdo gjë që të largon nga All-llahu – është zuhdi i gnostikëve (njohësve);
Mbi jetëshkrimin e këtyre personaliteteve, shih: “Sijeru a’lami-n-nubela”, si dhe librin “Zuhdi i tetë tabi’inëve” nga Alkame ibn Mirthed.

3. Safvan ibn Sulejm (ka vdekur në vitin 132 hixhri) – imam Ahmedi, për të, thotë: “Ai ishte njeriu, me fjalët e të cilit kërkohet ilaçi dhe me përmendjen e të cilit zbriste shiu”. Safvani, All-llahu qoftë i kënaqur me të, falte në tavan gjatë dimrit që të mos i vijë gjumi, sa kohë që ia ka dhënë besën All-llahut se nuk do të bjerë në shtrat derisa të takohet me Të.
4. ‘Ata es-Selimi (ka vdekur rreth vitit 140 hixhri) – dyzet vjet qëndroi i shtrirë në shtrat dhe nuk u ngrit prej tij nga frika që kishte ndaj All-llahut.
Nuk dilte jashtë, ndërsa abdest merrte në shtrat. Kur qante, qante tre ditë e net pa ndërprerë.
5. Kurz ibn Vebre - falte namaz derisa i mpiheshin këmbët. Përmbahet nga ushqimi, ashtu që qëndronte i uritur ditë të tëra. Ka banuar në Xhurxhan, qytet në të cilin kishte hyrë si luftëtar në rrugën e All-llahut. Edh-Dhehebi, në jetëshkrimin e tij, thotë: “Të këtillë ishin asketët dhe të devotshmit e gjeneratës së parë, njerëz që kishin frikë dhe përlusë, adhurim dhe thjeshtësi. Nuk vraponin pas dynjasë dhe stolive të saj, nuk u thellonin në shprehjet e definicionet që i shpikën të mëvonshmit, siç janë, bie fjala: “el-fena” (shkrirja) *, “el-mahv” (shlyerja), “el-istilam” (shkulja), “el-ittihad” (bashkimi e njësimi), terme këto, prej të cilave janë të pastër dijetarët e mëdhenj”.⁶
6. Habib el-’Axbemi - asketi i Basrës dhe i devotshmi i saj. Ishte njeriu, lutja e të cilit pranohej nga ana e All-llahut të Lartësuar dhe posedonte disa mrekulli.
7. Rabi’a el-’Adevijje (ka vdekur rreth vitit 135 hixhri) – grua e devotshme dhe e përlurur. Falte namaz gjithë natën, ndërsa kur agonte, bënte një sy gjumë e pastaj thoshte: “O shpirt, edhe sa do

* “el-fena”, apo “fena fi-l-lah” – shkrirja në Zotin, gjegjësisht anihilimi i vetvetes – paraqet teorinë e sufive mbi zhytjen totale e ekzistenciale në Qenien e Zotit. Njëkohësisht, paraqet shkallën më të lartë shpirtërore në rrugën e përsosmërisë së një sufiu, rrugë kjo, e cila gjoja arrihet përmes gradave të caktuara shpirtërore (ar. el-mekāmāt) si dhe përmes gjendjeve të caktuara shpirtërore (ar. el-hālāt). (vër. e përkthyesit).

⁶ “Sijeru a’lami-n-nubela”, 6/84.

të flesh dhe kur do të ngrihesh? Po afrohet koha kur do të biesh në gjumë, nga i cili do të ngrihesh ditën kur do të jepet llogaria”.

8. Vehb ibn-ul-Verd el-Mekki (ka vdekur në vitin 153 hixhri) – ishte një njeri mjaft i devotshëm, asket i njohur e i shquar. Sufjan eth-Thevri, kur e mbaronte ligjëratën e tij që e mbante në xhami, u thoshte të pranishmëve: “Ngrihuni të shkojmë tek Ibn-ul-Verdi”. Ai ishte betuar se All-llahu nuk do ta shihte kurrë duke qeshur me ndonjë njeri deri në vdekje. Në çastet e fundit të jetës, e dëgjuan duke thënë: “E përmbushe premtimin Tënd ndaj meje, ndërsa unë nuk e përmbusha premtimin tim ndaj Teje”.
9. Ibrahim ibn Ed’hem (ka vdekur në vitin 162 hixhri) – zotëria i të devotshmëve dhe prijësi i tyre. Sufjan eth-Thevri duke folur për të, ka thënë: “Ibrahim ibn Ed’hemi i ngjante Ibrahimit a.s., e sikur të ishte në mesin e as’habëve, do të ishte një njeri i virtytshëm”.
10. Davud et-Ta’i (ka vdekur në vitin 165 hixhri) – ka studiuar hadithin dhe fikhun, e më pastaj iu përkushtua adhurimit. Abdullah ibn-ul-Mubarek thoshte: “Athua, ekziston ndonjë metodë tjetër pos asaj të cilën e praktikonte Davud et-Ta’i!”
11. Shekik el-Belhi (ka vdekur në vitin 194 hixhri) – imami i shquar, dijetari i Horasanit. Ishte i devotshëm dhe përherë i angazhuar me adhurim. Ka marrë pjesë, po ashtu, në betejat e ndryshme, ku edhe ra dëshmor në njërën prej tyre.

Pas kësaj periudhe, u shfaq termi “et-tesavvuf” siç u përmend edhe më herët dhe me të drejtë mund ta quajmë “tesavufi sunit”, i cili përbëhej nga sheriatit dhe hakikati. Sheriatit, i cili e përkrahte hakikatin dhe hakikati, i cili bazohej në sheriat, kështu që sheriatit ishte sikurse druri, ndërsa hakikati – frutet e tij. Pikërisht kjo e shtyri Ibn Haldunin të deklaronte:

“Disiplina e sheriatit është ndarë në dy degë: Njërën prej tyre e drejtonin fukahatë, përkatësisht dijetarët e legjislacionit, të cilët merrreshin me studimin e parimeve dhe dispozitave të përgjithshme islame, siç janë: adhurimet, zakonet dhe dënimet, ndërsa dega tjetër drejtohej nga dijetarë që merrreshin me edukimin dhe kalitjen e shpirtit, ku për-

fshiheshin: sakrifica, llogaritja e vetvetes, mbështetja në All-llahun, përmendja e Tij, frika dhe shpresa, e shumë të tjera”.

Disa nga personalitetet eminentë të kësaj periudhe janë: Ma’ruf el-Kerhi, Serri es-Sekati, El-Harith el-Muhasibi, Bishr ibn-ul-Harith el-Hafi, Sehl ibn Abdullah et-Tusteri, Jahja ibn Muadh er-Razi, Hatim el-Esamm, El-Xhunejd el-Bagdadi, e shumë të tjerë, disa prej të cilëve i përmend Ebu Sa’d el-Malini në librin e tij “Kitabu-l-erbe’un fi shu-juhi-s-sufijje”. Ky drejtim shfaqet qartë në shekullin e tretë hixhri, ndërsa e arrin kulminacionin e vet në shekullin e pestë me imamin e shquar Ebu Hamid el-Gazali. Dijetarët e kësaj periudhe ia dolën t’i bashkojnë diturinë dhe punën⁷, e s’ka dyshim se të mësuarit e haditheve dhe fikhut është domosdoshmëri, të cilën duhet ta praktikojë çdo mysliman, posaçërisht një sufi, në mënyrë që të jetë syçelë dhe i udhëzuar, përndryshe do t’i ekspozohet shtrembërimit dhe devijimit. Për këtë arsye, Serri es-Sekati i kishte thënë njëherë Xhunejdit: “All-llahu të bëftë nxënës të hadithit – sufi, e mos të bëftë sufi – nxënës të hadithit.

Ebu Talib el-Mekki, duke e komentuar këtë fjali, në veprën e tij “Kut-ul-kulub” (Ushqimi i zemrave), thotë: “... do të thotë – kur të fillosh të studiosh shkencën e hadithit, me të gjitha degët e tij, e pastaj orientohesh kah adhurimi dhe zuhdi, do të përparosh në shkencën e tesavufit dhe do të bëhesh sufi i vërtetë dhe shembullor. Po, nëse, në fillim i përkushtohesh adhurimit dhe devotshmërisë, atëherë do të largohesh nga nxënja e dijes, kështu që, si rezultat i kësaj, do të jesh ose i devijuar ose i humbur për arsye të paditursisë tënde dhe mosnjohjes së parimeve dhe dispozitave burimore.

Së këndejmi, gjëja më e mirë është t’i kthehesh “ditursisë së jashtme” dhe librave të hadithit, pasi që kjo paraqet burimin nga i cili kanë lindur të gjitha shkencat dhe disiplinat tjera. Sa kohë që ti merresh me degën e po e lë anash rrënjën, ndërsa të parët kanë thënë: “Shumica

⁷ Këtë e dëshmon edhe Ibn Tejmije, shiko: “El-Fetava”, 10/516.

nuk e shijoi arritjen e caktuar final për shkak të shpërfilljes së parimeve burimore (librave të hadithit dhe disiplinave bazë të këtij lloji).⁸

Shpjegimi i autorit rreth lidhshmërisë ndërmjet shkencës së fikhut dhe tesavufit vë në pah një argument të qartë sa i përket kushtëzimit për nxënien e diturisë para hyrjes në tesavuf, në mënyrë që ta pengojë njeriun nga disa veprime të cilat mund ta nxjerrin nga rrethi i Islamit. Sufitë, siç thotë Ebu Nasr et-Tusi, pajtohen me fukahatë dhe dijetarët e hadithit lidhur me besimin e tyre. Ata i pranojnë shkencat dhe disiplinat e tyre dhe nuk i kundërshtojnë në kuptimet, nocionet dhe konceptet e tyre, kur është në pyetje largimi nga risitë dhe ndjekja e pasioneve. Ata pajtohen dhe janë dakord me ta në të gjitha shkencat e tyre.⁹

El-Gazali thotë: “Kush hyn në tesavuf pa pasur paraprakisht dituri, rrezikon vetveten”. Ez-Zebidi, duke e sqaruar këtë fjalë të tij, thotë:

“... Do të thotë, e vë veten në rrezik dhe shkatërrim, dhe njeriu i tillë nuk do të shpëtojë kurrë, ngase tesavufi paraqet pastrimin e shpirtit dhe largimin e tij nga veset e këqija, gjë që arrihet me anë të nxënies së diturive të sheriatit, të cilat ia ndriçojnë rrugën e tij”.

Sa u përket fjalëve që transmetohen nga disa mutesavifë* lidhur me të përmbajturit nga dituria dhe mjaftueshmëria pa të, siç është, bie fjala: “Ne e marrim diturinë tonë nga i Gjalli (d.m.th. All-llahu), i cili nuk vdes, ndërsa ju e merrni atë nga i gjalli, i cili vdes”, apo fjala e një tjetri: “Dituria është pengesë ndërmjet zemrës dhe All-llahut të Lartësuar”, ose një tjetër i cili kishte deklaruar si vijon: “Nëse e sheh sufiun që merret me “Na ka njoftuar ...”, dhe “Na ka transmetuar...”, laji duart nga ai (dije se nuk ka gjë prej tij)”, Ibn Kajjimi është përgjigjur në to duke thënë:

“Ai që i flet këto fjalë dhe të tjera të këtij lloji, nuk është tjetër veçse një i paditur, i cili arsyetohet për shkak të paditurisë së tij ose një i

devijuar dhe i shtrembëruar që e pranon gabimin e tij, meqë, po të mos ekzistonte “Na si ai, asgjë prej Islamit”.¹⁰

Në këtë periudhë mund të vërehet edhe një dukuri, e ajo është të folurit mbi sufizmin duke qenë si një grupim apo bashkësi, andaj edhe hasen fjalët, sikurse: “Doktrina jonë”, “Dituria jonë”, “Rruga jonë”, ... Xhunejdi thotë: “Dituria jonë bazohet në hadithin e të Dërguarit (paqja qoftë mbi të)”. Po ashtu, ai ka thënë: “Doktrina jonë mbështetet në Kur’an dhe sunet”. Sehl ibn Abdullah et-Tusteri ka thënë: “Parimet tona janë shtatë ...”, ndërsa Ibrahim ibn Muhammed en-Nasr Abadhi thotë: “Bazat e kësaj shkolle janë: “Të lidhurit pas Kur’anit dhe sunetit, të larguarit nga pasionet dhe risitë, të mbështeturit te dijetarët dhe të pasuarit e selefëve (gjeneratës së parë të myslimanëve)”. Ebu Sulejman ed-Darani thotë: “Shpeshherë ndodh të dëgjoj ndonjë rrëfim nga sufite, mirëpo nuk e pranoj pa dy dëshmitarë të drejtë nga Kur’ani dhe suneti”.

Në këtë periudhë, po ashtu, nisin të shkruhen libra të ndryshëm, të cilat shtjellojnë tematika të tilla si: sëmundjet e shpirtit dhe mënyra e mjekimit të tyre, koncentrimi dhe përqendrimi te sinqeriteti, mbështetja në All-llahun, abstinenca e gjëra të tjera të këtij lloji.

Këtu hyjnë librat që janë shkruar nga El-Harith el-Muhasibi, Ebu Talib el-Mekki, El-Hakim et-Tirmidhi, e shumë të tjerë të cilët e përzien tesavufin me hadithin dhe dogmatizmin, gjë që çoi deri te përme ndja e gjërave që bien ndesh me sheriatin.¹¹

Nga sa u tha, mund të nxirren dy përfundime:

Përfundimi i parë: Shfaqja e një lloji teprimi në adhurim dhe largimi nga gjërat e lejuara, gjë që ka qenë e pranishme po ashtu edhe te disa dijetarë në kohën e tabi’inëve dhe gjeneratave të tjera që erdhën pas tyre. Përkitazi me këtë, imam Edh-Dhehebi, thotë:

“Rruga shembullore është ajo muhamedane, e që është të përdorurit e gjërave të mira e të lejuara duke mos e tepruar, pasi që i Dërguari

⁸ “Kut-ul-kulub”, 2/125.

⁹ “Kitab-ul-leme”, fq. 28.

* “mutesavif” – pasues dhe ithtar i tesavufit. (vër. e përkthyesit). njoftuar ... “ dhe “Na ka transmetuar ...”, nuk do të arrijnë tek ky dhe të tjerët.

¹⁰ “Medarixhu-s-salikin”, 2/376.

¹¹ Shih: “Mexhmu’u-l-fetava” nga Ibn Tejmije, 10/361. Po ashtu, shiko ç’thotë lidhur me hadithet dhe rrëfimet e ndryshme të cilat përmenden në librat e sufive, 10/680.

(paqja qoftë mbi të) nuk ka rekomanduar murgërinë, as lidhjen jashtë-martesore, e as agjërimin e përvetshëm”.¹²

Kështu e kuptoi zuhdin gjenerata e parë e myslimanëve, me një kuptim të vërtetë e të çiltër, andaj ata nuk e tepruan e as nuk e mbingarkuan veten. I këtillë ishte zotëria i tabi’inëve, Se’id ibn-ul-Musejeb – i njohur për diturinë, vlerën dhe devotshmërinë e tij, të cilit shërbëtori i tij, Burdi, i kishte thënë njëherë: “Nuk kam parë ndonjëherë vepër më të mirë e më të lavdëruar nga ajo që bëjnë ata” (sufitë, vër. e përkthyesit). Se’idi ia ktheu: “E çka bëjnë ata?” Shërbëtori i tha: “E falin namazin e drekës, e më pas qëndrojnë në xhami duke falur derisa të afrohet koha e namazit të ikindisë”. Pas këtyre fjalëve të shërbëtorit, Se’idi i tha: “I mjeri ti, o Burd. Pasha All-llahun, nuk është ky adhurim. A e di, ç’është adhurimi? Adhurimi është meditimi dhe largimi nga ndalesat e All-llahut”.¹³

Pikërisht për shkak të këtij stërhollimi dhe teprimi, imam Ahmedi dhe të tjerët kishin antipati ndaj librave, të shkruar nga El-Harith el-Mahasibi dhe pasuesit e tij, andaj edhe parapëlqeu ta emërtojë librin e tij të suptilitetit me emrin “Ez-Zuhd”, duke u mbështetur tërësisht në Kur’an dhe sunet, në transmetimet lidhur me të dërguarit e All-llahut, nga Ademi deri te Muhammedi (paqja qoftë mbi të gjithë ata), pastaj në rrugën e as’habëve dhe tabi’inëve, duke mos hyrë në dyshime e halucinacione të ndryshme. Po t’ia shtojmë kësaj atë që e bënë para tij dijetarët e hadithit, siç ishin: Abdullah ibn-ul-Mubarek, Veki’ ibn-ul-Xherrah, Hennad ibn-us-Serri, Muhammed ibn Fudajl ibn Gazvan, Esed ibn Musa, e shumë të tjerë, të cilët shkruan vepra në këtë temë me po të njëjtin emër, do të qartësohet enigma e cila vë në pah para-

¹² “Sijeru a’lami-n-nubela”, 2/89.

¹³ Këtë e transmeton Ibn Sa’di në “Et-Tabekatu-l-kubra”, 5/135. Po ashtu e transmeton edhe Ibn-ul-Xhevzi në veprën e tij “Dhemmu-l-heva”, fq. 150. Njëherë, halifi Ebu Xha’fer el-Mensur e kishte lavdëruar Amr ibn Ubejdin – një mu’tezili – për zuhdin e tij, gjë të cilën Ibn Kethiri, në veprën e tij “El-Bidaje ve-n-nihaje” (Fillimi dhe mbarimi) e komentoi me fjalët: “Zuhdi nuk është provë për vlerën a virtutin e një personi, pasi që disa priftërinj mund të posedojnë zuhdin e tillë, të cilin nuk mund ta përballojë as Amri e as shumica e myslimanëve”.

pëlqimin e adhurimit të rekomanduar, veçoria e të cilit është mesatarja dhe moskundërshtimi i rrugës së drejtë.

Ibn-ul-Xhevzi, lidhur me këtë, sjell një mendim dhe thotë:

“I vështrova me kujdes veprimet dhe gjendjet e sufive, kështu që shumicën e tyre i gjeta në kundërshtim me sheriatin, disa prej tyre nga mosnjohja e sheriatit, e disa të tjerë nga risia që lindi nga mendja ... Nga historia, është e njohur mirë sasia e pasurisë që ka lënë Zubejri, Abdurrahman ibn Avfi dhe shumë të tjerë. Aliu r.a. ka lënë pas vetes dyzet mijë dinarë, Abdullah ibn Mes’udi – nëntëdhjetë mijë, Lejth ibn Sa’di fitonte çdo vit njëzet mijë, Sufjan eth-Thevri bënte tregti me para, ndërsa Ibn Mehdi fitonte çdo vit dymijë dinarë. Martesa me më shumë gra e robëresha ishte punë e lejuar dhe e lavdëruar, e kurrsesi e qortuar. I dërguari (paqja qoftë mbi të) kishte disa gra e robëresha, e po ashtu edhe as’habët (shokët) e tij, shumica e të cilëve kishin nga disa gra. Aliu r.a. kishte katër gra dhe shtatëmbëdhjetë robëresha, ndërsa i biri i tij, Hasani r.a. ishte martuar me rreth katërqind gra ...

I dërguari (paqja qoftë mbi të) hante çka gjente. Kur kishte pranë mishin, e hante. Atij i pëlqente mishi i pulës, të cilin e hante me ëndje, ndërsa gjërat më të dashura për të ishin ëmbëlsirat dhe mjalti. Nuk ka ndodhur asnjëherë që të përmbahej nga ndonjë ushqim i lejuar ...”¹⁴

Përfundimi i dytë: Shfaqja e termeve të caktuara, në të cilat vërehet paqartësia, konfuzioni dhe fshehtësia, andaj edhe secili i komentonte ashtu siç dëshironte. Pikërisht në këtë periudhë lindin komentime të llojllojshme rreth termeve të tilla, si: “el-fena” (shkrija), “el-beka” (përhershmeria), “es-sahv” (vetëdija), “el-mahv” (shlyerja), “et-texhrid” (zhveshja), e të tjera¹⁵, terme këto, të përgjithshme, të cilat ngërthejnë në vete të vërtetën dhe të shtrembrën. Kështu, bie fjala, shprehja “el-fena” (shkrija) mund të simbolizojë një pikëpamje të shtrembër, e që është bindja se nuk ekziston askush përveç All-llahut të Lartësuar, dhe se çdo gjë pos Tij nuk posedon ekzistencë të vërtetë, gjë që paraqet doktrinën, të njohur me emrin “Uniteti i Qenësisë” (ar. vahdetu-l-

¹⁴ “Sajdu-l-hatir”, fq. 25-27.

¹⁵ Shiko shpjegimin e këtyre termeve në veprën “Er-risaletu-l-kushejrije”.

vuxhud)*, andaj “el-fena”, në këtë aspekt, i ngjan ideve të ateistëve. Kjo shprehje, gjithashtu, ngërthen në vete bindjen dhe tendencën që njeriu “të fshehet” nga njerëzit dhe krijesat e tjera dhe të mos shohë asgjë tjetër përveç All-llahut, gjë e cila çon deri te humbja e ndjenjës dhe mosdija, andaj si rezultat i kësaj, njeriu, nuk arrinë ta dallojë mikun ndërmjet vetes dhe një tjetri, kështu që bindja e këtillë, shumë lehtë mund ta çojë njeriun në mosbesim.

Këtë e ka potencuar edhe imam Edh-Dhehebi, duke thënë: “Shprehje të tilla si “el-fena” dhe “el-beka” janë dokrra të sufive, të cilat i shpikën disa prej tyre, kështu që me to filluan të merren, përveç sufive, edhe shumë ateistë e heretikë. Si rrjedhim, sufite filluan të deklaroin se çdo gjë përveç All-llahut është e kotë dhe e përkohshme, se All-llahu i Lartësuar është i përhershëm, se Ai është gërshetimi i qenieve të krijuara dhe se nuk ekziston asgjë pos Tij. Një poet i tyre thotë:

*“Ti nga gjithësia fare nuk ndryshon
Gjithësia je Ti vetë, aspak nuk dallon.”*

Apo një tjetër, i cili thotë:

*“Asgjë pos All-llahut nuk gjallëron
dhe kurrëgjë përveç Tij nuk ekziston”.*

Vështroje me kujdes këtë shtrembërim dhe devijim. Përkundrazi, çdo gjë pos All-llahut është e krijuar dhe ekziston. All-llahu i Lartësuar thotë: **“... Ai (All-llahu) ka krijuar qiejt dhe tokën për gjashtë ditë... ”** (El-A'raf: 54). Ndonëse sufite e vjetër me këtë term - “el-fena” – kishin për qëllim të harruarit e krijesave dhe të larguarit nga to, shkrirjen e shpirtit nga preokupimi me gjithçka tjetër pos All-llahut,

* “Vahdetu-l-vuxhud” – paraqet teorinë mbi “Unitetin e Qenësisë”, thelbi i së cilës qëndron në bindjen se asgjë nuk posedon ekzistencë reale pos All-llahut. Ndjekësit e kësaj teorie e shihnin çdo objekt si gërshetim dhe personifikim i Zotit. Pikërisht kjo e shtyri njërin prej tyre të deklaronte: “Në xhennet nuk ka asgjë përveç All-llahut”. Sufite e komentuan këtë doktrinë në dy mënyra. Disa prej tyre e sqaruan atë me fjalët: “All-llahu personifikon shpirtin, ndërsa bota – trupin e atij shpirti, andaj All-llahu është çdo gjë”. Disa të tjerë deklaruan se: “Gjithçka që ekziston nuk paraqet ekzistencë reale pos ekzistencës së All-llahut, kështu që All-llahu është çdo gjë”. (vër. e përkthyesit).

prapëseprapë nuk iu pranohet ky pretendim i tyre, meqë, All-llahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij na kanë urdhëruar “ta preokupojmë veten” me krijesat, t'i vështrojmë e t'i hulumtojmë, si dhe ta madhërojmë Krijuesin e tyre.

All-llahu i Lartësuar thotë: **“A nuk i kanë parë ata mbretëritë e qiejve dhe të tokës dhe tërë atë çka ka krijuar Ai ... ”** (El-A'raf : 185).

Në një ajet tjetër, gjithashtu, thuhet: **“Thuaj, shikoni çka ka në qiej dhe në tokë! ... ”** (Junus: 101). I dërguari (paqja qoftë mbi të) ka thënë:

“Dy gjëra i kam të dashura nga kjo botë: gratë dhe aromat e këndshme, ndërsa kënaqësia e zemrës sime është namazi”.*

I Dërguari (paqja qoftë mbi të) e donte Aishen r.a., e donte Usamen, i donte dy nipërit e tij, e donte ëmbëlsirën dhe mjaltin, e donte malin Uhud, e donte vendlindjen e vet, i donte ensarët dhe shumë gjëra tjera të panumërta, për të cilat ka nevojë gjithmonë një besimtar”.¹⁶

Imam Edh-Dhehebi, në librin e tij “Tarihu-l-islam” (Historia e Islamit), në fragmentin mbi jetëshkrimin e imamit dhe dijetarit të shquar Ebu Abdullah Muhammed ibn Ali, i njohur me nofken El-Hakim et-Tirmidhi, midis tjerash flet edhe për devijimet e sufive dhe thotë:

“... nuk di çka të them, përveç se e lus All-llahun të më mbrojë nga devijimet e sufive, i mbështetem All-llahut nga shtrembërimet e sufive filozofë, të cilët pamjen e jashtme e stolisën me principet e Islamit, ndërsa në brendi punojnë për shkatërrimin e tij, i komentuan parimet e Islamit me simbole, aluzione e alegori të mjegullta, me definicionet e tyre të zbehta, me sjelljen dhe mënyrën e tyre të çuditshme si dhe me shijet e tyre të thata, nga të cilat, si rrjedhim, lindën terme të tilla, si: “el-fena”, “el-beka”, “el-mahv” e të tjera. All-llahu i Lartësuar thotë:¹⁶

“Dhe vërtet, kjo është rruga ime e drejtë, andaj ndiqeni atë ... ”, rruga – këtu do të thotë suneti i të Dërguarit (paqja qoftë mbi të). Më

* Hadithin e transmetojnë En-Nisai, Hakimi dhe Et-Taberani.

¹⁶ “Sijeru a'lami-n-nubela”, 15/393.

pastaj thotë: “...dhe mos ndiqni rrugë të tjera, pasi ato do t’ju ndajnë e do t’ju largojnë nga Udhë e Tij”. (El-En’am: 153). Kurse, El-Hakim et-Tirmidhi, ruana Zot, nuk i përket këtij grupi të sufive. Ai ishte dijetar i hadithit, shembull i pasimit dhe gojëmbël, ndonëse tek ai vërehen disa mangësi të vogla, gjë që është e zakonshme te dijetarët e mëdhenj, mirëpo kjo nuk e pakëson fare vlerën e tij, pasi që, nga çdonjëri merret fjala po edhe refuzohet përveç se nga i Dërguari i pagabueshëm (paqja qoftë mbi të)¹⁷, siç kishte thënë dijetari i njohur, imam Maliku r.a.”.

Nga sa u tha, nënkuptohet se tesavufi përmban gjëra të lavdëruara siç përmban edhe gjëra të qortuara, njëlloj sikurse sufitet*, për të cilët Ibn Tejmije thotë: “Ata janë njerëz, në grupin e të cilëve ka që ia qëllonjë, po ka edhe që gabonjë, njësoj sikurse ndodh edhe te të tjerët. Ata nuk mund të konsiderohen më të ngritur se as’habët dhe tabi’inët, dhe asnjëri prej tyre nuk është i pagabueshëm në tërë atë çka thotë përveç të Dërguarit (paqja qoftë mbi të)”¹⁸.

Pas kësaj, tesavufi hyn në një periudhë që konsiderohet një nga periudhat më të rrezikshme, e që mund të quhet, kushtimisht, “tesavufi filozofik” apo i ngjashëm me të. Ishte ky një lloj tesavufi, pasuesit e të cilit ndoqën një rrugë, të përzier me shijet e tyre sufiste dhe idetë e tyre mendore a logjike. Kjo lindi si pasojë e ndikimit të tyre me rrymat dhe filozofitë e huaja që hynë në Islam, siç ishin: filozofia indiane, greke, persiane, hebraike dhe krishtere.

Pjesë e Islamit, tashmë, u bënë edhe koncepte të mjegullta e të turbullta, si: “el-hulul” (inkarnacionizmi)*, “el-ittihad” (bashkimi me

¹⁷ “Tarihu-l-islam” (Historia e Islamit, jetëshkrimi i El-Hakim et-Tirmidhi), fq. 278.

* Këtu vlen të përmendet fjala e Ibn Hazmit, dijetar i njohur nga Endelusi, i cili në veprën e tij “El-milel ve-n-nihal” (Sektet dhe grupacionet), 4/226 përmend një grup të sufive, të cilët kishin deklaruar:

“Kush arrin gradën më të lartë të përsosmërisë, lirohet nga të gjitha obligimet fetare siç janë: namazi, agjërimi, zekati e të tjera dhe të tillit i lejohen të gjitha ndalesat, duke përfshirë këtu: prostitucionin, alkoolin e të ngjashme”. (vër. e përkthyesit).

¹⁸ El-istikame, 1/163.

* “el-hulul” – paraqet teorinë mbi “Inkarnacionizmin”, respektivisht gërshetimin e njeriut me Zotin, botëkuptim ky i cili e sheh njeriun si mishërim të Zotit. Ithtarët e kësaj teorie konsideronin se njeriu, duke qenë vepër e Zotit, i cili në vete përmban një frymë të Tij,

Zotin), “vahdetu-l-vuxhud” (Uniteti i Qenësisë) e të tjera. Pionier i këtyre pikëpamjeve ishte El-Hal-laxhi*, i cili në fund vritet për shkak të

në fund të fundit, pasqyron vetë Atë, kështu që njeriu dhe Zoti janë po e njëjta gjë. Këtë më së miri e ilustron deklarata e Bajezid el-Bistamit, i cili pati thënë: “O Ti, që je unë, tashmë jam bashkuar me Ty. I lartësuar qofsha, sa i madh që jam!” Inkarnacionizmi, si i tillë ka mjaft ngjashmëri me panteizmin. (vër. e përkthyesit)

* El-Husejn ibn Mensur el-Hal-laxh – (vdiq më 309 hixhri / 922 të e.r.) – konsiderohet njëri prej figurave më misterioze në tërë historinë e sufizmit. Udhëtoi nëpër shumë vise të botës, duke përfshirë Indinë dhe Persinë, si dhe vizitoi një numër të madh të kryeqendrave të botës islame, ku, më në fund zgjodhi për vendqëndrim Bagdadin, kryeqytetin e atëhershëm të halifatit islam. Koha, kur jetoi el-Hal-laxhi, ishte një kohë, në të cilën dominonin kulturat dhe civilizimet e huaja, si rezultat i zhytjes në studimin e filozofisë greke e romake nga ana e arabëve, të cilët edhe përkthyen një pjesë të madhe të veprave kapitale të filozofisë. Aty mbizotëronin edhe ideologji, doktrina e drejtime të ndryshme. Duke marrë parasysh tërë këtë, el-Hal-laxhi, i cili “përfitoi dituri” nga shumë burime, ndoqi një rrugë e cila në fund e hodhi në greminë. Ishte pikërisht el-Hal-laxhi ai që e shtjelloi teorinë mbi “Inkarnacionizmin” (ar. el-hulul), ndonëse para tij pati edhe të tjerë që shprehnin thënie të ndryshme lidhur me të. Këtë teori të tij, el-Hal-laxhi e zbërtheu në poezitë e tij të shumta, të cilat s’përmbajnë gjë tjetër pos herezi, rebelim dhe mosbesim. Kështu, në njërin nga poezitë e tij, el-Hal-laxhi thotë:

“Shpirti Yt është përzier me timin,
mu ashtu si alkooli kur me ujin përzihet.

Kur diçka të prek Ty, më prek edhe mua,
Vetja jote në timen në çdo gjendje shndërrohet”.

Sufiu i njohur el-Xhunejdi, i cili një kohë ishte shoqëruar me të, u mundua ta bindë që t’i largohet teorisë së tij çoroditëse, por pa sukses.

Këtë ideologji të tij mistike të cilën e përhapte me vargjet dhe shprehjet e tij “figurative”, el-Hal-laxhi e pagoi me kokë. Thënia e tij blasfemuese “Unë jam e vërteta” (ar. ene-l-hakk), respektivisht “Unë jam Zoti” (ar. ene-ll-llah), shprehte qarë devijimin e tij. Si pasojë e tërë kësaj, el-Hal-laxhi, tashmë një sharlatan i dyshimtë, akuzohet për ateizëm dhe rebelizëm. Pas zbulimit të disa provave mbi herezinë e tij nga ana e hetuesve policorë, el-Hal-laxhi i dorëzohet organeve të drejtësisë. Gjykata Supreme islame e asaj kohe, në krye të së cilës qëndronin dijetarët eminentë të kohës, e dënoi me vdekje. Tetë vjet qëndroi në burg dhe më pas iu shqiptua dënimi që parashihte prerjen e dorës, pastaj këmbës, heqjen e kokës dhe më në fund djegien e trupit. Ndodhi kjo në vitin 309/922, në kohën e halifit abasid, el-Muktedir. El-Hal-laxhi ishte dhe mbeti një enigmë, e cila ngjall polemika të zjarra edhe sot e kësaj dite. Derisa bashkëmendimtarët e tij, në një anë, e mbrojnë me ngulm teorinë e tij duke e ngritur el-Hal-laxhin në shkallën e shenjtërit, në anën tjetër pjesa dërrmuese e dijetarëve islamë e konsiderojnë me të drejtë reneгат dhe ateist. Shkroi mjaft libra, nga të cilat nuk mbeti asnjë pos “Kitabu-t-tavasin”, në të cilin shtjelloi ideologjinë e tij të inkarnacionizmit. Me jetën dhe veprimtarinë e tij

ideve të tij çoroditëse, të cilat s'janë tjetër pos mosbesim dhe rebelim. Rugës së tij kanë ecur personalitete, si: Ibn 'Arebi*, Ibn-ul-Farid, Ibn

është marrë orientalisti francez, Luis Massignon. Për më tepër shih: Dr. Zekki Mubarek "Et-tesavvuf el-islamij", vëll. I, fq. 155-161 si dhe Françesko Gabrijeli, "Arapaska književnost", fq. 203-206. (vër. e përkthyesit).

* Muhji-d-din ibn 'Arebi – (560-638 hixhri/1165-1240 të e.r.) – konsiderohet një nga personalitetet më të ngatërruara në tërë historinë e sufizmit. Ai duhet dalluar nga Ebu Bekr Ibn-ul-'Arebi (468-543 hixhri/1074-1148 të e.r.), dijetari i shquar nga Endelusi, autor i librave të njohur "Ahkamu-l-Kur'an" dhe "El-'avasim mine-l-kavasim". Mistiku nga Endelusi (Spanja e sotshme), i ashtuquajtur "evlija i fundit", po ashtu i njohur edhe me nofkat "esh-shejhu-l-ekber" si dhe "sultanu-l-'arifin", u lind në qytetin e Mursijes, në vitin 1165. Në moshën tetëvjeçare transferohet në Sevilje, ku jetoi deri në moshën tri-dhjetë e tetë vjeçare. Më pas, e lëshon Spanjën, për të udhëtuar në viset e ndryshme të lindjes. Fillimisht, e viziton Hixhazin, në të cilin qëndroi një kohë, ku edhe e kreu obligimin e haxhit në Meke. Më pas e viziton Egjiptin, Bagdadin, Mosulin dhe qendra tjera të rëndësishme të kohës për t'u vendosur përfundimisht në Damask, ku edhe ndërroi jetë më 1240.

Asokohe, nëpër xhamitë kryesore të qendrave islamike organizoheshin tubime dhe diskutime në të gjitha disiplinat fetare, andaj edhe vizita e tij e qendrave të ndryshme të botës islame dhe njohja me dijetarë të shquar të kohës, padyshim që i solli njohuri të gjerë në fushat dhe lëmenjtë e ndryshëm fetarë. Krahas kësaj, Ibn 'Arebi posedonte edhe njohuri të shumta mbi sufizmin, apo siç pëlqen të shprehet ai "përvoja dhe inspirime frymëzuese", të cilat paraqitnin vetëm fillimin e "ngritjes dhe përsosmërisë së tij shpirtërore", që u kurorëzua në fund me shpikjen e teorisë së "Unitetit të Qenësisë" (ar. vahdetu-l-vuxhud).

Ibn 'Arebi është autor i rreth katërqind librave, nga të cilat më të njohura janë: "El-futuhatu-l-mekkijje" (Zbulimet mekase), "Fususu-l-hikem" (Margaritarët e urtësisë), "Me-fatihu-l-gajb" (Çelësat e fshehtësisë), "Et-ta'rifat" (Definicione) si dhe "Divanu shi'r" (Përmbledhje poezish).

Vlen të përmendet fakti se Ibn 'Arebi i ndan njerëzit në dy kategori:

– Kategoria e njerëzve të rëndomtë, e cila duhet të merret ekskluzivisht me sheriatin dhe dispozitat lidhur me të dhe

– Kategoria e njerëzve të veçantë, e cila duhet të merret dhe preokupohet me hakikatin dhe me gradat e shkallët shpirtërore që kanë të bëjnë me të;

Pikërisht për këtë arsye, Ibn 'Arebi, siç cilësohet nga autorë të shumtë, bën pjesë në grupin e "sufive të rangut të lartë", respektivisht "Elita e sufive", e cila shkruante për aristokracinë, gjegjësisht për "njerëzit e veçantë", jo si shumica e dijetarëve të tjerë që shkruanin për "njerëzit e rëndomtë". Kjo do të thotë se Ibn 'Arebi konsideronte se ekzistojnë "disa tematika serioze" të cilat u referohen ekskluzivisht "njerëzve të posaçëm" dhe se vetëm ata janë të prirë të merren me to. Teorinë e tij të lartpërmendur, që e emëroi "Uniteti i Qenësisë" (ar. vahdetu-l-vuxhud), pikëpamja e së cilës është se Zoti ndodhet gjithkund dhe se çdo gjë është identifikim dhe manifestim i tij, Ibn 'Arebi e shtjelloi dhe e zbërtheu në librat e tij të shumta, që janë përplot me shprehje alegorike, tematika të zbehta, definicione blasfemuese dhe përfundime devijuese. Se sa të rrezikshme dhe

Seb'in, Abdu-l-kerim el-Xhili, Esh-Shihab es-Suhreverdi e shumë të tjerë.

Shejhu-l-islam, Ibn Tejmije thotë:

"Ibn 'Arebi dhe të tjerët që i ngjajnë atij, ndonëse pretendojnë se janë pjesë e grupit të sufive, ata nuk janë tjetër veçse pjesë e sufive filozofë dhe ateistë. Ata nuk hyjnë në grupin e sufive të ditur, aq më

devijuese janë idetë dhe pikëpamjet e tij, "le të dëshmojnë" dy kryeveprat e tij "El-futuhatu-l-mekkijje" dhe "Fususu-l-hikem", të cilat janë përkthyer edhe në gjuhën boshnjake, nga e cila gjuhë edhe janë marrë pjesët e shkëputura. Në veprën e parë të sapopërmendur, i gjejmë të shkruara edhe këto fjalë:

"... nga kjo kategori njerëzish bien dispozitat fetare ... " (Mekanska otkrovenja, fq. 124).

Ose në një vend tjetër ku thotë:

"O unë, Ai nuk është unë, e as unë nuk jam Ai. Po çka është ai?" (Vepra e cituar, fq. 273).

Gati në çdo faqe të këtij libri, lexuesi do të hasë në citate dhe thënie të tilla të turbullta, që janë tregues i qartë i devijimit të autorit. Sa për ilustrim, do t'i përmendim vetëm disa kapituj "figurativë" të librit: "Edhe rënia është ngritja" (fq. 92-102), "Xheza – ekstazë e vërtetë" (fq. 124-133), "Mbi zbulimin – el-keshf" (fq. 468-474), "Mbi bashkimin – el-xhem" (fq. 474-481), "Mbi dehjen" (fq. 481-489) dhe në fund "Përjetimi i ngritjes në qiell i Ibn 'Arebiut – el-isra" (551-584).

Vepra tjetër "Fususu-l-hikem", sikurse simotra e saj e lartpërmendur, është përplot me teori devijuese, botëkuptime çoroditëse dhe pikëpamje blasfemuese. Kështu, në të, mund të lexojmë edhe këtë: "Nëse e vështron Atë përmes Atij, do ta kuptosh se Ai gjithmonë e vështron Vetën nëpërmjet Vetes së Tij. Nëse e vështron përmes vetes tënde, Njeshmëria e Tij "do të shpërndahet" në qenien tënde, kështu që, në të vërtetë, është vetëm Ai që e vështron Vetën e Tij përmes Vetes së Tij (edhe njëra edhe tjetra këtu paraqesin vetëm Atë Vetë)". (Biseri mudrosti, fq. 94-95). Thënia në vazhdim e ilustron më së miri teorinë e tij të "Unitetit të Qenësisë": "... dhe së fundi, Ai, në të vërtetë, është ne (qenia jonë). (Vepra e cituar, fq. 131).

Apo thënia tjetër: "... dhe Zoti, edhe pse është Një në Qenien e Tij, është i shumëfishtë në format dhe trajtat e posaçme". (Vepra e cituar, fq. 264).

Gjithashtu: "Ai (gnostiku) e vështron vetëm Zotin, si thelbi i gjithçkaje që vëzhgon, duke vërejtur se vëzhguesi dhe i vëzhguari bëhen po e njëjta gjë". (Vepra e cituar, fq. 268). Si dhe: "Gnostiku është ai që e vëzhgon Zotin në gjithçka dhe, në tërësi, e sheh Atë si qenie të gjithçkaje". (Vepra e cituar, fq. 280).

Nga sa u tha, mund të konstatohet se Ibn 'Arebi, përkundër pohimeve të tij të shumta në favor të dispozitave të sheriatit, në mësimet e tij propagandonte një ide mjaft të rrezikshme që ngërthen ne vete shenja mosbesimi dhe devijimi. Pikërisht për këtë arsye, një numër i madh i dijetarëve eminentë islamë, midis të cilëve është edhe shejhu-l-islam, Ahmed ibn Tejmije, e konsiderojnë të dalë nga feja. Më gjerësisht mbi të, shih: Dr. Zekki Mubarek, "Et-tesavvuf el-islamij", vëll. I, fq. 119-154. (vër. e përkthyesit).

pak në grupin e dijetarëve, të cilët mbështeteshin kryekëput në librin e All-llahut dhe sunetin e të Dërguarit (paqja qoftë mbi të), siç ishin, bie fjala: Fudajl ibn 'Ijadi, Ibrahim ibn Ed'hemi, Ebu Sulejman ed-Darani, Ma'ruf el-Kerhi, El-Xhunejd ibn Muhammedi, Sehl ibn Abdullah et-Tusteri dhe shumë të tjerë, All-llahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata".¹⁹

Nga sa u tha, vihet re se tesavufi, i cili në fillim pati një zhvillim në frymën islame, me kalimin e kohës nuk shpëtoi nga ndikimet e huaja. Lidhur me këtë, Dr. Umer Ferruh thotë:

"Sufizmi paraqet një lëvizje, e cila filloi me "askezë" (ar. ez-zuhd) dhe "abstinencë" (ar. el-verë), që më vonë u zhvillua dhe u shndërrua në një model të ashpër të adhurimit, për të lëshuar rrënjë së fundi si një pikëpamje shpirtërore e mendore, duke qenë larg nga kahja e saj e parë, po edhe nga Islami me të cilin bie ndesh me shumë këndvështrimet radikale e ekstremiste që i ngërthen në vete".²⁰

*Nga arabishtja:
Jahja Hondozi*

Ebu Sa'd el-Malini

A FEW WORDS ABOUT THE HISTORY OF SUFISM AND ITS DEVELOPMENT

(Summary)

There are different views among historians with regard to the etymology of the word "Sufi". Some say that the word originates from Suf the Arabic word for wool, referring to the simple cloaks the early Muslim ascetics wore. Another etymological theory states that the root word of Sufi is the Arabic word safa meaning purity. This places the emphasis of Sufism on purity of heart and soul. Others suggest the origin is from "Ahl al-Suffa" ("People of the Veranda"), who were a group of Muslims during the time of the Prophet Muhammad who spent much of their time on the veranda of the Prophet's mosque devoted to prayer.

أبو سعد الملقني

بعض الكلمات حول تاريخ التصوف و تطوره.

(خلاصة البحث)

هناك آراء مختلفة بين المؤرخين بشأن كلمة التصوف أو الصوفي، فهناك من يقول بان اصلها بلباس الصوف و البعض الآخر يقول بان هذه الكلمة تتعلق باهل الصوفة الذين كانوا مجموعة من الفقراء كانوا يسكنون في مسجد الرسول صلعم. و هناك من يقول بان أصل هذه الكلمة الصفا و التي تتعلق بنظافة الروح.

¹⁹ "El-furkan bejne evlijai-r-rahman ve evlijai-sh-shejtan", fq. 44.

²⁰ "Tarihu-l-fikri-l-'arebijj", (Historia e mendimit arab), fq. 470.

RECENSIONE

Dr. Pajazit Nushi

VËSHTRIM I BOTIMIT SHQIP TË LIBRIT “A CULTURE OF PEACEFUL COEXISTENCE” – “KULTURA E BASHKËJETESËS” i autorit Ekmeleddin Ihsanoğlu

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë para pak kohësh botoi përkthimin në gjuhën shqipe të një vepre të rëndësishme për zhvillimin e mendimit teorik fetar të islamizmit, sikurse edhe për nevojat praktike të zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore, posaçërisht të shoqërisë multietnike dhe multikulturore e fetare të Kosovës dhe të popullsisë myslimane, të krishterë dhe ortodokse të këtij mjedisi. Zakonisht veprat e botuara mund të analizohen në aspekte të ndryshme. Këtë vepër të shkurtër prej 99 faqesh të paraqitur paralelisht në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze e analizuam nga këndvështrimi i **karakteristikave të përmbajtjes së veprës, të perso-**

nalitetit të hartuesit dhe nga këndvështrimi i popullit ose i lexuesve, të cilit i drejtohet vepra me porosinë e saja. Këtë vështrim trekomponentesh të veprës “Kultura e Bashkëjetesës” në shqipe e mundësuan përkthyesit Musli Ymeri dhe Mr. Xhabir Hamiti me bashkëpunëtorë.

Karakteristikat e përmbajtjes së veprës

Vepra e botuar ka përshkrimin dhe shpjegimin e drejtimit të zhvillimit të mendimit islam për kulturën e popujve për të jetuar në paqe, për koekzistencën e kulturave dhe të qytetërimeve të popujve të ndryshëm, për

rëndësinë e dialogut dhe tolerancën fetare e etnike të mjediseve të ndryshme. Nga zbërthimi i koncepteve themelore të përmendura kuptojmë se kjo vepër ka dimensione të një monografie shkencore, sepse për objekt studimi ka mendimin për qenien dhe zhvillimin e kulturës për bashkëjetesë të qytetarëve të etnive, të kulturave dhe të feve të ndryshme. Përmasa monografike e këtij studimi dallohet edhe në vështrimin e përvojës islame të pluralizmit fetar-kulturor gjatë shekujve, e cila nis që nga urdhri i Kur'anit të madhërishëm **“Në fe nuk ka dhunë...”**. Ky urdhër kuranor lidhet me disa “hadithe” të tjera dhe të gjitha janë udhërrëfyes si duhet jetuar, vepruar dhe si duhet të sillet myslimani në çdo mjedis dhe në çdo situatë, madje duke përfshirë edhe sjelljet e myslimanëve ndaj jomyslimanëve. Me këtë pohim autori ka shpjeguar se në fetë monoteiste dhuna ndaj të tjerëve përjashtohet nga sjelljet individuale e kolektive të të gjithë qytetarëve. Këtë pohim autori i kësaj vepre monografike shkencore e ka thënë, kur bën fjalë për zhvillimin e islamizmit, kur shkruan në faqen 24 të kësaj vepre: “Islami nuk e shikon veten si diçka që vjen në skenën religjioze ex nihilo, por si riafirmim i po asaj të vërtetë që e kanë paraqitur më herët apostujt e judaizmit e të krishterimit”. Jodhuna për islamizmin ka karakter universal, d. m. th. asnjë mysliman

nuk mund të sillet me dhunë ndaj askujt, sikurse edhe ndaj anëtarëve të pakicave Raportin ndërmjet shumicës dhe pakicës së një mjedisi autori e shpjegon duke cituar veprën e Abu Dawid, Sunan Abu Dawid-it, ku është shkruar: “Ty që shtyp pjesëtarin e pakicës së mbrojtur, e mashtron atë ose i ngarkon detyra jashtë aftësive të tij apo ia uzurpon pronën e tij, unë do të mundojë në Ditën e gjykimit”. Këtë raport të barazimit ndërmjet qytetarëve me kultura dhe me përkatësi fetare të ndryshme, sidomos ndërmjet myslimanëve e pakicave të tjetra, siç janë zimmit, E. Ihsanoglu e përfundon me këto fjalë të nxjerra nga faqja 30 e veprës në fjalë: “... Islami në thelb përkrah pluralizmin kulturor fetar. Ai i respekton të gjitha llojet e dallimeve etnike (Kur'ani, El Haxhurat, 49:13), fetare (Kur'ani, Junus, 10:48), gjuhësore dhe racore (Kur'ani, Er-Rum si dallime që vijnë nga Zoti dhe rrjedhimisht janë të ndryshme. Qëllimi i diversifikimit të këtillë të qenieve njerëzore në kombe është ta'rufi (pranimi/respektimi i të tjerëve) e jo konflikti...”

Me përhapjen e islamizmit dallohen qëndrime të veçanta pozitive ndaj joislamikeve. Këtë e dallojmë në pohimin e autorit të këtij libri kur në faqen 25 thotë: “Jehuditë dhe të krishterët kanë qenë të pranuar si Ahl-al-Kitab, pjesëtarët e disa besimeve të tjera, siç

janë: zaratrustianët, hindusit, budistët, gnostikët e Haranës dhe berberët pagan të Afrikës Veriore ...janë konsideruar pakica të mbrojtura”. Koncepti i barazisë e përshkon gjithë përmbajtjen e këtij libri. Mirëpo, konceptin e barazisë së qytetarëve të besimeve të ndryshme e ka nxjerrë nga vështrimet teorike dhe nga qëndrimet e nga sjelljet praktike të myslimanëve ndaj të tjerëve. Burimi teorik kryesor i të drejtave dhe i detyrave të myslimanëve ndaj jomyslimanëve për autorin ka qenë Kur’ani, sikurse edhe shumë vepra e dokumente të tjera. Ndër dokumentet e shfrytëzuara nga ana e autorit përmendet Kushtetuta e Medinës. Duke komentuar disa pjesë të kësaj Kushtetute E. Ihsanoglu ka shkruar në faqen 33-34: “...kushdo duhet të ketë liri të plotë, jo vetëm kur bëhet fjalë për respektimin e dogmës dhe praktikumin e fesë, por edhe lirinë për të vepruar në pajtim me ligjet e bashkësisë së cilës i përket, nga se Kur’ani e thotë qartë “Në fe nuk ka dhunë”. Autori i librit edhe shtetin, sikurse edhe sistemin e organeve dhe të institucioneve të tij, madje edhe organet gjyqësore, i konsideron institucione, të cilat i shërbejnë të drejtave dhe lirive njerëzore dhe mbrojtës së këtyre të drejtave pa marrë parasysh çfarë feje, gjinie, moshe, etj. i përket qytetari i secilit mjedis. Këtë përcaktim Profeti Muhamet u ka imponuar të gjithëve duke nënshkruar

edhe marrëveshje të posaçme për sigurinë personale, për mbrojtjen e pasurisë, të institucioneve fetare të jomyslimanëve, etj. Këtë e dallojmë që nga shekulli VII. Në këtë kohë bizantinët paskën pasë braktisur tokat pjellore përreth Misirit dhe Agjipe-shkvi i Jerusalemit, siç shkruan autori, nuk ka pranuar të u dorëzojë çelësat askujt tjetër përpos myslimanit Kalifit II Omer in al-Khatib, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje, ku, përpos tjerash thuhet: “Në emër të Zotit, të Mëshirshëm, Mëshirëplotë. Këtë kartë ia jep popullit Aelie kalifi Omer...Ai u garanton atyre sigurinë personale dhe pronësore, kishat dhe kryqet e tyre, të madhit e të voglit, dhe të gjithë ithtarëve të fesë së krishterë. As nuk do t’u merren kishat, as nuk do t’u shkatërrohen ato në asnjë mënyrë nuk do tu zhvaten as pasuria, as toka, as kryqet, as çfarëdo prone tjetër. Nuk do të detyrohen për asnjë send lidhur me besimin e tyre dhe askush nuk do t’u bëjë dëm...”. Këtë detyrim autori iu atribuon të gjithë myslimanëve, sidomos imamëve të tyre. Lidhur me këtë, duke u thirrur në librin e shkollës juridike hanbelike Matalib uli al-Nuha, në faqen 46 të këtij libri për të cilin i shkruajmë këta rreshta, ka shkruar: Është detyrë e imanit që të mbrojë zimmët. Ai duhet të zhdukë burimin e halleve të tyre..Që kur është në fuqi dispozita mbi zimmët, marrëveshja e nënshkr-

uar me ta ka vlerë detyruese. Të drejtat e tyre duhet respektuar njëllor sikur të drejtat e myslimanëve”. Autori, duke cituar juristin e famshëm anduluzian Ibn al-Hazma, ka vënë në dukje në faqen 47 të librit të tij thënien e Ibn al-Hazmas, sipas të cilit: “myslimanët, për ta kryer plotësisht detyrën e vet për mbrojtjen e zimmive (jomyslimanëve), kur e lyp nevoja, duhet të flijojnë jetën dhe pasurinë e vet”. Autori, duke përfunduar kaptinën “Praktika e hershme në historinë e islamit” ka shkruar edhe për disa praktika të shkeljes së të drejtave të myslimanëve dhe jomyslimanëve. Lidhur me këtë dukuri ka thënë: “...zimmët ashtu si edhe myslimanët, herë herë ballafaqoheshin me padrejtësi. Nga një herë myslimanët vuanin për shkak të sunduesve dhe udhëheqësve të padrejtë. Sidoqoftë, shtypja dhe tirania e ushtruar kundër zimmive nuk zgjatnin shumë, sepse opinioni publik i përkrahur haptas nga ulemaja dhe juristët, të gjithë ngrihen kundër padrejtësisë, kështu që së shpejti rivendoseshin të drejtat dhe liritë e njeriut...”. Le ta vëmë në parantezë një përvojë të këtyre të raporteve ndërmjet myslimanëve dhe katolikëve në kohën e Bajram Currit. Pohohet se për shkak të shkatërtimeve të mëdha në rrethin e Gjakovës, katolikët paskan pas ngelur pa kishë dhe pa mundësi që t’i kryejnë predikimet e tyre fetare. Bajram Curri, me përkatësi fe-

tare islame, në emër të tyre ka kërkuar leje nga pushteti i atëhershëm austriak për ngritjen e një kishë dhe, kur pas shumë pritjeve për të marrë leje për ngritje të kishës për t’i kryer edhe katolikët obligimet e tyre fetare në kishë sikur edhe myslimanët në xhami, Bajram Curri i paska pas qenë drejtuar me këto fjalë pushtetmbajtësit të Gjakovës: “Në qoftë se Ju nuk na jepni leje për ndërtim të kishës, na në Gjakovë kemi disa xhami dhe jemi në gjendje që të u vëmë në dispozicion njërën prej tyre për ta shndërruar në kishë dhe për t’i kryer obligimet fetare edhe qytetarët tonë të fesë së krishterë”. Kaq i madh ka qenë besimi i qytetarëve mysliman ndaj qytetarëve katolikë të Kosovës dhe kaq thellë i kanë përjetuar obligimet e tyre për mbrojtjen e të drejtave fetare të të gjithë qytetarëve. Me këtë shembull të njohur në historinë e zhvillimit të raporteve pozitive ndërmjet myslimanëve dhe katolikëve të Kosovës desha ta pasurojë përmbajtjen e këtij libri edhe me përvojë burimore të popullit të Kosovës, për të cilat pleqtë tonë flasin me kurajë të madhe. Më në fund, këtë qëndrim pozitiv të qytetarëve myslimanë, katolikë e argumentojnë edhe disa shembuj nga ndërtimtaria dhe arkitektura e ngritjes së kishave dhe të xhamive njëra pranë tjetrës, sikurse është rasti në Ferizaj.

Por, autori në librin e tij të çmuar e ka zbatuar më tepër metodën e zhvillimit të mendimit islam për barazi të qytetarëve duke u mbështetur në zhvillimin e praktikës së barazisë së qytetarëve mysliman dhe të krishterë në vendin e tij dhe në historinë e këtij vendi. Për këtë shkak ai i ka kushtuar kujdes përvojave të këtylla të sistemit osman dhe milletit, përvoja këto i përshkruan dhe i shpjegon prej faqes 55 deri në faqen 68, sikurse edhe përvojave pas Tanzimatit, që i ka paraqitë të shkoqitura në dhjetë faqe, përkatësisht prej faqes 69 deri në faqen 78.

Në mbështetje të rezultateve të hulumtimit të historisë së zhvillimit të kulturës për paqe dhe për bashkëjetesë të popujve islam, sidomos të popullit turk, autori i këtij libri udhëzon lexuesin në praktikën bashkëkohore të koekzistencës paqësore duke u thirrur kryesisht në shembuj praktik nga jeta e banorëve të Stambollit. Këtyre shembujve autori u ka kushtuar një kapitull të posaçme. Përmbajtja e kësaj kapitule ka të bëjë me disa shembuj konkret të bashkëjetesës në distrikte të ndryshme të Turqisë. Ndër këta shembuj autori përmendë posaçërisht distriktin e Kuzguncukut, që konsiderohej se ishte vend hebraik. Për këtë vend autori në faqen 87 shkruan: “Në distrikt ka xhami, kisha dhe sinagoga, që pasqyrojnë përbërjen demografike të popullsisë. ...Xhamia e Kuzguncukut

(1952) dhe kisha armene Surp Krikor Lusarović (1835) qëndrojnë pranë njëra tjetrës..., në rrugën e dytë gjenden sinagoga Betj Yaakov (1878) dhe kisha Ayios Yerios...”. Këta shembuj autori i ka ilustruar edhe me figura.

Epilogu i shqyrtimit të kulturës paqësore dhe bashkëjetesë të popujve me etni dhe me përkatësi fetare të ndryshme, që është paraqitur në këtë libër nuk ka vetëm karakter të fjalës përfundimtare të përmbajtjes së librit, por ka edhe karakter të rrjedhimit të koekzistencës paqësore dhe, si epilog i kësaj, është paraqitur edhe në formë porosie. Se epilogu është një përmbajtje sintetike e fjalës përfundimtare, e rrjedhimit të përvojës së kaluar në raportet e sotme ndërkombëtare dhe ndërfetare dhe, lidhur ngushtë me këtë, e porosisë së vështrimit të përvojës së kaluar fletë edhe pasuri i fundit i këtij epilogu, ku është thënë: **“Fryma dhe filozofia prapa pluralizmit islam në përgjithësi..., në sajë të të cilit kanë ekzistuar dhe funksionuar me sukses për shekuj të tërë me radhë, kanë për të thënë shumë për problemin tonë modern të bashkëjetesës. Sikur ky trashëgim historik të studiohet hollësisht, sidomos toleranca e tij fetare dhe kulturologjike, besojmë do të kishim marrë një mësim të rëndësishëm për ndërtimin e së ardhmes paqësore dhe humane”.**

Kush e ka bërë këtë vështrim dhe këto porosi?

Në analizën e përmbajtjes së një vepre rëndësi të veçantë ka autoriteti shkencor i autorit të veprës së caktuar, sikurse edhe niveli arsimor, kulturor, fetar dhe shkencor i tij. Në rastin tonë të librit “Kultura e Bashkëjetesës” autori i saj është profesor universitar i historisë së shkencës, i cili ka kryer shumë funksione arsimore të nivelit universitar, sikurse edhe disa funksione të organizimit të veprimtarisë shkencore. Ndër këto funksione përmendim: Drejtor i përgjithshëm i Institutit të Qendrës Kërkimore të Organizatës së Konferencës Islame me qendër në Stamboll, Kryetar i Unionit Ndërkombëtar për Historinë dhe Filozofinë e Shkencës, Nënkyetar i Fondacionit për Ruajtjen e Trashëgimit Islam me qendër në Londër, etj. E. Ihsanoglu është zgjedhur anëtar i disa akademive dhe shoqërive shkencore, ndër të cilat përmendim: Anëtar i Akademisë Ndërkombëtare të Historisë së Shkencës me seli në Paris, i Akademisë Mbretërore të Studimit të Qytetërimit Islam me seli në Aman, anëtar korrespondent i Akademisë së Gjuhës Arabe të Egjiptit, etj. Është zgjedhur doktor nderi i gjashtë institucioneve akademike. Ka shkruar shumë vepra, libra, studime, etj. Tematike e botimeve të shumta të këtij autoriteti shkencor ka

qenë kryesisht historia e kulturës dhe e qytetërimit islam.

Mbrojtës konsekuent dhe i qëndrueshëm i paqes në botë E. Ihsanoglu, ka ngritur **zërin edhe kundër shkeljes së të drejtave njerëzore dhe kundër krimit të ushtruar nga forcat serbe në Kosovën e viteve 90-ta të shekullit të kaluar.**

Kujt i drejtohet me këtë vepër?

E. Ihsanoglu me librin “Kultura e Bashkëjetesës” i është drejtuar të gjithë qytetarëve pavarësisht nga përkatësia kombëtare, racore dhe fetare e tyre. Me përkthimin e këtij libri në gjuhën shqipe autori i është drejtuar shqipfolësve duke falënderuar Fakultetin të Studimeve Islame të Prishtinës dhe gjithë stafit të përgatitjes së librit në gjuhën shqipe. Por, autori i librit shumë pjesë të tij i ka ligjëruar në gjuhë të ndryshme anë e mbanë gjithë botës. Prandaj, është bërë i njohur me qëndrimet e tija parimore për ruajtje të paqes dhe për zhvillim të kulturës së bashkëjetesës së popujve me përkatësi fetare e kombëtare të ndryshme. Në shqipe u përkthye nga anglishtja. Ndoshta dikush do të thotë se shqiptarët kanë traditë të lashtë të koekzistencës paqësore ndërfetare dhe pikërisht toleranca fetare e shqiptarëve është ndër vlerat kulturore më të rëndësishme të tyre. Se që toleranca fetare ndërmjet shqiptarëve mysliman, katolikë dhe

ortodoksë është ndër virtytet e larta njerëzore dhe kombëtare të tyre me një traditë të lashtë, kjo është një e vërtetë. Kjo e vërtetë ka mundur me gjet vend meritore edhe në këtë libër, por shqiptarët këtë vlerë u kanë bërë pak të njohur të tjerëve. Megjithatë, përmbajtja e librit të E. Ihsanoglit është aktuale edhe për shqiptarët. Përse?

Aktualiteti i këtij libri për shqiptarët mund të shtrihet në sferën teorike dhe në sferën praktike. Sa i përket sferës teorike ajo është e gjerë, por për këtë rast do të vë në spikamë disa vlera teorike të këtij libri.

Shqiptarët nga ky burim i dijenisë mësojnë se rrënjët e pluralizmit, sidomos ato të të drejtave të njeriut janë zhvilluar dhe janë afirmuar edhe nga zhvillimi i vetëdijes së besimit mono-teist. Vetëdija e besimit islam nisët nga Kur'ani, ku pohimi **“Në fe nuk ka dhunë”** e përshkon gjithë dijeninë islame. Në këtë pikëpamje islami vërtetë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm.

Vlerë teorike e librit është, do të thosha, edhe përshkrimi dhe shpjegimi i praktikave të raporteve pozitive ndër-fetare, nga të cilat autori ka nxjerrë rrugën dhe procesin e zhvillimit dhe të formimit të koekzistencës së popujve me përkatësi fetare islame, katolike dhe ortodokse. Kjo vlerë njerëzore është vlerë universale dhe rrënjësja e thellë e kësaj vlere në repertorin e sje-

lljeve të secilit qytetar është kërkesë aktuale edhe për shqiptarët dhe bazë e edukatës morale bashkëkohore.

Te një numër myslimanësh shqiptarë ka qëndrime negative, ndoshta edhe paragjyime për pjesëtarët e feve të tjera. Përmbajtja e librit tregon sa të dëmshme janë qëndrimet dhe paragjykimet e tyre dhe si duhet çrrënjësuar nga sjellja e myslimanit, sepse besimi islam i tyre këto nuk i njeh. Myslimani i mirë duhet të jetë i zhveshur nga të gjitha qëndrimet negative, sidomos nga paragjykimet e tija ndaj qytetarit të fesë tjetër.

Në shumë vende të botës ekzistojnë pakica kombëtare me përkatësi jo vetëm kombëtare të ndryshme, por edhe me përkatësi fetare të ndryshme. Shqiptarët janë ndër popujt e rrallë që i përkasin tri feve. Në Shqipëri, në Kosovë, por edhe në trevat e popullsisë kompakte shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Serbinë e Jugut përbërja e popullsisë shqiptare nga pikëpamja e përkatësisë fetare të tyre është popullsi heterogjene. Ndryshimet politike, ekonomike dhe socialo-organizative nuk kanë ngelë pa ndikim edhe në strukturën e vetëdijes fetare të shqiptarëve. Ky ndikim, në kushtet e zhvillimit ekonomik të ulët dhe shumë të ulët, të papunësisë së madhe të të rinjve gjithënjë e më shumë të kualifikuar, madje edhe me shkollim të lartë e universitar, shkalla e ulët e traditës

organizative demokratike të shoqërisë shqiptare, ndryshimet në raportet dhe në strukturën e familjeve, lëvizjet gjithnjë më të mëdha migruese, etj. kanë bërë që të ndihet një ftohësi ndërmjet shqiptarëve të besimit mysliman e të krishterë. Përmbajtja e librit, leximi dhe kuptimi i përmbajtjes së tij nxitë zhvillimin e qëndrimeve për mirëbesim respekt të secilit qytetar ndaj tjetrit pavarësisht nga përkatësia fetare dhe kombëtare e tij. Për këto shkaqe vlerat e librit janë aktuale edhe nga aspekti i jetës së përditshme të shqiptarëve, të familjeve dhe të mjediseve të tyre me përkatësi të ndryshme fetare. I vështuar nga ky aspekt përmbajtja e librit, kuptohet, kur lexohet me kujdes dhe kuptohet e përvetësohet i kontribuon kulturës së respektimit të të drejtave dhe lirive njerëzore kaq shumë të nëpërkëmbura në shumë vende të botës duke përfshirë edhe Shqipërinë e Kosovën.

Është e kuptueshme se një fushë kaq e gjerë siç është kultura e paqes dhe e bashkëjetesës vështirë mund të përfshihet e tëra në 110 faqe të formatit të vogël. Madje, vetëm përvoja turke e zhvillimit të raporteve të mira ndër-fetare është përvojë e paktë për të dëshmuar objektivin universal të fesë islame për tolerancë, mirëkuptim e bashkëjetesë të të gjithëve pavarësisht nga përkatësia fetare e tyre. Ka edhe vende të tjera ku paqja, mirëkuptimi

dhe respekti ndërmjerëzor i qytetarëve me përkatësi fetare të ndryshme është i një niveli lakmues. Unë ndër këto vende numëroj edhe popullsinë shqiptare të Shqipërisë e të Kosovës, të Zvicrës, të Sllovenisë, etj. Përvojat e tyre në këtë pikëpamje kanë rëndësi të posaçme për zhvillimin njerëzor të botës bashkëkohore.

Më në fund, vështrimi pozitivist i përvojës së zhvillimit të marrëdhënieve ndër-fetare duke lënë anash edhe disa përvoja negative dhe duke kërkuar shkaqet e paraqitjes së tyre me qëllim luftimi të tyre i jep këtij libri kaq të rëndësishëm një përmasë të vogël njëanësore. Në Shqipëri, në Kosovë, në Turqi, etj. ka raste të deformimit të këtyre raporteve, të cilat vet populli dhe institucionet për të drejtat dhe liritë e njeriut i gjykojnë dhe i dënojnë. Të përmendim vetëm rastin e raporteve ndërmjet turqve islamik dhe qipriotëve ortodoksë, ku lufta politike vështirë mund të ndahet edhe nga jo-toleranca fetare ndërmjet tyre. Nevoja për dialog ndër-fetar, kaq e theksuar në përmbajtjen e këtij libri, ka lind si nevojë e problemeve të shfaqura në fushën e raporteve ndër-fetare dhe si mënyrë e posaçme mirëkuptuese e zgjidhjes së këtyre problemeve.

Mirëpo, autoriteti shkencor i këtij niveli, siç është Z. E. Ihsanoğlu, burimet kur'anore dhe ato të ndërlihdura me përmbajtje të Kur'anit, burimet e

feve të tjera, burimet shkencore joteologjike, sikurse edhe përvoja e analizuar në fushën e kulturës së paqes dhe të bashkëjetesës i japin këtij libri **vlera të rëndësishme për zhvillimin e kulturës ndërfetare shqiptare, për**

thellim të tolerancës dhe respektim të të drejtave fetare të secilit qytetar në kuadrin e rrjedhave zhvillimore politike në Shqipëri, në Kosovë dhe në vendet e tjera të Evropës juglindore dhe më gjerë.

RECENSIONE

Akademik Jashar Rexhepagiqi

**LEKSIKONI I NOCIONEVE TË ISLAMIT –
VEPËR E SHKËLQYESHME, ME DISA
VËREJTJE E SUGJERIME**

Edhe kur një autor (ose shumë sish) është i preokupuar me vite me hartimin e një libri në të cilin trajtohen nocione e emra të ndryshëm e veçmas thesari leksikor nga fusha e caktuar, për suksesin në këtë veprimtari komplekse është normale të kihen parasysh disa parakushte qenësore, në radhë të parë njohja solide e fushës përkatëse, në këtë rast e Islamit (dhe e islamistikës) e kjo do të thotë edhe njohja e filozofisë, e bazës religjioze dhe e kulturës së Islamit dhe veçmas e gjuhës dhe e letërsisë arabe, por edhe e gjuhëve dhe e letërsive të tjera orientale. Puna në leksikonin e Islamit me siguri tejkalon fushat e doktrinës rigorozisht islame, dhe me këtë fushë merren më me sukses, para së gjithash, personat që në të njëjtën kohë kanë njohuri më

të gjithanshme dhe universale si dhe më shumë prirje për analiza subtile, krahasime, përgjithësime dhe një varg kualitetesh të tjera. Me këto hulumtime vërtet delikate, që kanë kërkuar gjurmime serioze, verifikime, plotësim dhe konsultime të literaturës së bollshme, deri te shkrimi përfundimtar dhe trajtimi gjuhësor i zërave, merren dekada me radhë dy orientalistë të shkëlqyer: prof. dr Rade Bozhoviq dhe mr. Vojislav Simiq. Librin e tyre **Leksikoni i Nocioneve të Islamit** (*Pojmovnik Islama*) e ka botuar Shtëpia Botuese “Narodna knjiga” në Beograd, në edicionin e saj “Bota Arabe”. Leksikoni është shtypur në vitin 2003 dhe bashkë me përmbajtje ka 160 faqe.

Para këtij Leksikoni, ndër të parët do të publikojnë Nerkez Smailagiq Leksikonin e Islamit (*Leksikon Islama*, Sarajevë, 1990) dhe Abdulah Shkaliq Turcizmat në gjuhën serbo-kroate (*Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku*, Sarejevë, 1985), por autorët e *Leksikonit të Nocioneve të Islamit* punën rreth hartimit të këtij Leksikoni të tyre e kanë filluar që para më shumë se njëzet vjetëve. Vepra është shkruar në alfabetin latin, kurse zërat janë renduar me alfabetin cirilik, si thonë autorët në Parathënie, “për shkak të respektimit të multikulturalitetit”.

Hartuesit e *Leksikonit të Nocioneve të Islamit* kanë trajtuar në radhë të parë një varg termash dhe fjalësh themelore më të rëndësishme dhe më pak të njohura para së gjithash nga shkenca që merret me studimin Islamit. Islamistika është zhvilluar brenda orientalistikës duke studiuar gjuhët persishte, arabishte e turqishte nga pikëpamja linguistike, por duke vënë në lidhje gjuhën e mësuar, letrare të shkruar me gjuhën e njerëzve që e përdorin në komunikim të përditshëm me historinë dhe letërsinë e Lindjes së Afërme dhe me doktrinën fetare islame.

Derisa në literaturë takojmë tituj të shumëllojshëm, prej të cilëve më të shpeshtë janë: fjalori, leksikoni, e pak më rrallë – *zërori* etj. autorët janë përcaktuar për termin *Leksikoni i nocio-*

neve, përkatësisht për librin që përmban regjistrin e nocioneve me shpjegime dhe tekstin e punuar ndryshe, me qëllim që, me anë të nocioneve, të njihet më për së afërmi dhe të kuptohet doktrina islame.

Në Parathënien e autorëve R. Bozhoviq dhe V. Simiq – njohësve të arabishtes dhe të kulturës e të fesë islame - theksohet kompleksiteti i të folurit të kësaj gjuhe. Kështu, për shembull, te ne thuhet “ezan”, ndërsa në *Leksikonin e Nocioneve të Islamit* shkruan “azan”, sepse nuk është “a” e pastër as “e” e pastër - si thuhet te ne. Megjithatë, këtu është përdorur fare drejt zëri arab “shejh” e jo “shajh”.

Është shumë pozitive dhe risi në *Leksikonin e Nocioneve të Islamit* kjo që nuk përmban vetëm analizën e shumë nocioneve dhe të ideve themelore islamiste, por edhe shpjegimin e një vargu personalitetesh të shquara, të merituarish për jetën shpirtërore dhe prosperitetin e botës islame. Në *Leksikonin e Nocioneve të Islamit* në vija të shkurtra dhe qenësore janë përfshirë edhe mendimtarë të shquar dhe më pak të njohur arabë e persianë dhe personalitete të tjera të shquara të doktrinës islame, p.sh. nga radha e shkencëtarëve e mistikëve persianë, juristëve fetarë, teologëve më të njohur dhe komentuesve të pranuar të Kur’anit, të misionarëve të doktrinës

shiite, të poetëve, të historianëve e të tjerëve.

Përparësitë e *Leksikonit të Nocioneve të Islamit* janë që përmban dhe trajton shumë terma që nuk i gjejmë në *Turcizmat në gjuhën serbokroate* të Shkaliqit as në *Leksikonin e Islamit* të Nerkez Smailagiqit. Për disa nocione, sidomos për personalitete që e kanë studiuar Islamin ose kanë kontribuar në doktrinën islame, autorët Bozhoviq dhe Simiq shkruajnë së paku në disa rreshta dhe në mënyrë mjaft informative. Në këtë libër modest për nga numri i faqeve, gjejmë emrin: *Xhamal al-Din al-Afgani* (në fq. 146-147) i cili, si thonë autorët, është një nga figurat më markante në Islam në shekullin 19. Ai ishte shumë i arsimuar; e njihte filozofinë arabe mesjetare... dhe bënte diskutime të rrepta me shkencëtarë përndimorë për mbrojtjen e Islamit (Po aty, në fq. 146). Do ta përkujtoj edhe një personalitet, e ky është *Çisti Hvalxa Muin al-Din Hasan*, njëri nga figurat më të shquara të sofizmit, e njëkohësisht themelues i rendit të përhapur mistik në Indi – *Çistia*. Për të gjallë (i lindur më 1141, vdekur më 1236) i ka vizituar “gati të gjitha vendet myslimane dhe qendrat fetare” (Po aty, fq. 144).

Veçohet shpjegimi i *Islamit*, në fq. 62-65 të *Leksikonit*. Shpjegimi në esencë është dhënë i saktë dhe i hollësishëm. Një term kaq i rëndësishëm

mungon fare te Shkaliqi, e mungon edhe në *Leksikonin e Islamit* të Smailagiqit. Në tekstin e *Leksikonit të Nocioneve të Islamit*, Islami është shpjeguar si “religjion i ri” i myslimanëve “që e ka shpallur Muhamedi në të cilin nuk ka kler” (Po aty, fq. 62). Ndoshta pjesa e fundit e formulacionit (se në religjion “nuk ka kler”) është e dykuptimshme, sikurse edhe termi mbi “nënshtrimin absolut (ndaj vullnetit të Zotit)”. Vendi i emërimit “nënshtrimi absolut” mbase është më afër përcaktimit: bindshmëri, përkatësisht përkushtim Zotit. (Shiko në librin *Çka është Islami – Sta je Islam*, Beograd, 1001. fq. 27).

Në librin e Milan Vukomanoviqit, me titull Religjioni (*Religija*, Beograd, 2004) në fq. 28 gjejmë shpjegimin e shkurtër por gjithashtu konsekuent të Islamit, që thotë: “Fjala *islam* tekstualisht do të thotë nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit dhe ka të bëjë si me *religjionin* monoteist që ka prejardhjen prej zbulimit të profetit Muhamed në shekullin e 7-të ashtu edhe me *bashkësinë* e pjesëtarëve të kësaj feje dhe me *qytetërimin* që ka dalë prej saj”.

Autorët (Bozhoviq dhe Simiq) kanë shkruar këtu, përveç të tjerash, për shtrirjen e Islamit në botë, veçmas në vendet e Ballkanit (Shqipëri, ish-Jugosllavi, Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni dhe Bullgari). Janë dhënë

shpjegime për detyrat themelore të myslimanëve (pesë sosh) dhe në fund (në fq. 65) për dy rrymat kryesore: *sunitët* që përbëjnë shumicën dhe *shiitët*, që, sipas autorëve përbëjnë “afërsisht 20 për qind”, ndërsa edhe në *Leksikon*, në vende të tjera, si dhe në literaturën e bollshme, shiitë ka proporcionalisht më pak, diku rreth 10 e 13 për qind. Në këtë nocion, pa dyshim ndër më të rëndësishmit, krahas domethënies së aspektit fetar, nuk duhet harruar rëndësinë filozofike, shkenore dhe përgjithësisht shpirtërore të Islamit, duke përfshirë këtu edhe kuptimin dhe përmbajtjen e tij etike, sociale dhe pedagogjike.

Leksikoni përmban me qindra terma dhe emra të personaliteteve që nuk janë në literaturën tonë leksikore. Përpos personaliteteve të tjera, nga personat e këtushëm më të shquar janë Hafiz Ibrahim Maglajliq, reis-ul-ulema (në fq. 82), Sabit Uzhiçanin (në f. 107), Fehim Spaho, reis-ul-ulema i Bashkësisë Fetare Islame në ish-Jugosllavi në vitet 1938-1942 (në fq. 112) etj., por nuk është Gazi Husrev-Begu, as Muhamed Uzhiçanin dhe një varg emrash të tjerë të rëndësishëm në historinë e kulturës dhe të religjionit të Islamit ndër ne. Këtu është një varg zërash që janë trajtuar më plotësisht dhe më mirë sesa p.sh. në librin e A. Shkaliqit “Turcizmat në gjuhën serbo-

kroate”. Ja disa fjalë, shprehje dhe definicione të tilla.

Në fq. 61 të *Leksikonit* termi *Iman* (besimi në Zotin) është shpjeguar më mirë dhe më shumë se në fjalorin e Shkaliqit (shiko tek ai në fq. 345). Gjithashtu zëri *Kibla* (drejtimi nga Meka, përkatësisht Qabeja, nr. fq. 76) këtu është përpunuar pak më tepër, por më hollësisht te Nerkezi (në fq. 328-329).

Në *Leksikon* është përshkruar në mënyrë precize dhe mjaft të qartë libri i shenjtë i myslimanëve – *Kur’ani* (në fq. 77-78), i cili, sipas autorëve, është “bazë e jetës së tërësishme shpirtërore dhe materiale, themel i ufmës, bashkësisë”. Autorët theksojnë me të drejtë se emërimit al-Kur’an medoemos i shtohet cilësori al-Karim (i Nderuar). Është shpjeguar në mënyrë solide edhe termi *Salat* (lutje e myslimanëve, nr. fq. 108-109), veçmas ato pesë lutjet që i ka përcaktuar Islami. Këtë zë Nerkezi në *Leksikonin* e tij (në fq. 527-53) e trajton në mënyrë më të hollësishme. Edhe emërtimi për shkencëtarët fetarë myslimanë dhe klerikët e lartë (imamët, kaditë) përkatësisht Ulema-të, Bozhoviq dhe Simiq i kanë ndriçuar më gjithanshëm në fq. 122 sesa Shkaliq në fjalorin e tij *Turcizmat...* (shiko tek ai në fq. 621). E zëri *Zikër* (në fq. 55), përkatësisht invokacioni i emrit të Zotit është ndriçuar më vëllimshëm dhe në mënyrë më precize

sesa në *Fjalorin* e Shkaliqit (shiko tek ai në fq. 653).

Në *Leksikonin e Nocioneve të Islamit* shumë terma dhe emërtime janë shpjeguar në mënyrë shumë koncize nga pikëpamja etimologjike dhe përmbajtësore dhe në bazë të shkencës islamike, të filozofisë sofistike, të teologjisë, në radhë të parë të Kur'anit dhe të veprave të kulturës. Duke u nisur nga shkalla e rëndësisë së zërave të ndryshëm, disa janë ndriçuar në mënyrë më të hollësishme, madje në nga disa faqe, si p. sh., përpos *Islamit* e *Kur'anit*, *Dervishi* (në fq. 47-48), *Muhamedi* (në fq. 94-96), *Fatima* (fq. 125-126), *Fikhu* (fq. 127-128), *Halifa* (fq. 133-134), *Haxhi* (f. 137-139), *Xheneti* (fq. 149-150), *Sheriati* (fq. 155-156), *Shiizmi* (fq. 157-158). Janë komentuar në mënyrë të shkëlqyeshme dhe të hollësishme shumë terma shiite, sekte të ndryshme të shiitëve dhe një varg zërash të rinj, që nuk i gjejmë në fjalorë dhe leksikonë të tjerë.

Për shembull, në *Leksikonin e Nocioneve të Islamit* flitet për një varg sektesh sociale-fetare, sikurse janë *Vahabitët* (nga shekulli XVIII), gjithashtu *Ismailitët* dhe *Zejditët*, sektet shiite e të tjera.

Edhe disa zëra terminologjikë, duke u nisur nga esenca dhe rëndësia e përgjithshme e shkalla e aplikueshmërisë së tyre, kanë merituar një analizë

më të hollësishme, e të këtillë janë: *myslimani* (shiko në fq. 92), *Sufizmi* (fq. 114), *tarikati* (shumë shkurt në fq. 116-117), *tesavufi* (fq. 119), *mevlud-it* (fq. 86-87), *qitabi* (ose *qitapi*, në fq. 121), kurse dy terma – *misticizmi islamik* dhe *arabistika* nuk janë shpjeguar as minimalisht.

Deskripcionet e institucioneve fetare dhe fetare-arsimore islame këtu janë shumë të varfra e disa prej tyre kanë munguar fare. Në këtë grup hyjnë: *xhamitë* (shiko në fq. 147), *teqetë* (fq. 118), *hanikahet* (fq. 135), *tyrbet* (fq. 120), *medresetë* (fq. 87), *mejtepet* (fq. 88). Është shumë pozitive që disa xhami të njohura në Bosnjë, p.sh. në Sarajevë, Mostar, Banja-Llukë dhe në lokalitete të tjera janë shënuar së paku me nga disa rreshta, por nuk janë shpjeguar institucionet: *imaret*, *ders*—*hana*, *kutubhana*, *sibjan-mektebi*, *ibtidadia*, *idadia*, *sulltania*. Nuk janë dhënë as emërtimet e disa shkollave të larta, as të institucioneve universitare dhe shkencore, p.sh. *Darul-Kurra*, *Darul-Hadis*, *El-Azhar* etj. Nuk janë përcaktuar as nocionet e termave: *mualim*, *muderis*.

Kanë munguar edhe disa disiplina islame si *ahmak*, *hikmet*, *tarih*, *texhvid*. Në libër jepen disa të dhëna elementare mbi disa rende të dervishëve – diçka më shumë për *bektashinjtë* (në fq. 35) dhe *mevlevinjtë* (në fq. 86), *kaderinjtë* (fq. 71), *rifainjtë* (në fq.

106) dhe *hamzevinjtë* (fq. 135) e nuk janë përfshirë edhe disa tarikate të dervishëve si janë: *sadinjtë*, *shahzelinjtë* dhe *melaminjtë*. Për shembull *sadinj* (ose *saadinj*) dhe teqe të tyre sot ka më shumë në Kosovë, sidomos në Gjakovë dhe në fshatrat përreth.

Është shumë pozitive që *Leksikoni i Nocioneve të Islamit* është pasuruar me rreth njëqind personalitete nga periudhat e pjesët e ndryshme të botës islame, por është e pakuptueshme që në libër mungojnë edhe disa emra të rëndësishëm të shkencës e të filozofisë islame e disa edhe të letërsisë e të teologjisë islame, si *Biruni* – njëri nga shkencëtarët më të mëdhenj të Islamit mesjetar (i lindur më 973, i vdekur më 1050); ose *Ibn Sina* (Avicena), filozof arab, shkencëtar i shkencave ekzakte, politikan, poet e mjek (i lindur më 980, i vdekur më 1037); gjithashtu *Ibn Roshd* (Averoes 1126-1198), filozof i shquar arab dhe studiues i teologjisë; e nga më të vonshmit *Evlija Çelebi*, udhëpërshkrues osman nga shekulli XVII. Përpos të tjerëve, është këtu edhe i pashmangshmi *Nasradin Hoxha* i popullarizuar në popull, i marrë nga folklori i Lindjes së Afërme.

Nuk gjejmë as informacione të shkurtra për vendet dhe krahinat në të cilat çmohej në mënyrë të veçantë kultura, tradita dhe feja islame, p.sh. Arabia, Horasani, Anadolli, Andaluzia e të tjera.

Edhe disa shembuj konkretë dhe analiza më të përafërta të fjalëve, të emërtimeve dhe të nocioneve do të japin një pasqyrë më të plotë të vlerave dhe të rezultateve të *Leksikonit të Nocioneve të Islamit*.

Në fq. 7 fjala *Abdall* është shpjeguar si “zëvendësim, surrogat dhe një nga shkallët e hierarkisë së shenjtëve të sufinjtë”, Është i domosdoshëm shpjegimi plotësues se fjala *abdall* njëkohësisht do të thotë: torollak, naiv, budalla. (Shiko te Shkaliqi, në fq. 66).

Në fq. 9 zëri *abdesoj*, *abdesohem*, përkatësisht marr abdes, nuk jam i sigurt se është në përdorim me këtë titull.

Në fq. 15 termi *azan*, *ezan* nuk është vetëm thirrje për falje (namaz), por edhe paralajmërim. Në popull është i njohur vetëm emërtimi *ezan*.

Akaba (në fq. 17) është nocion i ri për lokalitetin ndërmjet Mekës e Medinës, të cilin nuk e ka shënuar Shkaliqi.

Akaid (në fq. 17) është dogmatikë islame mbi normativat e besimit islam. Këtu janë paraqitur në mënyrë të përsosur pasqyruese 22 dogma kryesore islame.

Akliat (në fq. 18) është një term profesional në teologjinë islame dhe paraqet një risi të rëndësishme në *Leksikonin e Nocioneve të Islamit*.

Aksham (në fq. 18) interpretohet si “emërtim i lutjes së katërt rendore myslimane”, por është i domosdoshëm edhe plotësimi me këtë domethënie: terri i parë, parambrëmja, sipas Shkaliqit - pjesa e mbrëmjes pas përdimit të diellit (shiko në fq. 79).

Alah ose *Allah* (fq. 18) përkufizohet me fjalën *Zot*. Është mirë që autorët e kanë shënuar të dhënë mbi 99 emra të Allahut, si dhe surën *Ikra* se Allahu është “ai që e mëson njeriun për atë që nuk di”.

Do të shtonim se shpjegimi më e mirë për Allahun është se ai është i vetmi *Zot*, krijues i botës, i amshueshëm, i padukshëm, i gjithëpranishëm, i gjithëfuqishëm, i gjithëdijshtëm dhe se është sundues i botës.

Ahret (fq. 23) interpretohet si “bota tjetër, jeta pas vdekjes”. Mendohet për atë jetën tjetër, përkatësisht për botën në të cilën, sipas doktrinës islame, shkohet pas vdekjes. Në *Leksikonin e Nocioneve të Islamit* ky term është shpjeguar më shumë dhe më mirë te Nerkezi (në fq. 16) dhe Shkaliqi (në faqen 74). Nga ana tjetër, disa zëra, si *Ahmedia* (çallma, shalli), *Bazument* (lloj hajmalie), *Basmala* (në mënyrë më të përcaktuar dhe më tepër në të folur: *Bismila*), *Gula* (enë në formë të vorbës), *Exhel* (çasti i gjykimit, vdekja), *Iftar* (darka e ramazanit), *Ukubet*, *Efendia* (zotëria), *Zekat* (lëmoshë e obligueshme për të gjithë

myslimanët më të pasur) dhe disa të tjera - edhe autorët e *Leksikonit të Nocioneve të Islamit* i kanë shpjeguar sipas shembullit të Shkaliqit ose në mënyrë krejt të ngjashme si në fjalorin e tij mbi *Turcizmat në gjuhën serbo-kroate*.

Nën shkronjën **B** Bozhoviq dhe Simiq kanë futur disa terma të reja, si *bab* (emërtim për nxënësit që mësojnë tek imami i rendit më të lartë), *babistan almazahiba* (vepra persiane që përshkruajnë religjione të ndryshme), *bajumia* (sekt egjiptian që tubonte popullsinë më të varfër dhe hajdutët), *Baki* (varrezat më të vjetra myslimane në Medinë), *Baraka* (bekimi i Zotit drejtuar njeriut) e të tjera. Është dhënë edhe një varg zërash dhe emërtimeve të reja edhe në pjesët e tjera të *Leksikonit të Nocioneve të Islamit*, p.sh. *Gajb*, term profesional i sufizmit (në fq. 41) që tregon diçka që është e pakuptueshme, e fshehur; *Gulat*, term i ri (në fq. 42) që tregon emërtimet e personave, para së gjithash shiitëve që akuzohen për teprime; *Giilbaba* (fq. 42), emërtim për anëtarët e rendit bek-tashi e të tjerë, gjithashtu *dar al-nadva* (në fq. 46) për një lloj këshillimore të qytetit në kohën e Muhamedit.

Fjala arabe *Vakat* në fq. 38 është shpjeguar si “koha e lutjes myslimane”, por ka munguar domethënia tjetër: koha, stina. Është e njohur ajo fjala

e urtë populllore: “Vakti i qenarit¹ ndërton kulla. Vakti i ndërton, vakti shkatërron”. Në popullin tonë (mysliman) krahas termit vakat është në përdorim shumë edhe ndajfolja *vaktile*, me domethënie – në kohën e vet, dikur.

Nën shkronjën *V* është dashur të përfshihet së paku edhe zëri *vallahibilahi!* (betim më i fortë: Për Zotin! Pasha Zotin!).

Termi *vilajet* (në faqen 39) gjithashtu është dashur të shpjegohet shkurt se ky është territor i një valie.

Nën shkronjën *G* në fq. 40 është parashtruar rruga e zhvillimit dhe kontributi i teologut, juristit, mendimtarit origjinal dhe reformatorit fetar mysliman *Muhammad al-Gazali* (1059-1111), e gjithashtu edhe disa sufi, shehlerë sofistë e shkencëtarë osmanë dhe disa zëra të tjerë.

Megjithatë, duhet të vërejmë se ka munguar një term i rëndësishëm – *Gajret*, përkatësisht emërtimi i shoqatës bamirëse kulturore-arsimore myslimane që ka vepruar në Bosnjë, Sanxhak e mese të tjera para së gjithash myslimane.

Ndërkaq fjala *gajret* ka disa domethënie. Nëse pas fjalës *gajret* vjen pika çuditëse atëherë kjo fjalë do të thotë: përpiku, qëndro etj. Në “Fjalorin

rin e madh të gjuhës kroate” nga Vladimir Aniq (Zagreb, 2003) në f. 338 për fjalën *gajret* janë dhënë këta zëra: 1. përpikëri, përzemërsi, përkushtim për diçka; 2. përpjekje, mundim, kujdes; 3. qëndrim, qëndrueshmëri; 4. ndihmë, solidaritet (paraqitet në emrat e organizatave bamirëse myslimane).

Një varg termash nën shkronjën *D*, si *Dava* (fq. 44), që definohet si “apel. thirrje”, por ka edhe domethënie të tjera; sipas Shkaliqit (në fq. 207) *dava* është padi, proces, akuzë, gjithashtu pohim. *Dâr al-harb* (ose *Dârul-harb*). Në fq. 46 sipas autorëve është “vendi i luftës”, përkatësisht fushëbetejë. Përfshin “territoret ku ligjet myslimane nuk janë në fuqi”. Ky është interpretim i afërt me interpretimin e Shkaliqit, i cili, në fq. 206 thotë se *Dâri-harb* është “shtet jomysliman në të cilin myslimanët nuk i kanë ato liri fetare që i kanë në shtetin myslimanë”. Është e dukshme se nga të gjithë zërat që fillojnë me shkronjën “d” është formësuar më së miri dhe me një varg elementesh të reja termi *Dervish* (shiko në fq. 47-48).

Dy terma që mungojnë nën këtë shkronjë janë: *Defter* (*Teftër*), do të thotë fletore, protokol, regjistër; gjithashtu libër tregtar i pagesave e borxheve (hyrje-daljeve), si dhe libra fiskale në Perandorinë Osmane në të cilët janë regjistruar të hyrat. (Shiko më shumë në Fjalorin e madh të Aniqit, në

¹ Qenar (persisht) vijë, skaj, zgrip; një lloj shtr-oje ose pëlhure e pambuktë që ka shenjë në skaje. Më shumë për këtë shiko te Shkaliqi në fq. 189.

fq. 1576). Termi tjetër gjithashtu me rëndësi që nuk është dhënë në *Leksikonin e Nocioneve të Islamit* është termi *Divan*. Ky term ka disa domethënie, si p.sh. vëllim i poezisë ose i prozës, dispozitë, protokoll (te Nerkezi në fq. 126 e te Shkaliqi në fq. 220). Sipas Aniqit (fq. 224) kjo fjalë ka gjashtë domethënie.

Në grupin e nocioneve dhe të emrave nën shkronjën *Gj* duhej të regjistroheshin së paku edhe dy: *Gjergjelez (Alia)*, trim legjendar i boshnjakëve myslimanë në këngët dhe gojëdhënat popullore dhe *Gjulistan* (kopshti i trëndafilave).

Nën shkronjën *E* janë dhënë gjithsej tetë nocione, por mungojnë: *elif* (emërtimi i shkronjës së parë të alfabetit arab), *evlia* (njeri i shenjtë) dhe *elifba-sufara* (abetarja arabe).

Nën shkronjën *I* (në fq. 57, 58, 65, 68) janë trajtuar një varg personalitetesh nga radha e reformatorëve fetarë, njohësve arabë të traditës, shkencëtarëve spanjollo-arabë (p.sh. Ibn Hazm), poetëve mistikë, mistikëve spanjollo-arabë (p.sh. Ibn Arabi). Këta, krahas, termave të tjerë, e kanë pasuruar mjaft *Leksikonin e Nocioneve të Islamit*. Nga fjalët që nuk janë përfshirë nën këtë shkronjë, e do të duhej të parashtröheshin së paku në nga disa rreshta, po përmend këta: *ibadat* (lutje Zotit, falje dhe këndim – lexim), *ilmihal* (tekst shkollor mësim feje islame), *ihitib-*

ar (nder, nderim, respektim), ndërkaq më parë e kemi përmendur edhe fjalën *imaret* (kuzhinë bamirëse publike).

Shqyrtim të veçantë meriton zëri *Imam* i trajtuar pak më tepër në fq. 60 të *Leksikonit të Nocioneve të Islamit*. Është pozitive që autorët Bozhoviq e Simiq e kanë dhënë domethënien e parë të termit dhe gjatë historisë si dhe kushtet që kandidatët për imam duhet t'i plotësojnë, e ndër të cilat kushti i parë është - jeta dhe karakteri pa të meta, kurse te shiitët për imamë zgjidhen “besimtarët e shëndoshë, të ndershëm dhe të dijshtëm”. Përpos këtyre rezultateve dhe informacioneve të tjera, pa dyshim, pozitive, këtu do të mund të jepeshin edhe ato katër domethënie të fjalës *imam* sipas Shkaliqit (në fq. 345), si dhe një varg vërejtjesh dhe qëndrimesh në *Leksikonin e Nerkezit* (në f. 267-269). Është interesante se në librin *A e dini? (Da li znate?, Beograd, 2004)* në fq. 181 është paraqitur ndryshimi ndërmjet fjalës *imam* dhe *hoxhë*. Kjo është bërë në këtë mënyrë: imami është klerik i lartë i religjionit mysliman (islam), kurse hoxha është klerik i thjeshtë. Imami është klerik mysliman, si abati ndër katolikët, popi ndër ortodoksët, pastori ndër protestantët ose rabini – ndër çifutët.

Nën shkronjën *J* janë dhënë vetëm gjashtë njësi gjuhësore (islamike). Te Nerkezi, për shembull, janë trajtuar edhe tri të tjera: janiçari (jeniçerët) në

fq. 293-294, *jezici Islama* (gjuhët e Islamit) në fq. 300 dhe *Jeruzalem* (Jerusalemi) në fq. 294-299.

Nën shkronjën *K* autorët kanë trajtuar 57 fjalë dhe terma, ndër të cilat më hollësisht: *Kaba* (ky term ndoshta është më e drejtë të trajtohet nën shkronjën Q, pra të përdoret emërtimi Qaba, e në kllapa – Kaba), *Kadirije* (rend i dervishëve), *al-kalam* (fjala, të folurit, tregon “përdorimin e filozofisë në mbrojtjen e doktrinës fetare”, (Po ashtu në fq. 72), *Karmati* (emërtim i pjesëtarëve të një lëvizjeje shumë të përhapur religjioze-politike), *Kahin* (magjistër, falltar, klerik në bashkësitë e lashta), *Kibla* (drejtimi kah Meka), e sidomos *Kur’ani* (në fq. 77-78). Në lidhje me këtë libër të shenjtë ndoshta është dashur të thuhet se në shekullin IX janë përcaktuar mënyrat e ndryshme të leximit të Kur’anit në disa qendra: Medinë, Mekë, Damask, Kufë etj. (Për këtë shiko në librin *Religjia*, Beograd, 2004, nga Milan Vukomanoviq, në fq. 29).

Kjo pjesë e *Leksikonit të Nocioneve të Islamit* është dashur të plotësohet edhe me disa zëra, prej të cilëve më me rëndësi janë: *Kanunama* (urdhëresa e Sulltanit) dhe *Kalimedani*² (*Kale-megdan*).

² Kalimegdan, Kalemegdan, park në Beograd mbi grykën ku derdhet Sava në Danub. Nga fjala turke kale (qytet i fortifikuar) dhe mejdan (fushë, shesh, pjacë, dyluftim). Kjo fjalë (megdan, mejdan) ka ma shumë domethënie

Është simpatike që nën shkronjën *L* është treguar në mënyrë precize maksima e Muhamedit *La ilahe illa lah* (S’ka zot (tjetër) pos Allahut, në fq. 80). Aty është edhe shprehja *Lapashina xhamija* (Xhamia e Lapashës) në Livno dhe rreth dhjetë terma të tjerë faktikisht të marrë nga *Turcizmat* e Shkaliqit.

Nga termat nën shkronjën *M* që janë më shumë (150 zëra) disa janë trajtuar në mënyrë më të hollësishme, p.sh. *Mahkama* (gjyqi fetar), *mevlevije* (rend i dervishëve), *Medina, Meka, Muslimanska braqa* (*Vëllezërit myslimanë*) e sidomos dhe me fakte *Muhamd*. Disa zëra, si p.sh. shkollat, veçanërisht *Medresa* (në fq. 87) janë treguar varfërisht e pjesërisht edhe njëanshëm, si është thënë edhe më sipër.

Do t’i regjistrojmë edhe disa zëra që nuk janë në *Leksikonin e Nocioneve të Islamit*, e këto janë: *Nevruzi-sulltan* (dita e parë e pranverës, 21 marsi), *Synetia, Orienti, Orientalistika, Padishahu* (emërtimi i sundimtarëve islamë), *Palestina, Persia, letërsia, gjuha, kultura persiane, Gjysmëhëna* (simboli i Islamit), *Agjërimi, Pashai, Pashalluku, Pashalluku i Beogradit, Rahmeti* (mëshira e Zotit e domethënie të tjera), *rekati* (pjesë e lutjes, namazit), *raja, rubaia, Rumelia, sevapi, sevapi* (shpërblimi për vepër të mirë),

sihri, sihiri (sehîret, magjitë), *Sokoloviq Mehmed-pasha, dita e gjykimit, sulltani* (titulli i sundimtarit), *sabri, saburi* (durimi), *salnama* (vjetari, almanaku), *sanxhaku* (ka disa domethënie), *Sunitët*, sekt ose rrymë islame, e cila është shpjeguar vetëm me dy fjali në faqen 113, ndërsa shiitët dhe shiizmi janë shpjeguar në 3 shtylla (në fq. 157-158). Nuk janë përfshirë edhe disa terma, si p. sh. *Tarih* (historia), *tanzimati* (reformat), *terbijet* (edukata, prestigji), *Texhvidi* (rregullat fonetike për leximin (këndimin) e drejtë të Kur'anit), *turk* (pjesëtar i popullit turk, shpeshherë do të thotë edhe mysliman), *turcizmi, Topçideri*³, *Fallaka* (forma më e rëndë e dënimeve fizike në mejtepet e vjetra), *Fermani* (urdhëresa me shkrim e sundimtarëve myslimanë, të cilën duhej ta respektonte gjithkush; më shumë për këtë në librin *A e dini? (Da li znate?*, Beograd, 2004. në fq. 50), *hafiz, hafuz* (njeriu që e di përmendësh tërë Kur'anin), *hesap, hesab* (llogari, numër, vlerësim), *hiqaje* (tregim, ngjarje, diçka që ka ndodhur), *Hurriet* (Shpallja e Kushtetutës në Turqi në vitin 1909; emërtim i Shoqatës Zejtare Myslimane në Sarajevë), *Çarshia, çelexia* (zotëri, njeri i

edukuar mirë), *xhan* (shpirt), *Shahname* (ep i gjatë heroik i poetit persian Firdusi).

Përktheu nga boshnjakishtja:

Vehap Shita

³ Topçider – periferi e dikurshme, park dhe shëtitore e Beogradit, nga turqishtja topçu deresi (luginë e topçinjve).

RECENSIONE

Dr. Feti Mehdiu

SHPJEGIMI I KUPTIMEVE TË KUR'ANIT TË LARTË NË GJUHËN SHQIPE (përmbledhur në një vëllim) nga dr. Muhamed Taki-ud-Din El-Hilali dhe dr. Muhamed Muhsin Khan Përkthyer në gjuhën shqipe nga një grup përkthyesish pranë Darussalam, Riad, 2000, botimi i dytë, fq. 956.

Kështu është titulluar botimi, tash për tash, më i ri i një përkthimi të Kur'anit Kerimit në gjuhën shqipe.

Ky do të llogaritet si përkthimi i gjashtë i librit të shenjtë Islam në gjuhën shqipe. Nga 1985 e deri në vitin 1990 u patën botuar katër përkthime, kurse në vitin 1997-1998 u botua një përkthim në dhjetë vëllime, dhe më së fundi, në vitin 2000 doli edhe një përkthim, për të cilin do të themi disa fjalë në vazhdim. Nuk ka aspak dyshim se botimet e Kur'anit Kerim, qoftë në origjinal, qoftë të përkthyer në ndonjë rën nga gjuhët e ndryshme të botës,

është një ngjarje me rëndësi dhe është një veprim të cilit shumë kush ia ka lakmi, sepse është për lakmi. Por, gjithashtu është punë e cila kërkon angazhim me seriozitetin më të madh, gjë të cilën nuk e gjejmë te të gjitha përkthimet dhe botimet e deritashme.

Botimi të cilin e prezantojmë me këtë rast, në shikim të parë, duket të jetë serioz: me kopertinë luksoze, format dhe formë elegante, ngjyrë bari me shkronja ari dhe lidhje të fortë, mirëpo kur i sheh shënimet në faqet e para fiton një bindje krejt të kundërt.

Hapet nga ana e djathtë për në anën e majtë, me siguri nga arsyja se Kur'anit në origjinal fillon në këtë mënyrë, ngase origjinali është në gjuhën arabe dhe shkrimi arab shkon nga e djathta në të majtë, porse harrohet dedikimi se cilit lexues i ofrohet ky botim. Sa për lexuesin arab kësot botimesh nuk i hyjnë në punë fare, sepse ai ka botime shumë më cilësore dhe më praktike. Ndërsa lexuesin shqiptar, të cilit i dedikohet botimi, e fut në hutitë, sepse i duket sikur ia nis nga fundi e jo nga fillimi. Kjo është një zgjedhje jo e qëlluar, nga aspekti praktik i dështuar dhe nga aspekti teorik jo i detyruar.

Që nga ana e jashtme, kur lexojmë se ky është botim në gjuhën shqipe "*Në gjuhën shqipe*"... Nga dr. Muhamed Taki-ud-Din El – Hilali dhe... lind një dilemë: kush është ky dijetar që ka arritur të përkthejë Kur'anin famëlartë në gjuhën shqipe, i cili deri tani nuk ka qenë i njohur për opinionin shqiptar. Po ashtu në kopertinë, që, si të thuash, mund të trajtohet si pjesë përbërëse e titullit, lexojmë se e ka përkthyer në gjuhën shqipe një grup përkthyesish... dhe tani na del një pyetje kush çka ka bërë në këtë botim?! U mor vesh, në gjuhën shqipe e përktheu "*një grup përkthyesish*"..., por pse ai grup nuk është identifikuar se kush janë? Këtu nuk është fjala as për modesti as për mendje të madhe, këtu duhet

të dihet kush e bart barrën e meritave, por edhe të të metave eventuale. Sidomos për një punë kaq të madhe nuk mund të mos bëhet publik vepruesi i vërtetë, sepse u mbetet barra dy figurave të çmuara - M. Tekiu-ddin dhe M. M. Han.

Në faqen 1 qëndron edhe ky tekst: Versioni i përmbledhur i At-Tabari, Al-Kurtubi dhe Ibn-Kethir me komente nga Sahih Al-Bukhari përmbledhur në një vëllim. Veprat e të tre autorëve të përmendur, që janë autoritete të çmuara në fushën e tefsirit dhe i kaktërti Bukhari – në vend se të shkruhej shqip Bukhari, kanë nga disa vëllime, e si ka ndodhur që këta zotërinj anonimë - Grup përkthyesish, arrijnë t'i përmbledhin në një vëllim - është mjaft e çuditshme.

Në faqen 2, përveç disa shënimeve gjenerale, të cilat gjithashtu janë të stërngatërruara, është edhe një formulim vetvetiu i mjegulluar, por edhe që nxit mjegullime. "*Ky është... një ekip i kualifikuar pranë shtëpisë botuese...*", po përse pra anonim, pasi qenka aq i kualifikuar, për çka frikësohet të dalë për fushë? Pastaj shprehja "*Janë bërë të gjitha përpjekjet për të shmangur çdo gabim te botimet e mëparshme*", nxit dyshimin te lexuesit se botimet e mëparshme paskan qenë gabim, pa thënë fare se për cilat botime është fjala. A thua vallë, si i kanë lexuar këta zotërinj anonimë botimet e

mëparshme, symbyllur apo me tejëqyrje?

Nga faqja 4-9, jepen disa, gjoja sqarime, por që më tepër të neverisin, si: përmbajtje, dy fjalë nga botuesi, njohuri për përkthyesit etj., nga të cilat lexuesi shqiptar do ta kuptojë se “*ekipi i kualifikuar*” fort pak marrka erë nga puna së cilës i ka hyrë ta bëjë. Nuk tregojnë se cilën pjesë nga cila gjuhë e kanë përkthyer, por shihet se si e kanë përkthyer dhe si e kanë shkruar emrin All-llah dhe Muhammed! Ata nuk e njohin shenjen shëdde të grafisë arabe që është e domosdoshme për të shënuar emrat e sipërpërmendur. Ata edhe ajetin e Kur’anit e quajnë varg “... shpjegimin e kuptimeve të vargjeve të tij...”, “... të pashoqëruar me vargjet në gjuhën arabe” (fq.5). Ndërsa përkthimi “*Zoti i Aleminit*” çka u duhet? Nuk e dinë çka do të thotë “alemun”.

“...*Ekipi i kualifikuar*...” i fillon fjalitë, pa kurrfarë arsyeje”, ashtu siç janë në arabisht: Tregon Ebu Hurejreja, tregon Xhabiri, Tregon Ibn Umeri r.a. etj., në vend se këto fjalë t’i fillojë sipas natyrës së gjuhës shqipe, t’i bëjë fjalë emërore. Natyra e gjuhës arabe preferon fjalitë foljore, por kjo aspak nuk dëmton kuptimin e fjalisë nëse ia përshtat gjuhës shqipe.

Faqe 11-902 vjen Kur’ani Kerim në origjinal, arabisht dhe i përkthyer në gjuhën shqipe. Përkthimi është i

pajisur me tekstin origjinal të Kur’anit a.sh., sipas metodës të cilën tanimë e zbaton që disa kohë shtëpia botuese e Mbretit Fahd bin Abdu-laziz për shtyp të Kur’anit a.sh. në Medine. Në të njëjtën faqe është vënë teksti origjinal dhe përkthimi në gjuhën shqipe, por nuk është përdorur me korrektësi shprehja në titullin e këtij botimi. Nga titulli, lexuesi pret që këtu të gjejë: “*Shpjegimi i kuptimeve të Kur’anit të lartë...*”, por ai gjen, në origjinal vetëm tekstin e Kur’anit, jo edhe të shpjegimeve, kurse në gjuhën shqipe gjen edhe ndonjë shpjegim plotësues sipas tefsirëve tradicionalë, me të cilat shpjegime vetëm se ia ka humbur orientimin lexuesit dhe e ka vënë në dilemë se cilat fjalë, në gjuhën shqipe, i referohen tekstit origjinal të Kur’anit a.sh. e cilat janë pjesë e sqarimit.

Në këtë botim janë ngatërruar konceptet e përkthimit dhe nuk janë realizuar si duhet asnjëri. Dëshirohet të përkthehet një përkthim intralinguistik i Kur’anit në gjuhën arabe, por në praktikë është bërë një ngatërrim: paraqitet vetëm teksti i Kur’anit dhe fli-tet për tekstin e përkthyer të Kur’anit, siç dëshirojnë ta quajnë ata, të komentuar. Nuk kanë respektuar metodë adekuate për një punë të tillë.

Sa për një ilustrim krahasoni ajetin 53 nga sureja Al-u Imran, ku thuhet: “*O Zoti ynë në besojmë në atë çka ke dërguar dhe pasojmë të Dërguarin,*

andaj na evidento, na shkruaj me dëshmitarët”. Ndërsa ata që pretendojnë se po i japin shpjegim kuptimeve të Kur’anit, pa u ndalur të mendojnë se çka do të thotë – Kuptime, këtë ajet krejtësisht të qartë e kanë përkthyer:

“*Zoti ynë! Ne besojmë në atë çfarë Ti na ke dërguar dhe ndjekim të Dërguarin tënd (Isain). Na shkruaj pra prej dëshmuesve (të së vërtetës – La ilahe il-Allah – Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar përveç Allahut.)*”.

Ata që dinë origjinalin le ta krahasojnë, kurse ata që nuk dinë, në rast devijimi i paqin më qafë “*ekipi i kualifikuar pranë Darussalamit*”. (fq.92). Përveç këtyre ngarkesave, brenda tekstit të ajetit, përkthyesit anonim kanë dhënë sqarime edhe jashtë tekstit të ajetit, në fund të faqes, me ç’rast si duket kanë marrë përsipër ta maltretojnë lexuesin me gjithfarë historish vetëm e vetëm që të mos e lejnë ta shijojë thelbin e Kur’anit dhe bukurinë e qartësinë e tij, të paktën aq sa është i qartë për lexuesit konkretë dhe kohën konkrete. Këto sqarime vazhdimisht janë rezultat se: ka thënë Enesi..., ka thënë Ibn Abbasi..., tregon Enesi..., tregon Umeri... etj. Kanë sqaruar : “*Ora është një nga pesë gjërat që i di vetëm Allahu*” (fq.102). Sqarim se jo shaka! Pastaj edhe kështu: “*Vërtet dija për Orën është vetëm e Allahut*” (e njëjta faqe). Krahasoni përkthimet e tjera të Kur’anit a. sh. dhe binduni se

për çfarë ore është fjala! Ata edhe pjesën e ajetit “... *inde rab-bihim*...” e përkthejnë “...*me Zotin e tyre*...”, në vend se ta përkthejnë “...*te Zoti i tyre*...” (fq.301). Ku e kanë gjetur këtë, është punë e tyre, por Kur’anit dhe lexuesit i kanë mbetur borxh! Ata gjithmonë thonë – me shkrim – *La ilahe il-Allah* (fq. 431) dhe çka mendojnë me këtë vetëm ata e dinë, por lexuesi më i zakonshëm mysliman e di se kjo është *La ilahe il-lall-llah*, ngase kjo është dëshmia e parë dhe më e thekshta për një mysliman.

Përkthyesit e këtij botimi janë të parët që në përkthimin e tyre bëjnë konstrakte fjalish sikur këto: “*udhëheqje për El-Muttekunët, besojnë në Ghaib, duke u bërë kështu Dhalimunë* (f.30), *Ai isteva...siç i shkon Madhështisë së Tij...* (354), *është Meula* (815), *Dhe përgënjeshtrohet El-Husna*”, e shumë të tjera për të cilat përkthyesit e mëparshëm kanë gjetur fjalë të gurrës shqipe, të cilat i kanë shprehur shumë më mirë e më qartë këto konstrakte të fjalëve të Kur’anit. Kjo formë e përkthimit është në disproporcion me nivelin e lexuesve të sotëm shqiptarë. Më tepër do të ishte për nivelin e lexuesve të fillimit të shekullit 20-të se këtyre të sotmëve.

Shembujt që u përmendën nuk janë të rastit, sepse përdoren gjatë tërë tekstit, e për çfarë arsyeje, për këtë herë në këtë hapësirë nuk ka mundësi të

flitet më hollësisht. Edhe përdorimi, gjithsesi i gabuar, "... il Allahut a.s. dhe Bukhari...", që përdoren gjatë tërë këtij përkthimi nuk janë dëshmi se kemi të bëjmë me një ekip të kualifikuar, por dëshmojnë të kundërtën. Përse ndodh kështu, kjo mund të sqarohet tjetër herë dhe në nivel tjetër. Këtu vetëm bëhet prezantimi dhe kemi për qëllim të japim sugjerimet tona se edhe me këtë përkthim e botim të Kur'anit në gjuhën shqipe nuk është vepruar me korrektësinë që jemi të detyruar të veprojmë me Kur'anin a. sh.

Prej faqes 903-953 janë përkthyer edhe disa tekste me përmbajtje të ndryshme, të cilat për lexuesit e sotëm shqiptarë janë të tejkaluara që moti. Këtu lexuesi do të gjejë tekstet:

Pse Allahu çoi Pejgamber dhe të Dërguar (Paqja qoftë mbi ta)?

Teuhidi

Shehadeti - Dëshmia e Myslimanit

Isai dhe Muhamedi (paqja qoftë mbi ta) në Bibël dhe në Kur'an

Profecia biblike mbi ardhjen e Muhamedit (a.s.)

Përfundim mbi provat për fabrikimin e ndodhisë së kryqit

Shirku dhe kufri (Politeizmi dhe monohimi)

En-Nifak, hipokrizia dhe format e ndryshme të shfaqjes së saj

SHTOJCË II: Thirrja islame vendosmëria për Çështjen e Allahut në Kur'an.

Siç duket këto janë tekste të shkruara nga: Sheikh Abdullah bin Muhamed bin Humejd, Kryegjykatësi i Arabisë Saudite.

Këto tekste mbase janë shumë të mira për ndonjë kategori të caktuar lexuesish, të cilët duhet të mësojnë edhe shehadetin, por të përfshihen në një botim të Kur'anit të përkthyer në gjuhën shqipe, për lexuesin shqiptar janë krejtësisht jashtë kontekstit. Po të ishte botuar ky përkthim para 40-50 vjetësh ndoshta do të ishin me interes edhe ato shënime, sado që nuk janë herrur për lexuesit e Kur'anit, por në vitin 2000 lexuesi shqiptar, tanimë ka pasur rastin që disa dekada më parë të lexojë literaturë jo vetëm për shehadetin që i prezantohet këtu, por edhe në nivel shumë më të lartë. Edhe këto shënime janë të përkthyer aq pa kujdes aq sa, kërkoj falje nga autori i tyre i cili sigurisht i ka shkruar më mirë në gjuhën e vet, më mirë të mos ishin fare këtu. Le të bënin një botim të veçantë, pasi që e paskan vendosur përkthyesit e kualifikuar të kontribuojnë edhe në këtë nivel.

Përkthyesit prej fillimit e deri në fund të Kur'anit a.s.h., invokacionin *Bismil-lahirrr-rrahmanirr-rrahim*, rrafsh 114 herë e kanë përkthyer gabimisht, dhe tash prapë për të njëqindëpesëmbëdhjetën herë në faqen 903 e kanë bërë:

"Me Emrin e Allahut, i Gjithmëshirshmi, Mëshirëploti". Ata nuk e kanë lodhur trurin ta shohin se në origjinal, edhe "*Rrahman*" edhe "*Rrahim*" janë në gjenitivë dhe prandaj duhet të jetë: "*Në emër të All-llahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit*". Duhet të jetë kështu për shkak se para-fjala arabe *bi*, këtu nuk tregon mjetin a shoqërimin me ndonjë send, konkretisht me emrin e All-llahut, por tregon se dikush kryen një veprim sipas autorizimit të dikujt. Në këtë rast besimtari islam merr guximin që sipas autorizimit të Krijuesit të vet të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit, të fillojë një punë. Përkthyesit e këtij botimi, duhet përkujtuar se kur ndonjëri prej tyre merr rolin e prijësit të tërë grupit dhe i shpreh mirënjohje, f. v. shtëpisë botuese "Darussalam", thotë me emrin e grupit punues apo thotë në emër të grupit punues. Sigurisht, nëse marrin frymë shqip do të thonë: Në emër të grupit punues, njëlloj siç thuhet edhe në gjuhën arabe bismil-lahi...

Kanë qenë aq të pakujdesshëm, ose aq të padijshëm, sa në të njëjtën faqe (903) katër herë e kanë shkruar gabimisht *La ilahe il-Allah*, e kjo do të thotë në gjuhën shqipe "*Nuk ka zot All-llah*", All-llahu i faltë dhe i udhëzofhtë të mësojnë se kjo duhet shkruar *La ilahe il-lall-llah* – Nuk ka zot përveç All-llahut! Kjo mjafton, nuk ka nevojë të hapësh kllapa për të shkruar

një grumbull fjalësh dhe prapë të mos thuash asgjë të vlefshme. Pastaj të shkruhet e të shqiptohet: All-llah, Muhammed, sepse këta emra nuk janë të brumit shqip, por arab dhe ata kanë teshdid.

Pa dëshirën time duhet t'i maltretoj lexuesit edhe me disa fjali konfuze dhe të thurura mbrapsht nga përkthyesit, me qëllim që të heqin dyshimin se këtu nuk ishte fjala për përkthyes të kualifikuar, por përkthyes të kamufluar, prandaj as emrat nuk i kanë vënë të marrin përgjegjësin a lavdin për punën që kanë bërë. Ata shkruajnë: "... *derisa sytë e pejgamberit i gufuan, ndërrsa vërshoi Ebu Bekri përmbi Ukban dhe...*" (f.932), *Khalid bin Velid, Bukhariu, Omer bin Khatabit, Khalifi i Muslimanëve, Khalif i udhëzuar drejt, (f.948-949) etj., "Dhe për atë që ata janë trupat e Allahit dhe..."* (947) "... *dhe vrau një pjesë nga njerëzit e kësaj shtëpie dhe ata e menduan atë të ishte burrë...*" ...e shpërndanë vetveten pjesë-pjesë...", dhe të tjera sikur këto që nuk duan koment. Çfarë mund të mësojë lexuesi shqiptar nga këso farë "xhevahirësh", përveç gërdisë nga leximi edhe i Kur'anit.

Po "NJOFTIM"- i në faqen 954, çfarë funksioni ka këtu? Njëherë, sa është i qartë? Ku e ka fillin?

Po e zëmë se është gabim, për shkak të ngutjes, kur thonë: Kur'ani i Madhërishtëm Përkthyer nga dr. Mu-

hamed Taki-ud-Din Al-Hilali dhe dr. Muhamed Muhsin Khan, e këta të dy asnjëri nuk dinë shqip fare, por ec e merre vesh pasuesin vijues:

“Atëherë, si mund të thuhet se ky përkthim i Kur’anit të Madhërishëm nga dr. Taki-ud-Din Al-Hilali dhe dr. Muhamed Muhsin Khan është marrë nga Muhamed bin Abdul-Vahab, i cili ka vdekur në vitin 1206 Hixhrij pra, me një ndryshim në kohë prej qindra vjetësh (nga 400 deri në 1000 vjet) midis këtij të fundit dhe Tabariut, Ku-

rtubiut, Ibn Kethirit dhe Bukhariut!” – përshkrim besnikërisht!

Do të pyes përkthyesit: Çfarë lidhje ka kjo me përkthimin në gjuhën shqipe dhe ku e ka atë lidhje? Ashtu si çuditen ata “si mund të thuhet...” unë çuditem: kush tha, çka tha e kur e tha!

Përfundon me treguesin e Sureve (fq.955-956), duke dhënë emrin e sures, numrin e sures dhe numrin e faqes, si edhe shënimin a është surja e zbritur në Mekke apo në Medine, që janë standarde të të gjitha përkthimet dhe botimet.

RECENSIONE

Shevki Voca

LIBRI QË SHKAKTOI PËRÇARJE NË MESIN E AKADEMIKËVË SERBË

Kohë më parë shtëpia botuese “CLIO” në Beograd botoi në përkthim librin “POLITIKA” të autorit të njohur amerikan Andrew Heywood, i cili për recensent të saj kishte zgjedhur akademikun serb Vojislav Stanovčić. Botimi i këtij libri u ndihmua nga Seksioni për kulturë dhe shtyp i Ambasadës Amerikane në Beograd. Për nga forma dhe vëllimi me rreth 900 faqe, ky libër është mjaft impresiv. Menjëherë pas daljes nga shtypi, libri u gjend nëpër biblioteka kryesore, qofshin ato universitare apo rajonale, ndërsa studentëve të Fakultetit të Shkencave Politike, në Beograd, nga recensenti i librit akademik V. Stanovčić, dikur ligjërues i rregullt në po këtë fakultet,

iu preferua si tekst shkollor, që mund të shfrytëzohet në disa lëndë.

Libri “Politika” i ekspertit të kësaj veprimtarie, amerikanit A. Heywood, u përkthye në shumë gjuhë botërore dhe gjeti veten si te shtresat e gjera intelektuale e shkencore po ashtu edhe tek opinioni i gjerë kureshtar, që thjesht dëshirojnë të dinë dhe të njihen më për së afërmi me shkencat politike. Ajo u botua në vitin 1997 dhe u ribotua në vitin 2002, ndërsa përkthimi në gjuhën serbe në vitin 2004. Kaluan më tepër se dy vjet prej se libri arriti në duar të lexuesve, dhe asgjë nuk shkaktoi në prishjen e ekuilibrit, përderisa nuk reagoi profesori i Universitetit të Sarajevës si dhe profesor nderi nëpër universitetet Jejl, Montreal, Otavë,

Banja Llukë etj., Emilio Vlajki, i cili sipas medieeve serbe ishte i pari që i bëri një analizë këtij libri. Ai menjëherë pas leximit të librit shkroi një letër, të cilën më pas ua dërgoi qindra adresave serbe si dhe shumë institucione shtetërore dhe medimeve të ndryshme, duke ua tërhequr vëmendjen se në këtë libër populli serb paraqitet si popull i një politike gjenocide dhe fashiste, e cila i ngjante asaj të Luftës së Dytë Botërore, dhe duke iu drejtuar popullit serb në përgjithësi thotë: “A jeni të vetëdijshëm që fëmijët tuaj nëpër institucionet shkollore mësojnë për ju se jeni popull gjenocid-bërës.” Vlajki kërkon që libri në fjalë të tërhiqet nga programi i mësim-it shkollor në Fakultetin e Shkencave Politike dhe që studentët të mos mësojnë prej saj, ndërkaj që apeloj te recensenti i librit akademik Vojislav Stanovčić. Thënë kalimthi se profesori E. Vlajki, para disa vjetësh kishte botuar një shkrim me titull “Terrori dhe prostitucioni në Jugosllavi” në të cilën mes tjerash shkruante se si nëpër tekstet shkollore të klasës VIII-të në Serbi, në njëfarë mënyre arsyetohej sulmi nga ana e forcave të NATO-s në këtë vend. Kjo kaloi pa u vërejtur, por tek pas reagimit të tij për librin “Politika” të Hejvudit, u nxitën polemika edhe rreth kësaj.

Sipas medieeve serbe, kjo letër menjëherë pas paraqitjes së saj nëpër me-

dia të ndryshme informative, nxiti reagime të shumta si te qytetarët po ashtu edhe ndër institucione të ndryshme shkencore, që nga profesorët e fakulteteve e deri te institucioni më i lartë shkencor ASHAS, që në mesin e këtyre shkaktoi një përçarje, në të cilën më i zhurmshmi ishte akademiku dhe filozofi Mihajlo Marković, i cili shumë ashpër i kritikoi të gjithë ata që nuk kishin reaguar dhe që tani nuk reagojnë lidhur me këtë paraqitje skandaloze, siç shprehet ai. Më vonë do t’i paraqesim reagimet e Mihajloviqit në ASHAS dhe të disa intelektualëve tjerë serbë.

Në vazhdim i referohemi librit “Politika” të autorit E. Hejvud, nga e cila i citojmë disa pjesë që kanë të bëjnë me popullin serb. Në faqen 219 të librit “Politika” në mes tjerash shkruan: “Sikurse që e kishin kuptuar nazistët, njësoj më vonë e kuptuan edhe serbët e Bosnjës, se e vetmja mënyrë dhe më e sigurt për të formuar shtetin politiko-kulturor të bashkimit nacional është programi i spastrimit etnik.”

“Lufta e Dytë Botërore, shkruan në faqen 223 të librit, në masë të madhe ishte rezultat i programit të ekspansionizmit imperialist të inspiruar nga nacionalizmi, të cilën e zbatonin (udhëhiqnin Sh.V) Japonia, Gjermania dhe Italia. Shembulli i fundit dhe shkatërrues i kësaj forme të nacionalizmit në Europë ishin përpjekjet e serbëve të

Bosnjës që të krijojnë “Serbinë e madhe.”

Më pas autori i E. Hejvord, duke dërguar kritika në adresë të bashkësisë ndërkombëtare thotë: “Në vend se ta vendosë rendin botëror, i cili bazohet në respektin e lirisë dhe të drejtave të njeriut, bashkësia ndërkombëtare në ish-Jugosllavi qëndronte anash, dhe përderisa nuk shpërtheu kriza në Kosovë, i lejonte Serbisë të zhvillojë luftë për zgjerimin e territoreve duke zbatuar një politikë gjenocidi, e cila i ngjante asaj të Luftës Dytë Botërore” fq. 264-265. Ndërsa, në vazhdim në faqen 279, autori duke bërë fjalë për organizatat mbrojtëse me ç’rast këtu veçohet NATO, ai shkruan: “Për më tepër, roli i saj (NATO-s) për mbrojtje dhe siguri, sipas gjitha gjasave është ndërruar dhe tani aksenti është vënë në intervenimet humanitare dhe në ruajtjen e paqes. E këtë më së miri e dëshmoi intervenimi i bërë në Kosovë më 1999, që u ndërmor për t’i dhënë fund okupimit serb të Kosovës...”

Tani u kthehemi reagimeve të filozofit serb Mihajlo Markoviq, i cili pothuajse në disa momente e kishte qitur në harresë autorin e librit dhe vetë librin, ndërsa që kritika të ashpra dhe të pamatura i ka adresuar recensionit të këtij libri, akademikut Vojislav Stanovciq, anëtarit me korrespondencë të ASHAS, ndërkaq që propozojë të bëhet anëtar i rregullt i këtij institu-

cioni shkencor serb. M. Markoviq në kuvendin vjetor të Akademisë Serbe të Shkencave, që u mbajt pak kohë më parë, duke u munduar në tërësi ta zhvlerësojë librin e Hejvordit, në mes tjerash thekson: “Akademia Serbe e Shkencave nuk mund ta bartë përgjegjësinë për një libër të tillë, i cili ideologjikisht është i dobët dhe i njëanshëm dhe joobjektiv, duke vazhduar se është dobësi që Vojislav Stanovciq është anëtar me korrespondencë i Akademisë. Dobësia më e madhe është që nga mesi jonë (akademisë) dikush atë e propozon për anëtar të rregullt. Për më vjen në shprehje dobësia, në të cilën e keqja qëndron mu aty, se ai është zëvendës i sekretarit të seksionit të shkencave shoqërore. Ndërsa, që e keqja dhe dobësia të jetë edhe më e madhe, është, se ai përsëri propozohet që të zgjidhet në detyrën e zëvendësit të sekretarit, ndërkaq nëse ai zgjidhet për anëtar të rregullt në Akademi, ndodh që të bëhet sekretar i seksionit. Më pas duke u munduar ta njollosë të kaluarën e Stanovciqit, ai thotë: “Profesori dr. Vojislav Stanovciq ishte zgjedhur për anëtar me korrespondencë në bazë të biografisë në të cilën theksohen punimet e tij shkencore, të cilat pritej që shumë shpejt të dalin nga shtypi, ngase paralajmëronin të jenë vepra kapitale (“Historia e ideve politike”), por që këto as tetëmbëdhjetë vjet më vonë nuk u publikuan. Kandidati në fjalë,

vazhdon Mihajloviq, nuk ka qenë mjaft i kualifikuar për zgjedhje (me korrespondencë) të ASHAS, ndërsa që gati dy dekada pas asaj zgjedhjeje dhe përkundër të gjitha punimeve të tij, ai ende nuk i plotëson të gjitha kushtet që parashihen me rregullore dhe nenit 11 të Ligjit të ASHAS”. Mihajloviq nuk ngurron ta quajë kolegun e vet gënjeshtar, me ç’rast thotë se “Stanovciq vazhdon të gënjejë kolegët e vet, kur pohon se libri (skandaloz vër. e M. M) “Politika” i Hejvudit, nuk shërben si tekst shkollor në Fakultetin e Shkencave Politike, edhe nëse është e kundërta e asaj që e thotë, dhe se ai nuk e paska shkruar recensionin për këtë veper, përkundër faktit se në libër figuron emri i tij si recensent i saj”! Argumentet për këtë, thotë Markoviq, qëndrojnë në epilogun e librit të përfshirë në 32 faqe (shiko f. 827-859 të librit botimi Bg, SH.V.) e cila në mënyrë tejet të hapur këtë libër e ngrit në një nivel të lartë, nga i cili studentët serbë duhet të mësojnë: se i takojnë popullit gjenocid-bërës, të cilët nga motivet e shtyra për zgjerime territoriale kryenin spastrime etnike, dhe të cilët e mbajtën Kosovën nën okupim përderisa nuk intervenuan forcat ushtarake të NATO-s, dhe në fund serbët vepruan sikurse nazistët gjermanë dhe fashistët italianë e japonezë.”, thekson M. Markoviq.

Akademiku Vojislav Stanovciq, sikurse që thamë më parë, ishte propozuar për anëtar të rregullt të ASHAS. Mirëpo, ndodhi që në mbledhjen e kuvendit vjetore të Akademisë Serbe, në të cilën pritej që Stanovciq të pranohet si anëtar i rregullt i Akademisë-akademikët e njohur serbë të ndahen në dy grupe, ngase prej tetë akademikëve, sa ishin të pranishëm në kuvend, pesë prej tyre dolën me vota kundër Stanovciqit, ndërsa tre të tjerë ishin për pranimin e tij si anëtar i rregullt i Akademisë. Në mesin e atyre që votuan apo i dhanë përkrahje Stanovciqit, ishte edhe akademiku Ljubomir Tadiq, babai i kryetarit të Serbisë, Boris Tadiq.

Ndërkaq, që akademiku Stanovciq u gjend në një pozitë mjaft të padëshiruar. Ai, duke u deklaruar nëpërmes medieve të ndryshme serbe, ku i mbronte qëndrimet e veta ndaj veprës në fjalë, mes tjerash thotë: “Së pari sa i përket librit “Politika” të E. Hejvudit, ajo studentëve të Fakultetit të Shkencave Politike nuk iu është propozuar si tekst i obligueshëm, por si pjesë e literaturës së zgjeruar, e cila si e tillë mund t’i ketë cilësitë dhe dobësitë e veta, dhe e dyta, unë konsideroja që studentët janë mjaft të pjekur me ç’rast mund të dinë të vlerësojnë se cilës pjesë të saj duhet t’i dhurohet besimi, dhe cilat pjesë duhet t’i nënshtrohen kritikës.” Ndërsa sa i përket

recensimit të librit, do të thosha një të vërtetë. Unë e kam recensuar botimin e parë të kësaj vepre, e cila u botua në vitin 1997, në të cilën nuk bëhej asnjë fjalë për okupimin serb të Kosovës, sepse ky problem siç dihet është përshkallëzuar pas botimit të parë të librit të Hejvudit. Me këtë rast më duhet të pranoj se është bërë një lëshim, për të cilin duhet të them se botimin e dytë të librit nuk e kam kontrolluar në detaje, për shkak se kam menduar që qëndrimet e autorit janë të njëjta me ato nga botimi i parë.” Ndërsa në një intervistë dhënë gazetës “Politika” të Beogradit, Stanovçiqi në mes tjerash u përgjigjet edhe sulmeve të Markoviqit, me ç’rast thotë: “Shikuar në esencë këto sulme nuk kanë lidhje me librin e Hejvudit, por janë të kohës së mëherëshme dhe kanë të bëjnë me një mospajtim ideologjik mes meje dhe atij, kur unë si anëtar i Akademisë (me korrespondencë) kisha nënshkruar dy herë (1992 dhe 1999), kërkesën në të cilën theksohej dorëheqja e Slobodan Millosheviqit.” Profesor Stanovçiqi, gjithashtu, duke vlerësuar librin e autorit Hejvud, thotë se pjesët e mira të saj janë shkrimet për Noam Qomskin, për të cilin thotë Stanovçiq, pak njerëz në Perëndim e çmojnë, (për shkak kritikave të ashpra ndaj politikës së jashtme të SHBA-së, si dhe që ishte treguar shumë i zëshëm kundër bom-

bardimit të NATO-s në Serbi, si duket për këtë shkak.

Stanovçiq e cek Qomskin, (SH.V.), pastaj pjesët për Leninin, Prudonin dhe shumë e shumë të tjerë, që kanë zënë vend në këtë libër.

Ministri i Arsimit dhe Sportit i Serbisë, Slobodan Vuksanoviq, pasi që letra e Emilio Vlajkit ishte drejtuar edhe në këtë adresë, i përkujtoi të gjithë ata që e akuzuan këtë ministri për shkak të moscensurimit të librit në fjalë, se në vendet demokratike shteti nuk është ai që bën censurimin e teksteve dhe librave. Vuksanoviq më tej thotë: “Ministria e Arsimit nuk është adresë e saktë, ndërkaq që kritikët duhet t’i drejtohen dekanatit të Fakultetit të Shkencave Politike dhe Këshillit të fakultetit, si dhe ata duhet të dinë se këtu respektohet autonomia e universitetit, dhe se ata (kritikët) ose janë ende në periudhën e komunizmit ose jetojnë në kohën e gurit.”

Ndërsa sa u përket intelektualëve të tjerë, që reagues menjëherë pas publikimit të letrës së Emilio Vlajkit, numri i të cilëve ishte i madh, nga të cilët për këtë rast ne do t’i veçojmë disa. Dr. Oliver Antiq, profesor i Fakulteti Juridik në Beograd, duke dhënë një intervistë lidhur me këtë thotë: “Shikoni këtë çështje; momentalisht Serbia gjendet në një kaos të vërtetë në çdo aspekt, pra edhe në këtë. Ja ku është Kroacia që më duhet të pranoj se

në disa aspekte politike shpesh ka qenë më e favorshme se ne, atje p. sh., fakultetet janë shtetërore dhe nuk mund të jenë private. Kuadrot atje shkollohen për shtetin, që do të thotë se në të ardhmen ata do të jenë prokurorë, gjyqtarë dhe bartës të funksioneve shtetërore.” Profesor Antiq e përmend edhe autorin e letrës E. Vlajkin për të cilin thotë: “Ai është një personalitet shumë serioz. Por, a dini çka, asgjë nuk mund të ndodhë krejt rastësisht. Z. Vlajki është hebre, dhe thjesht ka vërejtur se bota në njëfarë mënyrë çdoherë e më tepër i ngjason Europës së viteve të tridhjeta!” (Këtu profesori Antiq aludon në kohën e përndjekjeve të hebrenjve, por me këtë rast, sipas tij, në vend të hebrenjve viktimë janë serbët plot. SH. V.). Profesor Antiq e zë në gojë edhe autonominë e universitetit, duke thënë se ajo me të vërtetë është e shenjtë, dhe ne si profesorë për lëndën të cilën e ligjërojmë mund të themi çka të duam, kuptohet në aspektin e formës së shpjegimit, por me këtë rast bëhet fjalë për diç tjetër. Si e para libri “Politika” është import i jashtëm, dhe nuk e ligjëron profesori nga universiteti ynë, pra nuk është E. Hejvud profesor te ne, dhe duke bërë një krahasim shton: “Kjo kishte me qenë njësoj sikurse të ishte importuar një libër për Osama bin Ladenin, dhe pastaj ajo studentëve në Fakultetin e Shkencave Politike t’u propozohet si

tekst i obliguar, ndërsa për arsyetim të thuhet: “Po, kjo është autonomia e universitetit, në të cilën ne nuk mund të përzhemi”.

Intelektuali, Slobodan Turllakov, thellë i goditur me atë se çka shkruan në librin e amerikanit Endu Hejvud, në mes tjerash thotë: “Si është e mundur që përkundër të gjithë atyre intelektualëve serbë që merren me këtë çështje shkencore, të dalë një jo-serb që të na bëjë me dije për këtë marri të paparë në botë, dhe vazhdon: “Unë dikur kam shkruar dhe kam thënë, se është e rëndomtë që pjesa më e keqe e një populli janë intelektualët, ndërsa intelektualët tanë janë edhe zuzarë”. Ndërsa intelektuali i organizatës fetare “Për jetë pa vulë”, Aleksandër Paviq, duke bërë fjalë për elitën serbe në përgjithësi citon mjekun Arqibald Rajs, (Rajsi ishte nga Lozana, me profesion doktor shkence në kimi, por më shumë është marrë me kriminalistikë, ai kishte kontaktuar me Nikolla Pashiqin dhe Stojan Protiqin nga radikalët e Serbisë, i cili më pas lajmërohet në ushtrinë serbe dhe merr pjesë në Luftën e Parë Botërore, ndërsa në shenjë respekti nga serbët nderohet me urdhrin e kapitenit të ushtrisë serbe, plot. SH.V) i cili për popullin serb ka thënë:

“As popull më të mirë, as elitë më të keqe”. Më pas duke vazhduar Paviqi thotë: “Kur jemi te libri i Hejvudit, njeriu i cili është recensent i saj, i cili

madje ka pranuar se nuk e ka lexuar librin, atëherë na bëhet e qartë se ai ka nënshkruar për ndonjë arsye. Si duket ne po e dimë se çka nuk dëshirojmë, por a thua jemi duke ditur se çka dëshirojmë”? - thotë Paviq. Lideri serb nga “Dera e altarit serb” Vladan Glisliq, duke përqeshur rolin e institucioneve serbe në përgjithësi, mes tjerash thotë: “Diçka është e vërtetë, të gjitha institucionet që i kemi, nuk janë asgjë tjetër përveç shkronjave të vdekura në letër, të cilat paraqesin vetëm ndërtesat, fasadat dhe ndonjë inventar, dhe duke vazhduar shton: “Atë çka z. Emilio Vlajki e gjeti, është vetëm një pikë uji nga deti, prej tërë asaj çka neve për çdo ditë na ndodhë nëpër shkolla dhe institucione të ndryshme.” Branislav Matiq, kryeredaktor i revistës “Evropa Nacija” librin e Hejvudit e quan pamflet antiserb, ndërsa për elitën serbe thotë: “Është paradoksale, por e vërtetë dhe e sigurt që elita serbe sot për shumë arsye është pjesa më e dobët e kombit serb.” Intelektuali tjetër profesor doktor Vlladan Çetković, profesor shumëvjeçar në Fakultetin e Shkencave Politike, ndërsa tani i angazhuar në ligjëratat dhe provimet e studimeve pasuniversitare në fakultetin e njëjtë, si dhe ligjërues i lëndës Metodologjia e hulumtimit në dukuritë e sigurimit, të cilën e ligjëron në Akademinë Policore gjithashtu në studimet pasuniversitare, për librin “Poli-

tika” të E. Hejvudit thotë: “Ai libër është një lloj engjëlli mëshirues, i cili prapë bombardon, por këtë herë duke u shërbyer me falsifikime dhe gënjeshtër dhe atë me ndihmën e lokatorëve, njëri prej të cilëve mban titullin e anëtarit të rregullt të ASHAS.” Profesori në fjalë duke u përqendruar në dukuritë tejet negative siç shprehet ai, që janë prezente në shoqërinë serbe, më tepër i fajëson organizatat joqeveritare, për të cilat thotë se ato me të madhe janë të involvuara në fushata kundër interesave të Serbisë, me ç’rast nuk ngurron t’i cekë disa emra si për shembull Sonja Biserko, Natasha Kandiq, Biljana Kovačević-Vuqo, pastaj Gratë në të zeza, për të cilat thotë se paraqiten çdoherë kur është gjendja e Serbisë tejet e rëndë, dhe atë kundër interesave të Serbisë.

Është për t’u habitur se si popullata serbe të gjitha disfatat, qofshin ato ushtarake apo politike, i përjeton si komplete ndërkombëtare të organizuara kundër tyre, për ç’gjë janë deklaruar edhe liderët politikë të tyre disa herë. Ndonëse ky rast nuk kishte lidhje me ndonjë komplot ushtarak apo politik, por thjesht me një agoni të thellë të tyren, apo siç thotë fjala e urtë popullore: “Të zuri vera në gjumin e dimrit,” duke ia shtuar kësaj metaforë e njohur “Kush e ka mizën pas veshit”.

PËRMBAJTJA

<i>Qemajl Morina</i>	
<i>Përkujtimi i Salahudin El-Ejubit (1138-1193).....</i>	5
<i>Nexhat Ibrahim</i>	
<i>Harixhitët dhe Murxhitët – sekte të hershme Islame.....</i>	11
<i>Burimet e të Drejtës së Sheriatit</i>	27
<i>Abdullah Nasih Ulvan</i>	
<i>Liria e besimit në Ligjin Islam.....</i>	41
<i>Angela Milo & Hajjah Liza Abdullah</i>	
<i>Zbatimi i Kur'anit në jetën tonë të përditshme</i>	71
<i>Mr. Aliriza Selmani</i>	
<i>BI e Gjilanit gjatë Luftës së Dytë Botërore</i>	77
<i>Dr. Hasan Kaleshi</i>	
<i>Veziri i madh Koxha Sinan Pasha – përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij.....</i>	95
<i>Mehmed Mujezinoviq</i>	
<i>Dorëshkrimet e xhamisë së Mehmet Pashës në Prizren</i>	145
<i>Ramadan Shkodra</i>	
<i>Xhamia “Sulltan Mehmed-Fatih” (Xhamia e Madhe) (1460/61) në Prishtinë- vepër madhështore e trashëgimisë Islame në Ballkan.....</i>	171
<i>Të rimenduarit e Islamit: perspektiva e diasporës britanike</i>	189
<i>Emine Vezaj</i>	
<i>Trajtimi i femrës në Islam.....</i>	201
<i>Intervistë me ish-diplomatin gjerman, prof. dr.Murad Hofman</i>	
<i>Myslimanët janë vetëpërgjegjës për imazhin e keq të Islamit në botën perëndimore!!</i>	223

Ebu Sa'd el-Malini

Disa fjalë rreth historikut të sufizmit dhe zhvillimit të tij

Dr. Pajazit Nushi

Vështrim i botimit shqip të librit “A culture of peaceful coexistence” – “Kultura e bashkëjetesës”

Akademik Jashar Rexhepagiqi

Leksikoni i nocioneve të Islamit - Vepër e shkëlqyeshme, me disa vërejtje e sugjerime.....

Dr. Feti Mehdiu

Shpjegimi i kuptimeve të Kur'anit të lartë në gjuhën shqipe.....

Shevki Voca

Libri që shkaktoi përçarje në mesin e akademikëve serbë.....

Përmbajtja

291